

PËRMBAJTJA

VENDIME ME OBJEKT – MARRËVESHJE TË NDALUARA

Nr. 675, Datë 07.02.2020	1
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës”	
Nr. 679, Datë 14.02.2020	3
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”	
Nr. 680, Datë 14.02.2020	5
“Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”	
Nr. 684, Datë 18.03.2020	9
“Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”	
Nr. 685, Datë 18.03.2020	11
“Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”	
Nr. 689, Datë 24.04.2020	13
“Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”	
Nr. 700, Datë 24.07.2020	21
“Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrimeve dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU”	
Nr. 703, Datë 06.08.2020	29
“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom”	
Nr. 708, Datë 23.09.2020	39
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”	
Nr. 712, Datë 08.10.2020	41
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka”	
Nr. 716, Datë 15.10.2020	45
“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK,	

“Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch – Farma” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”

Nr. 717, Datë 15.10.2020 51

“Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””

Nr. 723, Datë 17.11.2020 57

“Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”

Nr. 725, Datë 19.11.2020 67

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””

Nr. 726, Datë 19.11.2020 69

“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “IMI – FARMA” SHPK”

Nr. 727, Datë 19.11.2020 71

“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MEDICAMENTA” SHPK”

Nr. 728, Datë 19.11.2020 73

“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MINI INVEST” SHPK”

Nr. 729, Datë 19.11.2020 75

“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MSE” SHPK”

Nr. 730, Datë 19.11.2020	77
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “TRESI FARM” SHPK”	
Nr. 731, Datë 19.11.2020	79
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “DIAL-ALB” SHPK”	
Nr. 732, Datë 19.11.2020	81
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “LEKLI” SHPK”	
Nr. 733, Datë 19.11.2020	83
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “INTERMED” SHPK”	
Nr. 734, Datë 19.11.2020	85
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “SIROL 2008” SHPK”	
Nr. 735, Datë 19.11.2020	87
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “AQUILA GROUP” SHPK”	
Nr. 736, Datë 19.11.2020	91
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “EVITA” SHPK”	
Nr. 737, Datë 19.11.2020	93
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “DELTA MED” SHPK”	
Nr. 738, Datë 19.11.2020	97
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MONTAL” SHPK”	
Nr. 739, Datë 19.11.2020	99
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “INCOMED” SHPK”	
Nr. 740, Datë 19.11.2020	103
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “O.E.S DISTRIMED” SHPK”	
Nr. 741, Datë 19.11.2020	105
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “PHARMAONE” SHPK”	
Nr. 742, Datë 19.11.2020	107
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “ALFARMAKOS” SHPK”	

Nr. 743, Datë 19.11.2020	109
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “TRIMED” SHPK”	
Nr. 744, Datë 19.11.2020	113
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MEGAPHARMA” SHPK”	
Nr. 745, Datë 19.11.2020	117
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FARMA NET ALBANIA” SHPK”	
Nr. 746, Datë 19.11.2020	121
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FLORIFARMA” SHPK”	
Nr. 747, Datë 19.11.2020	125
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “CFO PHARMA” SHPK”	
Nr. 748, Datë 19.11.2020	129
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “DELTA PHARMA - AL” SHPK”	
Nr. 749, Datë 19.11.2020	133
“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FUFARMA” SHA”	
Nr. 751, Datë 26.11.2020	135
“Për vlerësimin ligjor mbi përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret e “Marrëveshjes së bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta””	
Nr. 752, Datë 03.12.2020	139
“Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””	
VENDIME ME OBJEKT - ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE	
Nr. 674, Datë 23.01.2020	141
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjiellës Kanalizime Roskovec” SHA”	
Nr. 693, Datë 14.05.2020	145
“Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve”	

Nr. 696, Datë 11.06.2020	157
“Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA për abuzim me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës” dhe dhënien e një rekomandimi MIE dhe MFE”	
Nr. 698, Datë 20.07.2020	165
“Për disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në lidhje me licensimin e Postës Shqiptare për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime”	
Nr. 699, Datë 20.07.2020	169
“Për disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në lidhje me licensimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime”	
Nr. 702, Datë 30.07.2020	173
“Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN”	
Nr. 704, Datë 10.09.2020	183
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Pogradec” SHA”	
Nr. 706, Datë 10.09.2020	187
“Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL-të publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL private”	
Nr. 707, Datë 23.09.2020	199
“Për hapjen e Hetimit Paraprak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”	
Nr. 710, Datë 08.10.2020	201
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Peqin” SHA”	
Nr. 711, Datë 08.10.2020	205
“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim- shkarkim, import, depozitim, shitje me shumicë të GLN”	
Nr. 715, Datë 15.10.2020	209
“Për marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes “MEGAPHARMA” SHPK në tregun e tregimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore”	
Nr. 719, Datë 28.10.2020	211
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”	

Nr. 720, Datë 12.11.2020	215
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Fier” SHA”	
Nr. 753, Datë 03.12.2020	219
“Për dhënien e disa rekomandimeve Agjencisë së Prokurimeve Publike mbi zbatimin e kuadrit ligjor”	
Nr. 754, Datë 09.12.2020	221
“Për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e Hetimit Paraprak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore””	

VENDIME ME OBJEKT – PËRQENDRIME

Nr. 673, Datë 23.01.2020	223
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.”	
Nr. 676, Datë 07.02.2020	225
“Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”	
Nr. 681, Datë 05.03.2020	233
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë RBM Assicurazione Salute S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.”	
Nr. 682, Datë 05.03.2020	235
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Dasof doo. nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.”	
Nr. 686, Datë 06.04.2020	237
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 5% të aksioneve të shoqërisë Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA nga shoqëria Banka Credins SHA”	
Nr. 687, Datë 06.04.2020	241
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmbH dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft”	
Nr. 690, Datë 28.04.2020	245
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë Peugeot SA. dhe shoqërisë Fiat Chrysler Automobiles N.V.”	
Nr. 691, Datë 06.05.2020	249
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Unione di Banche Italiane S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.”	

- Nr. 692, Datë 06.05.2020** 253
 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Air Liquide CZ, s.r.o dhe Air Liquide Slovakia, s.r.o nga shoqëritë Messer Technogas s.r.o dhe Messer Tatragas, spol.s.r.”
- Nr. 695, Datë 15.05.2020** 257
 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota Joint-Venture nga shoqëritë Saudi Aramco Development Company dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes)”
- Nr. 705, Datë 10.09.2020** 261
 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Euroconsult Rental Division S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.”
- Nr. 713, Datë 15.10.2020** 265
 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.”
- Nr. 721, Datë 12.11.2020** 267
 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG”
- Nr. 722, Datë 12.11.2020** 271
 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Solar Century Holdings Limited nga shoqëria Statkraft European Wind And Solar Holding AS.”
- Nr. 724, Datë 19.11.2020** 273
 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Hans Müller HMP Medizintechnik GmbH dhe shoqërisë Hans Müller medizinische und technische Gase GmbH nga shoqëria Messer Medical Home Care Holding GmbH”
- Nr. 750, Datë 26.11.2020** 277
 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Reyl & Cie SA nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.”
- Nr. 755, Datë 09.12.2020** 281
 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK nga Kastrati Group SHA”
- Nr. 756, Datë 16.12.2020** 285
 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët Joint-Venture me funksione të plota nga shoqëria Daimler Truck AG dhe shoqëria Aktiebolaget Volvo”

Nr. 758, Datë 28.12.2020	289
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK”	

Nr. 759, Datë 30.12.2020	293
“Mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”	

VENDIME TË TJERA

Nr. 677, Datë 13.02.2020	297
“Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020”	

Nr. 688, Datë 06.04.2020	299
“Për shtyrjen e afateve të gjitha procedurave hetimore në proces nga Autoriteti i Konkurrencës”	

Nr. 701, Datë 30.07.2020	301
“Për mos klasifikimin si përqendrim të transferimit të veprimtarisë ekonomike të degëve të shoqërive HIPPO Markets tek shoqëria SPAR Albania Shpk”	

Nr. 709, Datë 23.09.2020	305
“Për mos klasifikimin si përqendrim të transferimit të kuotave të shoqërisë Tranzit SHPK nga shoqëria “NCH Balkan Fund, L.P” dhe “New Century Holdings XI, L.P” tek Z.Andi Ballta”	

Nr. 714, Datë 15.10.2020	309
“Për mos klasifikimin si përqendrim të transaksionit lidhur me ndryshimin e strukturës së tërthortë të pronësisë së shoqërisë One Telecommunications SHA”	

Nr. 757, Datë 16.12.2020	313
“Mbi miratimin e Strategjisë së Advokacisë të Konkurrencës”	

AKTE TË MIRATUARA NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PKIE - 2020

Nr. 678, Datë 13.02.2020	315
“Mbi miratimin e Udhëzimit “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar””	

Nr. 683, Datë 18.03.2020	317
“Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike””	

Nr. 694, Datë 15.05.2020	319
“Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi konfidencialitetin dhe aksesin në dosje””	

AKTE TË TJERA TË MIRATUARA NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 9121/2003 “PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS”, I NDRYSHUAR

Nr. 697, Datë 30.06.2020..... 321

“Mbi miratimin e Udhëzuesit “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”

VENDIME ME OBJEKT – MARRËVESHJE TË NDALUARA

VENDIM

Nr. 675, Datë 07.02.2020

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.02.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës.

Baza ligjore: Nenet 24 shkronja (d), 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të importit dhe tregtimit të GLN-së për automjete dhe përdorim familjar”,

VËREN SE:

Nisur nga disa shqetësime në median e shkruar mbi rritjen e çmimit të shitjes së GLN për përdorim familjar dhe automjete, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe 29/1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, vendosi të realizojë një monitorim në këtë treg në lidhje me çmimin e shitjes së produktit GLN.

Nga monitorimi në terren në pikat e tregtimit me pakicë të GLN-së, u vërejt një rritje e njëkohshme e çmimit të GLN-së, duke filluar nga data 14 janar 2020, si pasojë e luhatjes në bursë dhe rritjes së çmimit të importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së. Kjo rritje vërtetohet edhe nga kuponat tatimor të shitjes së produktit GLN përpara dhe pas rritjes së çmimit.

Gjithashtu nga të dhënat e administruara nga DPD, në lidhje me importet e realizuara nga ndërmarrjet në tregun e brendshëm, vërehet se tregu i importit dhe shitjes me shumicë është një treg shumë i përqendruar. Indeksi i përqendrimit HHI paraqitet në nivelin 2828 duke qenë në nivelet e një tregu me përqendrim të lartë.

Nga treguesi CR3, konstatohet se 3 nga ndërmarrjet me pjesë më të madhe tregu zotërojnë rreth 91% të tregut, pra kanë një fuqi të madhe tregu. Ky tregues, përgjithësisht përfshin të gjithë tregun e importit të GLN duke na dhënë një pamje të qartë të ndërmarrjeve të cilët kanë fuqi në këtë treg.

Sa më sipër, referuar strukturës shumë të përqendruar të tregut dhe rritjes së njëkohshme të çmimit të shitjes së GLN nga ndërmarrjet në treg, rezulton se në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së ka shenja të arsyeshme të një sjellje të mundshme antikonkurrese të ndërmarrjeve që operojnë në këto tregje, sjellje e cila mund të çojë në shkelje të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në “Tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës”, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janari 2019 deri në 31 janar 2020.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 679, Datë 14.02.2020

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.02.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

Baza ligjore: Nenet 24 shkronja (d), 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut me pakicë të shërbimeve celulare”,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja Albtelecom me shkresën nr. 453/6 prot., datë 20.01.2020 dhe ndërmarrja Telekom Albania me shkresat me nr. 150/14 prot., datë 29.01.2020 dhe nr. 84 prot., datë 10.02.2020 kanë njoftuar Autoritetin e Konkurrencës mbi ndryshimet në çmim dhe përmbajtje të paketave të ofruara për programet me parapagesë (dhe ato me kontratë për individë, Telekom Albania).

Lidhur me ndryshimet e paketave celulare 30 ditore me parapagesë, pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë paraqitur edhe dy ankesa nga konsumatorë të telefonisë celulare, si dhe nëpërmjet shkresës nr. 91 prot, datë 13.02.2020, është paraqitur një ankesë nga Qendra “Konsumatori Shqiptar” nëpërmjet së cilës pretendohet se kompanitë celulare kanë rritur çmimet në mënyrë të pajustificuar, pa informuar konsumatorët e telefonisë celulare dhe në dëm të interesave ekonomike të këtyre konsumatorëve.

Bazuar sa më sipër si dhe nisur nga shqetësimet në masmedia mbi rritjen e çmimit të paketave celulare 30 ditore me parapagesë me 200 lekë, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, vendosi të realizojë një monitorim në këtë treg në lidhje me çmimin e paketave mujore që hidhen në treg nga operatorët celular Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom.

Nga monitorimi në terren pranë pikave të Vodafone Albania, Albtelecom dhe Telekom Albania, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i shkresave dhe ankesave të paraqitura, u konstatua se të tre operatorët celularë kanë hedhur në treg paketat e reja standarde 30 ditore me parapagesë me një rritje në çmim prej 200 lekësh, si dhe kanë rritur vlerën minimale për rimbushjeje me 100 leke, nga 100 në 200 lekë, në periudhën kohore 30 Janar – 11 shkurt 2020, sjellje e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në “Tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
 - II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Nëntor 2019 deri në 31 Mars 2020.
 - III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja e këtij vendimi.
 - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 680, Datë 14.02.2020

“Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.02.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Marrja e masës së përkohshme në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

Baza ligjore: Neni 4, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 44 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi kufizimet e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja Albtelecom me shkresën nr. 453/6 prot., datë 20.01.2020 dhe ndërmarrja Telekom Albania me shkresat me nr. 150/14 prot., datë 29.01.2020 dhe nr. 84 prot., datë 10.02.2020 kanë njoftuar Autoritetin e Konkurrencës mbi ndryshimet në çmim dhe përmbajtje të paketave të ofruara për programet me parapagesë (dhe ato me kontratë për individë, Telekom Albania).

Lidhur me ndryshimet e paketave celulare 30 ditore me parapagesë, pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë paraqitur edhe dy ankesa nga konsumatorë të telefonisë celulare, si dhe nëpërmjet shkresës nr. 91 prot, datë 13.02.2020, është paraqitur një ankesë nga Qendra “Konsumatori Shqiptar” nëpërmjet së cilës pretendohet se kompanitë celulare kanë rritur çmimet në mënyrë të pajustificuar, pa informuar konsumatorët e telefonisë celulare dhe në dëm të interesave ekonomike të këtyre konsumatorëve.

Bazuar sa më sipër si dhe nisur nga shqetësimet në masmedia mbi rritjen e çmimit të paketave celulare 30 ditore me parapagesë me 200 lekë, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, vendosi të realizojë një monitorim në këtë treg në lidhje me çmimin e paketave mujore që hidhen në treg nga operatorët celular Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom.

Nga monitorimi në terren pranë pikave të Vodafone Albania, Albtelecom dhe Telekom Albania, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i shkresave dhe ankesave të paraqitura, u konstatua se:

Vodafone Albania me 7 Janar 2020 ka njoftuar në faqen e saj të internetit se nga data 11 Shkurt 2020, Vodafone Albania do të ofrojë paketat e reja 30 ditore me parapagesë. Gjithashtu duke filluar nga data 11 Shkurt 2020, për Vodafone vlera e re minimale për rimbushjeje do të jetë 200 lekë.

Paketat që ofron Vodafone në treg për abonentët me parapagesë janë paketa standarde me minuta, SMS dhe MB: Vodafone Z, Vodafone Silver, Vodafone Talk Vodafone Combo dhe Vodafone Gold. Po ashtu Vodafone ofron edhe tre paketa të tjera me njësi të cilat shërbejnë si minuta, SMS dhe MB: YouMix S, YouMix M dhe YouMix L.

Secila prej paketave rriten me 200 lekë, por ndryshime ka edhe në njësitë që përfitohen. Konkretisht paketa Vodafone Talk mbetet e pandryshuar, ndërsa paketat Combo, Z, Silver dhe Gold do të pësojnë rritje të njërive MB me 0.5 për paketën Combo dhe 1GB për katër paketat e tjera. Gjithashtu paketa Gold pëson një rritje me 40 minuta ndërkombëtare.

Albtelecom me shkresën nr. 460 prot., datë 17.01.2020 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës nr. 453/6 prot., datë 20.01.2020) si dhe në faqen e saj të internetit, ka njoftuar se të gjithë abonentët e tij të telefonisë së lëvizshme, duke filluar nga data 30 janar 2020 do të ofrojë pesë paketa të reja 30 ditore për pajtimtarët me parapagesë. Gjithashtu, Albtelecom njofton se duke filluar nga data 30 janar 2020, vlera minimale e rimbushjeve do të jete 200 Lekë.

Nga krahasimi i paketave ekzistuese para këtij ndryshimi me paketat e reja vihet re një rritje në çmim me 200 lekë, si dhe një rritje e vlerës minimale të rimbushjes me 100 lekë (nga 100 në 200). Paketat e reja që ofron Albtelecom janë paketat Super 900 lekë, Super 1300 lekë, Super 1500 lekë, Gigastike 1500 dhe Super 2100 lekë.

Sipas njoftimit të Albtelecom, në paketën Super 900 sasia e minutave, MB dhe SMS mbetet e pandryshuar. Paketa Super 1100 lekë që tani kushton Super 1300 lekë përmban 0,5 GB më shumë internet, Paketa Super 1500 përmban 1GB më tepër, Paketa Gigastike përmban 200 minuta kombëtare si dhe 1 GB më tepër; dhe Paketa Super 2100 e re ka 60 minuta ndërkombëtare plus dhe 2 GB më tepër.

Telekom Albania me shkresat nr. 432 prot., datë 27.01.2020 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës nr. 150/14 prot., datë 29.01.2020) dhe nr. 742 prot., datë 06.02.2020 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës nr. 84 prot., datë 10.02.2020), si dhe në faqen e saj të internetit, ka njoftuar se duke filluar nga data 5 Shkurt 2020 do të ofrojë paketat e reja standarde 30 ditore me parapagesë: Paketa S/M/L/XL/Electronic Beats/FIT 4000/FIT 7000. Gjithashtu Telekom njofton klientët me parapagesë, se duke filluar nga data 5 Shkurt 2020, vlera minimale për një transaksion rimbushjeje do të jetë 200 lekë.

Konkretisht paketat e reja të ofruara janë: Paketa Simple 1000 lekë; Beats Xtreme 1600 leke; Paketa Optimal 1400 lekë; Paketa Full 1600; Paketa Premium 2200 lekë; FIT 4000- 1400 lekë; FIT 7000- 1600 lekë. Nga krahasimi i këtyre paketave të reja me ato të vjetra vihet re një rritje prej 200 lekësh në çmim për të gjitha paketat. Paketa Optimal dhe Full kanë një rritje me 1 GB; Paketa Full një rritje me 1 GB dhe 200 minuta drejt rrjeteve fix; Paketa Premium një rritje me 2 GB, 40 minuta ndërkombëtare plus, 500 min plus drejt rrjeteve fix.

Vihet re që të tre operatorët celularë kanë hedhur në treg paketat e reja standarde 30 ditore me parapagesë me një rritje në çmim prej 200 lekësh, si dhe kanë rritur vlerën minimale për rimbushjeje me 100 leke, nga 100 në 200 lekë, në periudhën kohore 30 Janar – 11 shkurt 2020, sjellje e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.

Si përfundim, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, referuar sjelljes së ndërmarrjeve Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, vlerësojmë se jemi përpara një rasti urgjence për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4, pika 2, gërma (a) të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

I. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:

a) Ndërprerjen e menjëhershme dhe jo me vonë se 5 ditë nga njoftimi i këtij vendimi, të aplikimit të paketave të reja standarde 30 ditore me parapagesë, për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom

II. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.

III. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 9121/2003.

IV. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës vendos gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore, deri sa ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom të veprojnë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme, në zbatim të nenit 76, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 9121/2003.

V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 684, Datë 18.03.2020

“Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.03.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi monitorimin e tregut të shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore.

Baza ligjore: Neni 4, Neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 44 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin e tregut të shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore,

VËREN SE:

Nisur nga disa shqetësime në masmedia dhe ankesave të paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi rritjen e çmimit të materialeve paramjekësore, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, realizoi një monitorim në këtë treg, i cili konsistoi në vlerësimin e sjelljes së ofruesve të këtyre materialeve në të gjitha nivelet e tregtimit (shumicë dhe pakicë).

Monitorimi u fokusua në tregtimin e materialeve dezinfektant duarsh, alkool dhe maska, për të cilat kërkesa konsumatore ka qenë në rritje si pasojë e situatës së krijuar nga virusi COVID-19.

Nga verifikimi në terren konstatohet se:

- tregu ka mungesë të materialeve në nivelin e tregtisë me pakicë (rrjeti farmaceutik),
- rritje e pajustificueshme e çmimit në të gjitha nivelet e tregtimit të këtyre materialeve (depo farmaceutike dhe rrjeti i farmacive).

Nga sa më sipër, ka shenja të arsyeshme të një sjellje të mundshme antikonkurruese të ndërmarrjeve që operojnë në këto nivele tregtimi, e parashikuar në nenin 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore.
 2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020.
 3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga përfundimi i periudhës hetimore.
 4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 685, Datë 18.03.2020

“Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.03.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi monitorimin e tregut të shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore.

Baza ligjore: Neni 4, Neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 44 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin e tregut të shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore,

VËREN SE:

Nisur nga disa shqetësime në masmedia dhe ankesave të paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi rritjen e çmimit të materialeve paramjekësore, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, realizoi një monitorim në këtë treg, i cili konsistoi në vlerësimin e sjelljes së ofruesve të këtyre materialeve në të gjitha nivelet e tregtimit (shumicë dhe pakicë).

Monitorimi u fokusua në tregtimin e materialeve dezinfektant duarsh, alkool dhe maska, për të cilat kërkesa konsumatore ka qenë në rritje si pasojë e situatës së krijuar nga virusi COVID-19.

Nga verifikimi në terren konstatohen se:

- tregu ka mungesë të materialeve në nivelin e tregtisë me pakicë (rrjeti farmaceutik),
- rritje e pajustificueshme e çmimit në të gjitha nivelet e tregtimit të këtyre materialeve (depo farmaceutike dhe rrjeti i farmacive).

Në kushtet e emergjencës shëndetësore, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore (dezinfektant, alkool dhe maska), pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të këtij ligji, për shkak të rritjes së pajustificueshme të çmimit të tregtimit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 44 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:

- a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
- b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
- c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.

2. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.

3. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 9121/2003.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 689, Datë 24.04.2020

“Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.04.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil.

Baza ligjore: Neni 4, neni 5, neni 6, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003), ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil” ka vendosur:
 - a. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.
 - b. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
 - i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;
 - ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregton dhe bar kodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
 - c. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
 - d. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.

2. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 623, datë 23.05.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të vendimit nr. 499, datë 15.02.2018 të Komisionit të Konkurrencës për kartonin jeshil” ka vendosur:
 - a. Monitorimin në vazhdimësi të tregut të sigurimeve për shitjen dhe administrimit të kartonit jeshil, në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil” deri në përfundim të marrëveshjes së përjashtuar me kushte dhe detyrime të vendosura deri më 15.02.2020.
 - b. Detyrimin e AMF për të parashtruar pranë Autoritetit të Konkurrencës, çdo rast që pengon, kufizon, apo shtrembëron konkurrencën, në lidhje me tregun e shitjes së policës - kartoni jeshil.
3. AK ka monitoruar tregun e sigurimeve për produktin kartoni jeshil në zbatim të VKK nr. 623, datë 23.05.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit VKK nr. 499, datë 15.02.2018 për kartonin jeshil”.
4. Për realizimin e këtij monitorimi, deri në përfundim të marrëveshjes së përjashtuar me kushte dhe detyrime të vendosura deri më 15.02.2020, është konstatuar se gjatë kësaj periudhe, shoqëritë e sigurimit kanë zbatuar të gjitha kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në VKK nr. 499, datë 15.02.2018, si dhe ky vendim ka pasur një sërë efektesh pozitive mbi tregun në përgjithësi dhe konsumatorët në veçanti. Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur rritje të çmimit të kartonit jeshil nga siguresit, po ashtu as rritje të çmimit të rriskut, i cili miratohet nga AMF. Për eliminimin e policave fallco, tashmë policia e sigurimit karton jeshil, është e vetmja policë sigurimi që printohet me QR Code.
5. AK ka bashkëpunuar me AMF, BSHS dhe ndërmarrjet e sigurimit, duke kërkuar informacion për zbatimin e këtij vendimi dhe rritjen e konkurrencës në këtë sektor, për të gjithë periudhën e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes.
6. Byroja Shqiptare e Sigurimit, duke qene në përfundim të afatit të parashikuar në VKK nr. 499, datë 15.02.2018, me shkresën nr. 45 prot., datë 22.01.2020 “Mbi përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes”, ka kërkuar në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil, deri në vitin 2023.

II. Palët në marrëveshje

7. Palët në marrëveshje janë të gjitha shoqëritë e sigurimit të cilat e ofrojnë produktin e kartonit jeshil të sigurimit të mjeteve motorike.

III. Përshkrimi i marrëveshjes

8. Objekt i kësaj marrëveshje është vendosja e një marrëdhënie bashkëpunimi mes shoqërive të sigurimit në tregun e sigurimeve të detyrueshme të mjeteve motorike të Kartonit Jeshil, lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil me qëllim kryesor përmirësimin dhe rritjen e garancisë.
9. Sipas BSHS, marrëveshja lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil është në përputhje me Rregulloren “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve të vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”, e cila parashikon përjashtimin nga ndalimi të disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve, të cilat kanë për objekt bashkëpunimin në lidhje me:
 - i. Vendosjen e tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve;
 - ii. Vendosjen e kushteve të policave standarde të përbashkëta për eliminimin e policave false dhe vendosjen e sistemit të kodit unikal-bar kod dhe njoftimin në kohë reale në sistemin e informacionit të

AMF-së të çdo police të kartonit jeshil;

- iii. Shlyerja e dëmeve (parashikohet rritja e pagesës së dëmeve dhe marrja përsipër nga shoqëritë e sigurimit të pagesës së dëmeve duke shmangur policat false, të cilat ekspozonin qytetarët që kanë marrë këtë produkt para përgjegjësive penale dhe financiare për dëmet e shkaktuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me mjetet e tyre motorike);
- iv. Testimi dhe pranimi i pajisjeve të sigurisë (sistemi i kodit unikal dhe verifikimi nëpërmjet pajisjeve të sigurisë në pikat e kalimit kufitar për verifikimin e bar-kodit unikal që vlerëson nëse policat e sigurimit të kartonit jeshil është e vlefshme dhe është sipas klasës së mjetit motorik).

10. Qëllimi i marrëveshjes është:

- i. Shitja e policave të kartonit jeshil nëpërmjet një numri të autorizuar operatorësh në pikat e kalimit kufitar dhe degët qendrore të shoqërive të sigurimit;
- ii. Procesi i shitjes të realizohet me anë të shoqërisë së brokerimit të autorizuar nga Byroja, e cila ka stafin teknik, sistemin e shitjes online në kohë reale që mundëson gjenerimin e Kodit Unikal (Nr. serial – bar kod) dhe broker fizik të licencuar.
- iii. Të rrisë garancinë dhe sigurinë e këtij shërbimi në përputhje me standardet COB (Këshillit të Byrove), shmangien e kolapsit për përjashtimin e BSHS nga Sistemi Ndërkombëtar i Kartonit Jeshil;
- iv. Rritjen e garancisë së drejtuesve të mjeteve, të cilët përdorin automjete përtej kufirit të RSH, të cilët duhet të jenë të siguruar kur hyjnë në vende ku një sigurim i tillë është i detyrueshëm;
- v. BSHS të hiqet nga statusi i monitorimit nën të cilin e ka vënë COB, (i cili është me afat jo më pak se pesë vjet) dhe të mos lejojë përjashtimin e tij nga COB.
- vi. Forcimin e sigurisë financiare të ofertuesve të këtij sigurimi.

11. Sipas BSHS kjo marrëveshje ka efekte vetëm për produktin Karton Jeshil, i cili zë një pjesë të vogël të totalit të tregut të sigurimeve dhe i shtrin efektet në zonën gjeografike të territorit të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja nuk kufizon lirinë tregtare dhe lirinë konsumatore për të përzgjedhur produktin dhe shoqërinë sipas kërkesës së tij.

IV. Tregu Përkatës

a. Tregu përkatës i produktit

12. Kartoni Jeshil mbulon përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit motorik, ndaj dëmeve që u shkakton palëve të treta, në përputhje me parashikimin e Ligjit të një prej shteteve anëtare të Këshillit të Byrove, ku ka ndodhur rasti në sigurim. “Kartoni jeshil” është certifikata ndërkombëtare e sigurimit, e cila rregullon marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet zyrave kombëtare të vendeve anëtare të sistemit të kartonit jeshil. Drejtuesi i mjetit motorik, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me një mjet, me regjistrim të huaj, duhet të jetë i pajisur me: a) karton jeshil, të vlefshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) dokument tjetër të vlefshëm, që vërteton ekzistencën e sigurimit të përgjegjësive ndaj palëve të treta, në ato raste kur ka një marrëveshje të veçantë dypalëshe, për mjetet me targë regjistrimi të shtetit tjetër, nënshkruar të kësaj marrëveshjeje.
13. Kjo policë lëshohet në territorin e Shqipërisë vetëm për automjetet me targa shqiptare dhe vepron jashtë territorit të Shqipërisë. Për njohjen e vlefshmërisë së dokumenteve ndërkombëtare të sigurimit, byroja njofton paraprakisht, autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar. Autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar janë të detyruara të kontrollojnë përmbushjen e kërkesave, të parashikuara në ligj.

b. Tregu përkatës gjeografik

14. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Meqenëse produkti (shërbimi) ofrohet në të gjitha pikat e licencuara për tregtimin e Kartonit Jeshil atëherë si treg gjeografik do të jetë territori i Republikës së Shqipërisë.

V. Analiza e konkurrencës

15. Tregjet e sigurimeve në përgjithësi dhe Kartonit Jeshil në veçanti janë të rregulluar dhe të mbikëqyrur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bazë të ligjit organik nr. 10076/2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.

16. Ndër 3 konkurrentët kryesorë në treg janë: Për vitin 2017 ndërmarrjet: Sigal me 25.21%, Eurosig me 24.55% dhe Sigma me 13.59%; për vitin 2018 ndërmarrjet: Sigal me 25%, Eurosig me 24.02%, dhe Sigma me 12.5%; për vitin 2019 ndërmarrjet: Sigal me 24.99%, Eurosig me 24.0% dhe Sigma me 12.51%.

17. Sipas renditjes në vite ndërmarrja Sigal radhitet e para (2017-2019) me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut gjatë gjithë periudhës, ndërmarrja Eurosig renditet e dyta (2017-2019) me rënie të vazhdueshme të pjesëve të tregut, ndërmarrja Sigma gjithashtu me zvogëlim të pjesëve të tregut, edhe se në vitin 2019 ka një rritje të lehtë prej 0.01%.

18. Nga vlerësimi i indeksit HHI për periudhën 2017-2019, ndërmarrjet ndonëse kanë ulur lehtësisht shkallën e përqendrimit (HHI në vitin 2017 është 1779.94, në vitin 2018 është 1747.15 dhe në vitin 2019 është 1746.76) duke kaluar nga një treg me një shkallë të lartë përqendrimi në një treg më përqendrim të moderuar, por duke ngelur në nivelin e sipërm të këtij të fundit. Kartoni Jeshil zë një peshë specifike 13.96% në totalin e tregut të sigurimeve të mjeteve motorike.

VI. Arsytet e përjashtimit nga ndalimi

19. Sektori i sigurimeve është një nga sektorët e tregut financiar ku marrëveshjet mes operatorëve për qëllime të mbulimit të riskut të përbashkët dhe standardizimit të produkteve mund të përfitojnë nga përjashtimi nga ndalimi sipas parashikimeve të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”.

20. Duke qenë në përfundim të afatit të parashikuar në VKK nr. 499, datë 15.02.2018, BSHS ka kërkuar në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil, deri në vitin 2023.

21. Sipas BSHS gjatë kësaj periudhe, shoqëritë e sigurimit, anëtare të BSHS, kanë zbatuar kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në pikën 2 të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 499, datë 15.02.2018.

22. BSHS ka paraqitur konfirmimin e mbylljes me sukses për Risigurimin e kartonit jeshil për vitin 2018-2019 dhe konfirmimin e mbylljes me sukses për Risigurimin e kartonit jeshil për vitin 2019-2020.

23. Në shkresën, dërguar nga BSHS në datën 12.06.2019 në vëmendje të Këshillit të Byrove me objekt daljen nga Statusi i Monitorimit është përcjellë informacioni se duke marrë parasysh treguesit e mirë të performancës së Byrosë Shqiptare të Sigurimit si më poshtë vijon:

a) Byroja Shqiptare e Sigurimeve për më shumë se tre (3) vjet nuk ka raportuar asnjë Thirrje për Garanci të Sistemit online të Këshillit të Byrosë të marrë nga zyrat Homologe të byrosë.

- b) Byroja Shqiptare e Sigurimeve Shqiptare ka përfunduar me sukses Marrëveshjen e Risigurimit dhe pagesën e primit të risigurimit çdo vit në përputhje me rekomandimet vjetore (1-10) të lëshuara çdo vit nga Këshilli i Byrove për Byrotë me status monitorimi.
- c) Byroja Shqiptare e Sigurimeve ka përfunduar me sukses brenda afateve ligjore, duke depozituar Garancinë në favor të Kartanit jeshil, në përputhje me rekomandimet e Këshillit të Byrove, për shumat e përcaktuara në vlerën 2,750,00 EUR, e cila ka përmbushur kriteret e garancisë financiar të Këshillit të Byrosë, përkatësisht të nenit 3.1.1.2 (*Standart dhe Poor*), përkatësisht me vlerësimin A ose më të lartë.
- d) Byroja Shqiptare e Sigurimeve, ka proceduar brenda afateve me pagimin e kontributeve vjetore të financimit në buxhetin e Këshillit të Byrosë, në përputhje me Rregulloret e Brendshme dhe nenin 13.4 të Kushtetutës së Këshillit të Byrove.
- e) Shitja e Certifikatës Ndërkombëtare të Kartanit jeshil, tashmë për më shumë se pesë (5) vjet, është e centralizuar dhe çmimi është i pandryshuar, kjo tarifë është aprovuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- f) Byroja Shqiptare e Sigurimeve, pati një bashkëpunim shumë të mirë me Zyrat e saj homologe, duke komunikuar dhe asistuar në çdo kërkesë që vinte nga byrotë fqinje dhe më gjerë.
- g) Në lidhje me procesin e tenderimit të marrëveshjeve të risigurimit, Byroja Shqiptare e Sigurimeve ka proceduar çdo vit në përputhje me dispozitat ligjore në Shqipëri, përkatësisht me nenet 3/12, 4, 31, 33 dhe në vijim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
- h) Mbi detyrimet e pagesës për Fondin e Kompensimit, nga viti 2018 e deri më tani, Byroja Shqiptare e Sigurimeve, ka paguar detyrime të prapambetura në vlerë prej rreth 1,200,000 EUR, duke paguar kështu jo vetëm detyrimet që ngarkojnë ligjin, por vërteton edhe stabilitetin që sot ofron tregu i sigurimeve në Shqipëri.
- i) Tashmë, nga 1 Prilli 2019 e tutje, Byroja Shqiptare e Sigurimeve, në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrës Financiare, ka miratuar Udhëzimin nr. 63, datë 27.03.2019 "Mbi zbatimin e sistemit Bonus-Malus në sigurimin MTPL e brendshme", tashmë duke marrë pjesë në veprimtarinë e saj, një metodologji dhe praktikë e cila ka rezultuar më e suksesshme në tregun e sigurimeve dhe që ka munguar në tregun shqiptar.

VII. Kushtet dhe detyrimet

24. Në bazë të nenit 50, pika 2 e ligjit nr. 9121/2003, vlerësojmë që kjo marrëveshje të jepet me kushte dhe detyrime me qëllim që të ketë konkurrencë të mjaftueshme në tregun përkatës dhe marrëveshja të mos kufizojë produktin apo shitjet, të mos ndajë tregun dhe klientët të mos bien dakord për primet e shitjes, si më poshtë vijon:

- i. Afati i marrëveshjes të jetë 3 vjeçar;

Marrëveshja e njoftuar për përjashtim sipas BSHS-së parashikohet të ketë një afat vlefshmërie për një periudhë 5 vjeçare, por duke ju referuar Rregullores së Komisionit Evropian 267/2010, "Mbi aplikimin e nenit 101(3) të TFEU për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve", si dhe Rregullores "Për zbatimin e nenit 6 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ndaj disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve" përjashtimi jepet për një periudhë të kufizuar kohe tre vjeçare. Në rastin tonë, afati i përcaktuar në rregullore prej 3 (tre) vjetësh vlerësohet si periudhë e përshtatshme për këtë marrëveshje bashkëpunimi.

- ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
25. Ndryshimet e mësipërme synojnë reduktimin e mundësisë së koordinimit të sjelljes dhe kanë si qëllim të shmangin një ndarje potenciale të pjesëve të tregut mes palëve njoftuese të marrëveshjes dhe në këtë mënyrë respektohen parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 5, nenin 6, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe Rregulloren “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve të vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”,

VENDOSI:

1. Të vazhdojë përjashtimin nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil.
2. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
 - i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;
 - ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
3. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
4. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të kryen pagesat e parashikuara në rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

MENDIM PAKICE

Argumentat për votën kundër të vendimit nr. 689 datë 24.04.2020 “Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin e tij nr.499 datë 15.02.2018 miratoi përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil.

Miratimi i përjashtimit nga ndalimi ishte i lidhur me respektimin e kushteve dhe detyrimeve : (i) Afati 2 vjeçar i përjashtimit (ii) seicila nga ndërmarjet duhet të tregojë produktin duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimin e çmimit mes palëve.

Vlen të risjellim në vëmendje se argumentat për të konsideruar marrëveshjen dhe miratimi i përjashtimit nga ndalimi lidheshin me nevojën që BSHS të dilte nga statusi “negativ” dhe tregu të mund të merrte tipare dhe funksione, të një tregu funksional brenda periudhës 2 vjeçare por pa abuzuar me ndarje tregu dhe paracaktim çmimi.

Ishin këto argumenta, të cilat lejuan Komisionin që të merrte një vendim mbështetës, por kufizues kohor. Marrëveshja e arritur mes kompanive ishte për një periudhë 5-vjeçare. Miratimi nga Komisioni i Konkurrencës u bë vetëm për një periudhë 2 vjeçare.

Në Vendimin nr.499 datë 15.02.2018 ne nuk kemi lënë ndonjë hapësirë për rishikimin e periudhës së përjashtimit nga ndalimi, pikërisht sepse e konsideronim që vetë miratimi i përjashtimit për një periudhë 2 vjeçare, ishte kohë plotësisht e mjaftueshme për të realizuar objektivat e parashtruara nga BSHS në kërkesën e saj pranë Autoritetit të Konkurrencës.

Në Vendimin nr.499 datë 15.02.2018 është përcaktuar gjithashtu se: “Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, mbasi në pikën 3 të vendimit është përcaktuar gjithashtu se Komisioni vendos “..revokimin e përjashtimit nëse nuk respektohen kushtet dhe detyrimet”.

Në Raportin e Monitorimit të majit 2019, përkatësisht në faqen 5 në kapitullin 2 Kushtet dhe Detyrimet nënvizohet se : Pavarësisht angazhimit të palëve në marrëveshje, është vlerësuar që ajo të miratohet me kushte dhe detyrime me qëllim që të ketë konkurrencë të mjaftueshme në tregun përkatës dhe marrëveshja të mos kufizojë produktin apo shitjet, të mos ndajë tregun dhe klientët të mos bien dakord për primet e shitjes.

Deri në përfundim të periudhës së përjashtimit nga ndalimi, datë 15.02.2020 kemi vlerësim të situatës në lidhje me zbatimin e Vendimit nr.499 datë 15.02.2018 nisur nga informacionet/raportimet e BSHS, AMF dhe kompanitë pjesë e marrëveshjes për shitjen e kartonit jeshil.

Nuk është aspak profesionale dhe nuk ofron asnjë siguri për Komisionerët fakti që nga ana e Autoritetit të Konkurrencës nuk është kryer qoftë edhe një monitorim me inspektorët e saj lidhur me plotësimin e kushteve dhe detyrimeve që janë konsideruar si shumë të rëndësishme në procesin e vendimarrjes për miratimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit. Eksperiencat personale dhe jo vetëm konfirmojnë faktin që qytetari e ka pothuajse të pamundur të blejë policën e sigurimit për kartonin jeshil nga kompania që ai dëshiron, sepse radha e shitjes është e paracaktuar.

Zgjatja e afatit të miratimit të përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes me kushte dhe detyrime kthehet në një "nonsense" për sa kohë që :

- 1) Sipas të dhenave të paraqitura në faqen 14 të raportit nga vlerësimi i indeksit të HHI për periudhën 2017-2019 është kaluar nga një treg me përqëndrim të lartë në një treg me përqëndrim të moderuar, por në nivelin e sipërm të këtij të fundit.
- 2) Kartoni jeshil zë 16,96 % të tregut (dhe jo 7% siç u përgjigjën nga pyetjet me shkrim që adresova)

- 3) Kur konfirmohet se “ shitja e Çertifikatës Ndërkombëtare të Kartonit Jeshil, tashmë më shumë se 5 vjet është e çentralizuar dhe çmimi është i pandryshueshëm” faqe 17, pika 5 gërma "e" kapitulli VII.3
- 4) Ndërkohë që në faqen 19 pika 7 “palët janë të ndërgjegjësuar për zbatimin e nenit 4 dhe sdo të ketë ndarje tregu, fiksimit çmimi.
- 5) Sipas shkresës së AMF 363/17 datë 10.02.2020 rezultoi se produkti i kartonit jeshil është ndërmjetësuar gjatë vitit 2018 rreth 98 % dhe gjatë vitit 2019 rreth 99 % nga e njëjta shoqëri brokerimi.
- 6) Kur vërtetohet që gjatë dy viteve të fundit kanë ndodhur ndryshime të pakonsiderueshme (më pak se 1%) në pjesën e tregut të zotëruar nga kompanitë më kryesore.
- 7) Kur nuk ka filluar funksionimi i Bonus-Malus, dhe me informacionet e marra mbas dërgimit të projektit vendimit nuk do të fillojë të zbatohet për mangësitë e kuadrit ligjor të fushës
- 8) Kur në tregun e sigurimeve kemi disa produkte që tregtohen në kuadër të miratimit të përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjeve të miratuara nga Komisioni i Konkurrencës
- 9) Kur BSHS ka marrë vlerësime pozitive nga Këshilli i Byrove dhe janë krijuar fondet e nevojshme të garancive

E konsideroj jo të mbështetur në argumenta dhe në prova, marrjen e vendimit për të zgjatur edhe për dy vite të tjera miratimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për tregtimin e kartonit jeshil dhe për këtë arsye votoj “ Kundër”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONER

Adriana Berberi

VENDIM
Nr. 700, Datë 24.07.2020

“Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrimeve dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.07.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, dhënien e detyrimeve dhe disa rekomandimeve.

Baza ligjore: Neni 4 dhe 9, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, pika 5, neni 45 pika 1 dhe neni 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin e thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK; relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës; pretendimeve të paraqitura nga ndërmarrjet: Agro Blend SHPK me shkresën protokolluar pranë AK nr. 56/6 prot, datë 16/07/2020 “Memo Informuese”, Miell Tirana SHA me shkresën protokolluar pranë AK nr.56/8 prot. datë 17/07/2020 “Kthim përgjigje...”, Bloja SHA me shkresën protokolluar pranë AK nr.56/7 prot. datë16/07/2020 “Bashkëlidhur pretendimet me shkrim...”, Atlas SHA /Atlas Mills SHPK me shkresën protokolluar pranë AK nr. 56/5 prot. datë 13/07/2020 “ Pretendimet për raportin e hetimit...” , lidhur me “Raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi pretendimet e paraqitura nga ndërmarrjet: Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja” SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga XXX në lidhje me disa shqetësime të konkurrencës në tregun e importit dhe tregtimit të miellit në tregun e brendshëm, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës filloi procedurën e monitorimit në këtë treg, në respektim të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi vlerësimin e ankesës në tregun e tregtimit të miellit”, në mbështetje të nenit 4 dhe 9, nenit 24, shkronja d) dhe nenit 42, pika 1, të ligjit 9121/2003,

me anë të vendimit të KK nr. 551, datë 04.10.2018, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të grurit dhe të miellit”, i ndryshuar, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të grurit dhe të miellit, për periudhën kohore nga 1 janar 2017 deri në 1 prill 2019, për të vlerësuar nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

3. Në përfundim të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës arriti në përfundimin se, referuar analizës së tregut të importit dhe prodhimit të grurit dhe miellit rezultoi se mund të ketë elementë të cilat mund të përbëjnë shkelje të konkurrencës apo sjellje të bashkërenduar nga ndërmarrjet që zënë peshën kryesore në treg Agro Blend, Miell Tirana, Bloja dhe Atlas referuar nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
4. Për sa më sipër, KK, në zbatim të nenit 4 dhe 9, nenit 24 shkronja d, nenit 26 dhe nenit 43, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003, me anë të vendimit nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK”, i ndryshuar, ka vendosur hapjen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, për periudhën kohore nga 1 janar 2017 deri në 30 qershor 2019.
5. Në zbatim të vendimit të mësipërm të KK, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me Autorizimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 421/9, datë 19.09.2019 "Autorizim inspektorësh", është dhënë autorizim inspektimi për kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve nën hetim të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun objekt hetimi.
6. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, gjatë periudhës së hetimit të thelluar janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet nën hetim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
7. Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr.56/3 prot, datë 07/07/2020 “Dërgim Raporti”, ka ftuar ndërmarrjet: Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK që të paraqesin me shkrim pretendimet e tyre mbi konkluzionet e Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj këtyre ndërmarrjeve.
8. Gjithashtu KK, nëpërmjet shkresës nr. 56/4 datë 07/07/2020 “Ftesë për dhënie mendimi”, i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në lidhje me problematikën e konstatuar gjatë procedurave hetimore dhe propozimit që në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, produkti miell i importuar të ndahet sipas karakteristikave, cilësisë së produktit, destinacionit përfundimtar të përdorimit të tij dhe përqindjes proteinike.
9. MFE në përgjigjen e saj protokolluar pranë AK me shkesën nr. 56/10 prot. datë 24/07/2020 “Mbi propozimin për ndarjen e produktit mielli importuar sipas karakteristikave cilësisë dhe destinacionit të përdorimit”, shprehet se: *“Duke qenë se kriteret për ndarjen e produktit, në rastin konkret miell gruri me Kod HS 1101, i referohen karakteristikave dhe qëllimit të përdorimit të tij pas importimit, këto elementë nuk disponohen nga autoriteti doganor. Në këto kushte, është e nevojshme që paraprakisht, nga ana e ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, të sigurohet nëse dhe sesi mund të garantohet nga pikëpamja dokumentare dhe procedurale, që deklarimi i llojit të produktit miell gruri pranë autoritetit doganor të jetë konform ndarjes së përcaktuar.”*
10. Në përgjigje të kërkesës së KK, ndërmarrjet: Agro Blend SHPK me shkresën protokolluar pranë AK nr. 56/6 prot, datë 16/07/2020 “Memo Informuese”, Miell Tirana SHA me shkresën protokolluar pranë AK

nr.56/8 prot. datë 17/07/2020 “Kthim përgjigje...”, Bloja SHA me shkresën protokolluar pranë AK nr.56/7 prot. datë16/07/2020 “Bashkëlidhur pretendimet me shkrim...”, Atlas SHA /Atlas Mills SHPK me shkresën protokolluar pranë AK nr. 56/5 prot. datë 13/07/2020 “ Pretendimet për raportin e hetimit...”, kanë paraqitur pretendimet e tyre mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, pretendime të cilat, në respektim të nenit 39 të ligjit 9121/2003, janë marrë në konsideratë nga KK në marrjen e këtij vendimi.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

11. Tregu përkatës janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët, ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen, ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:

- a) Tregu përkatës i produktit
- b) Tregu përkatës gjeografik

II.1.a Tregu përkatës i produktit

12. Tregu përkatës i produktit përcaktohet si: *“Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime, të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre”*. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.

13. Bazuar në VKK nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK”, i ndryshuar, tregu përkatës i produktit përfshin:

- Tregun e importit të grurit,
- Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit.

II.1.b Tregu përkatës gjeografik

14. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.

15. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Shqipërisë. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofrimi, ***treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.***

II.2 Struktura e tregut

II.2.1 Tregu i importit dhe prodhimit të grurit

16. Nga analiza e tregut përkatës konkludohet se në Shqipëri, nevojat për grurë sigurohen nga tregu ndërkombëtar dhe nga prodhimi vendas. Përveç grurit të zakonshëm në vend importohen dhe tipe të tjera, që nuk janë objekt i këtij hetimi. Gruri i prodhuar në vend kryesisht përpunohet privatisht në mullinj të vegjël lokal dhe konsumohet nga vetë familjet e fermerëve. Importi total i grurit të zakonshëm, për vitin 2017 është 213,711 ton, për vitin 2018, 237,750 ton dhe 92,822 ton për periudhën janar-qershor 2019.

17. Ndërmarrjet importuese të grurit klasifikohen në dy kategori: importues të cilët kanë aktivitet te tyre blerjen dhe shitjen e grurit dhe importues që krahas shitjes së grurit kanë linja të përpunimit të tij duke tregtuar edhe miell. Pjesa më e madhe e fabrikave të blajës përpunojnë grurin e importit. Por kjo nuk e përjashton faktin që këto ndërmarrje të jenë aktive edhe në tregun lokal si furnitorë apo si blerës të grurit.
18. Nga analiza e strukturës dhe pjesëve të tregut të importit të grurit të zakonshëm mund të themi se struktura e integruar e 4 ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas SHA / Atlas Mills SHPK ka krijuar një qëndrueshmëri e cila vjen si rezultat i politikave të tyre për shfrytëzim të linjave të prodhimit të miellit. Gjatë vitit 2018 vihet re një ulje e pjesëve të tregut të ndërmarrjeve vetëm importuese të grurit. Kjo situatë bën që ndërmarrjet e blajës të jenë faktor i rëndësishëm në përcaktimin e ofertës së grurit në tregun e brendshëm. Respektivisht, Miell Tirana SHA XX%, Agro Blend SHPK XX%, Bloja SHA XX%, dhe Atlas Mills SHPK XX% (pa marrë në konsideratë faktin se një nga ndërmarrjet kryesore të importit të grurit të zakonshëm, Besniku SHPK zotëron 100% të pronësisë së ndërmarrjes tjetër kryesore Atlas Mills SHPK dhe se të dy ndërmarrjet kanë shpesh marrëdhënie klient – furnitor).
19. Për të gjithë periudhën hetimore burimi më i madh i furnizimit me grurë për Shqipërinë mbetet Federata Ruse me XX-XX%. Për vitin 2018 vërehet se nuk ka sasi të importuar nga Ukraina, e cila për vitin 2017 zinte rreth XX% të sasisë së importuar të grurit, por vetëm për gjashtëmuajorin e parë të 2019, nga Ukraina janë importuar më shumë sasi se në vitin 2017. Për periudhën janar – qershor 2019, duket se sasi të importuara nga Serbia janë rreth XX% e sasive të importuara më parë nga ky vend.

II.2.2 Tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit

20. Nga analiza e strukturës dhe pjesëve të tregut të importit të miellit, për ndërmarrjet nën hetim, vërehet se ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe Atlas SHA / Atlas Mills SHPK zotërojnë pjesë shumë të vogla të tregut të importit të miellit. Ndërsa ndërmarrjet Miell Tirana SHA dhe Bloja SHA nuk rezultojnë si ndërmarrje importuese të miellit. Rrjedhimisht nuk rezulton asnjë ndërmarrje të zotërojë pozitë dominuese, si dhe nuk vihet re qëndrueshmëri e pjesëve të tregut për ndërmarrjet objekt hetimi për pasojë nuk kemi shkelje të nenit 9 të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
21. Në lidhje me vendet të origjinës rezulton se vendet kryesore të importit janë vendet që lidhen me Shqipërinë me transport tokësor, kushtëzuar kjo nga fakti që burim furnizimi janë vende kufitare me vendin tonë. Gjatë viteve 2017 e 2018 të periudhës së hetimit, konstatohet se burimet kryesore të furnizimit janë Kosova dhe Serbia, ndërkohë që për 6-mujorin e parë të 2019, furnizimi nga Kosova ka rënë ndjeshëm si pasojë e ndërprerjes së kontratës për furnizim me miell i ndërmarrjes Besniku SHPK.
22. Përsa i përket pjesëve të tregut, si në tregun e importit të grurit të zakonshëm, si në tregun e importit të miellit vlerësohet se ndërmarrjet nën hetim nuk kanë qëndrueshmëri të pjesëve të tregut.
23. Nga analiza e strukturës së tregut rezulton se ndërmarrjet importuese të grurit janë edhe prodhueset më të mëdha të miellit në vend, tre nga ndërmarrjet nën hetim, Miell Tirana SHA, Agro Blend SHPK, dhe Bloja SHA, janë dhe ndërmarrjet importuese më të mëdha të grurit të zakonshëm, *triticum aestivum*. Të vepruarit në këto tregje, zotërimi i sasive të mëdha të lëndës së parë dhe i linjës prodhuese krijon kushtet e integritimit vertikal në tregun e grurit dhe të miellit. Ky integritet e modifikon strukturën e tregut sepse shton një dimension në lidhjen midis konkurrentëve. Efektet e integritimit të ndërmarrjeve çojnë në rritjen e efikasiteteve të cilat nuk do të mund të arriheshin pa integritimin vertikal dhe gjithashtu krijon mundësinë për përjashtimin e firmave jo të integruara dhe pengesave financiare të mëdha në hyrje.
24. Duke qenë se ndërmarrje operojnë në të gjithë nivelet e tregut, konkretisht në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, bëjnë që ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, të zotërojnë pjesën më të madhe në treg si rezultat i integritimit vertikal, të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin në tregun e prodhimit të miellit.

II.2.3 Barrierat ligjore dhe ekonomike

25. Në treg nuk ekzistojnë barrierat ligjore për hyrje të reja. Integrimi vertikal i ndërmarrjeve është një barrierë e fuqishme për hyrje të reja në treg, dhe sidomos në tregun e prodhimit të miellit, ku ndërmarrjet më të mëdha të importit të grurit janë dhe prodhuesit më të mëdhenj të miellit në vend.
26. Pozita e konsoliduar e ndërmarrjeve në treg, qëndrueshmëria e pjesëve të tregut ndër vite, eksperiencia apo reputacioni, teknologjia dhe kapacitetet e larta përpunuese krijojnë vështirësi për një hyrës të mundshëm të ri. Për këtë arsye, një hyrje e re në këtë treg kërkon një investim shumë të madh dhe mundësisht integrim vertikal (të sigurojë lëndën e parë nga importi) për të përballuar tregun.

II.2.4. Fuqia kundërvepruese

27. Fuqia kundërvepruese e klientëve është e vogël si në tregun e shitjes së grurit ashtu dhe në tregun e prodhimit të miellit. Blerësit e grurit (blojet e vogla) janë ndërmarrje të detyruara të sigurojnë lëndën e parë për të mbajtur në punë linjat e prodhimit, të punësuarit e tyre dhe klientët e tyre të miellit. Fuqia e klientëve të miellit për të kundërvepruar është edhe më e dobët se e klientëve të grurit, pasi klientët (furrтарët) janë biznese të vogla që janë të detyruara të pranojnë çmime të caktuara prej furnitorëve të mëdhenj.

II.2.5 Fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve

28. Bazuar në analizën e fuqisë ekonomike dhe analizën e pasqyrave financiare të administruara, ndërmarrjet në hetim operojnë me norma fitimi të ulta nga XX%-XX%. Për ndërmarrjet shohim se norma e fitimit është përgjithësisht pozitive, përveç Bloja SHA në vitin 2018 (me XX % humbje). Norma e fitimit kryesisht është afërsisht XX% (Besniku SHPK, Bloja SHA dhe Miell Tirana SHA) për gjysmën e rasteve kur kjo normë është pozitive (XX%, XX% dhe XX%) dhe në tre raste kjo normë është mbi XX% (Agro Blend SHPK 2017, 2018, Besniku SHPK 2017) dhe një rast shumë e ulët, XX% që korrespondon me ndërmarrjen Atlas Mills SHPK gjatë periudhës që sapo kishte nisur aktivitetin në fund të vitit 2018. Nga analiza e ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve, vërehet se ndërmarrjet nën hetim operojnë me norma fitimi relativisht të ulëta.
29. *Për sa më sipër, duke vlerësuar pjesët e tregut, pengesat e hyrjes në treg, fuqinë kundërvepruese dhe fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjeve rezulton se asnjë nga ndërmarrjet nuk përmbush kriteret e nenit 8, duke mos zotëruar pozitë dominuese në tregun përkatës.*

II.3 Sjellja e ndërmarrjeve në treg

30. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve nën hetim në lidhje me çmimin e importit të grurit rezulton se ndërmarrjet nën hetim blejnë me çmime të përafërta, sasisht e importuara të ndërmarrjeve nën hetim nuk ndjekin trendin e çmimit CIF për të krijuar rezerva kur çmimi bie dhe për t'i përdorur këto rezerva kur çmimi është me i lartë, dhe nuk rezulton të ketë blerje në furnitorë të përbashkët.
31. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve nën hetim Bloja SHA, Atlas Mills SHPK, Miell Tirana SHA dhe Agro Blend SHPK, që zotërojnë pjesën më të madhe të tregut të importit të grurit, prodhimit dhe tregtimit të miellit si rezultat i integritimit vertikal, në lidhje me çmimin në tregun shitjes së miellit vërehet se aplikojnë çmime të përafërta, sjellje bashkërenduar e cila bie nën kushtet e nenit 3, pika 4 dhe nenit 4 pika 1 gërma a) e ligjit nr. 9121/2003.
32. Ndërmarrjet nën hetim, caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes pothuajse të njëjta, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 gërma a dhe b, e ligjit nr. 9121/2003 pasi caktohen çmimet të shitjes dhe kufizojnë konkurrencën duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritimit vertikal.

33. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve nën hetim në lidhje me çmimin e shitjes së miellit për bukë vërehet se çmimet mesatare mujore gjatë periudhës hetimore janë të qëndrueshme për të njëjtën ndërmarrje dhe të përafërta midis ndërmarrjeve. Gjithashtu, edhe çmimet mesatare të tremujorëve rezultojnë se janë të përafërta. Ndërmarrja Atlas Mills SHPK, gjatë vitit 2018 pas përqendrimit, kohë kur pronësia e saj është transferuar ndërmarrjes Besniku SHPK me VKK nr. 622, datë 13.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK”, ka shitur miell në tregun e tregimit të miellit për bukë me çmime më të ulta se konkurrentët e tjerë; Por gjatë vitit 2019, ndërmarrja Atlas Mills SHPK ndjek çmimet e konkurrentëve të tjerë në tregun e tregimit të miellit për bukë.
34. Përsa më sipër, ndërmarrjet nën hetim, caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes pothuajse të njëjta, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 gërma a dhe b, e ligjit nr. 9121/2003 pasi caktohen çmimet të shitjes dhe kufizojnë konkurrencën duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritetit vertikal.

III. Problematikat e tregut

35. Tregu objekt hetimi paraqitet problematik duke qenë se produkti miell për ëmbëlsira futet në tregun vendas si miell gruri pa përcaktuar destinacionin e tij përfundimtar dhe rrjedhimisht edhe cilësinë. Për këtë arsye mund të themi se çmimi i ulët i importit favorizon ndërmarrjet në treg, duke i vendosur ndërmarrjet prodhuese në kushte të pafavorshme të konkurrencës.
36. AKU, në rolin e mbikëqyrësit të cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore, nuk përcakton nivelin e proteinës (% proteinike) në “Raportet e Provës” marrë në PIK (Pikat e Inspektimit Kufitar) për produktin miell, duke sjellë për pasojë mos identifikimin e llojit të produktit apo të cilësisë së tij. Ky fakt u jep mundësinë importuesve të miellit të operojnë në treg me çmime më të ulta, për produkte cilësisht të ndryshme duke deformuar tregun.
37. Një tjetër arsye që lehtëson hyrjen e këtyre mallrave në treg është dhe mos kodifikimi doganor sipas karakteristikave dhe cilësisë së produktit, pra duke mos përcaktuar destinacionit përfundimtar të produktit (konkretisht miellit) siç dhe rekomandohet në udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Konkretisht DPD nuk e ka të parashikuar në “Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave 2020” ndarjen e produktit miell gruri sipas karakteristikave dhe cilësisë së produktit dhe destinacionit përfundimtar të produktit (konkretisht miellit) siç dhe rekomandohet në udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 207, datë 31.03.2015. Ky element regjistrimi i produktit pengon identifikimin e llojit të produktit (miell) sipas cilësisë dhe destinacionit përfundimtar të përdorimit.
38. Ky treg paraqitet problematik duke qenë se ky produkt futet në tregun vendas si miell gruri pa përcaktuar destinacionin e tij përfundimtar të përdorimit, përqindjen e proteinës dhe rrjedhimisht cilësinë e produktit. Për këtë arsye mund të themi se çmimi i ulët i importit të miellit me përqindje proteinike të ulët, nëse është përdorur jashtë qëllimit të tij të përcaktuar, favorizon ndërmarrjet importuese, si rrjedhojë deformon tregun, duke i vendosur ndërmarrjet prodhuese në kushte të pafavorshme të konkurrencës. Situatë e favorizuar edhe nga mos kodifikimi doganor sipas karakteristikave dhe cilësisë së produktit, pra duke mos përcaktuar destinacionin përfundimtar të produktit siç dhe rekomandohet në udhëzimin nr.207/2015 të MBZHR.
39. Në përmbledhje të analizës më sipër vihet re se rënia e importit të miellit për ëmbëlsira, konsumatori final nuk ka ndërë nevojën e mungesës së këtij produkti, gjë e cila të çon në dyshimin e arsyeshëm që mielli i importuar për ëmbëlsira ndryshon destinacion e për pasojë analiza e bërë më sipër, ka kufizime për këtë arsye.

Referuar konkluzioneve të mësipërme, rezulton se: nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve nën hetim Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, janë konstatuar shkelje të ligjit të konkurrencës, në kundërshtim me nenin 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 gërma a dhe b të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasi këto ndërmarrje bashkërendojnë sjelljen duke caktuar çmimet e shitjes dhe duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritit vertikal.

PËR KËTO ARSYE:

KK, në mbështetje të nenit 4 dhe 9, nenit 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, pika 5, neni 45 pika 1 dhe neni 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit.
- II. Konstatimin e sjelljes së bashkërenduar midis ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, pasi këto ndërmarrje bashkërendojnë sjelljen duke caktuar çmimet e shitjes dhe duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritit vertikal, sjellje e cila bie në kushtet e zbatimit të nenit 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 gërma a dhe b të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- III. Detyrimin e ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK si vijon:
 1. Të mos caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 2. Të mos kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 3. Të mos ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 4. Gjatë periudhës së monitorimit të raportojnë çdo 3 (tre) muaj pranë AK-së të dhëna mbi blerjet dhe shitjet në përmbushje të detyrimeve të dhëna sipas kësaj pike.
- IV. T’i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që në bashkëpunim me njëra-tjetrën, të sigurojnë nxjerrjen e një akti nënligjor të përbashkët për të realizuar ndarjen e produktit miell i importuar sipas karakteristikave, cilësisë së produktit, destinacionit përfundimtar të përdorimit tij dhe përqindjes proteinike në “Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave” siç përcaktohet në udhëzimin nr. 207, datë 31.3. 2015 të MBZHR:
 - miell gruri për prodhim buke me përqindje proteinike 12%;
 - bazë picash, kruasan, petë me përqindje proteinike 12.5%;
 - miell për ëmbëlsira, kek, biskota, petulla me përqindje proteinike 9%;
 - makarona me përqindje proteinike 11%.
- V. T’i rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si autoriteti mbikëqyrës i cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore:
 - a) Pas përditësimit të “Nomenklatures së Kombinuar të Mallrave”, në zbatim të pikës IV, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të mundësojë kontrollin e nivelit të proteinës (% proteinike) për produktin miell importi me qëllim përdorimin e këtij produkti në destinacionin përfundimtar tij.

VI. Moszbatimi i përmbushjes së pikës III të këtij vendimi, në zbatim të nenit 73 dhe 74 të ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohet me penalitetet përkatëse.

VII. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për një periudhë 1 (një) vjeçare.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 703, Datë 06.08.2020

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.08.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurave të hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimi i angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom.

Baza ligjore: Neni 3, pika 4, neni 4, neni 24 germa (d), neni 26, neni 45, pika 2 dhe neni 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Mbi procedurat e angazhimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare; informacion mbi Angazhimet Vodafone protokolluar në AK me shkresën nr. 92/35 prot., datë 24.07.2020; informacion mbi Angazhimet Telekom Albania protokolluar në AK me shkresën nr. 92/36 prot., datë 27.07.2020; informacion mbi Angazhimet Altelecom protokolluar në AK me shkresën nr. 92/37 prot., datë 28.07.2020,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës, pas monitorimit të tregut me pakicë të shërbimeve celulare, në zbatim të nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit, me anë të vendimit nr. 679, datë 14.02.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, vendosi: hapjen e procedurës së hetimit paraprak në “Tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 680, datë 14.02.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare” ka vendosur marrjen e masës së përkohshme për ndërprerjen e menjëhershme dhe jo me vonë se 5 ditë nga njoftimi i këtij vendimi, të aplikimit të paketave të reja standarde 30 ditore me parapagesë, për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom.
3. Procedura e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në vendimin nr. 679, datë 14.02.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, përfshin periudhën kohore nga 1 Nëntor 2019 deri në 31 Mars 2020.

4. Vodafone Albania sipas relacionit të monitorimit nr. 92/12 prot., datë 25.02.2020 “Mbi zbatimin e VKK nr. 680, datë 14.02.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, ka ndërprerë aplikimin e paketave të reja standarde 30 ditore me parapagesë dhe rivendosjen në aplikim të paketave të vjetra standarde.
5. Telekom Albania me shkresën nr. 92/8 prot., datë 20.02.2020 “Njoftim i shoqërisë Telekom Albania për ndërprerjen e aplikimit të paketave të reja standarde 30 ditore me parapagesë”, ka njoftuar se në bazë të vendimit nr. 680, datë 14.02.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, pika I, germa “a” ka ndërprerë aplikimin e paketave të reja standarde 30 ditore me parapagesë dhe ka rivendosur aplikimin e paketave të vjetra standarde.
6. Albtelecom me shkresën nr. 92/6 prot., datë 17.02.2020, “Mbi vendimin e Autoritetit të Konkurrencës nr. 680, datë 14.02.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare””, ka informuar AK se ka marrë menjëherë masat për zbatimin e masës së përkohshme për ndërprerjen e paketave të reja 30 ditore standarde me parapagesë dhe do të rikthejë çmimet e paketave të vjetra Super.
7. Me qëllim zbatimin e masës së përkohshme nga Autoriteti i Konkurrencës u realizua monitorimi në terren, në pikat e shitjes së operatorëve Vodafone Albania, Albtelecom dhe Telekom Albania. Monitorimi është realizuar çdo ditë, përkatësisht nga datat 15.02.2020 deri në datë 21.02.2020, me qëllim vlerësimin e zbatueshmërinë së masës së përkohshme dhënë nga Autoriteti i Konkurrencës.
8. Nga monitorimi i kryer pranë pikave Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom si dhe monitorimi i faqes zyrtare përkatëse të ndërmarrjeve, rezulton se këto ndërmarrje kanë ndërprerë aplikimin e paketave të reja standarde me parapagesë objekt hetimi dhe kanë rikthyer aplikimin e vjetër të këtyre paketave duke zbatuar pikën I, të VKK nr. 680, datë 14.02.2020.

II. Tregu përkatës

9. Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, gjatë përcaktimit të tregut përkatës janë marrë në konsideratë dhe kriteret e tjera për përcaktimin e tregut, sikurse: konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes.
10. Tregu objekt hetimi është tregu me pakicë i shërbimeve celulare ku si treg përkatës i produktit janë shërbimet publike të telefonisë së lëvizshme të ofruara nga kompanitë, që përfshijnë aksesin e përdoruesve në rrjet dhe thirrjet dalëse të ofruara nëpërmjet paketave si me parapagim dhe me kontratë. Pra, përdoruesi ka mundësi ta ketë këtë shërbim gjithmonë me vete (nëpërmjet një aparati telefonik celular) dhe disponibël për ta përdorur në çdo vend, të paktën brenda territorit të shërbimit që mbulon operatori, ku përdoruesi është abonuar. Telefonia fikse, nuk përfshihet në tregun përkatës për arsye të veçorive të ndryshme që ajo ka, në raport me telefoninë e lëvizshme. Nga pikëpamja e konsumatorëve, shërbimet e telefonisë fikse nuk janë të zëvendësueshme me shërbimet e telefonisë së lëvizshme. Në këtë treg numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare gjatë tre mujorit të IV të 2019 arriti në rreth XX milionë që përbën një rënie me rreth XX% me tre mujorit të III të 2019 dhe rënie me XX% në krahasim me tre mujorit të IV të 2018.
11. Bazuar sa më sipër tregu përkatës përfshin të gjitha shërbimet publike të telefonisë celulare të ofruara nga kompanitë celulare në tregun e shitjes me pakicë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
12. Treg përkatës gjeografik përkufizohet tregu i shërbimeve publike telefonike celulare, të cilat përfshijnë aksesin (në rrjet celular nga përdoruesit fundorë) dhe të gjitha llojet e thirrjeve dalëse, SMS-ve dhe aksesin broadband të ofruara nëpërmjet paketave me parapagim dhe me kontratë për shërbime të ofruara nga sipërmarrësit Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom në territorin e Republikës së Shqipërisë.

III. Pjesët e tregut

13. Nga vlerësimi i kriterit të pjesëve të tregut rezulton se:

- *Ndërmarrja me pjesë më të madhe të tregut, sipas të ardhurave të realizuara në tregun me pakicë për periudhën nën hetim, është Vodafone Albania me XX %. Konkurrenti i dytë është Telekom Albania, me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut, me XX % pjesë tregu. Ndërmarrja Altelekom përfaqësohet me XX % pjesë tregu.*
- *Duke vlerësuar treguesit e të ardhurave totale të kompanive për vitin 2019, rezulton se ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu për vitin 2019 është Vodafone Albania me XX %, e ndjekur më pas nga ndërmarrja Telekom Albania me XX %. Ndërmarrja Altelecom përfaqësohet me XX % të tregut.*
- *Referuar numrit të kontratave për pajtimtarët me post-pagesë në tregun përkatës rezulton se: Ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut për periudhën nën hetim është Vodafone Albania me XX %. Ndërmarrja e dytë në treg është Telekom Albania, me XX %. Ndërmarrja Altelecom ka qëndrueshmëri të pjesëve të tregut me rreth XX %.*
- *Duke vlerësuar numrin e pajtimtarëve me parapagesë në tregun përkatës rezulton se: Ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut për periudhën nën hetim është Vodafone Albania me XX %. Ndërmarrja e dytë në treg është Telekom Albania, me XX %. Ndërmarrja Altelecom ka qëndrueshmëri të pjesëve të tregut me rreth XX %.*
- *Referuar numrit të pajtimtarëve me parapagesë, vetëm segmenti i paketave mujore standarde në tregun përkatës, rezulton se: Ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut për periudhën nën hetim është Vodafone Albania me XX %. Ndërmarrja e dytë në treg është Telekom Albania, me XX %. Ndërmarrja Altelecom ka qëndrueshmëri të pjesëve të tregut me rreth XX %.*

14. Bazuar në numrin e përdoruesve për vitin 2019, ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu është Vodafone Albania me XX %, e ndjekur nga Telekom Albania me XX %. Altelecom ka qëndrueshmëri të pjesëve të tregut me rreth XX %.

15. Bazuar në paketat e shitura, të ndara sipas muajve dhe llojeve, për periudhën 1 nëntor 2019 - 31 mars 2020 rezulton se:

- *Sipas treguesit të numrit total të paketave të shitura për periudhën nëntor 2019 – mars 2020, rezulton se paketa Vodafone (Talk) përbën XX % të totalit të paketave të shitura, e ndjekur nga Altelecom (Super 700) me XX % dhe e fundit Telekom (Package S) me XX %.*
- *Paketa Vodafone (Combo) përbën XX % të totalit të paketave të shitura, e ndjekur nga Telekom (Package M) me XX % dhe e fundit Altelecom (Super 1100) me XX %.*
- *Paketa Telekom (Electronic Bits) përbën XX % të totalit të paketave të shitura, e ndjekur nga Vodafone (Silver) me XX % dhe e fundit Altelecom (Super 1300) me XX %.*
- *Paketa Vodafone (Z) përbën XX % të totalit të paketave të shitura, e ndjekur nga Altelecom (Gigastike) me XX % dhe e fundit Telekom (Package L) me XX %.*

16. Bazuar në kriterin sipas numrit të rimbushjeve minimale përqindja që zë secila kompani është si më poshtë:

- *Për muajin nëntor 2019: Vodafone Albania XX %, Telekom Albania XX % dhe Altelecom XX %.*
- *Për muajin dhjetor 2019: Vodafone Albania XX %, Telekom Albania XX % dhe Altelecom XX %.*
- *Për muajin janar 2020: Vodafone Albania XX %, Telekom Albania XX % dhe Altelecom XX %.*

- Për muajin shkurt 2020: Vodafone Albania XX %, Telekom Albania XX % dhe Altelecom XX %.
- Për muajin mars 2020: Vodafone Albania XX %, Telekom Albania XX % dhe Altelecom XX %.

17. Bazuar në kriterin e numrit total të përdoruesve aktivë të paketave të reja dhe të vjetra midis Telekom Albania dhe Altelecom vihet re se: për periudhën nëntor 2019 Telekom Albania ka XX përdorues aktivë më tepër se Altelecom. Për periudhën dhjetor 2020 Telekom Albania ka XX përdorues aktivë më tepër se Altelecom. Për periudhën janar 2020 Telekom Albania ka XX përdorues aktivë më tepër krahasuar me Altelecom. Për periudhën shkurt 2020 vihet re se numri i përdoruesve aktiv të Altelecom është më i madh se Telekom Albania, përkatësisht XX përdorues më tepër. Për periudhën mars 2020 Telekom Albania ka XX përdorues aktivë të paketave të reja/të vjetra më tepër se Altelecom. Vodafone Albania nuk ka dhënë informacionin për përdoruesit aktiv të paketave të vjetra dhe te reja standarde për periudhën 1 Nëntor 2019 – 31 Mars 2020.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

18. Analizimi i sjelljes së ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun përkatës është bazuar në evidencat ekonomike, nëpërmjet të cilave vlerësohet sjellja paralele e ndërmarrjeve nën hetim, ku treguesit më kryesore janë rritjet e njëkohshme dhe identike të çmimeve.
19. Për të provuar ekzistencën e sjelljes së bashkërenduar midis ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun përkatës, me anë të evidencave ekonomike të sjelljes janë krahasuar paketat e standarde të ndërmarrjeve nën hetim sipas tarifave të aplikuara, afatit dhe njësive që ato përmbajnë.
20. Kjo analizë është bazuar në metodologjinë e OECD-së “*Prosecuting cartels without direct evidence*”.

IV.1 Sjellja e kompanive të telefonisë celulare në lidhje me ofertat e paketave standarde

21. Të tre operatorët celularë kanë hedhur në treg paketat e reja standarde 30 ditore me parapagesë me një rritje në çmim prej 200 lekësh, si dhe kanë rritur vlerën minimale për rimbushjeje me 100 lekë, nga 100 në 200 lekë, në periudhën kohore 30 Janar – 11 shkurt 2020.
22. Gjithashtu të tre operatorët celularë, Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom kanë rritur vlerën minimale për rimbushjeje me 100 lekë, nga 100 në 200 lekë, në periudhën kohore 30 Janar – 11 shkurt 2020 në të njëjtën masë dhe në të njëjtën kohë.
23. Të tre kompanitë celulare kanë ndryshuar paketat standarde kryesore për një periudhë nga 3 ditë deri në 2 javë, përkatësisht për Vodafone Albania nga data 11.02.2020 deri 14 shkurt 2020, Telekom Albania nga data 05.02.2020 dhe Altelecom me 30.01.2020 deri më 17.02.2020. Ndryshimet e kryera janë kryesisht me rritje të çmimeve të të gjitha paketave standarde 30 ditore me parapagesë me 200 lekë nga të gjitha ndërmarrjet e telefonisë.
24. Ndërkohë për paketat e tjera standarde 30 ditore më parapagesë ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom kanë aplikuar rritje të çmimeve të paketave në të njëjtën masë por të shoqëruar me rritje të njësive të komunikimit të përfshira në paketa.
25. Ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom kanë rritur në të njëjtën masë dhe të njëjtën periudhë çmimin fillestar të rimbushjes së numrit nga 100 deri në 200 lekë, pa argumentuar këtë ndryshim.
26. Referuar analizës së sjelljes së ndërmarrjeve vërehet se 3 ndërmarrje në periudhën 30 janar deri në 17 shkurt 2020, për një periudhë 2 javore kanë rritur paketat standarde 30 ditore me parapagesë në të njëjtën masë duke ndjekur njëra tjetrën, si dhe kanë rritur vlerën minimale për rimbushjeje nga 100 në 200 lekë, duke shfaqur shenjat e një sjellje të bashkërenduar.

V. Rregullimi i Tregut

27. Në bazë të nenit 7 të Ligjit nr. 9918/2008, një ndër objektivat rregullatorë të AKEP-i është dhe nxitja e konkurrencës efçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike.
28. Në bazë të nenit 54 të Ligjit nr. 9918/2008, sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun ka detyrimin:
- të publikojë tarifat e shërbimeve dhe të mundësojë informimin e publikut edhe nëpërmjet aksesit në distancë;
 - të njoftojë, nëpërmjet mjeteve të informimit publik, çdo ndryshim në tarifat e shërbimeve, jo më pak se 7 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre ose të ndryshimeve dhe ky njoftim duhet të bëhet për jo më pak se 3 ditë rresht;
 - të paraqesë në AKEP tarifat e shërbimeve, si dhe çdo ndryshim të tyre.
29. Në bazë të nenit 8 të Rregullores nr. 27/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”:
- sipërmarrësit janë të detyruar të paraqesin në AKEP informacionin mbi tarifat e shërbimeve, si dhe çdo ndryshim të tyre me arsyetimet mbështetëse, jo më vonë se 15 ditë para hyrjes në fuqi të tarifave ose ndryshimeve të tyre.
 - Ky informacion duhet të dërgohet në rrugë elektronike dhe/ose shkresore. Forma e dërgimit të të dhënave në rrugë elektronike do të jetë e disponueshme edhe në faqen e internetit të AKEP.
 - AKEP-i publikon vlerësimin e përgjithshëm krahasues të tarifave aktuale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregulloreje.
 - Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të njoftojnë, nëpërmjet mjeteve të informimit publik, çdo ndryshim në tarifat e shërbimeve, jo më pak se 7 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre ose të ndryshimeve dhe ky njoftim duhet të bëhet jo më pak se 3 ditë rresht;
 - Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit kushtet e përgjithshme të kontratave tip dhe t’ia paraqesin ato AKEP-it për vlerësim, të paktën, 15 ditë para publikimit sipas nenit 98, pika 5 të Ligjit.
 - Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të njoftojnë pajtimtarët për çdo modifikim në kushtet e kontratave për jo më pak se 30 ditë përpara në përputhje me nenin 99, pika 3 të Ligjit.
30. Po ashtu në nenin 12, të Rregullores nr. 27/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, citohet se: “AKEP, analizon dhe bën vlerësimin e përgjithshëm të tarifave aktuale, të disponueshme për publikun me qëllim publikimin e tyre në një seksion të vecantë në faqen elektronike të tij. Për publikimin e tarifave, AKEP udhëhiqet nga parimet themelore që janë: ligjshmëria, transparenca, mosdiskriminimi dhe profesionalizmi”.
31. AKEP, nga ana e tij në datë 18 Shkurt 2020 ka publikuar dokumentin “Vlerësimin e përgjithshëm krahasues të tarifave aktuale me titull “Tarifat e shërbimit nga rrjete celulare në Shqipëri”. Sipas këtij dokumenti, në të jepen tabelat që i referohen tre operatortëve: Vodafone Albania; Telecom Albania dhe Albtelecom, dhe që përmbajnë komponentët e mëposhtëm:

- a. Përmbledhje e paketave standarte;
 - b. Tarifat standarte për shërbimin celular;
 - c. Planet tarifore, paketat dhe ofertat.
32. Në vlerësimin e AK, dokumenti i publikuar nga AKEP, nuk shoqërohet nga një analizë dhe vlerësim i përgjithshëm krahasues i tarifave aktuale, sipas përcaktimeve të nenit 8 dhe 12 të Rregullores nr. 27/2012 “Mbi Publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.
33. Nga ana tjetër, referuar komunikimit zyrtar midis AK dhe AKEP, në shkresën e AKEP nr. 92/16 prot., datë 17.03.2020 “Kthim përgjigje tuajës nr. 92/14 prot., datë 03.03.2020”, citohet se: *“Korrespondencat dhe diskutimet me sipërmarrësit kanë nxjerrë në pah se me gjithë respektimin e afatit të publikimit dhe njoftimit të paketave dhe çmimeve të reja, platformat informuese dhe shpjeguese në shërbim të pajtimtarëve dhe përdoruesve në përgjithësi, si nëpërmjet kanaleve audiovizive, po ashtu edhe nëpërmjet shërbimit të klientit, kanë pasur mungesë të theksuar efëçence. Për këtë arsye, operatorëve u janë risjellë në vëmendje detyrimet për informacion të plotë, të detajuar dhe në kohë reale ndaj publikut, sikundër rezultojnë nga neni 7 i Rregullores nr. 27/2012 si dhe domosdoshmëria për të përditësuar, në këtë aspekt, kodin e tyre të përbashkët të etikës”.*
34. Si përfundim, nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom në tregjet përkatëse konstatohet se:
- Të tre operatorët celularë, Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom kanë hedhur në treg paketat e reja standarde 30 ditore me parapagesë me një rritje në çmim prej 200 lekësh, me një rritje në të njëjtën masë dhe në të njëjtën kohë, në mënyrë të pajustificuar, sjellje e cila është në kushtet e nenit 3, pika 4 dhe nenit 4, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dhe përbën një sjellje të bashkërenduar.
 - Gjithashtu të tre operatorët celularë, Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom kanë rritur vlerën minimale për rimbushjeje nga 100 lekë në 200 lekë, në periudhën kohore 30 Janar – 11 shkurt 2020, në mënyrë të pajustificuar, në të njëjtën masë dhe në të njëjtën kohë, sjellje e cila është në kushtet e nenit 3, pika 4 dhe nenit 4, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dhe përbën një sjellje të bashkërenduar.
 - Ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom, nuk rezultojnë të kenë përdorur ndonjë metodologji për përcaktimin e çmimeve për paketat e reja standarde 30 ditore me parapagesë të shoqëruar me një rritje në çmim prej 200 lekësh, me synim orientimin e tarifave drejt kostos dhe që në çdo rast sipërmarrësit të shmangin përdorimin e tarifave abuzive, shpërdoruese dhe antikonkurruese sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 1 e Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
35. Duke qenë në kushtet e një sjellje të bashkërenduar dhe në një treg me një impakt të rëndësishëm për konsumatorët, siç është tregu i telefonisë celulare, Autoriteti i Konkurrencës ka identifikuar shqetësimet e ngritura të konkurrencës të cilat mund të eliminohen me marrjen e angazhimeve nga ana e ndërmarrjeve.
36. Në zbatim të nenit 45, pika 2 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ku ndërmarrjet marrin angazhime në përgjigje të vrejtyeve të bëra nga Autoriteti në vlerësimin paraprak, i cili i është komunikuar ndërmarrjeve, Komisioni me vendim, mund ti përcaktojë ato të detyrueshme për ndërmarrjet në formën e kushteve dhe detyrimeve.

37. Në zbatim të Rregullores “Mbi procedurat e angazhimeve”, Autoriteti vlerëson se vendimi me angazhime, paraqet angazhime të ofruara nga ndërmarrjet, të cilat janë detyruese, krijojnë siguri ligjore, rivendosin konkurrencën në treg dhe sigurojnë ruajtjen efektive të saj në mënyrë të vazhdueshme.
38. Për sa më sipër, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 92/31, datë 19.06.2020 i ka kërkuar ndërmarrjeve Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom, marrjen e angazhime në formë të shkruar.
39. Nga ndërmarrja Vodafone Albania më shkresën nr. 92/35 prot., datë 24.07.2020 janë depozituar angazhimet:
- Angazhimi nr. 1: Rritje e transparencës mbi produktet e reja/ndryshuara që hidhen në treg;
 - Angazhimi nr. 2: Akses për të gjithë;
 - Angazhimi nr. 3: Më shumë internet data në celular për të gjithë - paketat e solidaritetit dixhital për COVID-19;
 - Angazhimi nr. 4: Përputhshmëria e praktikave të ndryshimit të çmimit me ligjin për konkurrencën.
40. Nga ndërmarrja Telekom Albania me shkresën nr. 92/36 prot., datë 27.07.2020 janë depozituar angazhimet:
- Angazhimi nr. 1: Garantimi i pajtueshmërisë me të gjitha dispozitat rregullatore në fuqi, veçanërisht atyre që rregullojnë fushën e tarifave të aplikuara ndaj konsumatorëve;
 - Angazhimi nr. 2: Ruajtja e transparencës kundrejt konsumatorëve;
 - Angazhimi nr. 3: Ofrimi i një game më të gjere çmimesh, të përballeshme për tregun shqiptar, sipas treguesve ekonomikë të Shqipërisë;
 - Angazhimi nr. 4: Promovimi fuqishëm dhe zbatimi i strategjive me në qendër konsumatorin;
 - Angazhimi nr. 5: Të qenit proaktiv dhe mbështetës kundrejt sugjerimeve dhe nevojave që na adresohen nga klientët tanë;
 - Angazhimi nr. 6: Njoftimi i Autoritetit të Konkurrencës lidhur me ndryshimet e çmimeve.
41. Nga ndërmarrja Albtelecom me shkresën nr. 92/37 prot., datë 28.07.2020 janë depozituar angazhimet:
- Angazhimi nr. 1: Mundësi aksesi për përdoruesit me të ardhura të ulta;
 - Angazhimi nr. 2: Më shumë internet "mobile data" për të gjithë - solidaritet për COVID-19;
 - Angazhimi nr. 3: Bonus solidariteti për çdo rimbushje të kartës SIM për solidaritetin e gjithanshëm;
 - Angazhimi nr. 4: Informimi i Publikut.
42. Angazhimet e ndërmarrjeve Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom kanë në fokus të përbashkëta:
- Transparencën ndaj konsumatorëve dhe institucioneve mbikëqyrëse;
 - Paketa me çmime të përballeshme për përdoruesit me të ardhura më të ulta;
 - Ofrim i një kapaciteti më të madh të internet data në celular.

43. Në zbatim të Rregullores “Mbi procedurat e angazhimeve”, angazhimet e mësipërme janë marrë nga ndërmarrjet nën hetim për një periudhë kohore 2 vjecare. Këto angazhime janë të qarta, të vetëkërkueshme si dhe janë depozituar vullnetarisht nga ndërmarrjet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 45, pika (2) dhe nenin 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe Rregulloren “Mbi procedurat e angazhimeve”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
- II. Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve.

1. Për ndërmarrjen Vodafone Albania:

- a. Rritje e transparencës mbi produktet e reja/ndryshuara që hidhen në treg;
- b. Akses për të gjithë;
- c. Më shumë internet data në celular për të gjithë - paketat e solidaritetit dixhital për COVID-19;
- d. Përputhshmëria e praktikave të ndryshimit të çmimit me ligjin për konkurrencën.

2. Për ndërmarrjen Telekom Albania:

- a. Garantimi i pajtueshmërisë me të gjitha dispozitat rregullatore në fuqi, veçanërisht atyre që rregullojnë fushën e tarifave të aplikuara ndaj konsumatorëve;
- b. Ruajtja e transparencës kundrejt konsumatorëve;
- c. Ofrimi i një game më të gjerë çmimesh, të përbalueshme për tregun shqiptar, sipas treguesve ekonomikë të Shqipërisë;
- d. Promovimi fuqishëm dhe zbatimi i strategjive me në qendër konsumatorin;
- e. Të qenit proaktiv dhe mbështetës kundrejt sugjerimeve dhe nevojave që adresohen nga klientët;
- f. Njoftimi i Autoritetit të Konkurrencës lidhur me ndryshimet e çmimeve.

3. Për ndërmarrjen Albtelecom:

- a. Mundësi aksesit për përdoruesit me të ardhura të ulta;
- b. Më shumë internet "mobile data" për të gjithë - solidaritet për COVID-19;
- c. Bonus solidariteti për çdo rimbushje të kartës SIM për solidaritetin e gjithanshëm;
- d. Informimi i Publikut.

III. Ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom kanë detyrimin ligjor të mos bëjnë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:

- a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;

- b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
- c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
- d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohen me penalitetin përkatës.

V. T'i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare që hedhja e paketave të reja nga secila ndërmarrje në tregun e shërbimeve celulare me pakicë, të shoqërohet me një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm krahasimor në zbatim të Rregullores nr. 27/2012 "Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike".

VI. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për të gjithë periudhën e angazhimeve të marra nga ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom.

VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 708, Datë 23.09.2020

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.09.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një ankesë mbi disa praktika abuzive, me qëllim shtrembërimin dhe kufizimin e konkurrencës gjatë pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve të zhvilluara nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), Posta Shqiptare, UKT, OSHEE dhe UKD.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ankesës së paraqitur rezultoi se gjatë pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve të zhvilluara nga AKBPM, Posta Shqiptare, UKT, OSHEE dhe UKD, vihet re se:

- Kur numri i ofertuesve pjesëmarrës në këto procedura është i vogël, ofertat e paraqitura prej tyre janë shumë afër fondit limit dhe ndryshojnë shumë pak nga njëra-tjetra, ndërsa kur pjesëmarrja e ofertuesve është e madhe, vlerat e ofertave të paraqitura janë shumë më të ulëta në raport me fondin limit;
- Në disa raste ofertuesit rezultojnë fitues me rrotacion duke mbështetur njëri-tjetër nëpërmjet paraqitjes së ofertave fiktive të cilat përmbajnë terma specifike të papranueshme nga blerësi (autoriteti kontraktor);
- Kjo sjellje hedh dyshime për një bashkëpunim të mundshëm midis këtyre operatorëve ekonomik duke mbështetur njëri-tjetër në këto procedura me qëllim fitimin e tenderit me ofertën më të lartë dhe rrotacionin e fituesit.

Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, kjo sjellje hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis operatorëve në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga Janari 2018 deri në Dhjetor 2019.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 712, Datë 08.10.2020

**“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet
financiare jo banka”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.10.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka.

Baza ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24 shkronja (d) dhe neni 42, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të transfertave të parave (hyrje dhe dalje)”,

VËREN SE:

Subjektet financiare jo banka janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë financiare të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ, të tilla si: kredidhënia, mikrokredia, faktoringu, qiraja financiare, shërbimi i pagesave dhe i transferimit të parave, emetimi i parasë elektronike dhe këmbimi valutor.

Në tregun e kredidhënies operojnë ndërmarrjet: Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF; Ak-Invest; Fondi Besa; Noa; Tranzit; FIN-AL; Capital Invest; Micro Credit Albania dhe Albanian Financial Institution.

Në tregun e mikrokredisë operojnë ndërmarrjet: Agro & Social Fund; Capital Invest; Iutecredit Albania; Agro Partner; Kredo Financë dhe Micro Credit Risk.

Në tregun e faktoringut operojnë ndërmarrjet: Ak-Invest; Tranzit; Crimson Finance Fund Albania; Albanian Factoring Services; Tirana Factoring Institution; Omnifactor dhe Tirana Credit Trade.

Në tregun e qirasë financiare operojnë ndërmarrjet: Posta Shqiptare; Raiffeisen Leasing; FIN-AL; Landeslease; Porshe Leasing; Albania Leasing; Crimson Finance Fund Albania; Mogo Albania; Tirana Factoring & Lease dhe Albanian Financial Institution.

Në tregun e shërbimit të pagesave dhe transferimit të parave operojnë ndërmarrjet: Unioni Financiar i Tiranës; Ak-Invest; NOA; EasyPay; Posta Shqiptare; M-Pay; Kastrati; Pay&Go dhe Raea Financial Services.

Në tregun e emetimit të parasë elektronike operojnë ndërmarrjet: Unioni Financiar i Tiranës dhe Posta Shqiptare.

Në tregun e dhe këmbimit valutor operojnë ndërmarrjet: Unioni Financiar i Tiranës; Ak-Invest; Posta Shqiptare; NOA; Platinum Invest; Tirana Factoring Institution dhe Raea.

Sipas Raportit Vjetor të Mbikëqyrjes të vitit 2019 të Bankës së Shqipërisë¹, në dhjetor 2019, numërohen 32 subjekte financiare jo banka (SFJB), duke u shtuar me 2 subjekte në raport me vitin 2018. Totali i aktiveve për subjektet financiare jo banka (SFJB), në dhjetor 2019, arrin në nivelin 58.1 miliardë lekë, duke u rritur me rreth 11.8 miliardë lekë ose 25.4%.

Referuar analizës në Raportin Vjetor të Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë mbi ecurinë e aktiveve të subjekteve financiare jo banka rezultoi se zëri kryesor është portofoli i kredisë me rreth 50.4%.

Gjatë vitit 2019, subjektet financiare jo banka kanë njohur një rezultat pozitiv prej 3.46 miliardë lekësh. Ky rezultat është rritur me rreth 1.76 miliardë lekë (ose 103.5%) krahasuar me vitin paraardhës. Rezultati i institucioneve financiare jo banka përbën rreth 15% të rezultatit të sistemit bankar.

Tregu i kredisë dhe mikrokredisë, nga Subjektet financiare jo bankë, ka qenë objekt vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet procedurave të kontrollit të përqendrimeve. Gjatë vitit 2018, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 534, datë 05.07.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të 100% të aksioneve të shoqërisë FINAL SHA tek IUTECREDIT ALBANIA SHA” dhe Vendimin nr. 537, datë 20.07.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të BFSE HOLDING B.V tek shoqëria AMRYTA CAPITAL LLP” ka autorizuar transaksionin e ndodhura në këtë treg.

Në zbatim të Vendimeve të mësipërme të Komisionit, Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar tregun e kredisë dhe mikrokredisë, qirasë financiare dhe faktoringut, të ofruara nga SFJB-të nga ku është konstatuar se tregu i kredisë, mikrokredisë dhe qerasë financiare ka karakteristikat e një tregu të përqendruar me indeks të lartë të HHI, CR3 dhe CR5 dhe me ndërmarrje me fuqi në treg.

Gjatë vitit 2020, Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar përsëri tregun e subjekteve financiare jobankë dhe nga monitorimi i këtij tregu, lindi nevoja për grumbullimin e informacionit të nevojshëm lidhur me operatorët e tregut, tarifat që ata aplikojnë, pjesët dhe sjelljen e tyre në treg, informacion i cili u kërkua nga Banka e Shqipërisë dhe operatorët që operojnë në treg.

Sipas informacionit të Bankës së Shqipërisë dërguar me shkresën nr. 101/2 prot., datë 24.04.2020, në tregun e tranfertave të parave operojnë 9 subjekte të cilat janë: Unioni Financiar i Tiranës, Posta Shqiptare, Ak-Invest, NOA, EasyPay, M-PAY, Kastrati, Pay & Go dhe RAEA Financial Services.

Gjithashtu referuar informacionit mbi tarifat dhe komisionet e transfertave nga jashtë Shqipërisë – brenda dhe nga brenda Shqipërisë – jashtë, sipas SFJB-ve të licencuara, BSH referuar shkresës me nr. 101/2 prot., datë 24.04.2020 është shprehur se ky raportim nga subjektet financiare jo banka është ende në fazën e zhvillimit dhe në proces megjithatë gjendet në faqet zyrtare të internetit të këtyre subjekteve në kushtet kur në bazë të rregullores së transparencës, subjektet kanë detyrimin e publikimit të kushteve të punës në faqet zyrtare të internetit.

Si dhe sipas informacionit të ardhur sipas shkresave nr. 101/5 prot., datë 14.05.2020 të ndërmarrjes MPay; nr. 101/7 prot., datë 28.05.2020 të ndërmarrjes Ak-Invest; nr. 101/11 prot., datë 13.07.2020 të ndërmarrjes EasyPay; nr. 101/6 prot., datë 26.05.2020 të ndërmarrjes Kastrati Group; shkresave nr. 101/8 prot, datë 26.05.2020 dhe nr. 101/10 prot., datë 05.06.2020 të ndërmarrjes Unioni Financiar i Tiranës, nuk mund të arrihet në një konkluzion pasi informacioni i sjellë sipas kërkesës për informacion mbi volumin e transfertave të realizuara nga këto SFJB (flow në hyrje dhe flow në dalje), të dhëna mujore dhe vjetore për periudhën 2019-2020 dhe tarifat dhe komisionet e transfertave nga jashtë Shqipërisë-brenda, dhe nga brenda Shqipërisë – jashtë sipas SFJB të licencuara, nuk është i mjaftueshëm për një përpunim krahasimor.

¹ https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raporti_Vjetor/

Për sa më sipër, nisur nga konstatimet gjatë periudhës së monitorimit në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka, sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në këto tregje, mund të sjellë kufizim të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2018 deri në 31 Gusht 2020.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 716, Datë 15.10.2020

“Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch – Farma” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch – Farma” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”.

Baza ligjore: Neni 3, pika 4, neni 4, neni 24 germa (d), neni 26 dhe neni 43 pika 1 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Nisur nga disa shqetësime në masmedia dhe ankesave të paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi rritjen e çmimit të materialeve paramjekësore, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, realizoi një monitorim në këtë treg, i cili konsistoi në vlerësimin e sjelljes së ofruesve të këtyre materiale në të gjitha nivelet e tregtimit (shumicë dhe pakicë).

2. Monitorimi u fokusua në tregtimin e materialeve dezinfektant duarsh, alkool dhe maska, për të cilat kërkesa konsumatore ka qenë në rritje si pasojë e situatës së krijuar nga virusi COVID-19. Nga verifikimi në terren konstatohen se: tregu ka mungesë të materialeve në nivelin e tregtisë me pakicë (rrjeti farmaceutik); rritje e pajustificueshme e çmimit në të gjitha nivelet e tregtimit të këtyre materialeve (depo farmaceutike dhe rrjeti i farmacive).
3. Për sa më sipër Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me anë të Vendimit nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
4. Referuar VKK nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, hetimi paraprak do të përfshij periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020.
5. Gjithashtu në kushtet e emergjencës shëndetësore, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, vlerësoi se për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore (dezinfektant, alkool dhe maska), pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të këtij ligji, për shkak të rritjes së pajustificueshme të çmimit të tregtimit.
6. Bazuar sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore si vijon:
 - a) Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b) Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c) Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
7. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve gjatë periudhës Shkurt-Maj 2020 në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore konstatohet se ndërmarrjet kanë vazhduar të rrisin në mënyrë të pajustificuar çmimet, duke mos zbatuar VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
8. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore dhe do të vijojë të vlerësohet dhe gjatë hetimit të thelluar.
9. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; Qendrës Kombëtare të Biznesit; Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave; Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; Ministrisë së Shëndetësisë; Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut; “CFO Pharma” SHPK; “Rejsi Farma” SHPK “Delta Pharma – AL” SHPK; “Pharma One” SHPK; “Intermed” SHPK; “Alfarmakos” SHPK;

“Trimed” SHPK; “Megapharma” SHPK; “Evita” SHPK; “Aldosch – Farma” SHPK; “IMI – Farma” SHPK; “Fufarma” SHA; “Medicamenta” SHPK; “Pegasus” SHPK; “Mini Invest Albania” SHPK; “Delta Med” SHPK; “R&S Farma” SHPK; “O.E.S Distrimed” SHPK; “Montal” SHPK; “MSE” SHPK; “Farma Net Albania” SHPK; “Tresi – Farm” SHPK; “Incomed” SHPK; “Florifarma” SHPK; “Lekli” SHPK; “Dial – ALB” SHPK; “Sirol 2008” SHPK dhe “Aquila Group” SHPK

10. Në vazhdim të procedurës, në zbatim të vendimeve të mësipërme të Komisionit të Konkurrencës, në bazë të nenit 35, 36 dhe 38 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës ngritur me urdhrin nr. 110/44 prot., datë 24.08.2020, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë disa subjekteve farmaci në qytetin e Tiranës.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

11. Në bazë të nenit 3, pika 7 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përbëhet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”.

12. Në zbatim të Ligjit, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.

II.1.1 Tregu përkatës i produktit

13. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).

14. Zëvendësimi në anën e kërkesës nënkupton nëse ndërmarrjet në ofrimin e një produkti, do të rrisnin çmimin e këtij produkti, çfarë mundësish kanë konsumatorët të zëvendësojnë përdorimin e këtij produkti me një tjetër. Produkti/shërbimi që analizohet krahasohet me produkte të tjerë, nëse ato mund të zëvendësohen nga ana e konsumatorit. Nëse konsumatorët mund të zëvendësojnë produktin e ofruar nga ndërmarrja me një produkt apo produkte të tjera, këto të fundit duhet të përfshihen në tregun përkatës.

15. Zëvendësimi në anën e ofertës nënkupton që nëse ndërmarrjet do të rrisnin çmimin e produktit/shërbimit për një periudhë kohe jo tranzitore, a do të kishte presion nga ofrues të tjerë të mundshëm të këtij produkti? Ndërmarrje të tjera, të cilat nuk ofrojnë produktet në fjalë, mund të zhvendosin burimet e tyre në drejtim të ofrimit të këtyre produkteve.

16. Bazuar në sa më sipër, tregu përkatës i produktit do të përkufizohej tregu i shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve maska, gel-dezinfektant, alkool dhe termometër.

II.1.2 Tregu përkatës gjeografik

17. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.

18. Për analizimin e këtij rasti treg gjeografik konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Ndërmarrjet në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore

19. Qendra Kombëtare Kontrollit të Barnave është institucioni përgjegjës për kontrollin e çdo veprimtarie në fushën farmaceutike i cili funksionon në zbatim të ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin

farmaceutik”. Ky ligj përcakton rregullat për prodhimin, vendosjen në treg, importin, eksportin, tregtimin, përdorimin, farmakovigjilencën, publicitetin, kontrollin e cilësisë dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me barnat për përdorim njerëzor në Republikën e Shqipërisë, me qëllim garantimin e shëndetit publik.

20. Licenca profesionale për subjektet farmaceutike (fabrika, importues dhe tregtues me pakicë) për ushtrimin e veprimtarive respektive (fabrikim barnash, tregti me shumicë, farmaci) për barnat narkotike, psikotrope dhe prekursorët e kategorisë 1, lëshohen nga QKL, referuar Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licensat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar.
21. Kriteret e licencimit të farmacive dhe agjencive farmaceutike janë të përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 28.06.2019 për “Lidhjen e kontratave me farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për vitin 2019” të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Sipas pikës 8, të këtij udhëzimi, Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike, drejtohen me kërkesë me shkrim, pranë FOND-it, dhe dorëzojnë dokumentacionin sipas germave a, b, c, g, dhe h. Vetëm pasi kanë marrë miratimin e FOND-it, Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike, duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë Rajonale të rajonit, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre dokumentacionin përkatës sipas këtij udhëzimi.
22. Referuar shkresës nr. 110/11 prot., datë 29.04.2020 “Kthim Përgjigje” të Qendrës Kombëtare të Biznesit subjektet e licensuara në kategorinë “Tregtimi me shumicë i barnave” si dhe në kategorinë “Farmacitë ose agjensitë farmaceutike”, janë licensuar:
 - **199 subjekte** në tregtimin me shumicë të barnave:
 - **2358 subjekte/individ** për farmacitë ose agjensitë farmaceutike
23. Referuar shkresës nr. 110/13 prot., datë 04.05.2020 “Kthim Përgjigje” të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve subjektet/tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitetin e tregtimit të materialeve paramjekësore e farmaceutike janë 1689 subjekte/individ.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

24. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”², është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e kësaj situatë.
25. Referuar udhëzimit sa më sipër, në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.
26. Në kuadër të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
27. Ndërmarrjet “CFO Pharma” SHPK, “Delta Pharma-AL” SHPK, “Imi-Farma” SHPK, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “MSE” SHPK, “Tresi-Farm” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK dhe “Aquila Group” SHPK nuk i janë përgjigjur kërkesës për informacion të Autoriteti të Konkurrencës nr. 110/20 prot., datë 26.05.2020.
28. Sipas të dhënave të administruara, nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve gjatë periudhës hetimore Janar - Maj 2020, konstatohet se masa e përkohshme dhënë me VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, nuk është zbatuar nga ndërmarrjet “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK,

² <http://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=f27d3718-9b51-488a-b29b-fa03e458fdea>

“Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch – Farma” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK, ndërmarrjet kanë vazhduar të rrisin në mënyrë të pajustificuar çmimet për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant dhe termometëra.

29. Në këto kushte, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se ka dyshime për praktika të bashkërenduara midis ndërmarrjeve në treg në kuptim të nenit te nenit 3, pika 4 dhe nenit 4, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në neni 3, pika 4, neni 4, neni 24 germa (d), neni 26, neni 43 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjeve ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch – Farma” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK:
 - i. në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - ii. në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues;
 - iii. në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
 2. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.09.2020.
 3. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 muaj nga hapja e hetimit të thelluar.
 4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 717, Datë 15.10.2020

“Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 44, neni 67, neni 74, pika 1, germa (b), neni 75, pika 1 dhe neni 76, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003), Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

2. Në kushtet e emergjencës shëndetësore, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore (dezinfektant, alkool dhe maska), pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të këtij ligji, për shkak të rritjes së pajustificueshme të çmimit të tregtimit, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, ka vendosur:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - iii. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Nëpërmjet email të datës 24.03.2020 dhe me anë të shkresës 110/6 prot., datë 15.04.2020 “Njoftim vendimi”, ndërmarrjet që veprojnë në tregun me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore janë njoftuar mbi Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” dhe mbi Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
4. Në datën 18.04.2020 Vendimet e Komisioni të Konkurrencës, për sa më sipër, janë publikuar edhe në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës (www.caa.gov.al).
5. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
6. Ndërmarrjet “CFO Pharma” SHPK, “Delta Pharma-AL” SHPK, “Imi-Farma” SHPK, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “MSE” SHPK, “Tresi-Farm” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK dhe “Aquila Group” SHPK nuk i janë përgjigjur kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës nr. 110/20 prot., datë 26.05.2020.
7. Për sa më sipër, nga vlerësimi i sjelljes së këtyre ndërmarrjeve, mosbashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës gjatë procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore, vlerësohet si rrethanë rënduese në sjelljen e tyre.
8. Sipas të dhënave të administruara, konstatohet se sipas analizës së sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës, masa nuk është zbatuar nga ndërmarrjet “CFO Pharma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK,

“Evita” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK.

9. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve gjatë periudhës Shkurt-Maj 2020 në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve maska, alkool dhe gel-dezinfektant konstatohet se ndërmarrjet kanë vazhduar të rrisin në mënyrë të pajustificuar çmimet, duke mos zbatuar VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
10. Për shkak të mos zbatimit të masës së përkohshme, në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (b) të Ligjit nr. 9121/2003, Komisioni vendos gjoba, në masën deri në 10 për qind të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës, për çdo ndërmarrje pjesëmarrëse që nuk zbaton vendimin për marrjen e masave të përkohshme, sipas nenit 44.
11. Zbatimi i masës së përkohshme sipas VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, do të vijojë të vlerësohet dhe gjatë hetimit të thelluar.
12. Komisioni i Konkurrencës në rast të mos zbatimi edhe në vijim do të vendosë sanksione të parashikuara në nenin 76, pika 1, germa “b” të Ligjit nr. 9121/2003, në rast të mos zbatimit të saj.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 germa d, nenin 26, nenin 42, nenin 44, nenin 74, pika 1, germa (b), dhe nenin 75 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Gjjobitjen e ndërmarrjeve për moszbatim të masës së përkohshme sipas VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” dhe mos dhënies së informacionit:
 1. Gjjobitjen e ndërmarrjes “CFO Pharma” SHPK përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë
 2. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Delta Pharma – AL” SHPK përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë.
 3. Gjjobitjen e ndërmarrjes “IMI – Farma” SHPK përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë.
 4. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Medicamenta” SHPK përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë.
 5. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Mini Invest Albania” SHPK përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë.
 6. Gjjobitjen e ndërmarrjes “MSE” SHPK përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë.
 7. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Tresi – Farm” SHPK përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë.
 8. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Dial – ALB” SHPK përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë.
 9. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Sirol 2008” SHPK përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë.
 10. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Aquila Group” përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë.

II. Gjjobitjen e ndërmarrjeve për moszbatim të masës së përkohshme sipas VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”:

1. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Pharma One” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
2. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Intermed” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
3. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Alfarmakos” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
4. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Trimed” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
5. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Megapharma” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
6. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Evita” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
7. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Fufarma” SHA përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
8. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Delta Med” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
9. Gjjobitjen e ndërmarrjes “O.E.S Distrimed” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
10. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Montal” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
11. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Farma Net Albania” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
12. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Incomed” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
13. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Florifarma” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
14. Gjjobitjen e ndërmarrjes “Lekli” SHPK përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.

III. Detyrimin e ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK të mos bëjnë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:

- a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
- b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
- c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
- d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

IV. Zbatimi i Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” si dhe zbatimi i pikës I, II, III të këtij vendimi do të hyjë në fuqi pas inspektimeve që do të kryhen nga Autoriteti i Konkurrencës.

V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 723, Datë 17.11.2020

“Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen (BR), Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), Bankën Credins (BC) dhe Bankën Intesa SanPaolo (BISP).

Baza ligjore: Neni 3, neni 4, neni 8, neni 9, neni 24 pika d), neni 26, neni 43 neni 45 pika 1, dhe neni 74 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit të Grupit të Punës “Mbi hetimin e thelluar në sektorin bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”, relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe pretendimeve të depozituara me shkrim pranë Autoritetit nga bankat nën hetim,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 516, datë 22.05.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në sektorin bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”, vendosi hapjen e hetimit paraprak për katër bankat më të mëdha të sistemit bankar.

Mbështetur në gjetjet e hetimit, u ngritën dyshime për kufizim të konkurrencës në tregjet përkatëse në kuptim të nenit 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe me Vendimin Nr. 592, datë 31.01.2019, Komisioni i Konkurrencës vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për BR, BKT, BC dhe BISP për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore 01.01.2016 deri në 31.12.2018.

2. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit, “E drejta e palëve për tu dëgjuar”, Komisioni i Konkurrencës e bazoi vendimmarrjen vetëm në pretendimet e ndërmarrjeve në hetim dhe me shkresën nr. 246/13 prot.i AK, datë 06.08.2020 “Mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e shërbimeve bankare”, ftoi bankat nën hetim të paraqisnin pretendimet e tyre në lidhje me gjetjet e raportit, me shkrim.

3. Në përgjigje të ftesës, pranë Autoritetit është protokolluar shkresa nr.246/14 Prot.i AK, datë 31.08.2020 “Kthim përgjigje letrës suaj “Mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e shërbimeve bankare”, nga Banka Intesa SanPaolo SHA; shkresa nr. 246/15 Prot., i AK, datë 01.09.2020 “Përgjigje mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e shërbimeve bankare nr. 246/13 prot., datë 06.08.2020” nga Banka Raiffeisen SHA;

shkresa nr. 246/17 Prot., i AK, datë 08.09.2020 “Përgjigje mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e shërbimeve bankare” nga Banka Kombëtare Tregtare SHA si dhe shkresa nr. 246/18 Prot., i AK, datë 16.09.2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj nr. 246/13 prot. datë 06.08.2020, lënda “Mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e shërbimeve bankare” nga Banka Credins SHA, nëpërmjet të cilave, bankat objekt hetimi kanë paraqitur qëndrimet e tyre në lidhje me gjetjet dhe propozimet e raportit të hetimit të thelluar.

II. Analiza e konkurrencës

4. Gjatë viteve 2017-2018, në sektorin bankar ka patur një numër të konsiderueshëm transaksionesh për shitblerje të kuotave. Aktualisht në sistemin bankar operojnë 12 subjekte bankare (banka të nivelit të dytë).
5. Bankat ofrojnë një numër të konsiderueshëm shërbimesh klasike bankare. Zhvillimi i teknologjisë në fillim të viteve 2000, nxiti bankat që të përdornin si avantazh konkurruese shërbimin e tërheqjes së fondeve nga pajisje automatike ATM (Automatic Teller Machine) të cilat ofronin akses 24 orë në fonde dhe siguronin shtrirje te gjerë gjeografike. Vitet e fundit, bankat kanë ofruar përdorimin e platformave elektronike / mobile, të cilat i mundësojnë klientëve realizimin e transaksioneve bankare në çdo kohë dhe vend. Shërbimet online përbëjnë avantazh konkurrues për bankat në drejtim të zgjerimit të zonave gjeografike të shërbimit dhe uljes së kostove për bankën dhe klientin. Nga të dhënat e administruara, rezulton se vetëm gjatë periudhës hetimore, nga viti 2016, në vitin 2018 ky lloj shërbimi ka pësuar rritje me 62% dhe volumni i transfertave elektronike është 2.6- herë fishuar. Bankat nën hetim zotërojnë 41% të tregut të shërbimeve e-banking, ku Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Raiffeisen kanë pjesën më të madhe të transaksioneve të realizuar nëpërmjet platformave online.

II.1 Tregu përkatës

6. Në bazë të nenit 3, pika 7 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, analiza e konkurrencës fillon më përcaktimin e tregut përkatës, i cili përbëhet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - a. Tregun e produkteve
 - b. Tregun gjeografik
7. Përcaktimi i tregut si në dimensionin e produktit dhe atë gjeografik, bëhet me qëllim për të identifikuar konkurrentët aktualë dhe potencialë të ndërmarrjeve që janë të përfshirë në atë treg, për të vlerësuar sjelljen e këtyre ndërmarrjeve, llogaritjen e pjesëve të tregut, përcaktimin e fuqisë së ndërmarrjes, strukturën e tregut me qëllim vlerësimin e konkurrencës në treg.

II.1.1 Tregu përkatës i produktit

8. Bankat ofrojnë një numër të konsiderueshëm të produkteve/shërbimeve bankare. Nga analiza e realizuar në lidhje me tregjet përkatëse, produktet/shërbimet bankare janë grupuar në: llogari rrjedhëse; depozita me/pa afat; kredi konsumatore; kredi kufi (OVD); kredi hipotekore; kredi biznesi; transfertat bankare (hyrëse dhe dalëse) të ofruara nga bankat objekt hetimi.

II.1.2 Tregu përkatës gjeografik

9. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse bankat e nivelit të dytë janë prezente në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si treg gjeografik përcaktohet tregu i Republikës së Shqipërisë.

II.2 Barrierat e hyrjes dhe zgjerimit

10. Barrierat në hyrje përbëjnë një faktor me ndikim në konkurrencën në treg, të cilat vlerësohen në aspektin ligjor, ekonomik dhe social.
11. Barrierat ligjore përcaktojnë impaktin mbi konkurrencën në treg të akteve ligjore dhe nënligjore mbi të cilat funksionon tregu. Banka e Shqipërisë është autoriteti i vetëm përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe të degëve të bankave të huaja për të ushtruar veprimtari bankare dhe veprimtari të tjera financiare, në përputhje me ligjin nr. 9662/2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Referuar vlerësimit të legjislacionit primar dhe sekondar mbi të cilat funksionon sistemi bankar, rezulton se legjislacioni në tregun bankar nuk ka barrierë për hyrjet e reja në treg.
12. Nga analiza e strukturave organizative dhe shtrirjes gjeografike të bankave nën hetim, konstatohet se katër bankat kanë rrjetin më të madhe të degëve, zotërojnë numrin më të madhe të ATM dhe pikave POS në të gjithë vendin. Konkurrentet potencial, hyresit e rinj, duhet të përballen me rrjetin e degëve, shtrirjen gjeografike dhe klientelën e bankave ekzistuese, të cilët përdorin fuqinë e tyre ekonomike për fushata marketingu duke shpenzuar shuma të mëdha në reklama dhe marketing.
13. Tregu bankar karakterizohet nga "besnikëria" në sjelljen e klientëve, të cilët e kanë të vështirë ndryshimin e ofruesit të shërbimit duke u siguruar bankave një marrëdhënie afatgjatë me klientët, e cila në kuptim të ligjit nr. 9121/2003 është një tregues i qëndrueshmërisë së pjesëve të tregut për këto banka.
14. Në kushtet e një tregu të maturuar, për të rritur nivelin e konkurrencës në treg, bankat e nivelit të dytë duhet të garantojnë transparencë për shërbimet që ofrojnë, shërbime më cilësore me kosto më të ulët dhe produkte të reja.

II.3 Vlerësimi i strukturave të tregjeve të produkteve/ shërbimeve dhe sjellja e bankave nën hetim

15. Bankat ofrojnë një numër të konsiderueshëm të produkteve/shërbimeve bankare. Vitet e fundit bankat kanë filluar zgjerimin e gamës së shërbimeve të tyre me disa risi për tregun. Produktet/shërbimet bankare janë grupuar në: llogari rrjedhëse; depozita me/pa afat; kredi konsumatore; kredi kufi (OVD); kredi hipotekore; transfera bankare.
16. Në kuptim të nenit 4, pika 1, a) e ligjit nr. 9121/2003, një sjellje antikonkurrese e konkurrentëve në treg mund të vijë nëpërmjet vendosjes në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të çmimit të shitjes apo blerjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi. Për këto arsye, u vlerësua sjellja e bankave nën hetim kundrejt vendosjes së normave të interesit për depozitat dhe kreditë si dhe aplikimit të komisioneve për shërbimet bankare. Analiza u mbështet mbi tregues krahasimor midis bankave nën hetim, si dhe benchmark me rajonin duke iu referuar filialeve/degës të së njëjtës bankë në rajon.
17. **Depozitat** janë produkte nëpërmjet të cilave bankat sigurojnë likuiditetet monetare dhe klienti përfiton të ardhura nga interesat. Nga vlerësimi i strukturës së tregut dhe indekseve të përqendrimit të tregut u konstatua se bankat nën hetim janë bankat me vlerën më të lartë të portofolit të depozitave. Në lidhje me përqendrimin e tregut, treguesi i Herfindahl-Hirschman (HHI)³ dhe indekset e përqendrimit CR₃ dhe CR₄⁴, tregojnë për një treg mesatarisht të përqendruar gjatë periudhës hetimore.
18. **Depozitat me afat** në sektorin bankar gjatë vitit 2018 zënë 54% të portofolit të depozitës, në vitin 2017 zënë 57% të portofolit dhe në vitin 2016 zënë 59% të këtij portofolit. Struktura e tregut për produktin e depozitës me afat dhe treguesit e përqendrimit, tregojnë për një treg mesatarisht të përqendruar ku indeksi i përqendrimit

³ Herfindahl-Hirschman Index, matës specifik i përqendrimit të tregut, i llogaritur si shuma e katrorëve të pjesës së tregut të firmave në një industri. Kur HHI <1000, përqendrimi i tregut është i ulët, kur 1000 < HHI < 1800 tregu konsiderohet mesatarisht i përqendruar dhe kur HHI > 1800, tregu është i përqendruar.

⁴ CR₃ dhe CR₄ "concentration ratios"

HHI gjatë periudhës varion nga 1,589 (2016), 1,642 (2017), në 1,743 (2018).

19. Në produktin e depozitës me afat për individë:

- BR aplikon normat e interesit fikse (0.01%) pavarësisht shumës së depozituar.
- BC, BKT dhe BISP kanë interesa në varësi të shumës së depozituar dhe kohëzgjatjes së depozitës.
- BC paraqitet me normat e interesit me të larta e cila varion nga 0.3% deri në 3%.
- BISP ka normat e interesit që variojnë nga 0.5% deri në 2.2%.
- BR dhe BKT paraqiten me tregues nën mesataren e tregut.

20. Për produktin e depozitës me afat për biznes:

- BR ka normat e interesit më të ulëta në treg me vlerë 0.01% deri në 0.04%.
- BC, BISP dhe BKT aplikojnë norma interesi mbi mesataren e tregut bankar.

21. Nga krahasimi i normave të interesit të depozitës me afat 1 vjeçar me interesin e bonove të thesarit dhe analizën e spread-it, u konstatua se normat e interesit nominale të depozitave me afat nga bankat kanë pak ose aspak varësi nga ndryshimi i kërkesë-ofertës apo yield- i i bonove të thesarit.

22. **Depozitat pa Afat**, apo të njohura ndryshe si **llogari kursimi**, është një lloj depozite e cila e ndihmon klientin në depozitim të likuiditeteve të lira dhe tërheqjen e tyre në çdo kohë, duke përfutur interesa nëse banka aplikon të tilla. Depozitat pa afat zënë 11% në vitin 2018, 9% të tij në vitin 2017 dhe 8% të portofolit në vitin 2016. Tregu i depozitave pa afat është treg mesatarisht i përqendruar, ku treguesi HHI paraqitet me trend në rritje nga 1,132 (2016), 1,288 (2017) në 1,482 (2018).

23. Për depozitat pa afat për individ në lekë, BKT aplikon normat më të larta të interesit (0.2% në vitin 2016, në 0.3% për periudhën 2017-2018), faktor i cili ka ndikuar në rritjen e pjesës së tregut në këtë produkt me 10%.

24. Për produktin e depozitave me dhe pa afat u konstatua:

- BKT, BR, BC për hapjen e një depozite me afat kërkojnë depozitim të një shumë minimale;
- BKT aplikon komisionin më të lartë për mbylljen e depozitës brenda një viti në vlerën 1,500 lekë;
- BR për çeljen e një depozite pa afat kërkon një shumë minimale depozitimi prej 5,000 lekë ose 50 Euro, vlerë kjo relativisht e lartë krahasuar me banka të tjera.
- BR aplikon komisione për mbyllje të depozitës me afat në vlerën 500 lekë;
- BISP nuk aplikon komisione dhe penalitete për veprimet me depozitat.
- BISP aplikon humbjen e interesave të periudhës në rast të mbylljes së depozitës brenda afatit;
- BC aplikon komisionet më të ulta në lidhje me këtë produkt;
- Asnjë nga bankat nën hetim nuk aplikon komision mirëmbajtje për depozitën me afat.

25. **Llogaria rrjedhëse** është produkti më i rëndësishëm në drejtim të përthithjes së klientëve të rinj. Konkurrenca mes bankave në këtë segment është përqendruar në rritjen e numrit të kontratave të reja. Treguesit e përqendrimit për produktin e llogarive rrjedhëse, tregojnë për një treg shumë të përqendruar ku treguesi HHI varion nga 2,195 (2016) në 1,993 (2017) deri në 1,954 (2018) si dhe qëndrueshmëri e treguesit CR₃ dhe CR₄, e cila në kuptim të ligjit nr. 9121/2003 është një tregues i qëndrueshmërisë së pjesëve të tregut për këto

banka.

26. Për produktin e llogarisë rrjedhëse:

- BKT dhe BISP nuk aplikojnë norma interesi.
- BR dhe BC kanë norma interesi shumë të ulta krahasuar me normën mesatare të gjithë sistemit bankar.

27. Në produktin e llogarisë rrjedhëse u morën në konsideratë komisionet e vlerësuar si kosto bllokuese për lëvizshmërinë e klientëve nga një bankë në tjetrën, si dhe komisionet për shërbimet utilitare dhe nga analiza u konstatuan:

- Komisione të ngjashme të aplikuara nga bankat nën hetim për mirëmbajtjen e llogarisë rrjedhëse (në lekë dhe valutë) të cilat variojnë nga 100-150 lekë për individ dhe 150-500 lekë për biznes.
- Ndryshimi i komisioneve nga BKT ka qenë vazhdimisht në trendin rritës. Nga krahasimi benchmark midis mëmës BKT Shqipëri dhe filialit të saj BKT Kosovë, vihet re se komisioni i aplikuar për konsumatorin nga BKT në Republikën e Shqipërisë është 6 herë më i lartë (ose 10 herë nëse aplikon indeksin e fuqisë blerëse) sesa ai i aplikuar për konsumatorin në Republikën e Kosovës.
- BC ka aplikuar ulje të komisioneve për shërbimin e mbylljes së llogarisë rrjedhëse, dhe komisioneve për vërtetimeve për nxjerrje të gjendjes së llogarisë (statement).
- BKT dhe BC kanë aplikuar ndryshime të komisioneve gjatë periudhës hetimore.
- BISP aplikon komisione më të larta për mbylljet e llogarive rrjedhëse brenda një periudhe 3-mujore nga çelja e tyre.
- Bankat nën hetim aplikojnë komisione që variojnë nga 1,000-3,000 lekë për shërbimin e pajisjes me vërtetim bankar (statement), si dhe një komision që varion nga 100-300 lekë për nxjerrjen e lëvizjeve monetare në llogaritë e klientit.
- Komisionet e aplikuara janë të përafërta si në monedhën vendase dhe monedhën e huaj.

28. **Kreditimi** përfaqëson tradicionalisht një ndër aktivitetet kryesore të bankës prej të cilit banka siguron të ardhurat që i nevojiten për t'u paguar depozituesve të saj interesin e premtuar për depozitat, për të përballuar shpenzimet e veta të veprimtarisë si dhe për të siguruar fitim. Kredidhënia zë rreth 51% të gjithë totalit të depozitave të sistemit bankar. Vlera e portofolit të kredisë është shoqëruar me një rritje prej 3% në vitin 2017 dhe tkurrje prej 2% në vitin 2018 (nga 581 miliard lekë në 2016, në 597 miliard lekë në 2017 dhe 586 miliard lekë në 2018).

29. Në tregun e portofolit të kredisë (total) vihet re një qëndrueshmëri e pjesëve të tregut të ndërmarrjeve nën hetim, ku pjesën më të madhe të tregut e zë BKT me rreth 23% të tregut, e ndjekur nga BR dhe BC me 17% të tregut secila, ndërkohë që BISP zotëron vetëm 8% të tregut.

30. Pjesën më të madhe të kredisë e zë kredia e biznesit e cila zë mesatarisht 50-51% të portofolit të kredisë për periudhën hetimore. Kredia kufi (OVD), zë rreth 21-23% të portofolit të kredisë, me trend në ulje, e ndjekur nga kredia hipotekore me 19% të portofolit (stabël për periudhën hetimore) dhe kredia konsumatore me rreth 8-10% të portofolit. BR ka numrin më të madh të klientëve në kredinë konsumatore, kredinë kufi (OVD) dhe kredi biznesi, kjo si rezultat edhe i numrit më të madh të klientëve që kanë llogari rrjedhëse dhe paga marrësve.

31. Kredia kufi (OVD) ka tregues HHI shumë të lartë në vlerën 2,261 (2016), 1,994 (2017) dhe 1,736 (2018). Niveli shumë i lartë i përqendrimit për kredinë kufi (OVD) dhe kredinë konsumatorë e bankave nën hetim, në kuptim të ligjit nr. 9121/2003 është një tregues i qëndrueshmërisë së pjesëve të tregut për këto banka.

32. Nga analiza e normës së interesit të kredisë kufi (OVD) u konstatua se:

- BISP dhe BKT kanë ofruar interesa konstante gjatë gjithë periudhës hetimore, të cilat variojnë nga 22% në lekë, në 17% në euro për BISP, dhe 12% në lekë e 9% në euro për BKT.
- BR paraqet normat më të ulta të kredisë kufi (OVD) në lekë (6%-9%) dhe me trend të njëjtë me normën mesatare të interesit të sektorit bankar për këtë produkt.
- BKT ka norma të përafërta me BR për kredinë kufi (OVD) në euro me rreth 9%.
- BC paraqet norma me interesa të ndryshueshme për gjithë periudhën hetimore.

33. Në lidhje me komisionet e aplikuara për kredinë kufi (OVD) për biznesin vërehet se:

- Komisionet nuk kanë ndryshuar që nga viti 2016, si në monedhën lek ashtu dhe në euro;
- BR ka komisionin më të lartë në lidhje me vonesat në masën 25%.

34. Për komisionet e kredisë kufi (OVD) për individë vihet re se:

- BR ka patur ndryshime në nivele shumë të ulta nga 28.2% në 26.7%
- BKT aplikon komisionet të larta, të cilat kanë qenë të pandryshueshëm për periudhën hetimore, në lidhje me penalitetin për pagesat me 48% në monedhën lek.
- Komisionet më të larta për penalitetet i ka BR dhe BISP me rreth 20% dhe BKT me rreth 36%, BC 10 %.

35. Nga analiza e spread-it u konstatua se:

- BR spreadin me të ulët me rreth 6%-8% .
- BC dhe BKT kanë spread thujtë të njëjtë me rreth 9%-10%, pra aplikojnë diferenca thujtë të njëjta mes bono thesari dhe normës respektive të kredisë kufi (OVD).
- BISP ka spread-in me të lartë me rreth 20%.
- Trendet e spread-it të overdraftit me yield-in e bonove të thesarit, krahasuar mes bankave nën hetim, paraqiten me luhatje të lehta. Duket se BR, BKT dhe BC kanë norma interesi për kredi kufi (OVD) të përafërta.

36. Kredia konsumatore ka tregues HHI të lartë në vlerën 1,822 (2016), 1,803 (2017) dhe 2,049 (2018). Niveli shumë i lartë i përqendrimit në kuptim të ligjit nr. 9121/2003 është një tregues i qëndrueshmërisë së pjesëve të tregut për këto banka.

37. Për kredinë konsumatore vihet re se:

- BKT ka normat më të ulta në lekë nga 4%-5.5% ndërkohë që nuk ofron kredi në euro.
- BISP ka normat më të larta të kredisë konsumatore në euro me rreth 13%,
- BC dhe BR kanë norma të përafërta si në monedhën euro me rreth 4%-5% dhe lekë me rreth 8%-9%.

38. Në lidhje me analizën e spread-it u konstatua se:

- BKT paraqitet me spread-in më të ulët nga 1% deri në 3.4% për bono thesari. Në lidhje me depozitën 12mujore ky spread është konstant.
- BISP është banka me spread-in e dytë më të ulët si në lidhje me bono thesari dhe me depoziten-12

mujore.

- BR ka spread-in me të lartë se bankat e tjera nga 5% deri në 6.5%, kjo pasi siç u evidentua dhe tek pjesa e depozitave, kjo bankë aplikon interesat më të ulta të depozitave të gjithë sistemit bankar.
39. Përsa i përket komisioneve për kredinë konsumatore si në monedhën vendase dhe në euro vihet re se nuk ka ndryshime në vite. BR dhe BKT aplikojnë komisionet më të larta në lidhje me penalitetin për shlyerje të vonuar të këstit përkatësisht me 48% dhe 36%.
40. Kredia hipotekore ka treguesin HHI mesatarisht të përqendruar në vlerat 1,309 (2016), 1,325 (2017) dhe 1,351 (2018). Numrin më të madh të klientëve në kredinë hipotekore e ka BKT.
41. Normat e interesit të kredisë hipotekore të aplikuara nga bankat, si në lekë dhe në euro janë të ndryshueshme, vihet re si më poshtë:
- BC aplikon norma më të larta me rreth 7%-5%.
 - BR aplikon normat më të ulta, rreth 3%-5%.
 - BISP për kredinë hipotekore në euro ofron normat më të larta me rreth 4.75%
42. Për Kredinë hipotekore konstatohet se nuk ka ndryshime të komisioneve të aplikuara. Në lidhje me komisionin për shlyerje të vonuar për kredinë hipotekore në monedhën vendase, për BR komisioni është në masën 48% dhe BKT 36%.
43. Kredia e biznesit ka treguesin HHI mesatarisht të përqendruar në vlerat 1,560 (2016), 1,502 (2017) dhe 1,510 (2018).
44. Për kredinë për investime për biznesin e madh në lekë dhe euro u konstatua se:
- BKT dhe BR kanë normat më të ulta të interesit.
 - BISP ka norma fikse në 8%.
 - BC ka normat më të ndryshueshme përgjatë periudhës hetimore.
45. Në lidhje me komisionet që aplikohen për kredinë për biznesin (e cila konsiderohet si kredia me më shumë risk nga ana e bankave vihet re se:
- BR aplikon të njëjtat komisione si në kreditë e tjera.
 - BKT dhe BC komisionet janë tepër të ulta në raport me ato që aplikohen në llojet e tjera të kredive.
46. **Sistemi pagesave (transfertat bankare)** është tërësia e instrumenteve, procedurave bankare dhe sistemeve të transferimit të fondeve ndërbankare, nëpërmjet të cilave bëhet e mundur qarkullimi i parave. Në vitet e fundit janë zhvilluar platforma të cilat sigurojnë shërbimin e transfertave elektronike, pagesat në internet, kartat e debitit, kartat e kreditit, “monedhat” elektronike etj.
47. Tregu i shërbimit të transfertave bankare hyrëse paraqitet mesatarisht i përqendruar ku indeksi i përqendrimit të tregut HHI paraqitet në vlerën 1,617 (2016), 1,673 (2017) dhe 1,667 (2018) dhe katër bankat nën hetim zotërojnë rreth 77% të këtij tregu sipas treguesit CR₄.
48. Përsa i përket komisioneve për transfertat hyrëse, bankat e nivelit të dytë në Shqipëri aplikojnë tarifa të ndryshme.
49. Për kategorinë klientë individ për transfertat hyrëse në monedhën Euro, bankat nën hetim aplikojnë një tarifë minimale që varion nga 5 Euro deri në 10 Euro. BKT është ajo që ofron tarifën më të ulët dhe BC

tarifën më të lartë.

50. Për kategorinë klientë Biznes për transfertat hyrëse në monedhën Euro, bankat nën hetim aplikojnë një tarifë minimale që varion nga 5 Euro deri në 12 Euro, ku BKT është ajo që ofron tarifën më të ulët dhe BR tarifën më të lartë.
51. Për kategorinë klientë Individ për transfertat hyrëse, tarifat maksimale të bankave nën hetim variojnë nga 50 Euro në 100 Euro, ku përsëri BKT është ajo që ofron tarifën më të ulët dhe BC tarifën më të lartë.
52. Për kategorinë klientë Biznes për transfertat hyrëse, tarifat maksimale variojnë nga 50 Euro në 100 Euro, ku përsëri BKT është ajo që ofron tarifën më të ulët dhe BC tarifën më të lartë.
53. Në vitet e fundit është konstatuar rritja e numrit të transfertave online për të cilat bankat nën hetim aplikojnë komisione në vlerë deri në 50% më të ulta krahasuar me transfertat tradicionale të realizuara në ambientet e bankës.
54. Bankat nën hetim, në **tregun e shërbimit të transfertave bankare dalëse**, sipas treguesit CR₄ zotërojnë me rreth 81% në vitin 2016 dhe 2017 dhe 80% në vitin 2018. Ky treg ka karakteristikat e një tregu shumë të përqendruar ku indeksi i përqendrimit HHI varion nga 2,045 deri 2,010 gjatë periudhës hetimore. Niveli shumë i lartë i përqendrimit në kuptim të ligjit nr. 9121/2003 është një tregues i qëndrueshmërisë së pjesëve të tregut për këto banka. Banka me pjesën më të madhe të tregut është BR me ~36% të tregut gjatë periudhës hetimore, BKT dhe BC zënë secila nga ~15% të tregut dhe BISP zë ~14% të strukturës së tregut të transfertave dalëse.
55. Në shërbimin e transfertave dalëse, BR, BISP dhe BC aplikojnë komisionin maksimal të miratuar nga BSH me vendimin nr.12 datë 23.02.2011 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloret “Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe AIPS” dhe “Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël AECH”, në vlerën 500 lekë për transfertat brenda bankës dhe 1500 lekë për transfertat jashtë bankës, ndërkohë që BKT aplikon një komision prej 100 lekë dhe 1,200 lekë për transfertat brenda dhe jashtë bankës. Edhe për klientin biznes, bankat ofrojnë të njëjtin komision. Për transfertat në monedhat e huaja, vërehet bankat nën hetim, përkatësisht BR dhe BC e kanë tarifën e tyre në vlerën 10 Euro, ndërsa BISP e ka komisionin minimum në vlerën 15 Euro për kategorinë klientë të bankës dhe BKT 8 Euro.
56. Nga krahasimi i vlerës së komisioneve dhe normave të interesit mes bankave nën hetim nuk është vënë re aplikim i komisioneve apo interesave të njëjta mes tyre. Konstatohet se bankat nën hetim aplikojnë vlera të larta për komisionet që shërbejnë si kosto penguese (switching cost) për ndryshimin e ofruesit të shërbimit apo marrjen e shërbimit nga klientët e interesuar.
57. Në vitet e fundit, është zgjeruar përdorimi i platformave elektronike, shërbimit e-banking, nëpërmjet të cilave bankat nën hetim u kanë mundësuar klientëve shërbimin e kontrollit të detajuar dhe në çdo kohë të gjendjes së llogarive, historikun e veprimeve, transaksionet e kryera dhe transferimin e parave si brenda bankës ashtu edhe jashtë saj.
58. Zgjerimi i shërbimeve të ofruara online nga bankat (pa rrjet degësh fizike) së bashku me ndërgjegjësimin e klientëve për përdorimin e tyre do të sjellë përfitime për klientin dhe bankat në drejtim të kostove administrative.
59. Bankat nën hetim përfaqësojnë 92.1% të fitimit neto të sistemit bankar në vitin 2018, me një rritje të lehtë nga vitet e kaluara. Banka me pjesën më të madhe të fitimit neto është BKT që përfaqësohet me 67.1% për vitin 2016 dhe 45% për vitin 2017 dhe 57% për vitin 2018. BR në vitin 2016 rezulton të jetë më rezultat negativ për shkak të sistemit në pasqyrat financiare të kredive të këqija, ndërkohë që për vitin 2017 dhe 2018 BR rezulton me fitim duke zënë përkatësisht 30% dhe 25% të fitimit të sistemit.

60. Nga vlerësimi i strukturës së të ardhurave, u konstatua se pjesa më e madhe e tyre është realizuar nga interesat e kredive, niveli i shpenzimeve për interesat e depozitave është ndjeshëm më i ulët se shpenzimet administrative dhe operacionale të bankave. Norma e ulët për interesat e depozitave dhe norma e larta të interesave për kreditë kanë sjellë fitime të konsiderueshme për bankat nën hetim.
61. *Për sa më sipër nga analiza e strukturës së tregut dhe vlerësimin të indikatorëve të përqendrimit për produktet / shërbimet e ofruara nga katër bankat nën hetim, rezulton se:*
62. *Tregu i llogarisë rrjedhëse, tregu i kredisë konsumatore, tregu i kredisë kufi (OVD), tregu i transfertave bankare hyrëse dhe tregu i transfertave bankare dalëse janë tregje shumë të përqendruar, dhe në kuptim të ligjit nr. 9121/2003 është një tregues i qëndrueshmërisë së pjesëve të tregut për bankat nën hetim.*
63. *Tregu i depozitës me afat, tregu i depozitës pa afat, tregu i kredisë së biznesit dhe tregu i kredisë hipotekore janë tregje mesatarisht të përqendruar dhe në kuptim të ligjit nr. 9121/2003 është përsëri një tregues i qëndrueshmërisë së pjesëve të tregut për bankat nën hetim.*
64. *Bankat nën hetim kanë qëndrueshmëri të pjesëve të tregut dhe kjo vjen për shkak se fuqia kundërvepruese e blerësve (klientëve të bankave) është e ulët.*
65. *Bankat nën hetim kanë përfitueshmëri të sigurt për shkak të pandryshueshmërisë së pjesëve të tregut të secilës bankë nën hetim.*
66. *Bankat nën hetim aplikojnë komisione të larta krahasuar me rrjetin e këtyre bankave në rajon dhe me bankat e tjera të sektorit bankar në vend.*
67. Në përfundim të procedurave hetimore rezulton se bankat nën hetim nuk plotësojnë kriteret e nenit 8 të ligjit nr.9121/2003 dhe nuk kanë pozitë dominuese.
68. Bankat e nivelit të dytë dhe bankat nën hetim duhet të garantojnë transparencë për shërbimet që ofrojnë, shërbime më cilësore me kosto më të ulët dhe produkte të reja, si dhe të krijojnë lehtësira për lëvizshmërinë e klientëve duke ulur kostot penguese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 3, neni 4, neni 8, neni 9, neni 24 pika d), neni 26, neni 43 neni 45 pika 1, dhe neni 74 I ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e shërbimeve bankare për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo, me kushte dhe detyrime.
2. Detyrimin e Bankës Raiffeisen, Bankës Kombëtare Tregtare, Bankës Credins dhe Bankës Intesa SanPaolo për të rishikuar brenda 1 viti nga marrja e këtij vendimi:
 - a) Komisionet e shërbimeve bankare drejt uljes për produktet e depozitave, kredive si dhe për shërbimet e transfertave e pagesave.
 - b) Normat e interesit për produktet depozita dhe kredi me synim ngushtimin e *spread*-it midis normave respektive.
 - c) Kostot penguese (*switching costs*) për lëvizshmërinë e klientëve nga një bankë në tjetrën.
 - d) Politikat e bankës për zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve on-line, për të mundësuar rritjen e shkallës së përfshirjes së popullatës në shërbimet bankare (financial inclusion).

3. Detyrimin e Bankës Raiffeisen, Bankës Kombëtare Tregtare, Bankës Credins dhe Bankës Intesa SanPaolo, që gjatë periudhës së zbatimit të detyrimit të pikës 2, të njoftojnë pranë Autoritetit të Konkurrencës për çdo ndryshim në normat e interesit në produktet e depozitave dhe kredive si dhe ndryshimet në komisione për shërbimet të ofruara.
 4. T'i rekomandojë Shoqatës Shqiptare të Bankave që në bashkëpunim me të gjitha bankat e nivelit të dytë, të përgatisin dhe zhvillojnë programe të edukimit financiar për të shpjeguar dhe argumentuar epërsinë e shërbimeve e-banking në zonat gjeografike ku shkalla e përdorimit është ende e ulët.
 5. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të Vendimit, bankat nën hetim ndëshkohen me penalitet sipas dispozitave të nenit 76, pika 1 germa a) e ligjit nr. 9121/2003.
 6. Monitorimin e sjelljes së Bankës Raiffeisen, Bankës Kombëtare Tregtare, Bankës Credins dhe Bankës Intesa SanPaolo për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.
 7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 725, Datë 19.11.2020

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020, vendosi:

I. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch – Farma” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK:

- i. në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
- ii. në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues;
- iii. në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.09.2020.

III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 muaj nga hapja e hetimit të thelluar.

2. Komisioni i Konkurrencës, vlerëson se me qëllim realizimin e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe

tregtimit me shumicë të termometrave si dhe për shkak të kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, është e nevojshme shtyrja e periudhës kohore të hetimit të thelluar deri në datën 31.12.2020.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 717 datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, pika “2”, të ndryshohet si vijon:
 2. *“Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.*
 - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 726, Datë 19.11.2020

“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “IMI – FARMA” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “IMI – FARMA” SHPK.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 35, neni 36 dhe neni 44, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e pikës “IV” të VKK nr. 717, datë 15.10.2020,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - iii. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.

3. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
4. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, në datën 19.10.2020 dhe 20.10.2020 inspektorët dolën në terren për të inspektuar ndërmarrjen “IMI – FARMA” SHPK, vendndodhja e kësaj ndërmarrje nuk u gjend.
6. Për sa më sipër, referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, ndërmarrja “IMI – FARMA” SHPK në datë 14.03.2020 ka vendosur fillimin e procedurave për likuidimin e shoqërisë. Në datën 20.03.2020 statusi i kësaj ndërmarrje është ndryshuar nga “Aktiv” në "Shoqëri në Likuidim e Sipër". Në datën 08.09.2020 statusi i kësaj ndërmarrje u ndryshua nga "Shoqëri në Likuidim e Sipër" në ndërmarrje e "Çregjistruar".
7. Ndërmarrja “IMI – FARMA” SHPK ka ushtruar aktivitet deri në datën 08.09.2020 që statusi i kësaj ndërmarrje është ndryshuar në ndërmarrje e “Çregjistruar”.
8. Inspektorët janë paraqitur pranë disa subjekteve farmaci me emrin “IMIFARMA”, dhe pas blerjes së disa produkteve sipas kuponit tatimor rezultoi me emrin “LIFEMED” SHPK.
9. Ndërmarrja “LIFEMED” SHPK, referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” është themeluar në datën 05.04.2018 dhe regjistruar në datën 12.04.2018. Kjo ndërmarrje ka vendosur si adresa të ushtrimit të aktivitetit të saj adresat ku ushtronte aktivitet ndërmarrja “IMI – FARMA” SHPK.
10. Referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” rezultoi se ndërmarrja me emrin tregtar “IMI PHARMA ALBANIA” SHPK është e themeluar po në datën 05.04.2018 dhe regjistruar në datën 17.04.2018.
11. Zyrtat qendrore të ndërmarrjeve “LIFEMED” SHPK dhe “IMI PHARMA ALBANIA” SHPK sipas ekstraktit historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” rezultojnë të jenë në të njëjtën adresë dhe më të njëjtin ortak.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 35, nenin 36 dhe nenin 44 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Ndërmarrja “IMI – FARMA” SHPK nuk do të jetë pjesë e këtij hetimi administrativ dhe pasojave që rrjedhin prej tij.
 - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 727, Datë 19.11.2020

“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MEDICAMENTA” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MEDICAMENTA” SHPK.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 35, neni 36 dhe neni 44, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e pikës “IV” të VKK nr. 717, datë 15.10.2020,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e pikës “IV” të VKK nr. 717, datë 15.10.2020,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.

3. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
4. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, në datën 22.10.2020 u krye inspektim pranë ndërmarrjes “MEGAPHARMA” SHPK.
6. Gjatë këtij inspektimi ndërmarrja “MEGAPHARMA” SHPK mori njoftim mbi Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”.
7. Sipas procesverbalit për marrje shpjegimesh me pyetje-përgjigje në përputhje me nenin 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, u morën në dorëzim dokumentat dhe provat materiale të kërkuara nga grupi i inspektimit.
8. Të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje. Bazuar në të dhënat përpunuara si rezultat i inspektimit, rezultoi se ndërmarrja “MEGAPHARMA” SHPK:
9. Ka realizuar shitje të produkteve alkool për periudhën janar – maj 2020 me një total prej 8 740 njësi. Produkti *AQUI - ALKOOL 70% ILIT AQUILA (I BARDHE)* në shkurt 2020 është blerë mesatarisht me 195.7 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 300 lekë/copë. Në mars 2020 është blerë mesatarisht me 224.5 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 301.6 lekë/copë. Në prill 2020 është blerë mesatarisht me 260.4 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 390 lekë/copë. Në muajin maj është blerë mesatarisht me 250 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 289.2 lekë/copë. Për produktin *AQUI - ALKOOL 70% ILIT AQUILA (I BARDHE)* konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës shkurt – prill 2020.
10. Ka realizuar shitje të produkteve gel-dezinfektant për periudhën janar – maj 2020 me një total prej 6 075 njësi. Produkti *GHG - GEL HAND 500ML (AQUILA)* në shkurt 2020 është blerë mesatarisht me 266.7 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 408 lekë/copë. Në mars 2020 është blerë mesatarisht me 275 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 359.6 lekë/copë. Në prill 2020 është blerë mesatarisht me 271.7 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 381.2 lekë/copë. Në muajin maj po ky produkt është shitur mesatarisht me 262 lekë/copë. Për produktin *GHG - GEL HAND 500ML (AQUILA)* konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës shkurt – prill 2020

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 35, nenin 36 dhe nenin 44 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hyrjen në fuqi të gjobës për ndërmarrjen “MEGAPHARMA” SHPK për moszbatim të masës së përkohshme në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes “MEGAPHARMA” SHPK të zbatojë nenin 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 745, Datë 19.11.2020

“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FARMA NET ALBANIA” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FARMA NET ALBANIA” SHPK.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 35, neni 36 dhe neni 44, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e pikës “IV” të VKK nr. 717, datë 15.10.2020,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar

informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.

4. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënie të disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, në datën 26.10.2020 dhe 27.10.2020 u krye inspektim pranë ndërmarrjes “FARMA NET ALBANIA” SHPK.
6. Gjatë këtij inspektimi ndërmarrja “FARMA NET ALBANIA” SHPK mori njoftim mbi Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”.
7. Sipas procesverbalit për marrje shpjegimesh me pyetje-përgjigje në përputhje me nenin 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, u morën në dorëzim dokumentat dhe provat materiale të kërkuara nga grupi i inspektimit.
8. Të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-bletjet e realizuara nga kjo ndërmarrje. Bazuar në të dhënat përpunuara si rezultat i inspektimit, rezulton se ndërmarrja “FARMA NET ALBANIA” SHPK:
9. Ka realizuar shitje të produkteve maska për periudhën janar – maj 2020 me një total prej 951 148 copë. Produkti FACE MASK X 50 në shkurt 2020 është blerë mesatarisht me 6.2 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 12.0 lekë/copë. Në mars 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 11.4 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 85.8 lekë/copë. Edhe gjatë muajit prill ky produkt është shitur mesatarisht me çmim 78.7 lekë/copë. Në muajin maj, produkti është blerë mesatarisht me 35 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 80.0 lekë/copë. Për produktin FACE MASK X 50 konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës shkurt – maj 2020.
10. Ka realizuar shitje të produkteve alkool për periudhën janar – maj 2020 me një total prej 14 918 njësi. Produkti ALKOOL ETILIK I CNATYRUAR 70 _1L në mars 2020 është blerë mesatarisht me 343.6 lekë/njësi dhe shitur me mesatarisht 582.2 lekë/njësi. Në prill 2020 është blerë mesatarisht me 333.3 lekë/njësi dhe shitur mesatarisht me 655.7 lekë/njësi. Në maj 2020 është blerë mesatarisht me 266.7 lekë/njësi dhe shitur mesatarisht me 504.9 lekë/njësi. Për këtë produkt, ALKOOL ETILIK I CNATYRUAR 70 _1L, konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës mars – maj 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 35, nenin 36 dhe nenin 44 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hyrjen në fuqi të gjobës për ndërmarrjen “FARMA NET ALBANIA” SHPK për moszbatim të masës së përkohshme në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes “FARMA NET ALBANIA” SHPK të zbatojë nenin 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 746, Datë 19.11.2020

“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FLORIFARMA” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FLORIFARMA” SHPK.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 35, neni 36 dhe neni 44 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e pikës “IV” të VKK nr. 717, datë 15.10.2020,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar

informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.

4. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënie të disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, në datën 30.10.2020 u krye inspektim pranë ndërmarrjes “FLORIFARMA” SHPK.
6. Gjatë këtij inspektimi ndërmarrja “FLORIFARMA” SHPK mori njoftim mbi Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”.
7. Sipas procesverbalit për marrje shpjegimesh me pyetje-përgjigje në përputhje me nenin 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, u morën në dorëzim dokumentat dhe provat materiale të kërkuara nga grupi i inspektimit.
8. Të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e përpunuara si rezultat i inspektimit, rezulton se ndërmarrja “FLORIFARMA” SHPK:
9. Ka realizuar shitje të produkteve alkool për periudhën janar – maj 2020 me një total prej 6 129 njësi. Produkti *ALK_2 - ALKOL 70 * ILT* në shkurt 2020 është blerë mesatarisht me 208.3 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 235.2 lekë/copë. Në mars 2020 është blerë mesatarisht me 243.1 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 263.6 lekë/copë. Në prill 2020 po ky produkt është blerë mesatarisht me 250 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 300.4 lekë/copë. Në muajin maj është blerë mesatarisht me 208.3 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 294.5 lekë/copë. Për produktin *ALK_2 - ALKOL 70 * ILT* konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës shkurt – maj 2020.
10. Ka realizuar shitje të produkteve gel-dezinfektant për periudhën janar – maj 2020 me një total prej 3 248 njësi. Produkti *DIZ_22 - DEZIFEKTUES DUARSH *ILT* në mars 2020 është blerë mesatarisht me 375 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 450 lekë/copë. Në prill 2020 është blerë mesatarisht me 308.3 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 391.5 lekë/copë. Në maj 2020 është blerë mesatarisht me 267.2 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 469.4 lekë/copë. Për produktin *DIZ_22 - DEZIFEKTUES DUARSH *ILT* konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës mars – maj 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 35, nenin 36 dhe nenin 44 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hyrjen në fuqi të gjobës për ndërmarrjen “FLORIFARMA” SHPK për moszbatim të masës së përkohshme në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes “FLORIFARMA” SHPK të zbatojë nenin 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 747, Datë 19.11.2020

“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “CFO PHARMA” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “CFO PHARMA” SHPK.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 35, neni 36 dhe neni 44, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e pikës “IV” të VKK nr. 717, datë 15.10.2020,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar

informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.

4. Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 110/20 prot., datë 26.5.2020 “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar ndërmarrjes “CFO PHARMA”, në lidhje me shit-blerjet analitike për periudhën 1 janar 2020 deri 31 maj 2020, me afat për kthim-përgjigje brenda datës 10.06.2020. Ndërmarrja “CFO PHARMA” nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Autoriteti të Konkurrencës.
5. Për sa më sipër, mosbashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës gjatë procedurës së hetimit paraparak në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore, vlerësohet si rrethanë rënduese në sjelljen e tyre.
6. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
7. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, në datat 23.10.2020 dhe 27.10.2020 u krye inspektim pranë ndërmarrjes “CFO PHARMA” SHPK.
8. Gjatë këtij inspektimi ndërmarrja “CFO PHARMA” SHPK mori njoftim mbi Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”.
9. Sipas procesverbalit për marrje shpjegimesh me pyetje-përgjigje në përputhje me nenin 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, u morën në dorëzim dokumentat dhe provat materiale të kërkuara nga grupi i inspektimit.
10. Të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, rezulton se ndërmarrja “CFO PHARMA” SHPK:
11. Ka realizuar shitje të produkteve maska për periudhën janar – maj 2020 me një total prej 135 565 copë. Produkti *Maska Kirurgjikale X 50cope* në janar 2020 është blerë mesatarisht me 2.5 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 7.3 lekë/copë. Në shkurt 2020 është blerë mesatarisht me 5.8 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 8.1 lekë/copë. Në prill 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 41.3 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 58.5 lekë/copë. Në muajin maj, produkti është blerë mesatarisht me 29.2 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 58.6 lekë/copë. Për produktin *Maska Kirurgjikale X 50cope* konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës janar – maj 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 35, nenin 36 dhe nenin 44 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hyrjen në fuqi të gjobës për ndërmarrjen “CFO PHARMA” SHPK për moszbatim të masës së përkohshme dhe mos dhënie informacioni në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes “CFO PHARMA” SHPK të zbatojë nenin 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 748, Datë 19.11.2020

“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “DELTA PHARMA - AL” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “DELTA PHARMA - AL” SHPK.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 35, neni 36 dhe neni 44, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003)..

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e pikës “IV” të VKK nr. 717, datë 15.10.2020,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar

informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.

4. Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 110/20 prot., datë 26.5.2020 “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar ndërmarrjes “DELTA PHARMA - AL”, në lidhje me shit-blerjet analitike për periudhën 1 janar 2020 deri 31 maj 2020, me afat për kthim-përgjigje brenda datës 10.06.2020. Ndërmarrja “DELTA PHARMA - AL” nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Autoriteti të Konkurrencës.
5. Për sa më sipër, mosbashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës gjatë procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore, vlerësohet si rrethanë rënduese në sjelljen e tyre.
6. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
7. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, në datën 21.10.2020 u krye inspektim pranë ndërmarrjes “DELTA PHARMA - AL” SHPK.
8. Gjatë këtij inspektimi ndërmarrja “DELTA PHARMA - AL” SHPK mori njoftim mbi Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”.
9. Sipas procesverbalit për marrje shpjegimesh me pyetje-përgjigje në përputhje me nenin 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, u morën në dorëzim dokumentat dhe provat materiale të kërkuara nga grupi i inspektimit.
10. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, rezulton se ndërmarrja “DELTA PHARMA - AL” SHPK vetëm në muajin maj 2020 ka shitur një sasi prej 1 458 gel dezinfektant të paketimit 80 ml, me çmim konstant prej 154.32 lek/copa.
11. Ndërmarrja “DELTA PHARMA - AL” SHPK nuk ka realizuar shitje të produkteve maska dhe alkool për periudhën 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 35, nenin 36 dhe nenin 44 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hyrjen në fuqi të gjobës për ndërmarrjen “DELTA PHARMA - AL” SHPK për mosdhënie informacioni në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes “DELTA PHARMA - AL” SHPK të zbatojë nenin 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 749, Datë 19.11.2020

“Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FUFARMA” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FUFARMA” SHA.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 35, neni 36 dhe neni 44, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e pikës “IV” të VKK nr. 717, datë 15.10.2020,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar

informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.

4. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënie të disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, në datën 22.10.2020 u krye inspektim pranë ndërmarrjes “FUFARMA” SHA.
6. Gjatë këtij inspektimi ndërmarrja “FUFARMA” SHA mori njoftim mbi Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”.
7. Sipas procesverbalit për marrje shpjegimesh me pyetje-përgjigje në përputhje me nenin 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, u morën në dorëzim dokumentat dhe provat materiale të kërkuara nga grupi i inspektimit.
8. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje. Bazuar në të dhënat përpunuara si rezultat i inspektimit, rezultoi se ndërmarrja “FUFARMA” SHA ka realizuar blerje të vetëm të një lloji, gel-dezinfektant të markës "Alcolina Gel Mani 100 ml Two Bee", me një sasi prej 29 994 copë në prill 2020, me çmim 157 lekë/copë. Ka realizuar shitje të këtij produkti gjatë periudhës prill – maj 2020 me një sasi prej 12 456 copë, me çmim të pandryshuar prej 210 lekë/copë.
9. Ndërmarrja “FUFARMA” SHA nuk ka realizuar shitje të produkteve maska dhe alkool për periudhën 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 35, nenin 36 dhe nenin 44 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hyrjen në fuqi të gjobës për ndërmarrjen “FUFARMA” SHA për moszbatim të masës së përkohshme në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
 - II. Detyrimin e ndërmarrjes “FUFARMA” SHA të zbatojë nenin 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
 - III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 751, Datë 26.11.2020

“Për vlerësimin ligjor mbi përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret e “Marrëveshjes së bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për vlerësimin ligjor mbi përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret e “Marrëveshjes së bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.

Baza ligjore: Neni 4 dhe neni 6 dhe, 24 germa (d) dhe neni 70 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Në mbështetje të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 276, datë 18.03.2013 “Për miratimin e rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”, Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 4316 prot., datë 22.10.2020 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës më nr. 45/4 prot., datë 28.10.2020), ka depozituar “Marrëveshjen e bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.
2. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, është në përputhje me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 276, datë 18.03.2013 “Për miratimin e rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”.
3. Palët pjesëmarrëse në marrëveshje shprehën se për zbatimin e kësaj marrëveshje do të përcaktojnë modalitetet si për mënyrën e shitjes dhe administrimit, por edhe të kontrollit pa tejkalar parashikimet e kësaj marrëveshjeje, duke siguruar që në asnjë rast zbatimi i marrëveshjes të mos jetë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në fushën e sigurimeve dhe parimeve të konkurrencës së lirë në treg, marrëveshja të mos kufizojë produktin apo shitjet, të mos ndajë tregun, apo përcaktojë, apo ndajë primet.
4. Objekti i kësaj marrëveshjeje është në përputhje të plotë me ligjin, direktivat e Bashkimit Europian dhe rregullat e Komisionit Shqiptar të Konkurrencës dhe konkretisht i referohet (i) metodologjisë së

përlllogaritjes të tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve, ii) vendosjen e kushteve të plloçave standarde të përbashkëta, (iii) mbulimi i zakonshëm për disa lloje të caktuara rreziqesh, (iv) shlyerja e dëmeve, (v) sistemi i shitjes si dhe testimi dhe pranimi i pajisjeve të sigurisë dhe (vi) regjistrat dhe informacioni mbi rreziqet e rënda.

5. Qëllimi i marrëveshjes do të jetë shkëmbimi i informacionit mes palëve në marrëveshje për mbulimin e risqeve të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta MTPL e brendshme për vendosjen e standarteve në drejtim të sigurimit të mosfalsifikimit të policave të sigurimit MTPL e brendshme, shqyrtimin e informacionit (i cili mund të përfshijë disa llogaritje statistikore) duke lejuar llogaritjen e kostos mesatare të mbulimit të një rreziku specifik në të shkuarën ose për siguracionin e jetës, tabelat e normave të vdekshmërisë apo të frekuencës së sëmundjeve, aksidentet dhe invaliditeti ose të tjera të lidhura me MTPL, të cilat bëjnë të mundur përmisimin e njohurive mbi rreziqet dhe lehtëson vlerësimin e rreziqeve për kompanitë individuale.
6. Palët pjesëmarrëse në marrëveshje shprehen se janë dakord të plotësojnë dhe mos shkelin asnjë nga parashikimet e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar dhe Rregullores "Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve".
7. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare referuar shkresës nr. 2722/1 prot., datë 17.11.2020 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me nr. 45/6 prot., datë 17.11.2020 "Përgjigje Tuajës nr. 45/5 prot., datë 02.11.2020" është shprehur se bazuar në nenin 10 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar, miraton çdo vit për çdo shoqëri sigurimi tabelat e primit të rrezikut për përlllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta. Raportimi i shitjeve të këtyre kontratave behet në kohë reale në Qendrën e Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme, sipas nenit 38 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009. Gjithashtu bazuar në nenin 194, pika 2 të Ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", veprimtaria e agjentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëria e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.
8. Referuar Raportit të Monitorimit të Autoritetit të Konkurrencës nr. 222/74 prot., datë 24.10.2020 "Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 637, datë 09.07.2019 "Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit nr. 561, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës për produktin TPL e brendshme", rezulton se :
 - i. Shoqëritë e sigurimit, në zbatim të VKK nr. 637, datë 09.07.2019 "Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit nr. 561, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës për produktin TPL e brendshme", kanë zbatuar rekomandimet.
 - ii. AMF me Vendimin nr. 62, datë 27.03.2019 "Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përlllogaritjen e nivelit të provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, ka vendosur: Miratimin e tabelës së primit të rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti për kontratat TPL, police kufitare dhe karton jeshil, ka miratuar prime rreziku individuale për çdo shoqëri.
9. Për sa më sipër vlerësohet se marrëveshja është në përputhje me Ligjin nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar dhe me nenin 3 të Rregullores "Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa

kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”, miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 276, datë 18.03.2013.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 6, nenin 24 germa (d) dhe nenin 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Marrëveshja e bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, për nga objekti dhe qëllimi është në përputhje me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe me nenin 3 të Rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve” miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 276, datë 18.03.2013.
2. Në marrëveshjen e bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, të shtohen kushtet dhe detyrimet si më poshtë vijon:
 - i. marrëveshja mos të kufizojë produktin MTPL apo shitjet;
 - ii. marrëveshja mos të ndajë tregun apo klientët që blejnë produktin MTPL; dhe
 - iii. ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë marrëveshje bashkëpunimi duhet të mos kenë rënë dakord për primet e shitjes, të zbatuara për produktin MTPL.
3. Në pikën II.2 “Qëllimi i Marrëveshjes” të përcaktohet periudha kohore për të cilën do të shkëmbet informacioni me qëllim realizimin e llogaritjeve të përbashkëta, tabelave dhe studimeve të përbashkëta.
4. Në marrëveshjen përfundimtare mes palëve, të shtohet, si më poshtë vijon:
 - i. Shoqëritë duhet të vazhdojnë ta tregtojnë policën e sigurimit të detyrueshëm me logot respektive.
 - ii. Palët të raportojnë pranë Autoritetit të Konkurrencës për masat që kanë si synim të marrin për sigurimin e mosfallsifikimit të policave të sigurimit të brendshëm MTPL për të vlerësuar nëse këto masa mund të çojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.
 - iii. Palët të vendosin në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës, informacionin e shkëmbyer në bazë të marrëveshjes sa herë që kërkohet nga ky autoritet.
5. Në pikën II.3 “Detyrimet e palëve” të shtohet se palët kanë detyrimin që “Të mos japin asnjë informacion në lidhje me çmimin e policës së sigurimit, nivelin e fitimeve, kostot apo çdo element tjetër që ndikon në përcaktimin e çmimit fundor të policës së sigurimit, si dhe çdo informacion tjetër që mund të dëmtojë konkurrencën në treg”.
6. Në pikën II.6 “Kontrolli i zbatimit të marrëveshjes” të shtohet “Në rast përjashtimi të palëve nga marrëveshja të njoftohet Autoriteti i Konkurrencës për këtë fakt”.
7. Në pikën III.2 “Afati i vlefshmërisë së marrëveshjes” të ndryshohet dhe të shtohet “Afati i marrëveshjes do të jetë 2 vjet.” Palët në marrëveshje rezervojnë të drejtën për ripërsëritur këtë marrëveshje bashkëpunimi në rast të respektimit të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim.
8. Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, palët duhet të zbatojnë në nenin 10 dhe nenin 38 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar dhe nenin 194, pika

2 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

9. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

10. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 752, Datë 03.12.2020

“Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch – Farma” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vendosi:

I. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjeve ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch – Farma” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK:

i. në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;

ii. në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues;

iii. në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.09.2020.

III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 muaj nga hapja e hetimit të thelluar.

2. Në zbatim të urdhrit nr. 409, datë 16.11.2020 dhe nr. 409/1, datë 18.11.2020 “Për monitorimin në tregun e tregtimit me shumicë të produkteve maska, alkool, gel-dezinfektant dhe termometra“, u realizuan monitorime pranë ndërmarrjeve “Capital Group” SHPK, “Euromed” SHPK, “Biometric” SHPK, “Florfarma” SHPK, “Aquarius Medical” SHPK, “New Medical Plus” SHPK, “Fedos” SHPK, “Winpharma” SHPK, “Çene” SHPK, “Imipharma Albania” SHPK dhe “Lifemed” SHPK.
3. Për sa më sipër, me qëllim realizimin e një analize të plotë të ndërmarrjeve të cilat sipas monitorimit janë konstatuar se ushtrojnë aktivitet në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerësohet se është e nevojshme hapja e procedurës së hetimit të thelluar edhe ndaj ndërmarrjeve “Capital Group” SHPK, “Florfarma” SHPK, “Euromed” SHPK, “Aquarius Medical” SHPK, “New Medical Plus” SHPK, “Fedos” SHPK dhe “Winpharma” SHPK.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716 datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet si vijon:
“Capital Group” SHPK, “Florfarma” SHPK, “Euromed” SHPK, “Aquarius Medical” SHPK, “New Medical Plus” SHPK, “Fedos” SHPK dhe “Winpharma” SHPK.
 - II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020.
 - III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIME ME OBJEKT - ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE

VENDIM
Nr. 674, Datë 23.01.2020

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Roskovec” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.01.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Roskovec” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe neni 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Roskovec SHA,

VËREN SE:

1. ERRU nëpërmjet shkresës Nr. 444 prot., datë 06.12.2019, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr. 79 prot., datë 26.11.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Roskovec SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Roskovec SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e treguesve të performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale.
3. ERRU thekson që shoqëria “UK Roskovec” SHA aplikon tarifa të miratuara nga ERRU të diferencuara, për të gjithë zonën e shërbimit dhe kërkon unifikimin e tarifave për të gjithë zonën pas riorganizimit bazuar në:
 - Vendimin Nr. 9, datë 21.04.2014 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për ndërmarrjen UK Fier SHA”, pjesë e së cilës ka qenë pjesërisht deri në Nëntor 2017 për tre nga njësitë administrative, ndërsa për tre njësi të tjera nuk është ofruar shërbimi nga asnjë shoqëri Ujësjellësi, por administroheshin nga komunat respektive dhe tarifat përcaktoheshin nga Këshillat e Komunave.

- Aplikimi i tarifave të propozuar për t'u miratuar nga UK Roskovec SHA ka filluar që në vitin 2018 pas licensimit nga ERRU me vendimin Nr. 53, datë 23.11.2017.
- 4. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja ka aplikuar tarifat (50 lek/m³ 52 lek/m³ si edhe 60 lek/m³). Tarifa e propozuar për zonën e riorganizuar është 52 lek/m³ duke pësuar një rritje maksimumi 3,6% në disa zona dhe ulje nga zero% deri në 13.33% më pak se tarifa aktuale e propozuar për miratim nga UK tek ERRU. Kjo vlerë është propozuar nga ERRU të jetë 52 lek/m³ për të gjithë zonën e shërbimit të furnizimit me ujë.
- 5. Njëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Roskovec SHA, propozon rritje të tarifave për të mundësuar ndryshimin e tyre të ligjëruar, për konsumatorin familjar në të gjitha zonat në vlerën 45 lek/m³, duke pësuar një rritje që varion nga 12 lek/m³ deri në 20 lek/m³ për konsumatorët familjarë; tarifa për konsumatorët publik pëson një rritje nga 30 lek/m³ deri në 50 lek/m³ për të gjithë zonën pas riorganizimit, ndërsa për konsumatorët privatë rritja varion nga 20 lek/m³ deri në 30 lek/m³. Propozohet ndryshim i tarifës fikse duke pësuar një rritje nga 20 lek/muaj/lidhje deri në 100 lek/muaj/lidhje për konsumatorin familjar, një rritje nga 50 lek/muaj deri në 150 lek/muaj/lidhje të tarifës aktuale, tarifa fikse për konsumatorin publik dhe privat rritet. Tarifa volumetrike për largimin e ujërave të ndotura, propozohet një rritje me 4 lek/ m³ deri në 15 lek/m³ për konsumatorin familjarë, 12 lek/m³ deri në 25 lek/m³ për konsumatorin publik dhe për konsumatorin privat.
- 6. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2019 dhe vitin 2020 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, duke reduktuar kostot e mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar uljen e humbjeve teknike dhe administrative si edhe synimin kryesor për rritjen e qëndrueshmërisë financiare, transparencën në përfitimin e investimeve, rritjen e efikasitetit në faturime dhe menaxhimin e humbjeve teknike.
- 7. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Roskovec SHA pas riorganizimit arrin të mbulojë kostot e operim mirëmbajtjes pasi ajo parashikohet të jetë në masën 107 % gjatë 2019. UK Roskovec SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që tentojnë të mbulojnë mbi nivelin 100% kostot e operim & mirëmbajtjes.
- 8. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Roskovec SHA për vitin 2019 do të përmirësojë nivelin e lartë të humbjeve nga 77.1% në 75.9% njëpërmjet një plani të detajuar të ndarë në faza për reduktimin e humbjeve të cilat ndikojnë në përmirësimin e performancës financiare. Ndërmarrja UK Roskovec SHA duhet të mbajë në kontabilitet të ndara sipas llojit të shërbimit të ofruar kostot përkatëse, me qëllim që edhe tarifat të orientohen drejt kostove.
- 9. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Roskovec SHA duhet të punojë për reduktimin e nivelit të humbjeve teknike dhe administrative, duke angazhuar stafin për vlerësimin sa më të saktë të çdo komponenti që bilanci të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të mbajë evidenca mbi sasinë e ujit që nuk maten, mbi sasinë e autorizuara të pa faturuara, etj., si edhe të hartojë Bilancin e Ujit sa më real, në të gjithë zërat e tij. Gjithashtu, të gjitha pikat e prodhimit edhe pikat kryesore të rrjetit duhet të pajisen me matësa të mëdhenj me qëllim zbatimin e një strategjie të leximit dhe regjistrimit rigoroz të burimit, çdo ditë dhe çdo muaj.
- 10. Tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Roskovec SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.

11. Duke qenë se ndërmarrja nuk ka instaluar matësa në prodhim, në pikat kryesore të rrjetit, niveli i humbjeve administrative dhe real është shumë i lartë, rekomandohet të analizojë historikun e debisë nga mos pagimi i faturave të shërbimeve UK, si edhe të hartojë një plan të detajuar për vjeljen e debive të prapambetura. Gjithashtu, duhet të menaxhojë saktë dhe të shlyejë në kohë detyrimet ndaj furnitorëve me qëllim reduktimin e kostove shtesë që kanë të bëjnë me kamatë vonesat duke përfituar edhe nga subvencionet e alokuara nga Qeveria. Të gjitha investimet duhet të jenë sa më transparente, të përshtatshme, efikase dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
12. Nga vlerësimi i konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Roskovec SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Roskovec SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Roskovec SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura gjithashtu dhe kostot për shërbimin e ofruar me ngritje mekanike apo me rënie të lirë.
13. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).
14. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, gjithashtu është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe (f), nenin 69 dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 - a. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Roskovec SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 - b. ERRU të kërkoj nga Ujësjiellës Kanalizime Roskovec SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 - c. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 693, Datë 14.05.2020

“Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.05.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve.

Baza ligjore: Neni 8, neni 9, pika 2, germa (a), neni 24 germa (d), neni 26, neni 45, neni 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi gjetjet e raportit të hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit; shkresës nr.223 prot., datë 06.02.2020 të FSHF, protokolluar me tonën, me nr.55/19 prot., datë 07/02/2020 “Komente përfundimtare dhe angazhime të FSHF mbi vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 607/2019”; shkresës nr.55/21 prot., datë 27.04.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Relacion mbi shkresën e FSHF “Komente përfundimtare të FSHF mbi Vendimin e KK nr.607, datë 01.04.2019”;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka filluar monitorimin në sektorin e sportit të futbollit, si treg në të cilin kryet veprimtari ekonomike mbështetur në praktikat e trajtuara nga Komisioni European dhe Autoritetet e Konkurrencës në BE, nga ku rezultoi se në Bashkimin European ekziston një praktikë e gjerë mbi ndërhyrjen e konkurrencës për të rregulluar tregun në sektorin e sportit të futbollit, pasi konsiderohen se subjektet që e ushtrojnë këtë aktivitet, i nënshtrohen ligjit të konkurrencës si subjekte që zhvillojnë aktivitet ekonomik.
2. Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, nenit 8, nenit 9 dhe nenit 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, (ligji nr. 9121/2003) me Vendimin nr. 564, datë 25.10.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon për periudhën kohore 2015-2018.
3. Në bazë të nenit 35 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, dhe në zbatim të Vendimit nr. 564, datë 25.10.2018 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 631, datë 07.11.2018 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë Federatës Shqiptare të Futbollit, duke marrë shpjegime për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve.

4. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Klubeve të Futbollit.
5. Koha e mbetur në dispozicion është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së FSHF-së, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 564, datë 25.10.2018.
6. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, nenit 24, shkronja (d) dhe nenit 42, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2016 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me anë të Vendimit nr. 583, datë 17.01.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 564, datë 25.10.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”, vendosi për të shtyrë afatin e përgatitjes dhe dorëzimit të raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 25 Prill 2019.
7. Në përfundim të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës konkludoi se nga analiza e sjelljes së FSHF në tregjet përkatëse konstatohet: (i) Shitja e të drejtës audiovizive tek një operator i vetëm për një periudhë të gjatë 7 vjet, duke përfshirë në një paketë të vetme të gjithë të drejtat ekskluzive, duke u bërë përjashtuese për operatorët e tjerë; (ii) çmime të shitjes së biletave të larta krahasuar me rajonin, të pa mbështetura në një metodologji të miratuar, të cilat mund të kufizojnë konkurrencën në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.
8. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, me Vendimin nr. 607, datë 01.04.2019, vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit” për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore 01.01.2015 deri në 31.12.2018.
9. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 632, datë 20.06.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 607, datë 01.04.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit” vendosi të bëjë ndryshimin për zgjatjen e afatit: Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2015 deri në 30.04.2019.
10. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar Federatës Shqiptare të Futbollit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

11. Në bazë të nenit 3, pika 7 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përbëhet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”.
12. Produktet që duhet të përfshihen në tregun përkatës dhe kufijtë gjeografikë të atij tregu, përcaktohen në varësi të hapësirës në të cilën klientët mund të zgjedhin shumë lehtë midis produkteve të zëvendësueshme.
13. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.

II.1.1 Tregu përkatës i produktit

14. Në rastin tonë nuk kemi ndërmarrje të tjera që plotësojnë kushtet për t'u konsideruar si konkurrentë ekzistues pasi është e vetme FSHF. Në tregjet e shërbimeve si e drejta e transmetimit audiovizive është dhënë ekskluzivisht dhe konsumatorët nuk mund të këmbëjnë produktet me ato të tregut përkatës, në përgjigje të ndryshimeve të çmimeve.
15. Bazuar në sa më sipër, treg përkatës i produktit është i gjithë aktiviteti ekonomik i FSHF me produktet/shërbimet që kryen si: shitja e të drejtës së transmetimit të eventeve sportive në të cilën përfshihen ndeshjet e kategorisë superiore, kategorisë së parë, Kupa e Shqipërisë si dhe ndeshjet e ekipeve Kombëtare; shitja e biletave, sponsorizimet, etj.

II.1.2 Tregu përkatës gjeografik

16. Tregu përkatës gjeografik përcaktohet si: një treg përkatës gjeografik ku përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet përkatëse janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene dhe që mund të dallohen nga zona fqinjë sepse kushtet e konkurrencës janë vlerësuar të ndryshme në këto zona. Kështu edhe pse shet në Kosovë FSHF, kjo zonë dallohet nga parapëlqimet e konsumatorëve, rëndësia e preferencave kombëtare, informacioni mbi variacionet e çmimeve dhe të shitjeve sipas zonës, sa ju kushton klientëve për të kërkuar produktet që furnizohen nga zona të tjera gjeografike, diferencat e çmimeve në nivel kombëtar, si dhe nëse klientët e palëve zhvendosin porositë e tyre drejt ndërmarrjeve të vendosura diku tjetër në një periudhë afatshkurtër dhe me një kosto të pa konsiderueshme.
17. Si përfundim tregu përkatës gjeografik është i gjithë territori i Shqipërisë duke qenë se ky produkt tregtohet në të gjithë territorin me të njëjtat kushte.

II.2 Vlerësimi i Pozitës Dominuese

18. Në bazë të nenit 3, pika 5 të ligjit nr. 9121/2003, "Pozitë dominuese" është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
19. Sipas ligjit nr. 9121/2003, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese.
20. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të ligjit nr.9121/2003 janë: pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim dhe të konkurrentëve të tjerë; barrierat e hyrjes në tregun përkatës; konkurrenca potenciale; fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve; varësia ekonomike e furnizuesve dhe blerësve; fuqia kundërvepruese e blerësve/ konsumatorëve; zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së ndërmarrjeve dhe mundësitë e shfrytëzimit të burimeve të produkteve; lidhjet ekonomike me ndërmarrjet e tjera; karakteristika të tjera të tregut përkatës.
21. Në bazë të ligjit nr. 79/2017 "Për Sportin" FSHF është entiteti i vetëm të cilit shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare, në sportin e futbollit, konform këtij ligji. FSHF si organizatore e veprimtarive sportive është pronare e të drejtës së transmetimit të veprimtarisë futbollistike brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me konkurrim publik.
22. Në bazë të nenit 36 ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" - "Veprimtaria ekonomike e organizatës jofitimprurëse", cilësohet se për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të ushtrojë veprimtari ekonomike pa qenë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për këtë qëllim, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e organizatës jofitimprurëse, të

jetë deklaruar si një nga burimet e të ardhurave dhe me kusht që kjo veprimtari të mos përbëjë qëllimin primar të veprimtarisë së organizatës. Nëse organizata jofitimpurëse, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, realizon fitime, ato duhet të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit.

23. Sipas nenit 55 të Statutit të Federatës Shqiptare të Futbollit, FSHF dhe anëtarët e saj janë pronarë origjinalë të të gjitha të drejtave që dalin nga garat dhe ngjarje të tjera që vijnë nga juridiksioni respektiv i tyre. Këto të drejta përfshijnë midis të tjerash, çdo lloj të drejte financiare, audiovizuale dhe regjistrimin në radio, të drejtat e riprodhimit dhe transmetimit, të drejtat e multimedias, të drejtat e marketingut dhe reklamave, etj.
24. Detyrat e federatave janë përcaktuar në nenin 18, pika 2, të ligjit nr. 79/2017 “Për Sportin” ku asnjë person juridik, privat ose publik, nuk mund të ushtrojë asnjë nga kompetencat ekskluzive të federatës, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarisht prej saj.
25. Federatës Shqiptare të Futbollit i jepet një status monopol ligjor jo vetëm për organizimin dhe administrimin e aktivitetit të futbollit, por edhe për aktivitetet ekonomike të përfshira si shitja nga një njësi e vetme që zotëron të drejtat ekskluzive. Kjo ndërmarrje në kuptim të nenit 8, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, ka një pozitë dominuese ku zotëron 100% të tregut përkatës.

II.3 Metodologjia

II.4 Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve

26. Metodologjia që është përdorur për vlerësimin e aktivitetit të FSHF në kuadër të Ligjit për Konkurrencën, gjatë hetimit janë:
- (i) Materialet e OECD dhe UNCTAD: Competition Issues in Television and Broadcasting, OECD, 2013⁵; Competition and Sports, OECD, 2010⁶; Competition Issues Related to Sports, OECD, 1996⁷; Competition issues in the sale of audiovisual rights for major sporting events, UNCTAD, 2018.⁸
- (ii) Vendime të Komisionit Evropian: Case C-519/04, David Meca-Medina and Igor Majcen v. Commission, REG 2006 s. I-6991⁹; Case COMP/C-2/37.214 – Joint selling of the media rights to the German Bundesliga¹⁰; COMP/M. 2876 Newscorp/Telepiù, of April 2, 2003.¹¹
27. Komisioni Evropian për konkurrencën, ndër 13 sektorët më të rëndësishëm, trajton edhe Sektorin e Sportit pasi ka një rëndësi të madhe dhe ndikim të konsiderueshëm ekonomik në çdo vend edhe në BE, për pjesën që përfaqëson në PBB, për punësimin, për biznesin që bën për të drejtat e transmetimit, veçanërisht për TV duke u bërë shumë fitimpurëse.
28. Shumica e rasteve sportive janë trajtuar sipas rregullave të antitrustit të BE-së, të cilat ndalojnë marrëveshjet dhe praktikat anti-konkurrese, si dhe abuzimin e pozitës dominuese. Këto raste kanë të bëjnë me aktivitetet e gjenerimit të të ardhurave të lidhura me sportin, të tilla si të drejtat e mediave dhe shitjet e biletave dhe aspektet rregullatore/organizative të sportit.

⁵ Available at: <http://www.oecd.org/competition/competition-television-broadcasting.htm>, accessed 2019

⁶ Available at: <http://www.oecd.org/daf/competition/competition-and-sports-2010.pdf>, accessed 2019

⁷ Available at: <https://www.oecd.org/daf/competition/sectors/1920279.pdf>, accessed 2019

⁸ Available at: https://unctad.org/meetings/en/SessionalDocuments/ciclpd50_en.pdf, accessed 2019

⁹ Available at: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN>, accessed 2019

¹⁰ Available at: https://ec.europa.eu/competition/antitrust/cases/dec_docs/37214/37214_90_3.pdf, accessed 2019

¹¹ Available at: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF>, accessed 2019

29. Gjykata Evropiane e Drejtësisë vendosi që përderisa veprimtaria e kryer është një veprimtari ekonomike, e cila është e pamohueshme për sportet, ajo bie nën rregullat e Traktatit (TFEU), prandaj dispozitat e konkurrencës duhen aplikuar.
30. Në praktikat e vendeve të BE, Komisioni dhe Gjykatat Komunitare kanë vendosur që aktivitetet ekonomike në kontekstin e sportit të përfshihen në fushën e së drejtës së KE-së, duke përfshirë nenet 101 dhe 102 të TFEU. Kjo është konfirmuar dhe në rastin Meca Medina nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë (Rasti C-519/04 P David Meca-Medina dhe Igor Majcen kundër Komisionit).
31. FSHF kryen aktivitet ekonomik dhe gjeneron të ardhura lidhur me: shitjen e të drejtave të transmetimit televiziv; shitjen e biletave të ndeshjeve të ekipeve kombëtare; sponsorizime dhe reklama, etj., të cilat sipas parashikimeve të ligjit nr. 9121/2003 dhe sipas praktikës së BE-së dhe vendeve anëtare të saj, përfshihet në objektin e veprimtarisë dhe fushën e zbatimit të ligjit nr. 9121/2003.
32. Sipas nenit 48 të Statutit të Federatës Shqiptare të futbollit, të ardhurat e FSHF sigurohen veçanërisht nga: regjistrimet vjetore të anëtarëve dhe kuotat; të ardhurat e krijuara nga marketingu i të drejtave që gëzon FSHF; gjobat e vëna nga organet e autorizuara të FSHF; sponsorizimet, donacionet, kontribute, financimet nga shteti dhe, burime të tjera të ligjshme.
33. Duke qenë se sipas ligjit nr. 79/2017, FSHF është entitet i vetëm të cilit shteti i ka dhënë të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare, në sportin e futbollit, si dhe është pronare e të drejtës së transmetimit të veprimtarisë futbollistike brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, hyrja është me pengesa të larta në tregjet përkatëse.
34. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve, fuqia kundërvepruese e konsumatorëve dhe klubeve të futbollit dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, por dhe nga praktikat me të mira të së drejtës evropiane të konkurrencës, FSHF në tregjet përkatëse ka pozitë dominuese.
35. Federata Shqiptare e Futbollit, si pronare e të drejtës së transmetimit të veprimtarive sportive të organizuara prej saj, në bazë të nenit 35 të ligjit nr. 97/2017 “Për Sportin” kërkon të shesë të drejtën televizive për “Kategoria Superiore” dhe “Kupa e Shqipërisë”, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për një periudhë 3 vjeçare për periudhën 2015-2018 dhe një periudhë 4 vjeçare për periudhën 2018-2022.
36. DIGITALB ka fituar të drejtën e transmetimit të ndeshjeve zyrtare të “Kategoria Superiore” dhe “Kupa e Shqipërisë” brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për sezonet/periudhën 15.08.2015-15.05.2018.
37. DIGITALB ka fituar të drejtën e transmetimit të “Kategoria Superiore” dhe “Kupa e Shqipërisë” në territorin e Republikës së Shqipërisë për sezonet/periudhën 01.06.2018-01.06.2022.
38. DIGITALB ka fituar të drejtën ekskluzive, të plotë për ofrimin e të drejtës së transmetimit të “Kategoria Superiore” dhe “Kupa e Shqipërisë” në territorin e Republikës së Shqipërisë në platformën DIGITALB, në satelit dhe/ose dixhitale tokësore, PPV, Pay Tv, Kabllore, IPTV, OTT, me ose pa pagesë, mobile, internet.
39. DIGITALB ka fituar të drejtën e transmetimit të ndeshjeve zyrtare të “Kategoria Superiore” dhe “Kupa e Shqipërisë” brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për sezonet/periudhën 15.08.2015-15.05.2018 dhe ka kryer pagesën totale prej XXX euro për sezonet: Sezoni 2015/16 - XXX euro; Sezoni 2016/17 - XXX euro; Sezoni 2017/18 – XXX euro, me një pagesë të rritur nga viti në vit me të njëjtin marzh.

40. "DIGITALB", ka paraqitur vlerën ekonomike me totalin XXX euro për 4 sezonet: Sezoni 2018/19 Ekskluzive Paketa A XXX euro me tvsh + Ekskluzive Paketa B XXX; Sezoni 2019/20 Ekskluzive Paketa A XXX euro me tvsh + Ekskluzive Paketa B XXX euro; Sezoni 2020/21 Ekskluzive Paketa A XXX euro me tvsh + Ekskluzive Paketa B XXX euro me tvsh; Sezoni 2021/22 Ekskluzive Paketa A XXX euro me tvsh + Ekskluzive Paketa B XXX euro me tvsh, duke rritur për 2 vitet e fundit me XXX euro/vit.
41. Kontrata e licensimit e dhënë për 3 dhe 4 vjet (të njëjtit operator) bie në kundërshtim me praktikat ndërkombëtare. Komisioni Evropian, ka përcaktuar disa mjete kundër tejkalimit të të drejtave të kontratave ekskluzive në dy mënyra: (i) të drejtat ekskluzive duhet të reduktohen në fushëveprim, dhe (ii) kohëzgjatjen e ekskluzivitetit.
42. Në praktikën Liga e Kampioneve të UEFA-s dhe në rastet e Deutscher Fußball-Bund (DFB)-(Federata Gjermane e Futbollit) është parë se Komisioni ka pranuar kontrata me kohëzgjatje prej 3 vitesh në një kontekst ku të drejtat janë ndarë dhe u janë shitur operatorëve të ndryshëm.
43. Ekskluziviteti i një kohëzgjatjeje më të gjatë dhe për një gamë më të gjerë të të drejtave mund të kufizojë konkurrencën duke përjashtuar operatorët e tjerë në tregun e rrjedhës së poshtme, aq më tepër kur kemi të bëjmë me operator me pozitë dominuese në të dy tregjet. Dhënia e ekskluzivitetit absolut në aspektin e fushëveprimit dhe kohëzgjatjes të të drejtës së transmetimit tek një blerës i vetëm kufizon tregun.
44. Të drejtat e transmetimit të përcaktuara në kontratën e licensimit, i janë licensuar DIGITALB mbi baza ekskluzive ç'ka nënkupton që sipas termave të kësaj kontrate, Licensuesi nuk do t'i japë këto të drejta të tilla ndonjë pale të tretë dhe nuk do t'i ushtrojë as vetë këto të drejta, deri në përfundimin e kësaj kontrate në asnjë format të njohur transmetimi. Në pikën 3.2 të kontratës 3 vjeçare (15.08.2015-15.05.2018), FSHF parashikonte gjithashtu detyrimin për kalimin e të drejtave ekskluzive, por duke mbajtur të drejtën e të ardhurave prej XX% për kontratat që DIGITALB do të lidh për vendet e tjera Evropiane apo botërore, duke përfshirë jo vetëm ato televizive, por edhe internet, mobile, platforma "betting" në internet, pra duke vendosur kusht detyrues për palën në kontratë.
45. Federata zotëron të drejtat televizive të të gjitha ndeshjeve të kombëtares shqiptare. Federata dhe klubet pjesëmarrëse kanë rënë formalisht dakord që të centralizohet shitja e të drejtave televizive të Ligës shqiptare të futbollit dhe gjithashtu kanë rënë dakord që të jenë pjesë e një skeme e të ardhurave të gjeneruara. Fakt ky i pohuar në mënyrë verbale nga Federata.
46. Zbatimi i ligjit për konkurrencën për të drejtën audiovizive lidhet kryesisht me "shitjen kolektive/përbashkët" të së drejtës së transmetimit dhe të mbulimit të eventeve sportive. "Shitja kolektive" pa praninë e palës së tretë kufizon konkurrencën në dy mënyra kryesore: (i) Dhënia e një fuqie të tregut Federatës për të përcaktuar çmimin e të drejtave audiovizuale, që çon në çmime të fryra si në rrjedhën e sipërme për transmetuesit, ashtu edhe në rrjedhjen e poshtme për konsumatorët; (ii) Forcimi i pozitës së tregut të transmetuesve në tregun e rrjedhës së poshtme, pasi ata mund të jenë operatorët e vetëm në gjendje të ofrojnë të gjitha të drejtat në një paketë.
47. "Shitja e përbashkët" pa praninë e klubeve pjesëmarrëse në aktivitet parandalon secilin nga klubet të ketë të drejtën e vendimarrjes në shitjen e të drejtës audiovizive dhe si rezultat dhe në të ardhurat që përfitohen nga kjo kontratë.
48. Komisioni Evropian ka theksuar se shitja e paketave të ndara të të drejtës audiovizive rrit mundësinë për më shumë transmetues, duke përfshirë kompanitë e vogla dhe të mesme për të fituar të drejtën e transmetimeve dhe si rrjedhojë ndikon edhe në favor konsumatorëve.
49. Në rastin e Bundesligës Gjermane, Komisioni Evropian i Konkurrencës vuri në dukje se shitja ekskluzive e të drejtave të transmetimit komercial nga Shoqata e Ligës mund të kufizojë konkurrencën mes klubeve

dhe kompanive në divizionin e parë dhe të dytë Gjerman. Në këtë rast u vendosen angazhime për Shoqatën e Ligës për futjen e konkurrencës në marketingun e Bundesligës së parë dhe të dytë duke zvogëluar qëllimin dhe kohëzgjatjen e marrëveshjeve të ardhshme të marketingut për të siguruar një procedurë transparente dhe jodiskriminuese të marketingut. Komisioni pranoi vetëm kontratat me kohëzgjatje prej 3 vitesh në një kontekst ku të drejtat janë ndarë dhe u janë shitur operatorëve të ndryshëm.

50. Shitja e të drejtës audiovizive tek një operator i vetëm për një periudhë të gjatë dhe duke përfshirë në një paketë të vetme të gjithë të drejtat ekskluzive, përbën një sjellje përjashtuese dhe me pasojë kufizimin e tregut, gjë e cila në kuptim të nenit 9, pika 2 germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 përbën abuzim me pozitën dominuese.
51. Ekskluziviteti është një nga çështjet më të rëndësishme në lidhje me shitjen e përbashkët dhe marrjen e të drejtave së transmetimit. Në këtë fushë, Komisioni Evropian i Konkurrencës ka miratuar tre vendime që i referohen: “UEFA Champions League”; “Ligës Gjermane të Futbollit”; dhe “Ligës së Futbollit Anglez”. Në këto vendime, Komisioni ka evidentuar: se shitja e përbashkët përbën një kufizim të konkurrencës në kundërshtim me nenin 101 (1) të TFEU -së, meqë pengon konkurrencën midis klubeve në kuptimin e marketingut të të drejtave të tyre individualisht dhe prandaj mund të pengojnë konkurrencën midis klubeve në aspektin e çmimeve, risi, shërbime dhe produkte të ofruara për tifozët.
52. Shitja e përbashkët u pranua nga Komisioni në bazë të nenit 101 (3) të TFEU-së, me disa masa të caktuara në case by case. Në veçanti, Komisioni kërkoi modifikime dhe angazhime të caktuara, duke përfshirë p.sh.: një kohëzgjatje të shkurtër dhe një fushë të kufizuar për të drejtat ekskluzive mbi bazë të një procedurë transparente.
53. Kontratat e lidhura ndërmjet FSHF dhe Digitalb me nr.1209 prot., datë 15.09.2015, dhe nr.1001 prot., datë 18.09.2018, janë “kontrata ekskluziviteti” ku përfshihet “Kategoria Superiore” dhe “Kupa e Shqipërisë” me dallimin në ofertë me paketën A (ndeshjet kryesore, të rëndësishme) dhe B (ndeshjet e tjera).
54. FSHF nuk bën të qartë në qëndrimin e saj se përse është bërë oferta për shitjen e transmetimit e përbashkët për të dy kompeticionet, pavarësisht se këto kompeticione janë të ndara ndërmjet tyre. Ndarja që është bërë në ofertë me paketën A dhe B por që përfshin të dy kompeticionet, në kuptim të nenit 9, pika 2 germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 është formë e abuzimit me pozitën që ka FSHF për t’i shitur bashkë (bundle) duke mos ofruar alternativa në ofertën e saj.
55. Ndarja në ofertën për shitjen e të drejtave televizive ndërmjet “Kategorisë Superiore” dhe “Kupës së Shqipërisë” e bën më efektive pjesëmarrjen e subjekteve të tjera të interesuara për transmetimin e tyre ndoshta duke bërë dhe oferta që nuk përfshijnë të drejta ekskluzive. Diferencimi në oferta mund të nxisë kërkesën për pjesëmarrje të ndërmarrjeve që operojnë në transmetimin e aktiviteteve sportive dhe rrjedhimisht dhe konkurrencën ndërmjet tyre.
56. FSHF kryen aktivitet ekonomik dhe gjeneron të ardhura nga shitja e të drejtave të transmetimit televiziv; shitja e biletave të ndeshjeve të ekipeve kombëtare; sponsorizimet dhe reklama, etj., të cilat sipas parashikimeve të ligjit nr. 9121/2003 dhe sipas praktikës së BE-së dhe vendeve anëtare të saj, përfshihet në objektin e veprimtarisë dhe fushën e zbatimit të këtij ligji.
57. Të ardhurat kryesore të realizuara në katër vitet (2015-2018) nga FSHF vijnë kryesisht nga amortizimi i granteve të ardhura mbi XX% të totalit të të ardhurave. Amortizimi i granteve në të ardhura sipas shënimit të të ardhurave në pasqyrat e bilanceve përfaqësojnë grantet e përfituara sipas dhuruesve si: UEFA, FIFA dhe Qeveria Shqiptare. Grantet e përfituara janë të ndara sipas përfituesve: UEFA XXX mijë lekë; FIFA XXX mijë lekë dhe qeveria Shqiptare XXX mijë lekë. Në vitin 2016 grantet nga UEFA përfaqësojnë XXX mijë lekë, ose XX% të totalit të granteve të përfituara për vitin 2016. Federata në vitin 2017 ka marrë nga UEFA një shumë prej XXX EURO (XXX mijë LEK) për kompeticionin Nations League (Liga e

Kombeve) që u organizua në vitin 2018 dhe vazhdoi në vitin 2019. Duke pasur parasysh shumën totale që Federata ka përfituar nga pjesëmarrja në këtë kompeticion (XXX EURO ose XXX mijë LEK), nga të cilat [...] e vlerës është njohur në të ardhurat e vitit 2018 (XXX EURO ose XXX mijë LEK), dhe pjesa tjetër prej XXX EURO (XXX mijë LEK) do të njihet në vitin 2019, së bashku me pjesën tjetër që është arkëtuar në muajt e parë të vitit 2019.

58. Të ardhurat nga të drejtat televizive përfaqësojnë në total XXX mijë lekë ose rreth XX% të totalit të ardhurave për vitin 2017 dhe XXX mijë lekë ose rreth XX% të totalit të ardhurave për vitin 2018. Këto të ardhura përbëhen nga: Shitja e të drejtës televizive për ndeshjet e skuadrës kombëtare – UEFA; Shitja e të drejtës televizive për ndeshjet e skuadrës kombëtare – të tjerë: Shitja e të drejtës televizive për kampionatin shqiptar. Në këto të ardhura pjesën kryesore e përfaqëson shitja e të drejtës televizive për ndeshjet e skuadrës kombëtare – UEFA rreth XX% të të ardhurave të realizuara nga të ardhurat në total të të drejtave televizive. Federata zotëron të drejtat televizive të të gjitha ndeshjeve të kombëtares shqiptare.
59. Federata dhe klubet pjesëmarrëse kanë rënë formalisht dakort që të centralizohet shitja e të drejtave televizive të Ligës shqiptare të futbollit dhe gjithashtu kanë rënë dakort që të jenë pjesë e një skeme të gjeneruar e të ardhurave. Në këtë marrëveshje të centralizuar, Federata ka garantuar klubet pjesëmarrëse për një vlerë totale prej XXX euro (shpërndarë në bazë të numrit dhe renditjes të klubeve pjesëmarrëse të financuara nga të ardhurat e saj). Gjatë vitit 2016, FSHF ka njohur në të ardhurat e saj një vlerë totale prej XXX Euro nga të drejtat televizive marrë nga UEFA gjatë periudhës 2014-2018.
60. Një aspekt tjetër i gjenerimit të të ardhurave nga FSHF është shitja e “Highlitet” të ndeshjeve. “Highlitet” janë element jo kryesor i kontratave të lidhura midis FSHF dhe DIGITALB, por janë plotësues dhe si të tillë nuk duhet që detyrimisht të përfshihen në ekskluzivitetin e saj. Highlitet janë një mundësi për të përfshirë edhe subjekte të tjera audiovizive që shfaqin interes në shfaqjen e tyre, duke rritur kështu pjesëmarrjen e subjekteve që mund të promovojnë sportin dhe rritjen e konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve në këtë treg.

Ky ekskluzivitet shtesë i dhënë kufizon konkurrencën, pasi i heq mundësinë ndërmarrjeve që operojnë në tregun audioviziv për të marr pjesë, dhe përbën një abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003.

61. Në lidhje me sponsorizimet FSHF në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 79/2017 “Për Sportin”, nenit 35 të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jo-fitimprurëse”, si dhe nenit 48 të Statutit, duhet të arrijë synimet ligjore e statutore për sigurimin e të ardhurave përmes procedurave të qarta e transparente për “vettingun” e operatorëve të interesuar për të sponsorizuar në futbollin shqiptar.
62. Sponsorizimet përbëjnë një nga të ardhurat ligjore të FSHF, e cila duhet të jetë e hapur për çdo subjekt që dëshiron të mbështesë ekipin kombëtar pa asnjë kufizim. Neni 34 i ligjit “Për sportin” parashikon se organizatorët e veprimtarive sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjediseve sportive, ku zhvillojnë veprimtarinë ose garën sportive, për reklamën e shoqërive të ndryshme tregtare, në bazë të marrëveshjes kontraktuese me to. Siç vërehet nga ky formulim, ligji nuk parashikon asnjë procedurë, garë apo formalitet tjetër veç shprehjes së vullnetit të përbashkët dhe marrëveshjes.
63. Kontratat e lidhura midis FSHF dhe DIGITALB, përkatësisht kontrata me nr.1209 prot., datë 15.09.2015, dhe kontrata me nr.1001 prot., datë 18.09.2018, në pikën 4.3 të tyre citojnë: “Reklammat e klientëve të Digitalb, që janë konkurrentë të drejtëpërdrejtë të sponsorve të përgjithshëm të FSHF nuk kanë të drejtë të transmetohen gjatë pjesës së parë dhe pjesës së dytë të ndeshjes. Ndërsa blloku publicitar i klientëve që nuk konkurrojnë sponsorët e përgjithshëm të FSHF do të transmetohen në një bllok të veçantë publicitar”.
- Kjo dispozitë përbën një kufizim të reklamimit të aktivitetit të ndërmarrjeve që janë konkurrent të sponsorëve të FSHF, duke vendosur në kuptim të nenit 9, pika 2, germa (a), kushte të padrejta tregtimi.

64. Nga materialet e administruara, vihet re një lidhje që ekziston midis subjekteve që sponsorizojnë FSHF dhe pjesëmarrjes së tyre me të drejta pasurore në kompaninë DIGITALB.

Kështu, sipas faqes së saj zyrtare¹², sponsor i FSHF është AMA Caffè (emri zyrtar - New Century). Në këtë shoqëri, Z. A.Z. zotëron 55% të kuotës së kapitalit, i cili në të njëjtën kohë është edhe aksionar i DIGITALB.

Union Bank. Kjo shoqëri sponsorizuese ka lidhje me subjekte të cilët janë aksionarë të DIGITALB.

Në shoqërinë Union Bank SHA, Z. E.L. dhe Z. N.L., zotërojnë respektivisht 1.77% të aksioneve, ndërkohë që këta dy individë janë zotërues në mënyrë të drejtpërdrejtë të 35% të aksioneve secili tek shoqëria Union Grup SHA, dhe janë zotërues 42.5% të kuotës së kapitalit secili tek shoqëria Arch Investor SHPK dhe zotërojnë në mënyrë indirekte, nëpërmjet shoqërisë Union NET, nga 35% të kapitalit secili të shoqërisë Union Distribution Servis Albania SHPK.

Në mënyrë direkte dhe indirekte, Z. E.L. dhe Z. N.L., zotërojnë aksione në shoqërinë DIGITALB SHA dhe UNION BANK SHA.

65. Nga materiali administruar rezulton se ka një ndërlidhje të interesave pasurore të përfaqësuesve ligjore të FSHF me pjesëmarrjen e tyre në aksionet e shoqërisë DIGITALB. Nga ekstraktet e QKB¹³, rezulton se shoqëria A.I.B.A. Kompani, me aksionar të vetëm Z. A.D., zotëron 9.23% të aksioneve në shoqërinë DIGITALB.

Po ashtu, Z. A.D., në shoqërinë sponsorizuese AMA Caffè (New Century), zotëron 22.5% të kuotës së kapitalit, i cili në të njëjtën kohë është edhe përfaqësuesi ligjor ([...]).

66. Krijimi i Ligës Profesioniste sipas modelit të vendeve Evropiane është i domosdoshëm për të pasur transparencë ndërmjet klubeve dhe Federatës. Liga Profesioniste është një organizatë në të cilat marrin pjesë Presidentët e klubeve që përfaqësohen në kompeticion si “Kategoria Superiore” dhe “Kupa e Shqipërisë”. Liga është ajo që mbron interesat e klubeve dhe monitoron vendimet që FSHF jep dhe që prek interesat e tyre ekonomike apo sportive.

67. Gjatë hetimit rezultoi se Liga Profesioniste nuk ekziston. Krijimi i kësaj Lige, me një rol aktiv në negocimin dhe shitjen e të drejtës televizive dhe në transparencën e shpërndarjes së fondeve apo investimeve ndërmjet klubeve, është i nevojshëm për të kufizuar mundësinë që FSHF të abuzojë në pozitën dominuese sipas nenit 9, pika 2, germa (a), duke qenë se është vetë FSHF që përfaqëson interesin kolektiv të klubeve në shitjen e të drejtave audiovizive.

68. Gjatë procedurës hetimore, u analizua edhe çmimi i shitjes së biletave. Nga ana e FSHF nuk u soll as edhe një e dhënë/informacion mbi mënyrën se si përllogaritet ky çmim. FSHF refuzoi disa herë të dërgonte analizën lidhëse mes kostos dhe çmimit të biletave. Kështu, në mungesë të informacionit të një modeli të kostos të detajuar të shërbimeve, nga AK është përdor alternativa krahasuese në lidhje me çmimin e biletave, si një nga metodat kryesore të hetimit. Analiza bazuar në çmimin e lartë të biletave (excessive price), ju referua vendeve të tjera të rajonit (benchmarking): Kosovë, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Kroacia, shtete me karakteristika të ngjashme me Shqipërinë: duke parë kriterin e PBB-së dhe faktorë të tjerë, si popullariteti i futbollit në këto vende.

69. FSHF nuk ka një metodologji për përcaktimin e çmimeve të biletave me qëllim orientimin drejt kostos së shërbimit; nga krahasimi i çmimeve të biletave të miratuara nga FSHF me çmimet e biletave të rajonit rezultoi se janë më të larta se Maqedonia, Kosova, Kroacia, dhe Mali i Zi si vende me nivel të Produktit

¹² www.fshf.org

¹³ www.qkr.gov.al

të Brendshëm Bruto (PBB-sw) dhe të ardhurave për frymë të krahasueshme me Shqipërinë (p.sh. Maqedonia). Kjo sjellje e FSHF, duke aplikuar çmime të larta, përbën një abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003.

70. Edhe ankesat e disa qytetarëve gjatë procedurës hetimore të protokolluara me nr. 55/14, 55/15, 55/16 prot., datë 21.11.2019 lidhur me detyrimin për blerjen e biletës Shqipëri–Andorra në mënyrë që të shohësh ndeshjen Shqipëri-Francë, referon në kuptim të nenit 9, pika 2 germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 një abuzim me pozitën dominuese, duke vendosur kushte të padrejta për ata që duan të shohin ndeshjen për të cilën kanë interes.

71. Federata Shqiptare e Futbollit ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës shkresën nr. 55/7 prot., datë 04.07.2019 “Informacion mbi praktikat më të mira”.

Nëpërmjet kësaj shkrese FSHF bën me dije AK, se ajo do të të aplikojë në të ardhmen praktikat më të mira ndërkombëtare lidhur me çështjet objekt hetimi.

72. Duke vlerësuar informacionin e FSHF mbi praktikat më të mira të datës 04.07.2019, rezulton se: bazuar në ligjin nr. 9121/2013, “Rregulloren për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” të miratuar me VKK nr. 176, datë 24.02.2011, “Rregullores mbi Procedurat e Angazhimeve” miratuar me VKK Nr. 437, datë 5.10.2016, këto praktika të depozituara nga FSHF nuk vlerësohen të jenë angazhime të cilat eliminojnë shkeljet e konkurrencës në kuptim nenit 45, pika 2 të ligjit nr. 9121/2013.

73. Hetimi paraprak ka filluar me VKK nr. 564, datë 25.10.2018, hetimi i thelluar me VKK nr. 607, datë 01.04.2019 dhe është ndryshuar me VKK nr. 632, datë 20.06.2019, si dhe nga ana e FSHF nuk është treguar një vullnet për të bashkëpunuar. FSHF ka pasur një periudhë të gjatë kohe në dispozicion për t’ju drejtuar Autoritetit të Konkurrencës për ndërprejen e kësaj procedurë hetimore, pasi ajo vetë do të angazhohej për të eliminuar shkeljet e konkurrencës në zbatim të nenit 9 pika 2, germa (a) të ligjit nr.9121/2003.

74. Në përfundim: pasi u vlerësuan edhe komentet përfundimtare dhe angazhimet e FSHF dërguar me shkresën nr.223 prot., datë 06.02.2020 e protokolluar pranë AK me nr. 55/19 prot., datë 07.02.2020, Komisioni Konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, pika 2, germa (a), (c) nenin 24 germa (d), nenin 26, nenin 45, nenin 69 dhe nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të FSHF si entiteti i vetëm të cilit shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare në sportin e futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, në drejtim të shitjes së të drejtave të transmetimit televiziv; shitjes së biletave të ndeshjeve të ekipeve kombëtare; sponsorizime dhe reklama.
2. Dhënien e kushteve dhe detyrimeve për të ndaluar abuzimin me pozitën dominuese të FSHF:
 - a. Detyrimin e FSHF që shitja e përbashkët e së drejtës televizive, si një e drejtë ekskluzive në të ardhmen të reduktohet në fushëveprim dhe kohëzgjatjen e ekskluzivitetit, në një periudhe jo më shumë se 3 (tre) vjet, ku të drejtat të jenë të ndara dhe t’u shiten operatorëve të ndryshëm.
 - b. Detyrimin e FSHF në të ardhmen të ndajë prokurimin e dy kategorive “Kategorinë Superiore” dhe “Kupën e Shqipërisë”, me dallimin në ofertë me paketën A (ndeshjet kryesore, të rëndësishme) dhe B

(ndeshjet e tjera), në mënyrë që ato të mos i përkasin një operatori të vetëm, duke siguruar një pjesëmarrje sa më të madhe të operatorëve audioviziv.

- c. Heqjen e ekskluzivitetit në të ardhmen në kontratat e shitjes së të drejtave audiovizive “*Highlighte*” dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të gjerë për operatorët audioviziv.
 3. Përfshirjen e Ligës Profesioniste duke i dhënë asaj një rol aktiv në çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me “shitjen e përbashkët të së drejtë televizive”, si dhe të drejtave të tjera që burojnë prej saj.
 4. Detyrimin e FSHF për shpërndarjen e fondeve të ardhura me destinacion të përcaktuar nga UEFA, FIFA etj., në një procedurë transparente dhe korrekte, në prani të Ligës Profesioniste, në mënyrë që të ruhet konkurrenca e ndershme dhe efektive në treg. Kjo procedurë të bëhet publik në faqen zyrtare të FSHF – www.fshf.org.
 5. Detyrimin për zbatimin e një procedure transparente për zgjedhjen e sponsorit kryesor dhe sponsorëve të tjerë, duke mundësuar pjesëmarrje më të gjerë të ndërmarrjeve në treg. Kjo procedurë të bëhet publik në faqen zyrtare të FSHF – www.fshf.org.
 6. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis sponsorizuesve të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.
 7. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis përfaqësuesve ligjore të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.
 8. Detyrimin e FSHF në të ardhmen për lidhjen e çdo kontrate që vendos të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta në territorin e Republikës së Shqipërisë, për ndërmarrje ose produkte të caktuara, të realizojë procedura prokurimi transparente, jo diskriminuese duke mos vendosur kritere kufizuese dhe përjashtuese në tregun përkatës. Këto kontrata të sillen për vlerësim paraprak pranë Autoritetit të Konkurrencës.
 9. Detyrimin e FSHF të hartojë një metodologji për përcaktimin e çmimeve të biletave, me qëllim orientimin drejt kostos të shërbimit dhe çmimit të biletave. Sjelljen për vlerësim paraprak të metodologjisë pranë Autoritetit të Konkurrencës.
 10. Detyrimet e përcaktuara në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 9 duhet të përmbushen brenda afatit 120 ditor nga dita që ky vendim i është njoftuar.
 11. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, FSHF ndëshkohet me gjobë deri në 5 % të xhiros mesatare ditore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003.
 12. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 2 vjeçare.
 13. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 696, Datë 11.06.2020

“Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA për abuzim me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës” dhe dhënien e një rekomandimi MIE dhe MFE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.06.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i raportit të hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 8, neni 9, pika 2 germat (a), neni 74, pika 1, germa (a), neni 75, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin e thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit të thelluar; kundërshtimeve të paraqitura nga ndërmarrja “Durrës Container Terminal” SHA lidhur me “Raportin e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, nëpërmjet shkresës së saj nr. 158 prot, datë 08.05.2020 (protokolluar pranë AK me nr. 257/34 Prot., datë 11.05.2020); dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi kundërshtimet e paraqitura nga ndërmarrja DCT SHA,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrja Brunës SHPK lidhur me faturimin e padrejtë të shërbimit të zbrazjes dhe mbushjes së konteinerëve nga Koncesionari DCT SHA, filluan procedurat për vlerësimin e ankesës në respektim të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes Brunës SHPK ndaj Terminalit të Konteinerëve Durrës SHA (DCT)”, në mbështetje të nenit 9, nenit 24, shkronja (d) dhe nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 627, datë 13.06.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit

të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

3. Në përfundim të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konkludoi se: sjellja e ndërmarrjes koncesionare DCT SHA duke ofruar shërbimin e mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, kundrejt një tarife shtesë të vetëpërcaktuar në mënyrë të padrejtë dhe të pa miratuar, mund të përbëjë një abuzim me pozitën dominuese, (monopol) që zotëron ky koncesionar, në ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, duke krijuar dyshimin e arsyeshëm se mund të jemi para shkeljes së nenit 9, pika 2, germa a), të ligjit nr. 9121, datë. 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.
4. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 9, nenit 24 shkronja d, nenit 26 dhe nenit 43, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003, me anë të vendimit nr. 649, datë 03.10.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "Durrës Container Terminal" SHA, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA, për periudhën kohore nga 01.01.2018 deri në 30.09.2019.
5. Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se jemi përpara një rasti urgjence të parashikuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 të këtij ligji. Bazuar në këtë vlerësim Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 650, datë 03.10.2019, “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA”, vendosi marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes "Durrës Container Terminal" SHA, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës.
6. Në zbatim të vendimeve të mësipërme të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 257/23, datë 30.10.2019 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit të thelluar proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjes nën hetim DCT SHA, e cila ushtron veprimtarinë e saj në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës. Gjithashtu grupi i inspektimit, më datë 05.11.2019 realizoi një takim në ambientet e APD-së me përfaqësues të këtij Institucioni.
7. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, gjatë periudhës së hetimit të thelluar janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrja DCT SHA, Autoriteti Portual Durrës (APD) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

8. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - a) Tregu përkatës i produktit
 - b) Tregu përkatës gjeografik

II.1.a Tregu përkatës i produktit

9. Terminali i Konteinerëve Durrës është i përcaktuar si një nga facilitetet e portit të Durrësit që konsiston dhe përbëhet nga kalata nr. 6 dhe sheshet korresponduese, në përputhje me Master Planin e Portit të Durrësit, miratuar me VKM nr. 546, datë 28.05.2009.
10. Nga viti 2011, menaxhimi, operimi, ndërtimi, mirëmbajtja, përmirësimi teknik dhe adaptimi për përmbushjen e kërkesave aktuale dhe të ardhshme të trafikut në Terminalin e Konteinerëve Durrës është dhënë me koncesion.
11. Në bazë të kontratës së koncesionit, gjatë periudhës nën hetim, ky terminal menaxhohej dhe administrohej nga ndërmarrja DCT SHA, e cila ishte poseduesja dhe administruesja e vetme e të gjithë infrastrukturës dhe faciliteteve të këtij terminali, duke qenë 100% dominues në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim të anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura me to në këtë terminal, ku përfshihet edhe shërbimi i zbrazjes dhe mbushjes së konteinerëve.
12. Bazuar në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 649, datë 03.10.2019, hetimi i thelluar është hapur në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, ndaj ndërmarrjes "Durrës Container Terminal" SHA.
13. Referuar sa më sipër, tregu përkatës i produktit përfshin ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve nga ndërmarrja koncesionare DCT SHA.

II.1.b Tregu përkatës gjeografik

14. Bazuar në Masterplanin e miratuar dhe kontratën koncesionare, përpunimi i konteinerëve (ngarkim-shkarkimi i anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura me to) kryhet pranë Terminalit të Konteinerëve Durrës, ku ndërmarrja Koncesionare DCT SHA operon e vetme.
15. Referuar sa më sipër, tregu përkatës gjeografik vlerësohet zona gjeografike e Terminalit të Konteinerëve në Portin e Durrësit.
16. Si përfundim, tregu përkatës përfshin ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës nga ndërmarrja koncesionare DCT SHA.

II.2 Vlerësimi i Pozitës Dominuese

17. Vlerësimi i pozitës dominuese në treg është hapi i parë për të vazhduar me analizën e nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), për sjellje të mundshme antikonkurrese në treg. Përkufizimi i pozitës dominuese është përcaktuar në nenin 3, pika 5 të ligjit, përkatësisht: "Pozitë dominuese" është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
18. Sipas ligjit nr. 9121/2003, nuk është e ndaluar pozita dominuese nga një ose disa ndërmarrje në treg, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjeve një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të këtij ligji.
19. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të ligjit janë: pjesët e tregut përkatës, pengesat në hyrje në tregun përkatës, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike dhe financiare, varësinë ekonomike të furnizuesve dhe blerësve, fuqinë kundërvepruese të blerësve; zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes; karakteristika të tjera të tregut përkatës.

20. Terminali i Konteinerëve Durrës, në bazë të kontratës së koncesionit, duke filluar nga muaji Shkurt 2013 dhe gjatë gjithë periudhës nën hetim, operohej, menaxhohej dhe administrohej nga ndërmarrja DCT SHA, e cila ishte poseduesja dhe administruesja e vetme e të gjithë infrastrukturës dhe faciliteteve të këtij terminali. Çdo përdorues porti për të marrë shërbimet nga ky terminal, duhet patjetër të ketë akses në infrastrukturën dhe facilitetet që ofron ky terminal. Terminali ishte marrë me koncesion për 35 vjet nga ndërmarrja DCT SHA dhe për gjithë këtë periudhë kjo ndërmarrje do të ishte e vetme në këtë treg në qoftë se kontrata e koncesionit nuk do të ishte zgjidhur (Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, nr. 370 (86-2019-395), datë 12.02.2019). Por pavarësisht këtij vendimi ndërmarrja DCT SHA ka vazhduar të operojë në tregun objekt hetimi për gjatë gjithë periudhës nën hetim, gjë e cila është konfirmuar gjatë inspektimeve të zhvilluara pranë ambienteve të kësaj ndërmarrjeje si dhe raportimeve të dërguara nga APD dhe DCT SHA të cilat shpalosen gjatë analizës së sjelljes së kësaj ndërmarrjeje në vijim.
21. Duke marrë parasysh faktin që Koncesionari DCT SHA ishte posedues, operues, menaxhues dhe administrues i vetëm i infrastrukturës dhe faciliteteve të Terminalit të Konteinerëve Durrës edhe përgjatë gjithë periudhës nën hetim, duke zotëruar 100% të pjesëve të tregut përkatës; si dhe barrierat për hyrjen në treg; konkurrencën potenciale; fuqinë kundërvepruese të blerësve, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja DCT SHA vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve.

II.3 Sjellja e ndërmarrjes në treg

22. Ndërmarrja DCT SHA në bazë të kontratës Koncesionare ka pasur ekskluzivitet në ofrimin e shërbimeve të përpunimit të konteinerëve në portin e Durrësit. Si një ndërmarrje që operonte e vetme në këtë treg, për shërbimet që ajo ofronte aplikoheshin tarifa të miraturara paraprakisht nga APD dhe me Udhëzim të përbashkët të MIE dhe MFE.
23. Shërbimi i mbushjes- zbrazjes së konteinerëve është një shërbim që kryhet në rastet kur: nga ana e autoriteteve doganore kërkohet kontroll fizik i konteinerit; në rastet kur ky shërbim kërkohet nga vetë klienti; si dhe me kërkesë të AKU-së.
24. Ndërmarrja DCT SHA duke filluar nga muaji Maj 2018 ka ofruar shërbimet e mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve kundrejt një tarife të vetëpërcaktuar, tarifë e cila nuk ishte e miratuar dhe nuk ishte prezent në librin e tarifave të publikuara në faqen zyrtare të APD-së.
25. Koncesionari DCT SHA ka marrë miratimin e APD-së në 11 Maj 2018 për fillimin e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve. Sipas APD faturimi i këtij shërbimi do të kryhej me vlerën e përcaktuar nga tarifat të cilat do të vendoseshin nga mbledhja e Këshillit Drejtues. Konkretisht ofrimi i këtij shërbimi nga DCT SHA ka filluar nga data 14.05.2018, duke aplikuar tarifat e propozuara nga vetë kjo shoqëri, konkretisht: për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 20 feet një tarifë prej 120 Euro/Box; për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 40 feet një tarifë prej 150 Euro/Box.
26. DCT SHA ka vijuar punën për përpunimin e konteinerëve duke ofruar edhe shërbimin e mbushjes dhe zbrazjes, kundrejt një tarife të vetëpërcaktuar dhe të pa miratuar nga instancat përkatëse, pavarësisht kërkesave të APD-së për ndërprerjen e ofrimit të këtij shërbimi, duke operuar në kundërshtim me termat e Kontratës Koncesionare si dhe me Librin e Tarifave Portuale. Lidhur me këtë sjellje të DCT-së, APD ka kërkuar ndërhyrjen e MIE si Autoriteti Kontraktor.
27. Në vijim të shqyrtimit të propozimit për tarifat e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, Këshilli Drejtues i APD-së, me anë të vendimit nr. 21, datë 15.11.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 5, datë 02.03.2015 “Mbi përcaktimin dhe miratimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2015”, i ndryshuar, ka miratuar tarifat për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale

konkretisht si vijon: - Mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 20 feet (20') tarifa 65 Euro/Box; - Mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 40 feet (40') tarifa 86 Euro/Box.

28. Sipas pikës 2 dhe 4 të këtij vendimi, tarifat e miratuara sipas këtij vendimi i përcillen në formë propozimi për bashkëfirmosje Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Këto tarifa të miratuara hyjnë në fuqi sipas përcaktimit në aktin e miratimit nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Pavarësisht këtij miratimi paraprak të tarifës nga APD që nga muaji nëntor 2018, DCT SHA nuk e ka ndryshuar sjelljen e saj duke vazhduar ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së Konteinerëve me të njëjtën tarifë të vetëpërcaktuar, e cila ishte me e lartë se tarifa e miratuar për këtë shërbim nga APD, konkretisht 85% më e lartë për konteinerët 20' dhe 43% më e lartë për konteinerët 40'.
29. Të ardhurat e siguruara nga ndërmarrja DCT SHA nga vendosja e tarifës për shërbimin e mbushjes-zbrazjes së konteinerëve për periudhën Maj 2018 – Shtator 2019 janë 3,246,240 Lekë për konteinerët 20" dhe 34,009,500 për konteinerët 40". Në total të ardhurat e siguruara nga ndërmarrja DCT SHA për periudhën Maj 2018 - Shtator 2019 nga shërbimi i mbushjes-zbrazjes së konteinerëve 20" dhe 40" janë 37,255,740 Lekë, pa TVSH.
30. Në rastin e aplikimit të tarifave nga DCT SHA për ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve është përdorur metoda e krahasimit të kostos totale të shërbimit me çmimin përfundimtar të aplikuar, duke qenë se tarifa e ofrimit të këtij shërbimi është e njëjtë për të gjithë përdoruesit e terminalit, nuk kemi një shërbim tjetër të ngjashëm me të, si dhe krahasimi i tarifave për shërbime të njëjta me porte të tjera mund të mos jetë i saktë pasi kostot e tyre janë të ndryshme.
31. Sipas analizës së kostos së bërë nga DCT SHA për ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve 20' dhe 40' me çmimet përkatësisht 120 Euro dhe 150 Euro të aplikuar nga DCT SHA për periudhën Maj 2018 – Maj 2019 bazuar në koston e fuqisë punëtore, koston e përdorimit të pirunit & Reach stacker, kosto vegla pune dhe veshje pune, ky shërbim rezulton me një fitim prej 2,702 Euro. Sipas DCT SHA nëse për të njëjtën periudhë do të aplikoheshin tarifat e miratuara nga APD me çmimet përkatësisht 65 Euro dhe 86 Euro ky shërbim do të rezultonte me një humbje prej 2,340 Euro, pasi APD ka bërë një llogaritje kostoje pa marrë parasysh volumin e punës, rasteve, kostot e shërbimit, etj.
32. Pavarësisht miratimit të tarifave nga APD që nga muaji nëntor 2018, DCT SHA ka filluar aplikimin e tyre nga marrja dijani e vendimit të KK nr. 650, datë 03.10.2019, "Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës ndaj ndërmarrjes "Durrës Container Terminal" SHA", konkretisht nga muaji Tetor 2019.
33. Sa më sipër rezulton se gjatë periudhës nën hetim DCT SHA për ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve ka aplikuar tarifat e vetëpërcaktuara prej 120 Euro dhe 150 Euro, të cilat janë më të larta se tarifat e miratuara për këtë shërbim nga APD, konkretisht 85% më e lartë për konteinerët 20' dhe 43% më e lartë për konteinerët 40'. Pra kemi të bëjmë me çmime ekseseve, shumë të larta, pasi çmimi i aplikuar nuk ka lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit, koston e tij¹⁴.
34. Duke qenë se për ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve nga DCT SHA nuk ka pasur një tarifë të miratuar nga Ministrat përkatës, APD nuk ka arkëtuar asnjë të ardhur nga kryerja e këtij shërbimi. Gjatë procedurës së hetimit të thëlluar APD ishte duke bërë rakordimet e evidencave të

¹⁴ Neni 9, pika 1 dhe 2, gërma a, e Ligjit 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", përcakton qartë se të vendosësh çmime të padrejta apo kushte të padrejta tregtimi je para shkeljes së këtyre dispozitave. Termit "çmime të padrejta" i është referuar Gjykata Europiane e Drejtësisë dhe Komisioni Europian, në rastin e çmimeve ekseseve. Referuar këtyre rasteve të trajtuara nga Komisioni Europian dhe Gjykata Europiane e Drejtësisë, *çmim eksesev si përkufizim jepet çmimi që nuk ka lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit (Case 27/76 United Brands vs. Commission [1978] ECR 207, paragrafi 250).*

monitorimit për gjithë periudhën e ofrimit të këtij shërbimi dhe tarifa koncesionare do të mbahej për të gjitha këto shërbime të ofruara në momentin e miratimit të saj nga Ministritë.

35. Në bazë të kontratës Koncesionare DCT kishte ekskluzivitetin e shërbimeve të përpunimit të konteinerëve në Gjirin e Durrësit. Ushtrimi i kësaj të drejte përfshinte edhe të drejtën për të ofruar shërbimin e mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve si një shërbim i lidhur me shërbimet kryesore të ngarkim shkarkimit të konteinerëve, shërbim i cili është parashikuar si zë i veçantë në Udhëzimin e përbashkët të MIE dhe MFE Nr. 1568/3, datë 14.07.2015 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2015”, të ndryshuar, konkretisht në Kapitullin 2, pika 2.12/5/Vii. Sipas këtij udhëzimi shërbimi i mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, si shërbimet e tjera të renditura në nënpikën 5 si më sipër, faturohet dhe paguhet më vete. Referuar kontratës koncesionare dhe këtij udhëzimi, shërbimi i mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve është një shërbim ofrimi i të cilit i është dhënë ekskluzivisht koncesionarit. Por nga ana tjetër për këtë shërbim nuk rezulton asnjë tarifë e miratuar në këtë udhëzim.
36. Në kushtet kur, shërbimi i zbrazjes dhe mbushjes së konteinerëve nuk mund të kryhej jashtë sheshit doganor, terminalit të konteinerëve, për shkak të procedurave doganore, në zbatim të kontratës koncesionare ky shërbim nuk mund të kryhej nga persona ose subjekte që nuk janë kualifikuar ose licencuar për kryerjen e këtyre operacioneve, por vetëm nga koncesionari DCT SHA. Gjithashtu vetëm në këtë mënyrë nga të ardhurat e përfituara nga ky shërbim do të përfitonte edhe Autoriteti Kontraktor në formën e Tarifës Koncesionare dhe Pagësës së Koncesionit (Royalty) sipas marrëveshjes koncesionare (nenet 8.1 dhe 8.2).
37. Pavarësisht sa më sipër, në respektim të kontratës koncesionare (pika 2.5.1/(i)), DCT SHA merr përsipër që të mos aplikojë, zbatojë, vjelë, imponojë ose kërkojë, në çdo lloj forme, pagesa, tarifa, taksa apo pagesa të tjera të ndryshme të cilat përcaktohen në mënyrë ekskluzive nga Autoriteti Portual. Në rastin konkret DCT SHA ka aplikuar një tarifë shtesë në mënyrë të padrejtë, e cila nuk është e miratuar dhe nuk është prezent në librin e tarifave të publikuara në faqen zyrtare të APD-së.
38. Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr. 257/33 prot, datë 22.04.2020 “Dërgim Raporti”, ka ftuar ndërmarrjen DCT SHA që të paraqisni me shkrim pretendimet mbi “Raportin mbi hetimin e thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”.
39. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Konkurrencës, ndërmarrja DCT SHA nëpërmjet shkresës së saj nr. 158 prot, datë 08.05.2020 (protokolluar pranë AK me nr. 257/34 Prot., datë 11.05.2020), ka paraqitur pretendimet e saj mbi “Raportin e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, pretendime të cilat, në respektim të nenit 39 të ligjit 9121/2003, janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës në marrjen e këtij vendimi.

Si përfundim, referuar konkluzioneve të mësipërme, rezulton se sjellja e ndërmarrjes koncesionare DCT SHA, në kuptim të nenit 9, pika 2, germa a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, përbën abuzim me pozitën dominuese (monopol) që zotëronte ky koncesionar, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 8, nenit 9, pika 2 gërmat (a), nenit 24, shkronja (d), nenit 26, nenit 43, pika 5, nenit 45, pika 1, nenit 70, pika 2, nenit 74, pika 1, germa (a) dhe nenit 75, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit.
 - II. Gjobitjen e ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 9, pika 2, gërmat (a), të ligjit nr. 9121/2003, në masën 0,43 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar, në shumën 5,052,370 Lekë.
 - III. T’i rekomandoj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që brenda një afati 90 ditor, të marrin masat si vijon:
 - Rregullimin e tregut të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës duke përcaktuar dhe miratuar tarifën përkatëse për këtë shërbim në udhëzimin e përbashkët për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës, me qëllim shmangien e sjelljeve të mundshme abuzive nga operatorë të këtij tregu.
 - IV. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "Durrës Container Terminal" SHA, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontejnerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës".
 - V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 698, Datë 20.07.2020

“Për disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në lidhje me licensimin e Postës Shqiptare për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.07.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në lidhje me licensimin e Postës Shqiptare për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime.

Baza ligjore: Neni 8, neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 70 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të vlerësimit ligjor mbi shqyrtimin e kërkesës së Postës Shqiptare për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 1355 prot., datë 16.06.2020 (protokolluar pranë AK me nr. 236 prot., datë 18.06.2020) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), nisur nga pozita e veçantë e Postës Shqiptare ka depozituar kërkesën për opinion për pajisjen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime nga kjo drejtori.
2. Posta Shqiptare me shkresën nr. 1260 prot., datë 30.06.2020 (protokolluar pranë AK me nr. 251 prot., datë 30.06.2020), ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës dokumentacionin përkatës lidhur me miratimin për kryerjen e veprimtarisë si agjent në sigurime.
3. Posta Shqiptare citon se ka ushtruar veprimtarinë e agjentit të tregut të sigurimeve bazuar në licensën nr. 369, datë 21.12.2012 “Për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime jo – jetë në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit INSIG” SH.A”, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e vlefshme për periudhën 2012-2015.
4. Qëllimi i kësaj veprimtarie si agjent i sigurimeve jo – jetë ishte shitja e policave të sigurimit jo-jetë për llogari të kompanisë së sigurimit INSIG, aktivitet që ofrohej si çdo shërbim tjetër në sportelet e Postës Shqiptare kundrejt një komisioni, p.sh. shitja e kuponave ALEAT, shërbimin e-albania e të tjera.
5. Në kushtet e rinovimit të kësaj licencë, Posta Shqiptare SHA ka aplikuar pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për licensimin e këtij aktiviteti. AMF duke ju referuar kërkesave ligjore si në Vendimin të Bankës së Shqipërisë nr. 01, datë 17.01.2013 “Për licensimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jo banka”, i ndryshuar, ka kërkuar paraprakisht një konfirmim nga Banka e Shqipërisë, i cili ka për qëllim verifikimin e dokumentacionit sipas akteve ligjore dhe nënligjore.

6. Banka e Shqipërisë me Vendimin nr. 1473, datë 05.03.2020 ka vendosur për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë si agjent i sigurimeve nga subjekte financiare jo bankë” për Postën Shqiptare” SH.A.
7. Posta Shqiptare SH.A shprehet se pas komunikimeve dhe takimeve me AMF ka plotësuar të gjithë dokumentacionit ligjor nga me qëllim shqyrtimin dhe miratimin e aktivitetit të agjentit në tregun e sigurimeve të cilin e ka depozituar dhe në AK.
8. Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të nenit 70 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” bashkëpunon me çdo organ të administratës publike, dhe ent rregullator për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, dhe nga ana tjetër çdo entitet publik është i detyruar në mënyrë individuale të zbatojë dispozitat e këtij ligji, për të siguruar edhe ai një konkurrencë të lirë dhe efektive, në fushën e rregullimit të tij.
9. Posta shqiptare është shoqëri anonime e krijuar në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë nga transformimi i ndërmarrjes së Postës Shqiptare emërtohet "Posta Shqiptare" SH.A dhe është shoqëria më e madhe tregtare që operon në tregun e shërbimeve postare dhe financiare.
10. Sipas nenit 4 të Statutit: 1. objekt i veprimtarisë së shoqërisë është aktiviteti i gjithë shërbimeve postare, financiare dhe bankare: aktiviteti i shërbimeve bazë të telekomunikacioneve dhe elektronike; botimi i gazetës online "Postieri"; aktiviteti radiofonik "Radio Posta"; veprimtari biznesi; etj. në përputhje me legjislacionin në fuqi. 2. Shoqëria, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryejë çdo veprimtari tjetër që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e parashikuar në pikën 4. 1. Kjo përfshin gjithashtu zgjerimin e aktivitetit, krijimin e shoqërive të reja, si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit. Pra, Shoqëria mund të marrë pjesë nëpërmjet investimeve apo kontributeve kapitale si ortakë ose aksionerë në shoqëri përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionare, apo në forma të tjera të organizimit apo shoqërizimit, të cilat i krijojnë vetë ose tek të cilat merr pjesë me ortakë/aksionarë të tjerë vendas apo të huaj.
11. Banka e Shqipërisë me licencën nr. 03, datë 18.04.2001 i ka dhënë Postës Shqiptare SHA licencën për të ushtruar veprimtari financiarë si “subjekt financiar jo bankë”.
12. Posta Shqiptare SHA është i vetmi operator publik postar, në tregun shqiptar e cila drejton administron dhe zhvillon rrjetin postar kombëtar si dhe ka detyrimin për përmbushjen e shërbimeve bazë postare.
13. Posta Shqiptare SH.A gjatë zhvillimit të veprimtarisë, sa më lart dhe shtrirjes gjeografike, në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar ka pozitë dominuese në tregun e shërbimeve postare në territorin e Republikës së Shqipërisë.
14. Bazuar në nenin 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, parashikon se veprimtaria e agjentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti.
15. Sipas nenit 9, të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, Posta Shqiptare ka depozituar pranë AK dokumentacionin përkatës sipas kërkesave ligjore
16. Referuar sa më sipër, nga vlerësimi ligjor i kërkesës për opinion depozituar nga AMF, në kuadër të liberalizimit të tregut, vlerësojmë se kjo kërkesë për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit si agjent

në sigurime nga Posta Shqiptare SHA, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9 dhe nenin 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si autoriteti përgjegjës që licencon dhe mbikëqyr veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime në zbatimin e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” përpara licensimit, ti kërkojë Postës Shqiptare:
 - a) të lidhë kontrata të veçanta me të gjitha shoqëritë e sigurimit.
 - b) të mos vendosë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmime të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregimit;
 - c) të mos zbatojë kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - d) të mos vendosë kushte për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.
 - e) të tregtojë produktin e sigurimit me logon e shoqërisë së sigurimit dhe barkodin përkatës në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” për të shmangur koordinimin e sjelljes, ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimin e çmimeve mes shoqërive të sigurimit dhe Postës Shqiptare.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 699, Datë 20.07.2020

“Për disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në lidhje me licensimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.07.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në lidhje me licensimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime.

Baza ligjore: Neni 8, neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26, dhe neni 70 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të vlerësimit ligjor mbi shqyrtimin e kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 1355 prot., datë 16.06.2020 (protokolluar pranë AK me nr. 236 prot., datë 18.06.2020) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), nisur nga pozita e veçantë e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) ka depozituar kërkesën për opinion për pajisjen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime nga kjo drejtori.
2. DPSHTRR më shkresën nr. 1177/1 prot., datë 26.06.2020 (protokolluar pranë AK me nr. 236/1 prot., datë 29.06.2020), ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës dokumentacionin përkatës, lidhur me vlerësimin e shkallës së kufizimit ose pengimit të konkurrencës dhe me qëllim sqarimin përkatës mbi nevojën dhe vullnetin për aplikimin agjent në sigurime.
3. Nga ana e DPSHTRR synohet që të bëhet e mundur dhe klasifikimi policës së sigurimit bazuar në sistemin Bonus-Malus që rregullon nivelin e primit të sigurimit të mjetit, bazuar në historikun e drejtuesit të mjetit, shkeljeve dhe aksidenteve.
4. Sipas DPSHTRR është e nevojshme një nismë e tillë, pikërisht për shkak për ofrimin përfitimeve për drejtuesit e disiplinuar dhe të kujdesshëm dhe në të njëjtën kohë ndëshkues për drejtuesit që kanë një historik negativ në drejtimin e mjetit. Në aspektin social, me aplikimin e sistemit “Bonus-Malus” synohet si ndërgjegjësimi i drejtuesëve të mjeteve me fokus në sigurinë rrugore si dhe në rritjen e cilësisë së shërbimit në tregun e sigurimeve.
5. Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të nenit 70 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” bashkëpunon me çdo organ të administratës publike, dhe ent rregullator për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, dhe nga ana tjetër çdo entitet publik është i detyruar në mënyrë individuale të

zbatojë dispozitat e këtij ligji, për të siguruar edhe ai një konkurrencë të lirë dhe efektive, në fushën e rregullimit të tij.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 21.07.1999, në zbatim të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, si institucion me vetëfinancim, me kapital tërësisht shtetëror, mbi bazën e pasurisë dhe kapitalit të Ndërmarrjes së Shërbimeve të Transportit Rrugor.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është e organizuar dhe funksionon me DPSHTRR si drejtori qendrore me seli në Tiranë dhe 13 Drejtori Rajonale të krijuara në bazë rajoni me qendër në Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Sarandë, Berat, Gjirokastrë, Korçë, Elbasan, Laç, Shkodër, Dibër dhe Kukës. Kompetencat, detyrat dhe të drejtat e DPSHTRR dhe Drejtorive Rajonale përcaktohen në statutin e kësaj drejtorie i cili miratohet nga Ministri.
8. Më urdhrin nr. 186, datë 23.06.2020 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është shtuar në objektin e veprimtarisë së DPTSHRR-së dhe: kryerja e veprimtarisë së agjentit në sigurime sipas përcaktimeve ligjore.
9. DPSHTRR-ja sipas nenit 3 të Statutit, e ushtron veprimtarinë e saj si drejtori shërbimesh në të gjithë territorin e Shqipërisë nëpërmjet krijimit të Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor si dhe Drejtorinë e Targave e Shtypshkrimeve, të strukturuar në degë, sektorë e zyra në varësi të tyre.
10. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor si institucion shtetëror, është person juridik, publik, jobuxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për transportet, e krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 21.07.1999 "Për krijimin e DPSHTRR" dhe është entiteti i vetëm të cilit shteti i ka deleguar të drejtën për të ushtruar veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon fushën e transportit rrugor.
11. DPSHTRR gjatë zhvillimit të veprimtarisë, sa më lart dhe shtrirjes gjeografike, në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka pozitë dominuese në tregun e shërbimeve në fushën e transportit rrugor në të gjithë territorin e Shqipërisë.
12. Referuar nenit 4 të ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në transportin publik”, i ndryshuar, pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim.
13. Bazuar në nenin 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, parashikon se veprimtaria e agjentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti.
14. Sipas nenit 10, të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, DPSHTRR ka depozituar pranë AK dokumentacionin përkatës sipas kërkesave ligjore.
15. Referuar sa më sipër, nga vlerësimi ligjor i kërkesës për opinion depozituar nga AMF, në kuadër të liberalizimit të tregut, vlerësojmë se kjo kërkesë për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësisimit si agjent në sigurime nga DPSHTRR, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9 dhe nenin 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si autoriteti përgjegjës që licencon dhe mbikëqyr veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime në zbatimin e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” përpara licencimit, ti kërkojë DPSHTRR:
 - a) të lidhë kontrata të veçanta me të gjitha shoqëritë e sigurimit.
 - b) të mos vendosë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmime të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;
 - c) të mos zbatojë kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - d) të mos vendosë kushte për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.
 - e) të tregtojë produktin e sigurimit me logon e shoqërisë së sigurimit dhe barkodin përkatës në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” për të shmangur koordinimin e sjelljes, ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimin e çmimeve mes shoqërive të sigurimit dhe DPSHTRR.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 702, Datë 30.07.2020

“Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.07.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN.

Baza ligjore: Neni 8, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, pika 5, neni 70, pika 2, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin e thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit të thelluar; kundërshtimeve të paraqitura nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania Ltd lidhur me “Raportin e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, nëpërmjet shkresës së saj protokolluar në AK nr. 560/31 prot., datë 27/07/2020 “Memo lidhur me objeksionet e Shoqërisë Bankers Petroleum Albania LTD mbi “Raportin mbi hetimin e thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto””; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi kundërshtimet e paraqitura nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania Ltd,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në ankesat e paraqitura nga ndërmarrja Tosk Energji SHA (Tosk) dhe Al.Global Oil SHA kundrejt ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd (Bankers) lidhur me abuzimin me pozitën dominuese të kësaj të fundit, filloi procedurat për vlerësimin e ankesës në respektim të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Komisioni i Konkurrencës, në përfundim të vlerësimit të ankesës, në mbështetje të nenit 9, nenit 24, shkronja (d) dhe nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), me anë të vendimit nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto” (ndryshuar me vendimin e KK nr. 604, datë 21.03.2019, dhe nr. 618, datë 09.05.2019), me propozim të Sekretariatit, vendosi: hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto.

3. Me kërkesë të ndërmarrjeve ankuese, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, KK me vendimin nr. 578, datë 20.12.2018 vendosi marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd, vendim i cili i është njoftuar ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd, nëpërmjet shkresës nr. 607/12 prot, datë 20.12.2018.
4. Lidhur me zbatimin e vendimit të mësipërm nga ana e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd, Komisioni i Konkurrencës është shprehur me anë të vendimit nr. 603, datë 21.03.2019 “Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd”.
5. Në përfundim të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konkludoi se: sjellja e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd mund të përbëjë një abuzim me pozitën dominuese që zotëron kjo ndërmarrje në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, duke krijuar dyshimin e arsyeshem se mund të jemi para shkeljes së nenit 9, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.
6. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 652, datë 10.10.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, për periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 31 tetor 2019. Ky vendim i është komunikuar ndërmarrjes nën hetim Bankers Petroleum Albania Ltd, si dhe ndërmarrjes ankuese “Tosk Energji” SHA nëpërmjet shkresës sonë nr. 560/2 prot, datë 10.10.2019.
7. Në vazhdim të procedurës, në zbatim të Vendimit nr. 652, datë 10.10.2019, të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 560/15, datë 14.11.2019 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit të thelluar proceduan me kryerjen e inspektimit pranë ndërmarrjes nën hetim Bankers Petroleum Albania Ltd.
8. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, gjatë hetimit të thelluar janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: ndërmarrja Bankers Petroleum Albania Ltd, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe “Albpetrol” SHA.
9. Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr. 560/30 prot, datë 13.07.2020 “Dërgim Raporti”, ka ftuar ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD që të paraqesë me shkrim pretendimet mbi “Raportin mbi hetimin e thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”.
10. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Konkurrencës, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD nëpërmjet shkresës protokolluar në AK nr. 560/31 prot., datë 27/07/2020 “Memo lidhur me objeksionet e Shoqërisë Bankers Petroleum Albania LTD mbi “Raportin mbi hetimin e thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto” ka paraqitur pretendimet e saj mbi “Raportin e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, pretendime të cilat, në respektim të nenit 39 të ligjit 9121/2003, janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës në marrjen e këtij vendimi.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

11. Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.

II.1.1. Tregu përkatës i produktit

12. Tregu përkatës i produktit përcaktohet si: *“Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime, të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre”*. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.

13. *Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës*, nënkupton që një rritje e çmimeve e bën një produkt më pak të pëlqyer nga konsumatorët, të cilët vendosin të blejnë më pak nga ai produkt dhe më shumë nga produktet zëvendësuese.

14. Aktiviteti i prodhimit të naftës bruto në vendin tonë kryhet nga disa ndërmarrje. Sipas të dhënave të analizuara rezultojnë se Bankers Petroleum Albania LTD ka pjesën më të madhe të prodhimit të naftës bruto, ndërkohë ekzistojnë edhe disa ndërmarrje të tjera që e realizojnë këtë aktivitet, duke përfshirë edhe Albpetrol. Sasia e naftës së prodhuar varet nga rezervat natyrore të vendburimeve përkatëse të naftës nga ku rezultojnë se vendburimi që zotëron ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka rezervat më të mëdha të naftës në vendin tonë.

15. Nga analiza jonë është përjashtuar gazi natyror për arsye se vendburimet e naftës dhe gazit janë të ndara në vendburime që nxjerrin naftë dhe ato që nxjerrin gaz, pra në të njëjtin vendburim nuk mund të nxirret dhe naftë dhe gaz. Gjithashtu nafta bruto dhe gazi natyror janë produkte të pazëvendësueshme midis tyre pasi kanë funksione dhe qëllime të ndryshme përdorimi.

16. Për sa më sipër, në rastin tonë, *tregu përkatës të produktit do të konsiderojmë tregun e prodhimit dhe tregtimin të naftës bruto*.

II.1.2. Tregu përkatës gjeografik

17. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Ndërmarrjet që operojnë në tregun e prodhimit dhe tregtimin të naftës bruto në vendin tonë e ushtrojnë aktivitetin e prodhimit të naftës në vendburimet e naftës, të cilat gjenden apo janë të shpërndara në të gjithë territorin e vendit. Prandaj, *tregu përkatës gjeografik në rastin tonë përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë*.

18. Bazuar në ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, *Bankers ushtron veprimtarinë në territorin gjeografik të Republikës së Shqipërisë, i cili përcaktohet si tregu gjeografik në bazë të ligjit 9121/2003 dhe Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 76, datë 07.04.2008 “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës”*.

19. Në rastin tonë, *tregu përkatës është tregu i prodhimit dhe tregtimin të naftës bruto në territorin e Republikës së Shqipërisë*.

II.2 Licencë Marrëveshja dhe Marrëveshja Hidrokarbure

20. Operacionet hidrokarbure në RSH, rregullohen nga ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”, i ndryshuar. Në RSH, sipas këtij ligji: shteti është i vetmi pronar i të gjithë

burimeve natyrore brenda territorit dhe zonave detare të saj, dhe ka të drejtë për të kërkuar, zhvilluar, nxjerrë, prodhuar dhe përdorur burimet natyrore (neni 3, LH).

21. AKBN (ish AKH), në emër të Ministrisë përgjegjëse ka të drejtë ekskluzive për të hyrë në një Licencë Marrëveshje me Albpetrolin për të kryer të gjitha operacionet hidrokarbure të përshkruar në këtë marrëveshje.
22. Nga ana e tij Albpetroli, në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 7746/1993, me miratimin e Ministrisë përgjegjëse, ka të drejtë të transferojë, të delegojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave, titullimit dhe interesave të tij një personi juridik vendas ose të huaj, ose ndonjë institucioni ndërkombëtar finciar në lidhje me kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në një zonë të kontaktuar, bazuar në një License Marrëveshje. Kjo Licencë Marrëveshje është lidhur më 26 korrik 1993, ndërmjet Ministrisë dhe Albpetrolit.
23. Në përputhje me nenin 4 dhe 12 të ligjit nr. 7746/1993 dhe për qëllim të zbatimit të kësaj Licencë Marrëveshje, Ministria përkatëse, përfaqësuar nga AKBN (ish AKH) ka autorizuar në datë 7 qershor 2004, ndërmarrjen Albpetrol SHA të hyjë në një Marrëveshje Hidrokarbure me partnerë të ndryshëm (sipas kushteve të kësaj Licencë Marrëveshje) për të kërkuar, zhvilluar e prodhuar hidrokarbure në zonën e kontratës. Marrëveshje e cila nga ana e saj është objekt i miratimit nga KM.
24. Sipas nenit 5, pika 3, germa a), a)/2, b), c) të ligjit nr. 7746/1993: Një Marrëveshje Hidrokarbure mund t'i japë një Kontraktori sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në të:
 - Të drejtën ekskluzive për një periudhë që nuk i kalon 25 vjetët, për të zhvilluar dhe prodhuar rezervat e hidrokarbureve në Zonën e Kontratës, në përputhje me kushtet e një Plani Zhvillimi të miratuar nga Ministria, si dhe për të ripërtërirë këtë të drejtë aty dhe në masën që parashikon Marrëveshja e Hidrokarbureve.
 - T'i japë Kontraktorit të drejtën e pronësisë për pjesën e tij të hidrokarbureve të prodhuara në zonën e kontratës në një pikë që specifikohet në Marrëveshjen e Hidrokarbureve.
 - I garanton Kontraktorit të drejtën të shesë apo të tregtojë për eksport apo ndonjë gjë tjetër Hidrokarburet për të cilat ai ka marrë pronësinë sipas Marrëveshjes së Hidrokarbureve, përveç rasteve kur i nënshtrohet të drejtës së porosisë në kushte emergjence si dhe çdo detyrimi që përmban Marrëveshja e Hidrokarbureve për të furnizuar ose për të kontribuar në furnizimin e tregut lokal.
25. Sa më sipër, Albpetrol SHA ka lidhur MH për vendburimin e Patos-Marinzës me ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD (ish Saxon International Energy LTD), marrëveshje kjo e miratuar me VKM nr. 477, datë 16.07.2004 "Për Miratimin e Marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Patos-Marinzës", të ndryshuar.
26. Bankers nëpërmjet MH, merr përsipër të realizojë operacione vlerësimi, zhvillimi dhe prodhimi, dhe të mbulojë operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës. Në përputhje me kushtet dhe termat e kësaj MH, Albpetrol, cakton dhe konstituon Kontraktorin (Bankers) në mënyrë të vetme dhe ekskluzive për të kryer operacionet hidrokarbure (neni 2, pika 2.1, 2.2, MH).

Palët e kësaj marrëveshje, Albpetrol dhe Bankers Petroleum Albania LTD kanë të drejtë: "ta përdorin për llogari të vet, ta shesin, shkëmbejnë, eksportojnë, ta nxjerrin ose posedojnë naftën e prodhuar nga zona e kontratës dhe të marrin fitim dhe të drejtën e pronësisë ndaj kësaj nafte të prodhuar" (neni 2, pika 2.3, germa d) e Marrëveshjes Hidrokarbure.

27. Gjithashtu në respektim të pikës 12.2, të nenit 12 "Të drejtat dhe detyrimet e palëve", të MH: "Kontraktori do të ketë të drejtën gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate të marrë, trajtojë, transportojë, disponojë dhe eksportojë lirshëm pjesën e tij të naftës dhe të mbajë jashtë shtetit të ardhurat e fituara prej saj".
28. Po sipas nenit 10.4 të LM Kontraktori Bankers, si palë e kësaj LM, mund të përdorë lirshëm, shesë, eksportojë, realizojë ose ndryshe të disponojë gjithë hidrokarburet e disponueshme dhe të mbajë të ardhurat e realizuara pre tij.
29. Në vazhdim, bazuar në nenin 12.10 të MH, Albpetrol dhe AKBN angazhohen t'i sigurojnë Kontraktorit infrastrukturën e nevojshme në Shqipëri me qëllim mundësimin e Kontraktorit që të prodhojë, transportojë, eksportojë dhe shesë naftë në ose nga Shqipëria sipas MH.
30. Në referencë të nenit 5, pika 3, germa c), Marrëveshja Hidrokarbureve i garanton kontraktorit të drejtën të shesë apo të tregtojë për eksport apo ndonjë gjë tjetër hidrokarburet për të cilat ai ka marrë pronësinë sipas Marrëveshjes së Hidrokarbureve, përveç rasteve kur i nënshtrohet të drejtës së porosisë në kushte emergjence si dhe çdo detyrimi që përmban Marrëveshja e Hidrokarbureve për të furnizuar ose për të kontribuar në furnizimin e tregut lokal.
31. Ky rregull, i parashikuar në dispozitat e ligjit nr.7746/1993 i jep kontraktorit Bankers Petroleum Albania LTD të drejtën të shesë apo të tregtojë për eksport apo ndonjë gjë tjetër hidrokarburet për të cilat ai ka marrë pronësinë sipas Marrëveshjes së Hidrokarbureve, përjashtimi lejohet vetëm në rastet kur ndodhemi përpara "kushteve të emergjencës", ose "për të kontribuar në furnizimin e tregut lokal". Në lidhje me këto rrethana në MH nuk është cituar ndonjë detyrim për palën kontaktore.
32. ***Kontraktori Bankers Petroleum Albania LTD nuk ka as edhe një kufizim, ai është plotësisht i lirë të shesë dhe të tregtojë naftën bruto që prodhon, në tregun vendas ose për eksport.***
33. Gjithashtu dhe në Licencë Marrëveshjen dhënë Albpetrol-it nga MIE nuk parashikohet një detyrim i tillë për kontraktorët e Albpetrol. Nqs do ishte parashikuar një detyrim i tillë në licencë marrëveshje, ky detyrim, si çdo e drejtë, privilegj dhe detyrim tjetër që i jepet Albpetrolit lidhur me operacionet hidrokarbure në zonën e licencës, do i transferohej kontraktorit Bankers, palë në marrëveshjen hidrokarbure.

II.3 Vlerësimi i Pozitës Dominuese

34. Vlerësimi i pozitës dominuese në treg është hapi i parë për të vazhduar me analizën e nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), për sjellje të mundshme antikonkurrese në treg. Përkufizimi i pozitës dominuese është përcaktuar në nenin 3, pika 5 të ligjit, përkatësisht: "Pozitë dominuese" është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
35. Sipas ligjit nr. 9121/2003, nuk është e ndaluar pozita dominuese nga një ose disa ndërmarrje në treg, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjeve një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të këtij ligji.
36. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të ligjit janë: pjesët e tregut përkatës, pengesat në hyrje në tregun përkatës, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike dhe financiare, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristika të tjera të tregut përkatës.

37. Nga analiza e pjesëve të tregut të prodhimit të naftës bruto të prodhuar në Shqipëri, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD për vitin 2016 zë rreth XXX% të tregut, në vitet 2017 dhe 2018 ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD zë përkatësisht XXX% dhe XXX% të tregut, ndërsa për periudhën janar - qershor 2019 zë XXX% të tregut, duke qenë kështu prodhuesi më i madh i naftës bruto në vend. Pra vëmë re se pjesa e tregut të ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD ka patur një rënie të vogël nga viti 2016 duke ruajtur pjesën e tregut për vitet 2017 dhe 2018, pra ka paraqitur një qëndrueshmëri të pjesëve të tregut në tregun e prodhimit të naftës bruto në vite. Ndërsa volumi i prodhimit ka pësuar rënie nga viti 2016 në vitin 2018. Gjithashtu rezulton se vetëm ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD kryen operacione të eksportit të naftës bruto.
38. Nga sasitë totale të naftës bruto të shitur në tregun e brendshëm, për vitin 2016 ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka shitur XXX% të prodhimit, ndërsa në vitet 2017 ka shitur XXX% të prodhimit dhe në vitin 2018 ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka shitur XXX% të prodhimit. Mbështetur në Udhëzimin “Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të ligjit 9121/2003” dhe përvojën e vendeve të BE, pozita dominuese nuk është e mundur nëse pjesa e tregut përkatës është më e vogël se 40%. Nga ana tjetër, sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrja zotëron këtë pjesë tregu aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e AK. Si rrjedhojë, Bankers Petroleum Albania LTD nuk gëzon pozitë dominuese në tregtimin e naftës bruto në tregun e brendshëm.
39. Gjatë periudhës nën hetim në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto kanë operuar disa kompani, të cilat kanë nënshkruar Marrëveshje Hidrokarbure me Albpetrol SHA për prodhimin dhe zhvillimin e vendburimeve ekzistuese të naftës dhe gazit. Marrëveshjet Hidrokarbure jepen për një periudhë që nuk i kalon 25 vjet. Duke qenë se burimet natyrore të hidrokarbureve janë të kufizuara në numër dhe marrëveshjet për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburim janë me afate shumëvjeçare (deri në 25 vjet), mund të themi që barrierat për hyrjen e konkurrentëve në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto janë barriera natyrore më tepër sesa ligjore. Gjithashtu, hyrja në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj kërkon investime të mëdha, investime të cilat përbëjnë barriera të larta ekonomike për hyrjen në tregun përkatës.
40. Aktiviteti i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto në vend realizohet nga disa ndërmarrje, por vetëm njëra prej tyre, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD rezulton të ketë pjesën më të madhe të prodhimit të naftës (përkatësisht XXX%, XXX% dhe XXX% për vitet 2016, 2017, 2018), ndërsa ndërmarrjet e tjera kanë një pjesë shumë të vogël, prandaj konkurrenca në tregun e prodhimit të naftës bruto është në nivele të ulta. Sasia e naftës së prodhuar varet nga rezervat natyrore në vendburimet përkatëse të naftës nga ku rezulton se vendburimi që zotëron ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka rezervat më të mëdha të naftës në vendin tonë.
41. Konsumatorët e naftës bruto (rafineritë që bëjnë përpunimin e naftës) nuk zotërojnë fuqi kundërvepruese për t'u marrë në konsideratë, nevojat e tyre në tregun e naftës bruto mund të përmbushen nga prodhuesit e naftës bruto vendas, apo të huaj.
42. *Duke marrë parasysh pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjeve, barrierat për hyrjen në treg (ligjore dhe ekonomike), konkurrencën potenciale, fuqinë kundërvepruese të blerësve dhe qëndrueshmërinë e pjesëve të tregut në vite, bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH.*

II.4 Sjellja e ndërmarrjes në treg

43. Ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD kryen edhe eksportin e naftës bruto. Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit vërehet se ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka eksportuar

konkretisht XXX% të prodhimit gjatë vitit 2016, XXX% të prodhimit gjatë vitit 2017 dhe XXX% të prodhimit gjatë vitit 2018.

44. Çmimi i shitjes së naftës bruto nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD përcaktohet vetëm nga kushtet e tregut si: konjuktura e tregut, kërkesa, disponueshmëria dhe aksesit në kohën kur negociohet dhe nënshkruhet kontrata respektive e shitjes.
45. Çmimi i shitjes brenda vendit të naftës bruto nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD për vitin 2016 rezulton të jetë XXX % më i lartë se çmimi i eksportit. Për vitin 2017 çmimi i eksportit të naftës bruto nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD rezulton të jetë XXX % më i lartë se çmimi i shitjes brenda vendit. Për vitin 2018 çmimi i eksportit të naftës bruto rezulton të jetë XXX % më i lartë se çmimi i shitjes brenda vendit, ndërsa për periudhën janar-prill 2019 çmimi i eksportit të naftës bruto rezulton të jetë XXX % më i lartë se çmimi i shitjes brenda vendit.
46. Nga krahasimi i çmimeve të eksportit dhe shitjes në vend të naftës bruto të Bankers Petroleum Albania LTD me çmimet e bursës Brent rezulton se çmimi mesatar i eksportit ndjek trendin e bursës Brent me mesatarisht XXX % të Brent-it ose mesatarisht XXX \$/bbl më pak. Çmimi mesatar i shitjes brenda vendit rezulton të jetë mesatarisht XXX % i çmimit të Brent-it, ose mesatarisht XXX \$/bbl, pra rreth XXX % më i ulët se çmimi mesatar i shitjes për eksport. Nga analiza e të dhënave në lidhje me shitjet brenda vendit për Bankers Petroleum Albania LTD rezulton se çmimi i shitjes brenda vendit është i njëjtë për ndërmarrjet në tregun e brendshëm. Për shitjet jashtë vendit Bankers Petroleum Albania LTD aplikon çmime të ndryshme në varësi të kontratave të lidhura.
47. Në RSH, ushtrojnë aktivitetet të përpunimit të naftës bruto 4 (katër) rafineri nga të cilat rafineria më e madhe është Rafineria e Ballshit (KPTHN në Ballsh), e cila operohet nga ndërmarrja Tosk Energji.
48. Ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka lidhur me ndërmarrjen Tosk kontratën e shitjes së naftës bruto datë 01.05.2018 për furnizime për periudhën maj - dhjetor 2018. Në bazë të kësaj kontrate ndërmarrja Tosk është furnizuar me XXX MT naftë bruto për muajt maj – shtator 2018. Konkretisht për muajin maj sasia e furnizuar është XXX MT, në qershor sasia e furnizuar është XXX MT, në korrik sasia e furnizuar është XXX MT, në gusht sasia e furnizuar është XXX MT dhe në shtator sasia e furnizuar është XXX MT.
49. Ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka lidhur me ndërmarrjen Tosk kontratën e shitjes së naftës bruto për vitin 2019. Në bazë të kësaj kontrate Tosk Energji, është furnizuar: në janar sasia e furnizuar është XXX MT, në shkurt sasia e furnizuar është XXX MT, në mars sasia e furnizuar është XXX MT, në prill sasia e furnizuar është XXX MT, në maj është XXX MT, në qershor sasia e furnizuar është XXX MT, në korrik sasia e furnizuar është XXX MT, në gusht sasia e furnizuar është XXX MT dhe për muajin shtator XXX MT.
50. Pavarësisht kontratës së lidhur midis Bankers Petroleum Albania LTD dhe Tosk për vitin 2019 midis palëve ka vazhduar problematika ku nga ana e Bankers-it pretendohet se Tosk nuk ka tërhequr sasitë e kërkuara për naftë bruto, e cila rezulton me moskryerjen e parapagimit apo çeljes së Letër Kreditit për volumin e programuar. Nga ana tjetër, Tosk pretendon se Bankers Petroleum Albania LTD nuk e ka furnizuar me sasinë e kërkuar të naftës bruto. Marrëdhëniet midis palëve janë marrëdhënie kontraktore dhe si të tilla ato mbartin të drejta dhe detyrime reciproke, të cilat rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil dhe nuk janë objekt i ligjit nr. 9121/2003.
51. Ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka lidhur kontratën e shitjes së naftës bruto edhe me ndërmarrjen Al.Global Oil SHA datë 01.04.2018 për furnizime për periudhën prill - dhjetor 2018. Nga kjo kontratë rezulton se çmimi i shitjes është i njëjtë me atë të Tosk, prej XXX % të Brent-it, kurse sasia e furnizimit referuar të dhënave të analizuar më sipër rezulton se gjatë muajve gusht, shtator, tetor të vitit 2018 është mesatarisht XXX MT/muaj.

52. Për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2019 Bankers Petroleum Albania LTD ka lidhur kontratë me Al.Global Oil SHA, dhe referuar të dhënave të analizuara rezultoi se sasia e furnizuar për Al.Global Oil SHA, gjatë muajve mars, prill të vitit 2019 është mesatarisht XXX MT/muaj, me një çmim mesatar prej XXX % të Brent-it.
53. Marrëdhëniet midis palëve si Bankers-Tosk; Bankers-Al.Global; si dhe çdo marrëdhënie tjetër kontraktore e Bankers Petroleum Albania LTD me rafineritë e tjera të naftës që operojnë në territorin e RSH janë marrëdhënie kontraktore, dhe si të tilla ato rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil. Në këto kushte, referuar natyrës së kontratës së furnizimit, ku *“Furnizimi është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet, kundrejt pagesës së një çmimi, të kryejë në dobi të palës tjetër furnizime periodike ose të vazhdueshme të sendeve”*, detyrimet e palëve janë të ndërsjellta (neni 772 §1 K.C.), dhe nga ana tjetër në mbështetje të nenit 773 të Kodit Civil: *“Kur nuk është përcaktuar sasia e furnizimit nënkuptohet se marrëveshja është për sasinë që përkon me nevojat normale të palës që furnizohet deri në kohën e përfundimit të kontratës. Në qoftë se palët kanë vendosur vetëm kufirin maksimal dhe minimal për furnizimin ose për shërbimet e veçanta, i takon atij që ka të drejtën e furnizimit të vendosë brenda kufijve të mësipërm për sasinë e duhur. Në qoftë se sasia e furnizimit duhet të përcaktohet sipas nevojave mbi një sasi minimale të caktuar në kontratë, pala që furnizohet përgjigjet për sasinë përkatëse sipas nevojave në rast se tejkalohet sasia minimale”*.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 24 shkronja d, nenin 26, nenin 43, pika 5, dhe nenin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto.
- II. Dhënien e rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD si subjekt me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH:
1. Të aplikojë kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore;
 2. Të furnizojë ndërmarrjet e përpunimit të naftës bruto në tregun vendas, në respektim të marrëdhënieve kontraktore bazuar në dispozitat e Kodit Civil.
- III. Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD të depozitojë pranë AK:
1. çdo raportim tremujor mbi kostot e naftës;
 2. çdo raportim tremujor mbi prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure.
- IV. Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD të depozitojë pranë AK për vlerësim paraprak çdo draft kontratë që do të lidhë me çdo rafineri, në respektim të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
- V. T’i rekomandojë Albpetrol SHA, në respektim të Marrëveshjes Hidrokarbure:
- i. Të bëjë parashikimet/planifikimin e nevojave të tregut vendas për furnizimet e nevojshme me naftë bruto;
 - ii. Të mbikëqyrë planet e furnizimit të tregut vendas nga ana e Bankers Petroleum Albania LTD.
- VI. T’i rekomandojë AKBN, në respektim të Marrëveshjes Hidrokarbure:

- i. Në bashkëpunim me Albpetrol, të bëjë parashikimet/planifikimin e nevojave të tregut vendas për furnizimet e nevojshme me naftë bruto;
 - ii. Të mbikëqyrë dhe monitorojë planet e prodhimit të naftës bruto nga ana e Bankers Petroleum Albania LTD.
- VII. Moszbatimi i përmbushjes së pikës II, III dhe IV të këtij vendimi, në zbatim të nenit 73 dhe 74 të ligjit 9121/2003 ndërshkohet me penalitetet përkatëse.
- VIII. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Gjatë periudhës së monitorimit, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD duhet të raportojë çdo 3 (tre) muaj pranë AK të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të pikave II, III dhe IV të këtij vendimi.
- IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 704, Datë 10.09.2020

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Pogradec” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.09.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Pogradec” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës Nr. 149 Prot., datë 03.09.2019, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr. 61 Prot., datë 29.03.2020, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjetllës dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale.
 - UK Pogradec SHA ka aplikuar tarifat e miratuara nga ERRU sipas Vendimit Nr.28 datë 19.11.2012 “Për miratimin e tarifave për konsum publik të UK Pogradec SHA. Sipas ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA, niveli i tarifave në fuqi nuk është ndryshuar për një periudhë të gjatë kohore rreth tetë vjet, si edhe pas riorganizimit të Bashkisë Pogradec kërkohet të aplikohet një tarifë e ndryshuar për të siguruar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit.
3. *Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm*, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon dy nivele tarifimi volumetrik si dhe dy tarifa fikse shërbimi për FU dhe për KUZ+ITUN, tarifa të diferencuara për zonën urbane të Pogradecit dhe të Njësisë Administrative Bucimasit. Niveli i bllokut të parë të tarifës i përket konsumit deri në 4.5 m³ ujë/ muaj, ndërsa niveli i dytë i përket konsumit mbi 4.5 m³/ muaj. Në zonën e re të shtuar shoqëria për tre kategoritë e klientëve aplikon faturimin mujor afrofe.

4. Njëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA, propozon ndryshimin e tarifave për faktin që aplikimi i tarifave i ndarë sipas blloqeve, për ata konsumatorë që kanë shtëpi të dyta apo pushimi në Pogradec penalizon shoqërinë UK Pogradec SHA në realizimin e të ardhurave për përballimin e kostove, në nivel më të mirë se ai ekzistues, si rezultat i zgjerimit të zonës së shërbimit, si edhe nevoja për të ardhura shtesë për investime në të gjithë zonën pas riorganizimit, realizimin e detyrimeve që shoqëria ka ndaj institucioneve të kredisë për financimet e deritanishme të cilat kanë siguruar një kohëzgjatje 21-22 orë/ ditë në zonën urbane të Bashkisë Pogradec.
5. Tarifa për konsumatorin familjar në të gjitha zonat urbane unifikohet në 60 lekë/m³ duke pësuar një rritje që varion nga 38 lekë/m³; për ata konsumatorë që janë pjesë e bllokut të parë deri në 4.5 m³/muaj, ndërsa për konsumatorët familjar që janë pjesë e bllokut të dytë mbi 4.5 m³/muaj tarifa pëson një ulje në 2 lekë/m³. Tarifa për konsumatorin familjar në zonën rurale të shtuar pas riorganizimit në bazë të VKM-së nr.63 datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” është e diferencuar dhe pëson një rritje nga 20 lekë/m³ deri në 30 lekë/m³.

Për konsumatorët privat dhe publik, në zonën urbane, tarifa rritet me 74 lekë/m³ në bllokun e parë dhe 0 lekë/m³ në bllokun e dytë. Tarifa për konsumatorët privat dhe publik në zonën rurale, për të gjithë zonën pas riorganizimit, pësojnë një rritje 100 lekë/m³. Propozohet ndryshim i tarifës fikse të furnizimit me ujë duke pësuar një rritje me 100 lekë/muaj/lidhje vetëm për konsumatorin familjar në bllokun e dytë, pra me një rritje 100% të tarifës aktuale, tarifa fikse për konsumatorin publik dhe privat mbetet e pandryshuar për zonën e bllokut të parë, por tarifa pëson rritje për këtë kategori konsumatorësh që janë pjesë e bllokut të dytë me 100 lekë/muaj/ lidhje. Për konsumatorët publik dhe privat në zonën rurale kjo tarifë fikse e furnizimit me ujë pëson ulje nga 500lekë/muaj/lidhje në 100lekë/muaj/lidhje. Tarifa volumetrike për largimin e ujërave të ndotura, për të tre konsumatorët nuk është një tarifë e re pasi ajo është miratuar në vitin 2012, për këtë tarifë kërkohet rritje me 19 lekë/m³ për konsumator familjarë në bllokun e parë, zbritje në 3 lekë/m³ për bllokun e dytë, rritje e tarifës për zonën rurale me 15 lekë/m³ me kushtin e aplikimit të këtyre tarifave vetëm nëse UK Pogradec SHA do të realizojë investime në zonat rurale të KUN, për konsumator publik dhe konsumator privat në zonat urbane tarifa volumetrike për KUN pëson rritje me 28 lekë/m³ për bllokun e parë dhe rritje 4 lekë/ m³ për bllokun e dytë. Për konsumator publik dhe konsumator privat në zonën rurale tarifa pëson një rritje me 30 lekë/m³. Në këtë aplikim nuk është kërkuar unifikimi i saj si pjesë e këtij projekt vendim të ERRU-së. Aplikimi nuk është unifikues për të gjithë zonën e shërbimit, por sipas ofrimit të shërbimit dhe vlerësimit të kostove për zonat respektive.

6. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2019, vitin 2020 dhe vitin 2021 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, duke reduktuar kostot e mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar uljen e humbjeve teknike dhe administrative si edhe synimin kryesor për rritjen e qëndrueshmërisë financiare, rritjen e mundësisë për shlyerjen e investimeve të deritanishme dhe përfitimin e investimeve të tjera.
7. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA pas riorganizimit arrin të mbulojë kostot e operim mirëmbajtjes pasi ajo parashikohet të jetë në masën 119 % gjatë 2019 dhe 105% gjatë vitit 2020, por mbulimi i kostove totale të operimit dhe mirëmbajtjes ishte 56% për vitin 2019 dhe parashikohet 54% për vitin 2020 dhe 79% për vitin 2021.
8. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA duhet të punojë për reduktimin e nivelit të humbjeve teknike dhe administrative, duke anagzhuar stafin për vlerësimin sa më të saktë të çdo komponenti që bilanci të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të mbajë evidenca mbi sasinë e ujit që nuk maten, mbi sasinë e autorizuara të pa faturuara, etj, si edhe të hartojë plan biznesin 5 vjeçar sipas

riorganizimit në kuadër të VKM Nr.63, me qëllim argumentimin për nevojën e investimeve në lidhje me përmirësimin e shërbimit si edhe qëndrueshmërinë financiare.

9. Tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Pogradec SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
10. Duke qenë se niveli i kostove totale për vitin 2020 mbetet thajse në nivele relativisht të ulëta krahasuar me ato të vitit 2019 me një zbitje prej 2%, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove, si dhe të gjitha investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit duhet të jenë sa më transparente.
Nga vlerësimi i Konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Pogradec SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura.
11. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të tre shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).
12. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, por nuk është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 1. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 2. ERRU të kërkoj nga Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 3. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
 - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 706, Datë 10.09.2020

“Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL-të publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL private”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.09.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL-të publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL private.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), (f), neni 26, neni 41, neni 69 dhe 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar me vendimet nr. 620, datë 13.05.2019, nr. 662, datë 21.11.2019 dhe nr. 672, datë 24.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë””, në mbështetje të nenit 4 dhe 9, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 41 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; si dhe ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, vendosi të miratojë hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë.
2. Arsyeja e hapjes së hetimit është për të analizuar nivelin e konkurrencës në tregun e ofrimit të shërbimit të arsimit të lartë.
3. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 41 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka realizuar një hetim të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë, i cili u mbështet mbi praktikat më të mira të vlerësimit të tregut të OECD.
4. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, gjatë periudhës së hetimit të përgjithshëm janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) publike dhe private, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

5. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:

- a) Tregu përkatës i produktit
- b) Tregu përkatës gjeografik

II.1.a Tregu përkatës i produktit

6. Arsimi i lartë luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik e shoqëror dhe ka efektet e tij sociale në shoqëri.

7. Drejtimi kryesor në të cilin synon të zhvillohet arsimi i lartë, është kërkesa për IAL sa më cilësore, të orientuara drejt kërkimit shkencor. Sipas gjetjeve të progres raportit të Komisionit Evropian për vitin 2018, cilësia e arsimit duhet të ngrihet në të gjitha nivelet, veçanërisht për t'i pajisur më mirë njerëzit me aftësi që i nevojiten tregut të punës. Sipas progres raportit të Komisionit Evropian 2019, progres është bërë vetëm në implementimin e kurrikulave dhe kornizës legjislative dhe sidomos në zhvillimin e një aplikacioni për njohjen e diplomave.

8. Konkurrenca në arsimin e lartë është zhvilluar në mënyrë të ndjeshme në dekadat e fundit, nga konkurrenca për studentët në konkurrencën për buxhetet dhe konkurrencën për profesorë, por edhe natyra e konkurrencës ka evoluar, duke çuar në forma të reja të konkurrencës. Konkurrenca në arsimin e lartë nuk ndodh më vetëm mes individëve dhe vendeve, por është bërë institucionale, duke çuar në transformimin e universiteteve në konkurrentë. Kjo konkurrencë paraqitet më tepër si një konkurrencë për cilësinë sesa për çmimin.

Konkurrenca midis IAL-ve prek një sërë çështjesh, si: konkurrenca për studentët, grante, akademikë, zbulime, patentë, burime publike dhe private, etj.

9. Nëse një individ është i gatshëm të ndjekë një IAL, ai duhet të zgjedhë se cilin IAL të ndjekë (publik apo privat) duke krahasuar përfitimet/dobinë e tij në të dy institucionet. Përderisa IAL-të publike janë më të lira, studentët do të jenë të gatshëm të ndjekin një IAL privat, i cili është më i kushtueshëm, vetëm nëse ky i fundit ofron cilësi më të lartë se ai publik.

10. IAL-të konkurrojnë me njëri-tjetrin për të marrë studentët më të mirë, duke ofruar infrastrukturë cilësore, staf akademik, programe konkurruese dhe kërkim shkencor.

11. Tregjet për Institucionet e Arsimit të Lartë dallojnë shumë nga tregjet e tjera konkurruese. Për shkak të llojeve të ndryshme të programeve të studimit dhe vendndodhjeve të ndryshme gjeografike të IAL-ve, ofrimi i shërbimit të arsimit të lartë është i diferencuar. Nga ana e kërkesës, informacioni është jo i plotë dhe jo transparent, pasi jo të gjitha IAL-të, kanë një listë të çmimeve (tarifave të studimit) të publikuar për të gjitha programet dhe shërbimet që ofrojnë.

12. Fokusi i këtij hetimi të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë janë të gjitha institucionet publike dhe private në vend që ofrojnë arsimin e lartë apo operojnë si IAL. Në këtë kuadër nga ana e ofertës konsiderohen të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit të lartë, si universitetet, akademitë, kolegjet universitare dhe kolegjet profesionale të larta. Ndërsa nga ana e kërkesës qëndrojnë studentët që

duan të ndjekin studimet në IAL, në një program të caktuar, në njërin nga ciklet e studimit (bachelor, master, doktoraturë) dhe në njërin nga format e studimit (me kohë të plotë apo me kohë të zgjatur).

13. Tregjet konkurruese karakterizohen nga ofrues që konkurrojnë me njëri - tjetrin duke qenë përgjegjës ndaj klientëve të tyre. Në këto tregje, një klient ka aftësinë për të kaluar tek një ofrues alternativ nëse ai ofron një cilësi më të mirë të shërbimit ose ofron të njëjtin produkt me një çmim më të ulët. Prandaj ofruesit duhet të konkurrojnë për konsumatorët (në rastin tonë studentët), duke siguruar një nxitje për të rritur mundësinë e zgjedhjes, cilësinë, inovacionin dhe intensitetin e konkurrencës nëpërmjet çmimeve.
14. Ekzistenca e konkurrencës në arsimin e lartë do të thotë që nëse studentët kanë aftësinë për të zgjedhur midis IAL-ve, atëherë IAL-të do të stimulohen për të performuar më mirë duke rritur cilësinë.
15. Përkufizimi i tregut në Sektorin e Arsimit të Lartë është një temë e vështirë si nga perspektiva e kërkesës ashtu dhe nga ajo e ofertës, veçanërisht për shkak të diversitetit të cikleve, programeve të ndryshme të studimit dhe formës së studimit. Fakti që ekzistojnë Institucionet e Arsimit të Lartë private është sepse ka studentë që janë të gatshëm të paguajnë për këto shërbime alternative. Kjo zgjedhje mund të shpjegohet me ekzistencën e një niveli të diferencuar të cilësisë së shërbimeve, për shembull kushte më të mira për konsumatorët (studentët), të pajisura me laboratorë modernë, ose rasti kur studenti nuk arrin të fitojë një program që ai dëshiron në IAL-të publike.
16. Përshkrimi më i mirë i strukturave të tregut në arsimin e lartë në Europë dhe më gjerë, sipas studimeve të OECD, është se ata janë përzierje e konkurrencës monopoliste dhe oligopolit. Disa tregje të arsimit të lartë janë të ngjashme me konkurrencën monopoliste në atë se shërbimi i ofruar nga ofruesit është shumë heterogjen, dhe për ata studentë që mund të konsiderojnë një shtrirje të madhe gjeografike, mund të ketë shumë ofrues që ofrojnë diploma Bachelor, Master apo Doktor, brenda fushës së tyre të studimit. Në të njëjtën kohë, tregjet mund të ngjajnë oligopole pasi ka pengesa të dukshme për hyrjen dhe daljen në arsimin e lartë dhe tregjet e përcaktuara në nivel rajonal.

Në vendin tonë, nga rezultatet e analizës së tregut, rezulton se struktura e tregut në arsimin e lartë është më afër asaj të konkurrencës monopolistike, për shkak të numrit të konsiderueshëm të IAL-ve që operojnë në treg, duke ofruar programe studimi për afërsisht të ngjashme, por të diferencuara nga pikëpamja e cilësisë.

17. Për sa i përket arsimit të lartë publik, ai vepron sipas kuotave të ofruara nga IAL-të publike dhe në bazë të rezultateve të provimeve të maturës shtetërore dhe përzgjedhjes së programit të studimit nga ana e studentit. IAL-të private mund t'i ofrojnë një mundësi studimi secilit student që paraqet interesin e tij për të marrë shërbim në këto Institucione përkatës të Arsimit të Lartë privat, por gjithsesi dhe këto të fundit bëjnë përzgjedhjet e tyre në varësi të kuotave dhe të nivelit të studentëve. Dallimi kryesor midis IAL-ve publike dhe private ka të bëjë me tarifën apo çmimin e paguar për shërbimin e marrë, i cili është më i lartë në IAL-të private.
18. Duke u nisur nga ndikimi që ka niveli i arsimit në cilësinë e jetës së individëve, kërkesa konsumatore ndiqet nga nevoja për arsim/dije dhe në përgjithësi konsumatori priret drejt shërbimit që i plotëson më mirë nevojat dhe aty ku mendon se cilësia është më e mirë duke u nisur nga programi i studimit, stafi akademik dhe kushtet e tjera. Pra, siç thamë edhe më lart zgjedhja e një ofruesi në këto raste është e orientuar tek ofruesi më i mirë në dispozicion duke patur parasysh buxhetin e konsumatorit.
19. Sektori publik dhe privat i shërbimit të arsimit janë zëvendësues nga ana e kërkesës për sa i përket karakteristikave të shërbimit të ofruar dhe funksionit që kryejnë, por nuk janë të zëvendësueshëm për sa i përket çmimit.

20. Sipas të dhënave të administruara nga IAL-të publike dhe private në vendin tonë, rezulton se ato ofrojnë programe të ndryshme të studimit. Gjithashtu ka dhe IAL që janë të specializuara në një fushë të caktuar (p.sh. mjekësi, stomatologji, estetikë, etj). Për sa i përket IAL-ve, të cilët kanë të njëjtin profil, apo specialitet ato mund të konsiderohen të zëvendësueshëm nga ana e ofertës, publike apo private qofshin, pasi nuk ka kosto shtesë nga pikëpamja e stafit akademik, të cilët janë të profilizuar në degën e caktuar. Ndërsa IAL-të që ofrojnë programe studimi në degë të ndryshme nuk janë të zëvendësueshëm midis tyre nga ana e ofertës (p.sh mjekësia dhe artet).
21. Në këtë rast është bërë një përcaktim i gjerë i tregut përkatës të produktit, për arsye se kemi të bëjmë me një hetim të përgjithshëm të sektorit të arsimit të lartë, dhe për këtë qëllim është parë e arsyeshme që për të analizuar tregun e arsimit të merren në konsideratë të gjithë karakteristikat e tregut dhe faktorët që ndikojnë anën e kërkesës (zgjedhjet e konsumatorëve) dhe të ofertës. Sidoqoftë, sipas rastit mund të bëhet një nënndarje në tregje më të vogla produkti (nën tregje) *mbi bazën e fushës së studimit*, siç është sigurimi i shërbimit të arsimit në një program studimi të caktuar; *sipas cikleve të studimit* (bachelor, master, doktoraturë); *ose sipas formës së studimit* (me kohë të plotë apo të zgjatur).
22. Referuar sa më sipër, *tregu përkatës të produktit do të konsiderojmë tregun për ofrimin e shërbimit të arsimit të lartë nga Institucionet e Arsimit të Lartë, duke përfshirë të gjitha shërbimet e ofruara për studentët nga Institucionet publike dhe private të Arsimit të Lartë.*

II.1.b Tregu përkatës gjeografik

23. Nga analiza e të dhënave të studentëve dhe IAL-ve, rezulton se meqenëse qyteti i Tiranës ka dhe numrin më të madh të IAL-ve dhe të banorëve, ka dhe numrin më të madh të studentëve në krahasim me qytetet e tjera të Shqipërisë. Megjithatë IAL-të publike dhe private janë të shpërndara në të gjithë territorin e vendit dhe kryesisht në qytetet më të mëdha. Për këtë arsye konsumatorët apo studentët në rastin tonë mund të zgjedhin të shkojnë në IAL-në më të afërt me vendbanimin e tyre, ose në rast të degëve të veçanta të shkojnë drejt IAL-ve më të largëta, në qytetin më të afërt apo në kryeqytet.
24. Referuar sa më sipër, *tregu përkatës gjeografik përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë.*
25. *Si përfundim, tregu përkatës në këndvështrimin e përgjithshëm do të konsiderojmë tregun për ofrimin e shërbimit të arsimit të lartë nga Institucionet e Arsimit të Lartë, duke përfshirë të gjitha shërbimet e ofruara për studentët nga Institucionet publike dhe private të Arsimit të Lartë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

II.2 Barrierat e hyrjes dhe zgjerimit

26. Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” përcakton disa kriteret, të cilat duhet të plotësohen për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë pas plotësimit të standardeve akademike, sigurimit të mjeteve të nevojshme financiare për përfundimin e studimeve të filluara nga secili student i regjistruar dhe përmbushjen e kriterëve të tjera, të përcaktuara me ligj apo akte të tjera nënligjore, të nevojshme për të siguruar cilësinë e programeve të planifikuara të studimeve, si dhe të veprimtarive të tjera të institucionit.
27. Në tregun e arsimit të lartë ekzistojnë pengesa ligjore për të hyrë në treg për shkak të kuadrit ligjor dhe rregullator të licencimit dhe pengesa ekonomike për shkak se IAL-të kanë kosto të konsiderueshme fikse dhe kosto të lartë variabël të hapjes së një IAL-je dhe shpenzimeve të nevojshme për t'u zhvilluar infrastruktura e nevojshme për të siguruar diploma në fusha të caktuara dhe për kërkimin shkencor. Megjithatë, në Shqipëri, numri i lartë i IAL-ve që ekzistojnë në treg dhe fakti se arsimit i lartë në Republikën e Shqipërisë është një treg i liberalizuar tregon se plotësimi i këtyre lloj kriterëve është i realizueshëm dhe nuk ka kufizuar hyrjen e IAL-ve në treg.

II.3 Transparenca dhe asimetria e informacionit

28. Në lidhje me transparencën e publikimit të tarifave të studimit, të ndara në tarifa regjistrimi dhe tarifa shkollimi nga ana e IAL-ve publike apo private, rezulton se për IAL-të publike vetëm Universiteti i Tiranës, Universiteti Luigj Gurakuqi në Shkodër dhe Universiteti Fan S. Noli në Korçë paraqesin përditësime në website-t e tyre në lidhje me tarifat e studimit. Pjesa tjetër e faqeve të IAL-ve publike nuk kanë të publikuar informacion në lidhje me tarifat e studimit.

Përsa i përket IAL-ve private, vetëm një pjesë e tyre kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare informacion në lidhje me tarifat si: Universiteti Marin Barleti, UET, TBU, Kolegji Universitar Bedër dhe Kolegji Profesional i Tiranës. Pjesa më e madhe e IAL-ve private nuk kanë të publikuar informacion në lidhje me tarifat e studimit.

29. Sipas raportit të OECD-së, në arsim ka një problem të asimetrisë së informacionit. Konsumatorët mund të kenë vështirësi në vëzhgimin e cilësisë së arsimit të ofruar. Në çdo rast, cilësia e arsimit mund të jetë një përvojë personale dhe mund të jetë edhe më e vështirë të vlerësohet cilësia e arsimit në një IAL pa ndonjë përvojë të drejtpërdrejtë personale. Ky problem i asimetrisë së informacionit shkakton nevojën për rishikim, vlerësim dhe shërbime të akreditimit të pavarur.

II.4 Struktura e tregut në Sektorin e Arsimit të Lartë

30. Struktura e tregut në Sektorin e Arsimit të Lartë është paraqitur në varësi të numrit të studentëve në IAL-të publike dhe private; dhe treguesve të buxhetit si: të ardhurat dhe shpenzimet në IAL-të publike dhe private.

31. Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në IAL-të publike dhe private për vitin akademik 2016-2017 është XXX studentë, nga ku IAL publike kanë XXX studentë të regjistruar ndërsa IAL private kanë XXX studentë të regjistruar, ose në terma relativ IAL-të publike zënë XXX% të tregut të arsimit të lartë sipas numrit të studentëve të regjistruar, ndërsa IAL private zënë vetëm XXX% të tij. Ndërsa për vitin akademik 2017-2018 numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në IAL-të publike dhe private është XXX studentë, nga ku IAL publike kanë XXX studentë të regjistruar, ndërsa IAL private kanë XXX studentë të regjistruar. Në terma relativë IAL-të publike zënë XXX% të tregut sipas numrit të studentëve të regjistruar, ndërsa IAL private zënë vetëm XXX% të tij.

Numri i studentëve gjatë vitit e akademik 2017-2018 ka pësuar rënie me rreth XXX % krahasuar me vitin akademik 2016-2017.

32. Për sa i përket tregut të arsimit të lartë për IAL-të publike dhe private sëbashku apo më vete, sipas numrit të studentëve të regjistruar, për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018, IAL-të me numrin total më të madh të studentëve të regjistruar janë të njëjta dhe përkatësisht ndër IAL publike janë Universiteti i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Universiteti Politeknik, ndërsa ndër IAL private Universiteti Albanian University, Universiteti European i Tiranës dhe Universiteti Zoja e Këshillit të Mirë.

Ky është një tregues i anës së kërkesës, preferencave të studentëve për programet që ofron IAL, si dhe rrjedhojë e shpërndarjes së popullsisë dhe IAL-ve, ku Tirana ka dhe numrin më të madh të IAL-ve dhe rrjedhimisht edhe të studentëve, si dhe i anës së ofertës në lidhje me kuotat e universiteteve.

33. Për IAL-të publike, për vitin akademik 2017-2018 sipas numrit të studentëve të regjistruar, niveli i përqendrimit HHI ka vlerën prej XXX. Kjo HHI tregon se tregu i arsimit të lartë publik paraqitet me një nivel të moderuar konkurrence. Për IAL private, për vitin akademik 2017-2018 sipas numrit të studentëve të regjistruar, niveli i përqendrimit HHI ka vlerën prej XXX, në nivelin e një tregu me përqendrim të ulët.

34. Në tregun e arsimit të lartë publik dhe në atë privat, IAL me pjesë më të madhe tregu për nga numri i studentëve të rregjistruar ruajnë të njëjtën renditje, si në rastin kur IAL-të publike dhe private merren veç, ashtu dhe kur ato merren sëbashku, vetëm se pesha specifike e tyre është më lartë në rastin që IAL-të publike dhe private merren më vete. Treguesi i përqendrimit HHI është më i ulët në rastin kur IAL-të publike dhe private merren sëbashku, kjo për shkak të numrit më të lartë të tyre.

35. Sipas nivelit të të ardhurave të realizuara, midis IAL-ve publike, IAL me pjesën më të madhe të tregut është Universiteti i Tiranës me përkatësisht XXX% dhe XXX% të tregut të arsimit të lartë publik për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018. Më pas vijnë Universiteti i Mjekësisë i Tiranës dhe Universiteti Politeknik me pjesë tregu prej XXX% secili për vitin akademik 2017-2018.

Niveli i të ardhurave të IAL-ve publike ka rënë me XXX% në vitin akademik 2017-2018 krahasuar me vitin e mëparshëm.

Treguesi i HHI-së për tregun e arsimit të lartë publik rezulton XXX për vitin akademik 2016-2017 dhe XXX për vitin akademik 2017-2018, duke pësuar rënie, por përsëri qëndron në nivelin e një tregu me përqendrim të moderuar.

36. Ndër IAL-të private, universiteti me pjesën më të madhe të tregut sipas të ardhurave të realizuara për tre vitet akademike është Universiteti "Albanian University" me përkatësisht XXX%, XXX% dhe XXX% të tregut të arsimit të lartë privat për vitet akademike 2016-2017, 2017-2018 dhe 2018-2019. Më pas vijnë Universiteti Zoja e Këshillit të Mirë dhe Universiteti European i Tiranës me pjesë tregu prej XXX% dhe XXX% për vitin akademik 2018-2019. Albanian University ka një rënie të pjesës së tregut sipas nivelit të të ardhurave nga viti akademik 2016-2017 në vitin 2018-2019 me XXX%, ndërsa IAL-të e tjera paraqesin në përgjithësi një qëndrueshmëri të pjesëve të tregut me rënie ose rritje të vogla prej rreth 1%.

Niveli i të ardhurave të IAL-ve private ka ardhur në rritje nga viti në vit.

Treguesi i HHI-së për tregun e arsimit të lartë privat rezulton XXX për vitin akademik 2016-2017 dhe XXX për vitin akademik 2017-2018, dhe XXX për vitin akademik 2018-2019, duke pësuar rënie, dhe duke shkuar në kufirin e poshtëm të një tregu me përqendrim të moderuar.

37. Sipas nivelit të shpenzimeve të realizuara, midis IAL-ve publike, universiteti me pjesën më të madhe të tregut është Universiteti i Tiranës me përkatësisht XXX% dhe XXX% të tregut të arsimit të lartë publik për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018. Më pas vijnë Universiteti Politeknik dhe Universiteti i Mjekësisë i Tiranës me pjesë tregu prej XXX% dhe XXX% për vitin akademik 2017-2018.

Niveli i shpenzimeve të IAL-ve publike për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018 ka pësuar një rënie të lehtë duke qëndruar në të njëjtat nivele.

Treguesi i HHI-së për tregun e arsimit të lartë publik rezulton XXX për vitin akademik 2016-2017 dhe XXX për vitin akademik 2017-2018, duke na treguar për një treg me përqendrim të moderuar.

38. Ndër IAL-të private, universiteti me pjesën më të madhe të tregut sipas shpenzimeve të realizuara për tre vitet akademike është Universiteti Zoja e Këshillit të Mirë me përkatësisht XXX%, XXX% dhe XXX% të tregut të arsimit të lartë privat për vitet akademike 2016-2017, 2017-2018 dhe 2018-2019. Më pas renditet Universiteti European i Tiranës me pjesë tregu sipas viteve respektivisht XXX%, XXX% dhe XXX%. Ndërkohë IAL-të e tjera kanë pjesë tregu më të vogël se XXX% për të gjithë periudhën. Vëmë re se Universiteti Zoja e Këshillit të Mirë ka një rritje të ndjeshme të pjesës së tregut sipas nivelit të shpenzimeve gjatë vitit të fundit, ndërsa IAL-të e tjera paraqesin në përgjithësi një qëndrueshmëri të pjesëve të tregut gjatë viteve 2016-2017 dhe 2017-2018 dhe rënie të pjesëve të tregut gjatë vitit 2018-2019.

Niveli i shpenzimeve të IAL-ve private ka ardhur në rritje nga viti në vit, madje në vitin e fundit ka një rritje prej XXX% krahasuar me vitin e mëparshëm dhe kjo për arsye të nivelit të shpenzimeve të Universitetit Zoja e Këshillit të Mirë.

Treguesi i HHI-së për tregun e arsimit të lartë privat rezulton XXX për vitin akademik 2016-2017, XXX për vitin akademik 2017-2018, në nivelet e një tregu me përqendrim të moderuar dhe XXX për vitin akademik 2018-2019.

39. *Për sa i përket tregut të arsimit të lartë për IAL-të publike dhe private sëbashku apo më vetë, sipas numrit të studentëve të regjistruar, sipas nivelit të të ardhurave të IAL-së, si dhe sipas nivelit të shpenzimeve të IAL-së, për vitet akademike 2016-2017, 2017-2018, dhe 2018-2019, IAL-të me pjesë tregu më të madhe janë të njëjta dhe përkatësisht ndër IAL publike janë Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Mjekësisë i Tiranës dhe Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, ndërsa ndër IAL private Universiteti Albanian University, Universiteti European i Tiranës, Universiteti Zonja e Këshillit të Mirë dhe Universiteti Epoka.*

II.5 Tarifat e studimit IAL publike vs. IAL private

40. Në lidhje me tarifën e studimit, e cila përbëhet nga tarifa e regjistrimit dhe ajo e shkollimit, për IAL-të publike ato miratohen çdo vit me VKM, ku paraqitet kufiri maksimal i tarifës vjetore të shkollimit për universitete të ndryshme dhe programe të ndryshme brenda të njëjtit universitet. IAL-të publike janë të lirë të vendosin vetë tarifatat brenda këtij niveli maksimal.

Për IAL-të private, të cilët i vendosin vetë tarifatat për çdo program studimi, tarifatat e regjistrimit dhe të studimit janë disa herë më të larta se tarifatat respektive në IAL-të publike mesatarisht tarifatat e regjistrimit rreth XXX herë më të larta ((XXX lekë ~XXX€) me XXX€) dhe tarifatat e shkollimit rreth XXX herë më të larta ((XXX lekë ~XXX€) me deri në XXX€). Gjithashtu IAL private konkurrojnë me çmime të diferencuara duke aplikuar tarifa të ndryshme sidomos në tarifatat e shkollimit.

III. Funkcionimi i IAL-ve publike dhe private

41. Për IAL publike burimi kryesor i të ardhurave janë fondet e siguruara nga Buxheti i Shtetit, ndërsa për IAL private burimi kryesor i të ardhurave janë të ardhurat e siguruara nga tarifatat e shkollimit dhe regjistrimit., pasi tarifatat e IAL private janë disa herë më të larta se ato të IAL publike siç është evidentuar më sipër.
42. IAL publike dhe private e mbështesin veprimtarinë e tyre në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe kuadrit nënligjor në fuqi. Në respektim të bazës ligjore është nxjerre dhe kuadri Rregullator i Brendshëm: Statuti, rregulloret e ndryshme të organizimit dhe funksionimit të tyre.
43. Pjesën më të madhe të shpenzimeve të IAL-ve publike dhe private e zënë shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore (XXX-XXX%), më pas shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes dhe shpenzimet për investime. Tek IAL publike vëmë re se nuk ka të evidentuara shpenzime për kërkim shkencor, ndërsa një pjesë e IAL-ve private kanë të evidentuara shpenzime për kërkim shkencor.
44. Për metodologjinë e llogaritjes së kostos së studimeve, të tarifës së studimit, të tarifës së shkollimit, të tarifës së kurseve të formimit të vazhduar, IAL-të publike, nëpërmjet Senatit dhe Bordit të Administrimit, bazuar në ligjin nr. 80/2015 dhe VKM 288, datë 21.05.2018 miratojnë çdo vit akademik tarifatat e studimit për të gjithë ciklet e studimit. Kosto totale mesatare bazohet në mësimdhënie, kosto studimi dhe kosto totale për numër studentesh. Merren parasysh shpenzimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore, shpenzimet materiale, shpenzime indirekte (amortizimi), etj.

Për IAL-të private nuk ka një VKM që të shërbejë si indikator për përcaktimin e tarifave të studimit. IAL-të private i vendosin vetë tarifën, duke u mbështetur dhe në tarifën e IAL-ve të tjera private që operojnë në zonën ku ndodhet IAL, apo në ato që ofrojnë programe studimi të ngjashme. Pjesa më e madhe e IAL-ve nuk paraqesin një metodologji për miratimin e tyre, por shprehen se metodologjia bazohet në kuadrin ligjor në fuqi duke marrë parasysh se kosto përfshin shpenzimet për personelin, shpenzimet për kërkimin dhe zhvillimin, shpenzimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, shpenzimet për taksa dhe fonde për t'u paguar, si dhe shpenzimet për investime. Për të përllogaritur koston e programit të studimit, kostoja për student shumëzohet me numrin e studentëve në atë program studimi. Gjithashtu kur vendosen tarifën e studimit merren parasysh dhe tarifën e IAL-ve të tjera private në treg.

45. Metodologjia e llogaritjes së koston së programit të studimit, si për IAL publike dhe ato private, bazohet në bazë të përllogaritjes së koston për student, bazuar në kërkesat që ka secili program. Metodologjia ka për bazë llogaritjen mbi bazën standarte të shpenzimeve në total, shpenzimeve të departamentit me numrin total të studentëve dhe numrin e studentëve për programet që ofrohen nga departamenti. Për të përllogaritur koston e programit të studimit, kostoja për një student shumëzohet me numrin e studentëve të rregjistruar në atë program. IAL-të nuk kanë sjellë një metodologji specifike për llogaritjen e koston së programit të studimit.

46. Për dhënien dhe akordimin e bursave IAL-të publike respektojnë bazën ligjore në fuqi (VKM Nr. 903, datë 21.12.2016).

IAL-të private, në përgjithësi, kanë politikën e tyre të bursave, të cilat miratohen nga Bordi i Administrimit, Senati, Asambleja e Ortakëve/ Aksionarëve apo Fondacioni, i cili mbështet këto institucione. IAL private shpërndajnë bursa kryesisht për kategori studentësh të tillë si studentë ekselence, bazuar në mesataren përkatëse, studentë nga familje në nevojë, studentë me status jetim, pa kujdestari prindërore, pamundësi ekonomike, fëmijë të punonjësve të rënë në detyrë, etj. Disa IAL nuk aplikojnë bursa studimi, por vetëm reduktim të tarifave studentore, bazuar në elemente të caktuar dhe kritere që përcaktohen nga organet drejtuese të këtyre institucioneve.

47. IAL publike dhe private, për politikën e pagave dhe elementet e llogaritjes së tyre, bazohen në legjislacionin përkatës dhe aktet nënligjore në fuqi, Udhëzime të MASR dhe VKM dhe vendime të Bordit të Administrimit, si dhe në Kodin e Punës. Çdo IAL vendos pagat bazuar në pozicionin e punës, eksperiencën dhe titujt akademikë dhe gradat shkencore të profesorëve dhe stafit. Pjesa më e madhe e IAL-ve private në vendosjen e pagave bazohen dhe në vrojtimet e tregut lidhur me nivelin e pagave të IAL-ve konkurrencte.

48. Pjesën më të madhe të të punësuarve nga IAL publike e ka Universiteti i Tiranës, ndërsa për IAL private Albanian University, Universiteti European i Tiranës, Universiteti Marin Barleti dhe Universiteti Zoja e Këshillit të Mirë. IAL publike kanë një numër të konsiderueshëm staf akademik me kohë të pjesshme, krahas atyre me kohë të plotë. IAL publike dhe private kanë të punësuar staf akademik pensionistë dhe staf akademik të huaj.

49. Për pjesën më të madhe të IAL private dhe publike buxheti nuk alokohet në njësitë bazë, por menaxhohet nga njësitë qendrore. Sidoqoftë alokimi i buxhetit bazohet në kërkesat që kanë njësitë bazë. Për një pjesë të IAL-ve buxheti alokohet në njësitë bazë. Bordi i Administrimit me miratim të Senatit miraton buxhetin vjetor dhe afatmesëm të IAL dhe për secilën njësi bazë mbikëqyr zbatimin e tij. Çdo njësi bazë është përgjegjëse për menaxhimin e fondeve sipas buxhetit në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe politikën e zhvillimit të institucionit.

50. IAL publike funksionojnë sipas legjislacionit për arsimin e lartë dhe kuadrin nënligjor në fuqi.

IAL private kryesisht janë të organizuara në formën e shoqërive tregtare (SHPK ose SHA), kanë status juridik, karakter akademik dhe shkencor, forma organizimi bazuar në kriteret që përcakton ligji nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kriteret të përcaktuara për marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë akademike dhe shkencore.

Ndërkohë që ka IAL që kanë karakter jofitimprurës, siç është rasti i Kolegjit Universitar Bedër, Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Kolegjit Universitar Logos apo Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë.

Në ligjin nr. 80/2015, në nenin 17 “Organizimi i institucioneve të arsimit të lartë” parashikohet se institucionet jopublike të arsimit të lartë janë persona juridikë privatë dhe veprimtaria që ato zhvillojnë mund të jetë fitimprurëse ose jofitimprurëse.

51. IAL publike funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore.

IAL private, në respektim të bazës ligjore dhe ligjit për arsimin e lartë, apo ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, statusin e personit juridik e ushtrojnë sipas përcaktimeve të Statutit duke gëzuar liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit. Institucioni, nëpërmjet Statutit dhe akteve të tjera themeluese ka përcaktuar organeve të tilla si - Administratori, i cili është përgjegjës për veprimtarinë organizative dhe administrative të shoqërisë, apo Rektori përgjegjës për veprimtarinë akademike.

52. IAL në përgjithësi funksionojnë si njësi më vete duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi, aktet e brendshme që janë hartuar nga organet vendimmarrëse të këtyre institucioneve, parimet kryesore të lirisë akademike, autonomisë, pavarësisë, etj.

Sipas legjislacionit në fuqi, në aktin e themelimit të fondacioneve, i cili është akti me të cilin themeluesit e tij shprehin vullnetin e tyre për themelimin e organizatës jofitimprurëse, përveç informacionit rreth llojit, emrin, selinë, identitetin e themeluesve, është shprehur edhe qëllimi dhe fusha e veprimtarisë si dhe informacione të tjera. Ligji detyron që të përcaktohet edhe natyra, burimi dhe vlera e pasurisë së nevojshme për realizimin e qëllimit dhe fushës së veprimtarisë të fondacionit. Në objektin e veprimtarive të fondacioneve, objekt të veprimtarisë së tyre kanë hapjen dhe funksionimin e institucioneve arsimore.

53. IAL, të cilat janë krijuar si SHPK apo SHA kanë NIPT-in e shoqërisë tregtare. Në të kundërt, nëse janë krijuar nga Fondacionet përkatëse, kanë NIPT-in e fondacionit.

Bazuar në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 42.1.1, Organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve të veçanta, entet publike kombëtare apo vendore, organizatat politike, organizatat fetare, humanitare, bamirëse, shkencore, arsimore, e të tjera të ngjashme me to, të cilat nuk kanë për qëllim fitimin, regjistrohen në administratën tatimore. Sipas pikës 42.1.3, Këta persona marrin një numër të vetëm identifikimi, sado që të jetë numri i degëve që ato kanë. Në rastet kur organizatat jofitimprurëse ushtrojnë veprimtari në më shumë se një adresë, administrata tatimore lëshon një certifikatë regjistrimi për çdo adresë të ushtrimit të veprimtarisë, e cila ka të njëjten numër NIPT-i si adresa kryesore, por me numër serial të ndryshëm.

54. Përfaqësimi i IAL-ve kryhet bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe përcaktimeve ligjore, qoftë sipas ligjit nr. 80/2015 apo Statuteve dhe akteve të brendshme rregulluese të këtyre institucioneve, në të cilat është përcaktuar mënyra e përfaqësimit të tyre. Në rastin e IAL private në formën e shoqërisë tregtare, institucioni përfaqësohet nga Administratori i zgjedhur sipas përcaktimeve të Statutit dhe Bordit të Administrimit, për veprimtaritë me karakter organizativ, administrativ dhe financiar, si dhe nga Rektori për veprimtaritë akademike dhe shkencore. Në rastet e IAL-ve të cilat menaxhohen nga Fondacioni, ato përfaqësohen nga Fondacioni.

55. IAL-të e ushtrojnë autonominë dhe lirinë akademike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015 dhe bazës ligjore rregulluese të tyre (Statuti). Si në ligjin për arsimin e lartë ashtu edhe në dispozitat e Statutit të këtyre IAL-ve është përcaktuar se IAL gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit.

Në dispozitat e Statuteve të këtyre IAL janë përcaktuar rregullat lidhur me funksionet dhe kompetencat e organeve drejtuese administrative të IAL, të cilat janë në përputhje me nenin 3 të ligjit nr. 80/2015 “Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë”.

56. IAL-të e garantojnë sigurimin dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë sipas kuadrit ligjor në fuqi, përcaktimeve nga MASR, akreditimit nga ASCAL dhe përcaktimeve e parashikimeve në Statutin dhe Rregulloren e tyre. Pjesa më e madhe e tyre kanë ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe sigurimin e standardeve të cilësisë e realizojnë nëpërmjet krijimit të mjedisit dhe infrastrukturës së posaçme, nëpërmjet investimeve në kampus, laboratorëve, stafit akademik, etj.

57. Pjesa më e madhe e IAL-ve private, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe në Statutin dhe Rregulloret e vetë IAL kanë ngritur strukturën e Auditit të Brendshëm që kryen auditin e IAL çdo vit fiskal. Disa IAL nuk kanë strukturë Auditit të Brendshëm.

IAL-të publike, bazuar në ligjin nr. 80/2015, kanë ngritur strukturën e Auditit të Brendshëm që realizon auditin e brendshëm. Ato IAL që nuk kanë njësi të auditit të brendshëm auditohen nga MASR.

58. Për IAL private auditimi i jashtëm kryhet kryesisht nga auditues të jashtëm apo kompani audituese të pavarura bazuar në ligjin për auditimin. Auditimi akademik realizohet nëpërmjet procesit të akreditimit nga ASCAL.

Auditi i jashtëm në IAL-të publike realizohet sipas legjislacionit në fuqi nga institucionet shtetërore si MASR dhe KLSH, ndërsa për Akademinë e Forcave të Armatosura audit kryhet nga Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet drejtorisë së Auditit.

59. Transparencën e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditit të brendshëm dhe të jashtëm një pjesë e IAL private e realizojnë duke publikuar gjetjet dhe rekomandimet në faqen zyrtare të web-it. Disa IAL, gjetjet ia vënë në dispozicion organeve kolegjiale dhe hartohet plani i masave.

Për IAL publike gjetjet dhe rekomandimet diskutohen nga organet kolegjiale, Senati dhe Bordi i Administrimit duke hartuar planin e masave për zbatimin e tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), (f), nenin 26, nenin 41, nenin 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

I. T'i rekomandojë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë:

1. Të kryejë një studim të plotë tregu në mënyrë që të përcaktohen kërkesat për studentë/specialistë, i cili duhet të publikohet **para fillimit të çdo viti akademik** dhe duhet të sigurojë:
 - a. Orientimin e IAL-ve për hapjen e programeve të reja të studimit;
 - b. Balancimin e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës;
 - c. Reduktimin e inflacionit të profesionistëve në degë të caktuara;
 - d. Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, duke e drejtuar kërkesën e tyre drejt një oferte, e cila do

të garantojë punësimin në një kohë të shkurtër pas diplomimit.

2. Për sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, MASR të hartojë dhe propozojë kuadrin e nevojshëm ligjor për burimet e financimit të IAL-ve private me qëllim që:

i) Të ardhurat e përfituara nga këto IAL private nga:

- a. pagesat e studenteve për arsimim,
- b. të ardhura për shërbime të kryera,
- c. të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palë të tjera,
- d. fonde publike
- e. donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi,
- f. veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik të ndahet ndërmjet personelit akademik dhe IAL-së private, sipas rregullores së miratuar nga çdo IAL private.

ii) Çdo IAL private të rregullojë me aktet e tyre të brendshme mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e mësipërme.

iii) Afati i përmbushjes së këtij rekomandimi nga MASR është shtator 2021.

3. Të kërkojë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, për çdo projekt - akt normativ që në mënyrë të veçantë ka të bëjë me:

- a. kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin;
- b. vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejta të veçanta në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara;
- c. imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

II. T’i rekomandojë IAL-ve publike dhe private:

1. Të llogarisin koston për student për secilin program studimi dhe të bëjnë publike tarifën e studimit, për çdo vit akademik.
2. Të bëjnë transparente mënyrën e përdorimit të fondeve duke e publikuar në faqet e tyre zyrtare.
3. Të bëjnë transparent fondin e kërkimit shkencor, kriteret dhe procedurat që njësitet kryesore, njësitet bazë dhe kërkuesit shkencorë si individë duhet të ndjekin për të përfituar mbështetje financiare për kërkimin shkencor.
4. Të mundësojë ofrimin e informacionit për cilësinë e IAL-së, përpara fillimit të çdo viti akademik në mënyrë që të lehtësohen mundësitë e zgjedhjes së konsumatorëve (studentëve), bazuar në:
 - a) Performancën akademike të studentëve të diplomuar, si dhe nivelin e punësimit të tyre në tregun përkatës të punës;
 - b) Vlerësimin/Reputacionin e IAL në bazë të të dhënave objektive - ekzistenca e qendrave të kërkimit, bibliotekave dhe laboratorëve;

- c) Lidhjet me universitete ose qendra të njohura kombëtare ose ndërkombëtare;
- d) Shërbimet e përgjithshme - kampuset;
- e) Çmimet si një mekanizëm për të balancuar ofertën dhe kërkesën.

5. IAL-të, duhet të informojnë Autoritetin e Konkurrencës, për zbatimin e pikës II të këtij vendimi brenda **muajit mars të vitit 2021**.

III. Detyrimin e IAL-ve private që:

- 1. Të ndajnë llogarinë ekonomike të tyre me NIPT të veçantë nga llogaria ekonomike e shoqërisë tregtare (SHPK/SHA) ose Fondacionit që e ka krijuar dhe e financon.
- 2. Zbatimi i detyrimit të pikës III.1 të këtij Vendimi, duhet të realizohet brenda **muajit mars të vitit 2021**.
- 3. IAL-të private, duhet të informojnë Autoritetin e Konkurrencës, për zbatimin e këtij detyrimi brenda afatit të përcaktuar në pikën III.2.

IV. T'i rekomandojë INSTAT:

- 1. Të mbledhë të dhëna për arsimin e lartë dhe të mundësojë ofrimin e informacionit krahasues për cilësinë e IAL-ve për çdo vit akademik, në mënyrë që të lehtësojë mundësitë e zgjedhjes së studentëve, për:
 - a. nivelin e punësimit të të diplomuarve sipas fushave; dhe
 - b. profileve të tyre në tregun vendas përkatës të punës.

V. Autoriteti i Konkurrencës, do i drejtohet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në rast të mos përmbushjes së pikës II dhe III të këtij vendimi nga IAL-të, të cilat cenojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, duke kërkuar përmbushjen e tyre.

VI. Mbylljen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë.

VII. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi nga MASR, IAL-të publike dhe private dhe INSTAT për një **periudhë 2 vjeçare**.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 707, Datë 23.09.2020

“Për hapjen e Hetimit Paraprak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.09.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore.

Baza ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi hapjen e hetimit në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore,

VËREN SE:

Kuvendi i Shqipërisë, në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018”, i ka kërkuar Autoritetit “Të mbikëqyrë me prioritet dhe të dalë më rekomandime konkrete për tregjet me sensitivitet të lartë publik e ndikim social si: tregu bankar, tregu i shërbimeve spitalore dhe tregu farmaceutik,.. etj”.

Nga procedurat e deritanishme, në kuadër të hetimit të përgjithshëm në shërbimin spitalor, janë konstatuar se kostot e barnave dhe investimet në pajisjet mjekësore përbëjnë një element të rëndësishëm për të qenë konkurrues në tregun spitalor dhe vlerësimi i tij do të sjellë një panoramë më të plotë për të parë ndikimin e tyre në përmirësimin e shërbimit shëndetësor në vend.

Tregu i barnave ka qenë edhe më parë objekt vlerësimi nga Autoriteti, nga ku kemi konstatuar se plotësimi nevojës për barna në vend realizohet në pjesën më të madhe nëpërmjet importit të tyre.

Çmimi i barnave në tregun farmaceutik nuk është element konkurrues pasi fiksimi i tij për të paktën një periudhë 6 mujore dhe përcaktimi i tij në pullën e kontrollit e bën atë të pandryshueshëm, duke sjelle kufizim të konkurrencës me çmimet e produkteve në tregun farmaceutik nga aktorët e këtij tregu.

Oferta për barna në treg është e kufizuar për shkak të shkallës së lartë të fuqisë së tregut nga mbajtësit e patentave apo të drejtave ekskluzive ndërkohë që kërkesa për barna nuk përcaktohet drejtpërsëdrejti nga konsumatori (pacienti), por nga mjeket dhe në këtë mënyrë konsumatori nuk ka mundësi të bëjë zgjedhjen e tij bazuar në çmime më të lira dhe cilësi më të mirë, por si rregull ndjek udhëzimet e doktorit.

Tregu paraqet asimetri në informacion për shkak të marrëdhënieve mes doktorit dhe pacientëve, doktorit dhe prodhuesve/importuesve farmaceutikë, i cili mund të jetë një nga shkaqet kryesore të mosfunksionimit të tregut mbi bazën e kërkesës dhe ofertës.

Ndërkohë tregu i pajisjeve mjekësore është një treg i ri dhe në dinamikë për shkak të zhvillimit teknologjik në fushën e ekzaminimeve shëndetësore. Parë në këtë këndvështrim, është i nevojshëm vlerësimi i kufizimeve që sjellin në treg ekskluzivitetet e dhëna në lidhje me markat e pajisjeve apo shërbimet e mirëmbajtjes së tyre.

Autoriteti vlerëson nevojën e një analizë të plotë dhe gjithëpërfshirëse në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, për të parë nëse ka kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës nga ndërmarrjet që operojnë në treg, nëpërmjet të drejtave ekskluzive, fuqisë së konkurrentëve në treg, lidhjes së kontratave kufizuese, të parashikuara në nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore.
2. Hetimi i përgjithshëm të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2019 deri në 30 nëntor 2020.
3. Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e vendimit.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 710, Datë 08.10.2020

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Peqin” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.10.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Peqin” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Peqin SHA,

VËREN SE:

- ERRU-ja nëpërmjet shkresës Nr. 181 prot., datë 14.9.2020, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr. 90 Prot., datë 28.07.2020, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Peqin SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
- Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Peqin SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë dhe aplikim për herë të parë të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura.
 - UK Peqin SHA ka aplikuar tarifat e miratuara nga ERRU sipas Vendimit Nr. 43, datë 30.07.2010 “Për miratimin e tarifave për konsum publik të UK Peqin SHA. Sipas ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Peqin SHA, niveli i tarifave në fuqi nuk është ndryshuar për një periudhë të gjatë kohore rreth dhjetë vjet, në këto kushte si edhe pas riorganizimit të Bashkisë Peqin, kërkohet të aplikohet një tarifë e unifikuar në të gjithë zonën e shërbimit për të siguruar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit.
- Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon një nivel tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN. Këto tarifa aplikohen vetëm për zonën urbane të Peqinit dhe të Njësisë Administrative Shezë. UK Peqin SHA për zonat Gjocaj, Karinë, Pajove, Përparim nuk ka patur tarifa të miratuara nga ERRU për FU dhe KUZ.

4. Njëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Peqin SHA, propozon unifikimin e tarifave si rezultat: a) i zgjerimit të zonës së shërbimit, b) licensimit të UK Peqin SHA në kategorinë e largimit të ujërave të ndotura sipas vendimit të KKRR Nr. 26, datë 31.05.2020, c) nevoja për të ardhura shtesë për investime në të gjithë zonën pas riorganizimit, d) realizimi i të ardhurave për përbalimin e kostove të cilat janë të papërbalueshme, dhe e) FU në zonën e shërbimit ofrohet në 22 orë në ditë gjatë vitit 2019.
5. Tarifa për konsumatorin familjar në të gjitha zonat urbane unifikohet në 48 lekë/m³ duke pësuar një rritje me 18 lekë/m³ për konsumatorët e zonës Peqin dhe Shezë. Tarifa për konsumatorin familjar të zonës Gjocaj, Karinë, Pajovë, Përparim të cilët nuk kanë tarifë të miratuar nga ERRU pas riorganizimit propozohet të aplikohet në 48 lek/m³. Tarifa për konsumatorin familjar si për FU dhe KUN në zonën rurale të shtuar, pas riorganizimit, në bazë të VKM-së Nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” pa miratimin e ERRU-së nuk ishte miratuar nga ERRU. Për konsumatorët privat në zonën urbane, tarifa rritet me 20 lek/m³, për konsumatorët publik tarifa rritet me 30 lek/m³. Tarifa e KUN për konsumatorët familjar për të gjithë zonën pas riorganizimit, propozohet të jetë 12 lek/m³ meqë niveli i ofrimit të shërbimit është shumë i ulët rreth 18.5%, për konsumatorët privat dhe publik propozohet të miratohet 16 lek/m³ në të gjithë zonën e ofrimit të shërbimit nga UK Peqin SHA.
6. Nga “UK Peqin” SHA propozohet një rritje 100% të tarifës aktuale fikse të shërbimit në vlerën 100 lek/muaj/lidhje për konsumatorin familjar, tarifa fikse për konsumatorin publik dhe privat në të gjithë zonën e shërbimit rritet me 100%, pra në vlerën 200 lek/muaj/lidhje. UK Peqin SHA kërkon të realizojë investime në zonat e shtuara pas riorganizimit që të përmirësoj cilësinë e ofrimit të shërbimit për konsumator familjarë, publik dhe privat në shërbimin e ofruar për FU dhe KUN. UK Peqin SHA ka kërkuar unifikimin e tarifave, për vendosjen në një nivel të ri pas dhjetë vitesh të tarifave për shërbimin e FU dhe KUN referuar dhe vlerësimit të kostove për secilën zonë.
7. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2020 dhe vitin 2021 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar reduktimin e humbjeve teknike dhe administrative, rritjen e efikasitetit në reduktimin e numrit të stafit i cili është shumë i lartë, 22,8 staf/1000/lidhje, rritjen e qëndrueshmërisë financiare si edhe rritjen e mundësisë për përfitime të investimeve në shërbimet e ofruar.
8. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Peqin SHA pas riorganizimit nuk arrin të mbulojë kostot direkte e operim mirëmbajtjes pasi ka qenë në masën 47.3 % gjatë vitit 2019, kosto e cila parashikohet 48.5% në vitin 2020 e cila parashikohet të rritet në 78% gjatë vitit 2021. Aktualisht mbulimi i kostove totale të operimit dhe mirëmbajtjes është 45-46% për vitin 2019 -2020 dhe parashikohet 74% për vitin 2021.
9. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Peqin SHA duhet të punojë për reduktimin e nivelit të humbjeve teknike dhe administrative, duke angazhuar stafin për vlerësimin sa më të saktë të çdo komponenti që bilanci të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të mbajë evidenca mbi sasitë e ujit që nuk maten, humbet, mbi sasitë e autorizuara të pa faturuara, etj., si edhe të hartojë plan biznesin 5 vjeçar sipas riorganizimit në kuadër të VKM Nr. 63, me qëllim argumentimin për nevojën e investimeve në lidhje me përmirësimin e shërbimit si edhe qëndrueshmërinë financiare.
10. Tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Peqin SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.

11. Duke qenë se niveli i kostove totale për vitin 2020 mbetet thuajse në nivele relativisht të ulëta krahasuar me ato të vitit 2019 me një rritje rreth 2%, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove, si dhe të gjitha investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit duhet të jenë sa më transparente dhe të kontabilizohen.
12. Nga vlerësimi i Konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Peqin SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Peqin SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për unifikimin e tarifës dhe nivelin e ri të tarifës për FU dhe KUN, UK Peqin SHA ka realizuar ndarjen veç e veç të kostove sipas shërbimit FU dhe KUN, por nuk ka aplikuar ndarjen e kostove sipas zonave, megjithëse KUN është një shërbim i ri i ofruar për largimin e ujërave të ndotura.
13. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot të ndara për të dy shërbimet e ofruara, duke zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).
14. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, germa (d) e (f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 1. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Peqin SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 2. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 711, Datë 08.10.2020

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim- shkarkim, import, depozitim, shitje me shumicë të GLN”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.10.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Raportit “Mbi Hetimin Paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës.”

Baza ligjore: Neni 4 dhe 9, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1 dhe 2, e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të Grupit të Punës “Mbi Hetimin Paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës”,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Nisur nga disa shqetësime në median e shkruar mbi rritjen e çmimit të shitjes së GLN për përdorim familjar dhe automjete, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe 29/1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, realizoi një monitorim në tregun e importit dhe tregtimit të GLN-së për automjete dhe përdorim familjar në lidhje me çmimin e shitjes së produktit GLN.
2. Për realizimin e monitorimit u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në lidhje me çmimin e importit për periudhën tetor-janar 2020, si dhe çmimin e bursës Platts për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve që operojnë në treg.
3. Gjithashtu nga të dhënat e administruara nga DPD, në lidhje me importet e realizuara nga ndërmarrjet në tregun e brendshëm, vërehet se tregu i importit dhe shitjes me shumicë është një treg shumë i përqendruar, indeksi HHI paraqitet në nivelin 2828.
4. Nga treguesi CR3, konstatohet se 3 nga ndërmarrjet me pjesë më të madhe tregu zotërojnë rreth 91% të tregut, pra kanë një fuqi të madhe tregu. Ky tregues, përgjithësisht përfshin të gjithë tregun e importit të GLN duke na dhënë një pamje të qartë të ndërmarrjeve të cilët kanë fuqi në këtë treg.
5. Referuar strukturës shumë të përqendruar të tregut dhe rritjes së njëkohshme të çmimit të shitjes së GLN nga ndërmarrjet në treg, nga monitorimi u konstatua se në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së ka shenja të një sjellje të mundshme antikonkurrese të ndërmarrjeve që operojnë në këto tregje, sjellje e cila mund të çojë në shkelje të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

6. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4 dhe 9, nenit 24 (shkronja d) dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 675, datë 07.02.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës”, vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg.
7. Në zbatim të këtij vendimi të Komisionit të Konkurrencës bazuar në nenet 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” ka lëshuar “Autorizim për Inspektim” nr. 52/4, datë 13.02.2020”.
8. Inspektorët e AK, gjatë periudhës së hetimit paraprak kanë kryer inspektime pranë ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit GLN. Qëllimi i inspektimeve ishte administrimi i provave dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun përkatës.
9. Gjatë procedurës së inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve sipas nenit 4 të ligjit nr.9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

10. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - a. Tregun e produkteve
 - b. Tregun gjeografik
11. Tregu përkatës i produktit GLN përbëhet nga :
 - b. Tregu i ngarkim – shkarkimit
 - c. Tregu i depozitimit
 - d. Tregu i importit
 - e. Tregu i shitjes me shumicë
12. Në këto kushte, vlerësojmë se tregu i përkatës i produktit në këtë rast është tregu i ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe tregimit me shumicë të produktit GLN.
13. Ndërmarrjet nën hetim e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pra treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm.
14. Importi, ngarkim-shkarkimi dhe depozitimi i GLN-së në territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet nëpërmjet 3 Koncensioneve në dy porte në zonën gjeografike të ish Uzinës së Sodës PVC në Gjirin e Vlorës dhe në zonën gjeografike të Porto Romanos, Durrës, porte të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë mbi bazën e marrëveshjeve të koncesionit. Ndërmarrja Romano Port dhe Porti MBM i cili operon në det, Porti Vlora-1, si dhe ndërmarrje që kanë depozita me qera të cilat operojnë në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN.

15. Ndërmarrja Romano Port në zonën gjeografike të portit Porto Romano ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit të produktit të GLN-së. Referuar ekstrakteve të regjistrit tregtar, Ndërmarrja ROMANO PORT SHA zotërohet nga z. P. B. zotëron 99.84% të aksioneve. Në ndërmarrjen INTER GAZ SHA që ka ndërtuar depozita gazi pranë këtij Porti, zotërohet gjithashtu 50% nga z. P. B. dhe 50% nga z. A. D. Ky aksionar (z. P. B.) zotëron 100% të aksioneve në ndërmarrjen A&V GAZ SHA, e cila kryen veprimtari importi dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë të GLN. Ndërmarrja A&V GAZ SHA zotëron 100% të aksioneve në ndërmarrjen AV Distribution SHA, e cila ushtron veprimtarinë në tregun e shitjes me shumicë të GLN-së. Për sa më sipër konstatohet se Romano Port SHA, kryen veprimtari në import, depozitim, tregtim me shumicë të GLN.
16. Në zonën e Portit Vlora 1, në bazë të marrëveshjes së Koncesionit, ndërmarrja PIA zotëron me koncesion Portin dhe infrastrukturën e ngarkim shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së. Ndërmarrja PIA zotërohet nga 100% nga LA PETROLIFERA ITALO RUMENA e cila me koncesion Portin dhe infrastrukturën e ngarkim shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së. PIA gjithë kapaciteti depozitues të GLN-së ia ka dhënë me qira ndërmarrjes FAM Gas L.L.C. – Kevin Gas SHA i cili ka si aksioner z. Gj. L. importon gaz nëpërmjet FAM GAS. Kevin Gas SHA zotëron 100 % të aksioneve në ndërmarrjen Emanuel Gas SHPK i cili operon në tregun e shitjes me shumice dhe pakicë.
17. Porti MBM ka të drejtën ekskluzive për përdorimin e portit dhe zotërimin e lirë të zonës (neni 32, pika 1/a), për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra, për një periudhë prej 35 vjetësh nga hyrja në fuqi e saj.
18. Porti MBM zotërohet 99 % nga ndërmarrja ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP SHPK e cila zotërohet 65% nga KASTRATI GROUP. TENET SHA e cila operon në tregun e depozitimit të GLN dhe shitjes me shumicë zotërohet 50% nga KASTRATI SHA, pjesë e KASTRATI Group. TENET SHA shet në tregun e pakicës nëpërmjet ndërmarrjes Albania Gas Tech SHPK e cila është pjesë e KASTRATI GROUP.
19. Koncesionet PIA, Romano Port dhe porti MBM, të cilat operojnë me modele të ndryshme tregu (Koncenisone) janë ndërmarrje që zotërojnë pozitë dominuese në tregun ngarkim-shkarkimit të GLN dhe operojnë më tarifa të miratuara nga OSHA. Këto ndërmarrje kanë intergrim vertikal në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, tregtimit me shumicë dhe pakicë të GLN. Ky integrim vertikal i ndërmarrjeve rrit fuqinë e tyre për të abuzuar më këtë fuqi në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Udhëzimit “Mbi zbatueshmërinë
20. e nenit 8 dhe 9 të ligjit 9121/2003” duke refuzuar për të tregtuar ose duke ngjeshur çmimet, gjë e cila mund të reflektohet tek ndërmarrjet me të cilat janë të integruara vertikalisht.
21. Nga analiza e të dhënave të importit rezulton se gjatë vitit 2019 në portin Romano Port, ku operojnë MBM dhe Romano Port SHA , është realizuar importi i rreth 75% e sasisë totale të GLN të ardhur në vend. Në portin Petrolifera sasia e importuar e GLN-së është rreth 25% e sasisë totale të importuar.
22. Nga analiza e strukturës së tregut të importit të GLN vërehet se për vitin 2019 ndërmarrja me pjesën më të lartë të tregut prej 34.8% është ndërmarrja TENET SHA, ndërmarrja A&V Gas për vitin 2019 zotëron pjesën prej 32.1% të tregut, ndërsa Kevin Gas zotëron pjesën prej 25.4% të tregut.
23. Tregu i importit të GLN paraqitet me tregues shumë të lartë përqendimi të treguesve CR3 dhe HHI ku tre ndërmarrjet importuese TENET SHA, A&V GAZ SHA dhe Kevin Gas SHA, kanë zotëruar mbi 90% të tregut për vitin 2019.

24. Nga analiza e të dhënave të çmimit mesatar të blerjes dhe shitjes, nga importuesit kryesor dhe nga ndërmarrjet në tregun e shumicës rezulton se ndërmarrjet ndjekin çmimin CIF dhe kanë çmime blerje të përafërta. Përsa i përket çmimit të shitjes ndërmarrjet kryesore importuese A&V Gas SHA dhe Kevin Gas SHA kanë çmime të përafërta. Ndërmarrja TENET, ka aplikuar çmime më të larta se ndërmarrjet AV Gas dhe Kevin Gaz.
25. Duke qënë se tregu është i përqendruar dhe ka integrim vertikal, si dhe ndërmarrjet PIA, Romano Port, Porti MBM mund të abuzojnë me pozitën dominuese duke refuzuar për të tregtuar ose duke ngjeshur çmimet e shitjes së GLN, si dhe për të vlerësuar sjelljen e këtyre ndërmarrjeve në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të GLN nëpërmjet ndërmarrjeve ku janë të integruara vertikalisht: Tenet, Intergaz, A&V Gas, AV Distribution, Kastrati Group, Albania Gas Tech, Kevin Gaz, Emanuel Gaz, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se mund të jemi përpara shkeljes së neneve 4 dhe 9 të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), në tregun e ngarkim- shkarkim, import, depozitim, shitje me shumicë të GLN.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 4 dhe 9, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 dhe 2, e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar në tregun e ngarkim- shkarkim, import, depozitim, shitje me shumicë të GLN.
 - II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore 1 Janar 2017 deri 30 Shtator 2020
 - III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga marrja e këtij vendimi.
 - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 715, Datë 15.10.2020

“Për marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes “MEGAPHARMA” SHPK në tregun e tregtimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Marrja e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes “MEGAPHARMA” SHPK në tregun e tregtimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore.

Baza ligjore: Neni 8, neni 9, neni 24, shkronja (d) dhe neni 44 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi ankesën ndaj ndërmarrjes “MEGAPHARMA” SHPK,

VËREN SE:

1. Kuvendi i Shqipërisë, në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018, i ka kërkuar Autoritetit “Të mbikëqyrë me prioritet dhe të dale me rekomandime konkrete për tregjet me sensitivitet të lartë publik e ndikim social si: tregu bankar, tregu i shërbimeve spitalore, tregu farmaceutik, etj.”.
2. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121/2003, me Vendimin Nr. 707, datë 23.09.2020, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore.
3. Në kuadër të këtij hetimi, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr. 330/2 prot., datë 06.10.2020, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, ka kërkuar informacion mbi autorizimet për tregtimin e vaksinave anti-gripale në formën e dozave apo llojet e paketimeve në tregtimin e tyre.
4. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore me shkresën nr. 6930/1 prot., datë 07.10.2020, protokolluar në AK me nr. 330/3 prot., datë 13.10.2020 i është përgjigjur kërkesës për informacion. Nga përgjigja e AKBPM-së konstatohet se ndërmarrja “MEGAPHARMA” SHPK, është ndërmarrja e vetme e autorizuar për të importuar dhe për të hedhur në treg vaksinën INFLUVAC SUB-UNIT TETRA, Suspension for injection x (15mcg HA+15mcg HA+15mcg HA+15mcg HA)/0.5ml, Box x 1pre-filled syringe with needle, me mbajtës të autorizimit për tregtim “Sanofi Pasteur” Francë dhe me prodhues “Abbot Biologicals BV” Hollandë.
5. Për rrjedhojë, në datën 13.10.2020, sipas autorizimit nr. 330/5 prot, datë 13.10.2020 të lëshuar nga Komisioni i Konkurrencës u kryen inspektime në tregun e tregtimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, pranë ndërmarrjeve farmaceutike të cilat operojnë në tregun e tregtimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore. Grupi i punës inspektojë gjashtë subjekteve “Farmaci”: “Golden Enterprise”, “Regi”, “Orange” (pranë adresës “Libri Universitar”), “Nabis”, “Minella” dhe “Prima Farma”.

6. Gjatë inspektimit rezultoi se vakcina “INFLUVAC SUB-UNIT TETRA” mund të gjendej vetëm pranë rrjetit të farmacive “Orange”, ku ndërmarrja “MEGAPHARMA”SHPK zotëron 75% të kapitalit të rrjetit të farmacive “Orange”, referuar regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Nga inspektimi u konstatua gjithashtu se farmacitë e tjera deklarojnë se nuk posedojnë vaksinën, dhe se në të gjithë rastet e kërkesës për furnizim, gjatë fillimit të muajit tetor 2020, depoja e furnizimit “MEGAPHARMA”SHPK është shprehur se nuk disponon sasi për të kryer furnizimin e këtyre farmacive. Nga inspektimi rezultoi se farmacia “Orange”, gjatë po të njëjtës periudhë, është furnizuar me vaksinën “INFLUVAC SUB-UNIT TETRA” nga shoqëria “MEGAPHARMA SHPK” dhe e tregton atë rregullisht.
7. Si përfundim, bazuar në nenin 44 të Ligjit Nr. 9121/2003, vlerësojmë se jemi përpara një rasti urgjence, pasi mos furnizimi i farmacive apo depove farmaceutike me vaksinën “INFLUVAC SUB-UNIT TETRA”, të cilat operojnë në tregun tregtimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore sjell nxjerrjen nga tregu të këtyre ndërmarrjeve për sa i përket produktit në fjalë. Nxjerrja nga tregu e ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në tregun tregtimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore mund të sjellë një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën dhe ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 44 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes “MEGAPHARMA SHPK” në tregun e tregtimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, si vijon:
 - a) Ndërmarrja “MEGAPHARMA SHPK” detyrohet të furnizojë të gjitha depot dhe farmacitë e tjera, dhe jo vetëm rrjetin e farmacive “Orange”, me vaksinën “INFLUVAC SUB-UNIT TETRA”.
- II. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
- III. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrja “MEGAPHARMA SHPK” ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (b) të Ligjit Nr. 9121/2003.
- IV. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës vendosë gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore, deri sa ndërmarrja “MEGAPHARMA SHPK” të veprojë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa b) të Ligjit Nr. 9121/2003.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 719, Datë 28.10.2020

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.10.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve.

Baza ligjore: Nenet 24 shkronja (d), 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi hapjen e hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”,

VËREN SE :

1. Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të kërkesave të vazhdueshme ndër vite të Rezolutave të Kuvendit, ka kryer në vijimësi vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve të cilave u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive dhe të veçanta nëpërmjet kontratave koncesionare.
2. Importi, depozitimi dhe ngarkim-shkarkimi i karburanteve në territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet nëpërmjet tre koncesioneve në dy porte në zonën gjeografike të Gjirit të Vlorës dhe në zonën gjeografike të Porto Romanos, Durrës, porte të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë mbi bazën e marrëveshjeve të koncesionit.
3. Sjellja e ndërmarrjeve Koncesionare La Petrolifera Italo Albaneze SHA (PIA) dhe Romano Port SHA ka qënë objekt hetimi nga ana e Autoritetit të Konkurrencës ndër vite lidhur me shërbimet që ato realizojnë në tregun përkatës. Për Portin MBM, Komisioni i Konkurrencës është shprehur me vendimin nr. 383, datë 17.11.2015 “Për disa rekomandime lidhur me kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”.
4. Porti Vlora-1 i është dhënë me koncesion nga shteti Shqiptar, ndërmarrjes La Petrolifera Italo Rumena SPA e cila operon në Shqipëri me La Petrolifera Italo Albaneze SHA (PIA), me anë të ligjit nr. 9231, datë 13.05.2004, “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOO”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në gjirin e Vlorës, si dhe për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës”.
5. Koncesionari PIA është i vetmi entitet i pajisur me të drejtën, në të gjithë zonën e Gjirit të Vlorës, që lejohet të ndërtojë, të shfrytëzojë terminalin bregdetar dhe infrastrukturën portuale, dhe të realizojë

aktivitetin e depozitimit dhe trajtimit (ngarkim-shkarkim) (nga brenda dhe jashtë, nga toka dhe nga deti) naftë (bruto dhe të përpunuar), produkte të naftës, produkteve të gazeve të lëngshme dhe produkte të lëngshme në Gjirin e Vlorës. Koncesionari nuk ushtron aktivitetin në veprimtari tregtare për naftë, gaz dhe nënprodukte të tij.

6. Porti “Porto Romano” i është dhënë me koncesion nga shteti Shqiptar, ndërmarrjes Romano Port SHA, me anë të Ligjit nr.9298, datë 28.10.2004, Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”.
7. Koncesionari Romano Port SHA kryen aktivitetin e tij në fushën e përpunimit të anijeve të ngarkuara me të gjitha llojet e hidrokarbureve dhe nënprodukteve të saj në zonën bregdetare të Porto-Romano, Durrës. Kjo ndërmarrje ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit në zonën e “Porto Romano”, me kapacitet të kufizuar të përpunimit të anijeve që transportojnë hidrokarbure, deri në 20.000 ton.
8. Me ligjin nr. 104/2015, datë 23.9.2015, është miratuar kontrata e koncesionit të formës BOT (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare Porti MBM (Multy Buoy Mooring).
9. Koncesionari Porti MBM ka të drejtën ekskluzive për përdorimin e portit duke e vendosur atë në pozita monopol për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20.000 ton.
10. Tarifat për shërbimet e ofruara nga kjo ndërmarrje koncesionare, miratohen nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA).
11. Tregu i karburanteve rregullohet nga ligji nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, si dhe VKM nr. 808, datë 05.11.2004 “Për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre”, të ndryshuar.
12. Referuar të dhënave të importit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për karburantet e përpunuara (ngarkim-shkarkim, depozitim) të realizuara në këto porte vihet re se:
 - Pjesa më e madhe e karburanteve që importohen në vend është mbi 80% naftë dhe më pak se 20% benzinë. Sasia totale e importuar për karburantet rezulton se ka patur ulje në vitin 2018 dhe ka vijuar të rritet në periudhën 2019-2020.
 - Tregu i importit të karburanteve për periudhën 2017-2020 (janar-shtator) paraqitet si shumë i përqendruar ku treguesi CR3 është mbi 80 %.
 - Trendi i çmimeve mesatare vjetore të importit të karburanteve në vitin e fundit është në ulje krahasuar me periudhën 2017-2019, ndërsa sasi të importuara në rritje, dhe ndërmarrjet importojnë me çmime të përafërta.
13. Referuar numrit të kufizuar të operatorëve që realizojnë ngarkim-shkarkimin dhe depozitimin e karburanteve në dy portet Vlora-1 dhe Porto Romano, dhënë me koncesion, ku secili koncesionar operon me modele të ndryshme dhe zotëron pozitë dominuese në zonën gjeografike, portin ku operon, dhe strukturës shumë të përqendruar të tregut të karburanteve, lind dyshimi për sjellje të mundshme antikonkurruese të ndërmarrjeve që operojnë në këto tregje, të cilat mund të çojnë në shkelje të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në “Tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore Janar 2017 - Tetor 2020.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 720, Datë 12.11.2020

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Fier” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Fier” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës Nr. 205/2 prot., datë 21.10.2020, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr. 76 prot., datë 30.06.2020, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjetllësit dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë dhe aplikim për herë të parë të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura.
 - UK Fier SHA ka aplikuar tarifat e miratuara nga ERRU sipas Vendimit Nr. 9, datë 21.04.2014 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për UK Fier SHA. Sipas ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA, niveli i tarifave në fuqi nuk është ndryshuar për një kohë të gjatë edhe as pas riorganizimit të Bashkisë Fier, në këto kushte kërkohet të aplikohet një tarifë e unifikuar në të gjithë zonën e shërbimit, për të siguruar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit.
3. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon një nivele tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN. Këto tarifa për FU dhe KUZ nuk aplikohen për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga UK Fier SHA.

4. Nëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Fier SHA propozon unifikimin e tarifave si rezultat: a) i zonave të shtuara pas zgjerimit të zonës së shërbimit, b) nevoja për të ardhura shtesë për investime në të gjithë zonën pas riorganizimit, c) realizimi i të ardhurave për përballimin e kostove të cilat janë të papërballeshme, dhe d) FU në zonën e shërbimit ofrohet në 20 orë në ditë gjatë vitit 2019.
5. Tarifa për konsumatorin familjar në të gjitha zonën e shërbimit unifikohet në 52 lek/m³ duke pësuar një rritje nga 2 lek/m³ për konsumatorët familjar të zonës Cakran, Mbrostar 7 lek/m³ për konsumatorët familjar të zonës Frakull, Portëz, Levan, 10 lek/m³ për konsumatorët familjar të zonës Dermenas dhe 12 lek/m³ për konsumatorët familjar të zonës Libofsh. Tarifa për konsumatorin familjar të zonës Fier, Tropojë dhe Qendër nuk ndryshon mbetet e njëjta tarifë 52 lek/m³. Tarifa e FU për konsumatorët publik në të gjithë zonën e shërbimit propozohet të mos ndryshoj 105 lek/m³. Tarifa e FU për konsumatorët privat propozohet të rritet nga 55 lek/m³ deri në 75 lek/m³ në zonën Cakran, Mbrostar dhe Libofsh për tu unifikuar në të gjithë zonën me tarifën 125 lek/m³.
6. Tarifa për konsumatorin familjar për KUN në të gjithë zonë e ofrimit të shërbimit nga UK Fier SHA përfshirë dhe zonën rurale të shtuar pas riorganizimit, propozohet të jetë 13 lekë/m³, në bazë të VKM-së Nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”. Për konsumatorët publik në zonën e shërbimit, tarifa KUN mbetet e pandryshuar me 18 lek/m³. Për konsumatorët privat në zonën urbane Frakull, Fier, Tropojë dhe Qendër tarifa KUN mbetet e pandryshuar 20 lek/m³, për zonën Cakran, Dermenas, Mbrostar, Portëz, Levan, Libofsh propozohet të vendoset tarifa e unifikuar 20 lek/m³ dhe niveli i ofrimit të shërbimit është rreth 48%.
7. Nga “UK Fier” SHA propozohet një rritje 100% të tarifës aktuale fikse të shërbimit në vlerën 200 lek/muaj/lidhje për konsumatorin familjar, për konsumatorin publik dhe privat në të gjithë zonën e shërbimit. UK Fier SHA kërkon të realizojë investime në zonat e shtuara pas riorganizimit që të përmirësoj cilësinë e ofrimit të shërbimit për FU dhe KUN kundrejt konsumatorit familjarë, publik dhe privat.
8. UK Fier SHA ka kërkuar unifikimin e tarifave, për vendosjen në një nivel të ri pas gjashtë vitesh, të tarifave për shërbimin e FU dhe KUN referuar dhe vlerësimit të kostove për secilën zonë.
9. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2020 dhe vitin 2021 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar reduktimin e humbjeve teknike dhe administrative, rritjen e efikasitetit në reduktimin e numrit të stafit, i cili është i lartë, 6.26 staf/1000/lidhje, rritjen e qëndrueshmërisë financiare si edhe rritjen e mundësisë për përfitime të investimeve në shërbimet e ofruar.
10. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Fier SHA pas riorganizimit ka një nivel të pranueshëm të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes totale, që varion nga 75 % për vitin 2019 me një rritje të lehtë 76 % për vitin 2020. Nevoja për të ardhura synon përmirësimin e nivelit të mbulimit të kostove O&M, i cili parashikohet të jetë në nivelin 79% në vitin 2021.
11. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Fier SHA duhet të punojë për reduktimin e nivelit të humbjeve teknike dhe administrative, duke angazhuar stafin për vlerësimin sa më të saktë të çdo komponenti që bilanci të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të evidentojë të gjitha lidhjet me rrjetin, si edhe të hartojë një plan biznesi 5 vjeçar duke marrë në konsideratë situatën aktuale të zonës së shërbimit pas riorganizimit në kuadër të VKM Nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” me

qëllim argumentimin për nevojën e investimeve në lidhje me përmirësimin e shërbimit si edhe qëndrueshmërinë financiare.

12. Tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Fier SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
13. Duke qenë se niveli i kostove totale për vitin 2020 mbetet thuajse në nivele relativisht të moderuara krahasuar me ato të vitit 2019 me një rritje rreth 1%, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove, si dhe të gjitha investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit duhet të jenë sa më transparente dhe të kontabilizohen.
14. Nga vlerësimi i Konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Fier SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Fier SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për unifikimin e tarifës dhe nivelin e ri të tarifës për FU dhe KUN, UK Fier SHA ka realizuar ndarjen veç e veç të kostove sipas shërbimit FU dhe KUN, por nuk ka aplikuar ndarjen e kostove sipas zonave, megjithëse KUN është një shërbim që faturohet për herë të parë në largimin e ujërave të ndotura në zonat rurale.
15. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot të ndara për të dy shërbimet e ofruara, duke zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).
16. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, germa (d) e (f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 1. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Fier SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 2. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 753, Datë 03.12.2020

“Për dhënien e disa rekomandimeve Agjencisë së Prokurimeve Publike mbi zbatimin e kuadrit ligjor”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Agjencisë së Prokurimeve Publike mbi zbatimin e kuadrit ligjor.

Baza ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe neni 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe Udhëzues “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 4778/2 prot., datë 25.08.2020 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me nr. 312 prot., datë 27.08.2020) Agjencia e Prokurimit Publik (APP), ka depozituar një shkresë për referim rasti lidhur me ankesën depozituar pranë APP nga ndërmarrja “DMD” Shpk me objekt “Ankimin kundër subjektit “New Medical Plus” dhe “Acquarius Medical”.
2. Nëpërmjet kësaj shkrese, APP ka referuar ankesën e dërguar nga shoqëria “DMD” Shpk, ku pretendon se subjektet “New Medical Plus” dhe “Acquarius Medical”, të cilat kanë të njëjtin pronar dhe administrator të tyre Z. Alvaro Nazarko, rezultojnë se marrin pjesë njëkohësisht në procedurat e prokurimit, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke prishur konkurrencën e drejtë.
3. Sipas shoqërisë “DMD” Shpk, Z. Alvaro Nazarko, futet në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, njëkohësisht me të dy firmat, me oferta të ndryshme, me qëllim përfitimin me ofertën më të mirë. Nisur nga ky pretendim, APP ka bërë verifikimet përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektronik, sa i takon pjesëmarrjes së këtyre dy shoqërive në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, nga ku ka rezultuar se kanë marrë pjesë njëkohësisht në 454 procedura prokurimi me vlerë të vogël, në periudhën 30.03.2020 deri në 30.07.2020.
4. Agjencia e Prokurimit Publik, nisur nga parimi i nxitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, si dhe në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 28/2 prot., datë 02.04.2019, të nënshkruar me Autoritetin e Konkurrencës, e përcjell rastin, për t’u hetuar nëse përbën deformim të konkurrencës pjesëmarrja e dy operatorëve ekonomikë me të njëjtin administrator në një procedurë prokurimi.
5. Bazuar në Udhëzuesin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në ofertë në prokurimet publike” marrëveshjet e ndaluara në oferta ndodhin kur ndërmarrjet (operatorët ekonomikë), të cilët supozohet të konkurrojnë, në mënyrë të fshehtë bien dakord për rritjen e çmimeve ose uljen e cilësisë së produkteve (të mirave apo shërbimeve) për blerësit (autoritetet kontraktore), të cilët dëshirojnë të sigurojnë produktet dhe shërbimet nëpërmjet një procesi prokurimi.

6. Referuar nenit 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore. Në çdo rast qëllimet e këtij ligji janë:
 - i. Të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
 - ii. Të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 - iii. Të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - iv. Të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - v. Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.
7. Si dhe sipas nenit 13, pika 2, germa (g) e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Agjencia e Prokurimit Publik verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, shqyrton rekomandimet e organeve audituese për procedurat e prokurimit, si dhe monitoron mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore.
8. Në nenin 65, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “Ndërhyrja në ofertë”, përcaktohet se asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdo lloji kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.
9. Për sa më sipër, nga vlerësimi i kësaj ankese, rezulton se ky rast nuk përbën rastin e një marrëveshje të ndaluar në oferta sipas Udhëzuesit “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, por është e ndaluar sipas parashikimeve të nenit 65 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku këto ndërmarrje nuk mund të ofertojnë njëkohësisht në të njëjtën procedurë prokurimi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe (f); nenin 26; nenin 69 dhe nenin 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe Udhëzues “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”.

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Agjencisë së Prokurimeve Publike:
 - i. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson dhe shqyrton vetëm rastet e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike në formën e ofertave të mbuluara, ofertave të përmbajtura dhe ofertave në rotacion.
 - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 754, Datë 09.12.2020

“Për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e Hetimit Paraprak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.12.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e Hetimit Paraprak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”.

Baza ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d) i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e Hetimit Paraprak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121/2003, me vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e Hetimit Paraprak në tregun e barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” vendosi:

1. Hapjen e procedurës së hetimit të paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore
2. Hetimi të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2019 deri në 30 nëntor 2020.
3. Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e vendimit.

Për vlerësimin e konkurrencës në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, është kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, informacion i cili ende nuk është depozituar.

Koha e mbetur në dispozicion për përpunimin dhe dorëzimin e raportit është e pamjaftueshme,

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e Hetimit Paraprak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, pika 3 e tij të ndryshohet si vijon:

“3. Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 29 janar 2021”

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIME ME OBJEKT – PËRQENDRIME

VENDIM

Nr. 673, Datë 23.01.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.01.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendimeve.” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.

Pala blerëse: Mol Crossroads B.V është një shoqëri me seli ligjore në Amsterdam, Hollandë, e zotëruar tërësisht nga Mol Hungarian Oil and Gas Public Limited Company. Kjo është shoqëria mëmë në Mol Group, e regjistruar sipas legjislacionit Hungarez dhe aktive në zinxhirin e shoqërive të tregut të naftës së përpunuar dhe gazit natyror.

Mol Group ka aktivitet kryesor: eksplorimin, prodhimin dhe rafinimin e naftës së papërpunuar, furnizimin me produktet e rafinuara të naftës, si me shumicë dhe pakicë, prodhimin dhe tregtimin e lëndëve petrokimike, eksplorimin dhe prodhimin e gazit natyror dhe transmetimin e gazit natyror në Hungari.

Mol Group nuk është prezent në Shqipëri nëpërmjet filialeve të tij por gjeneron të ardhura përmes shoqërive të grupit të tij Ina Group dhe MOL LUB Kft.,

Pala shitëse: Chevron Global Ventures Ltd dhe Chevron BTC Pipeline LTD janë shoqëri të themeluar sipas legjislacionit të ishujve të Bermudës

Asnjë nga shoqëritë shitëse nuk është prezent dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Shoqëria Target: Chevron Khazar Ltd, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të ishujve të Bermudës, e cila është pjesë e Chevron Corporation. Aktiviteti i Chevron Khazar Ltd përfshin operacione në fushën e të naftës në Azerbajxhan.

Chevron Khazar Ltd nuk është prezent dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Vlerësimi i përqendrimit

Më datë 04 Nëntor 2019, midis blerësit Mol Crossroads B.V dhe palës shitëse Chevron Global Ventures Ltd dhe Chevron BTC Pipeline LTD është nënshkruar “Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e kuotave”, të shoqërive Chevron Khazar Ltd; Baku - Tbilisi - Ceyhan Pipeline dhe Btc International Investment Co, me garantues Mol Hungarian Oil and Gas PLC.

Pas implementimit të transaksionit të propozuar, Mol Group nëpërmjet Mol Crossroads B.V do të zotërojë:

- i. 100% të aksioneve të Chevron Global Ventures Ltd;
- ii. 8.63% pjesëmarrje në Baku - Tbilisi - Ceyhan Pipeline
- iii. 8.9% pjesëmarrje në Btc International Investment Co

Kontrolli i qëndrueshëm mbi shoqërinë Chevron Khazar Ltd, është përftim kontrolli nga pala blerëse Mol Crossroads B.V dhe vetëm ky transaksion plotëson kriteret e nenit 10, pika 1 germa b të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Referuar pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni plotëson edhe kriteret e përcaktuara në 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionin dhe praktikat më të mira të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit është lënë i hapur dhe përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i vlerësuar është përftimi i kontrollit të Chevron Khazar Ltd nga Mol Crossroads B.V. Mol Crossroads B.V. nuk ka prezencë fizike apo shoqëri të regjistruar por realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet shoqërive të Grupit MOL. Shoqëria target, Chevron Khazar Ltd, nuk ka prezencë fizike apo shoqëri të regjistruar dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 676, Datë 07.02.2020

“Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.02.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA,

VËREN SE:

Transaksioni dhe palët

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA.

Pala blerëse: *Vodafone Albania SHA* (VFAL) është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie: Krijimin dhe vënien në punë e sistemeve të radio telefonisë së lëvizshme celulare GSM dhe kërkimi, projektimi, krijimi dhe vënia në punë e sistemeve të telekomunikacionit, përfshirë rrjetet e internetit ("Sistemet"); furnizimi me dhe/ose shitja e pajisjeve, materialeve dhe të ngjashmeve, të përdorura në lidhje me Sistemet; krijimi dhe vënia në punë e njësive që mbështesin Sistemet; dhënia e shërbimeve të telekomunikacionit dhe të shërbimeve me vlerë të shtuar nëpërmjet Sistemeve; prodhimi dhe shfrytëzimi i programeve softuer (software) në funksion të telekomunikacioneve e në lidhje me to; furnizimi, tregtimi dhe shpërndarja e telefonave, kompjuterëve e aksesorëve të tyre, pajisjeve të telekomunikacionit, të zërit, figurës dhe të mjeteve transmetuese të të dhënave, si dhe të produkteve dhe aksesorëve të komunikimit për dhe në lidhje me shërbimet e telekomunikacionit; furnizimi, tregtimi dhe shpërndarja e materialeve promovionale me logon Vodafone, ose me logon Vodafone dhe logon e çdo partneri zyrtar të Vodafone, etj.

VFAL është nën kontrollin fundor të Grupit Vodafone (“Vodafone Group”), shoqëria holding, me aktivitet kryesor operimin e rrjeteve të telefonisë së lëvizshme dhe ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme, të tilla si shërbimi i telefonisë celulare, mesazheve dhe shërbimi i të dhënave. Disa nga shoqëritë e grupit në mbarë botën ofrojnë edhe shërbime të tilla si transmetimi kabllor i kanaleve televizive, shërbime të telefonisë fikse si edhe internet fiks apo IPTV.

VFAL zhvillon aktivitetin bazuar në Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit nr. 2012-AP-U112-8-6, datë 19.03.2012, nr. 2013-AP-U112-8-2, datë 06.03.2013, nr. 2015-AP-U112-8-597, datë 06.07.2015 & nr. 2016-XVI / 2020

AP-U112-8-582, datë 08.06.2016 (Autorizime të Përgjithshme) dhe Autorizime Individuale të AKEP për përdorimin e spektrit.

VFAL nuk është aktiv në shërbimet e telefonisë fikse në Shqipëri.

Pala shitëse: American Broadband B.V. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në shtetin e Holandës, me qëllimin për të vepruar si një kompani aksionere. Shoqëria American Broadband B.V. është pjesë e një grupi i kryesuar nga Fondi i Kapitalit të Evropës Juglindore II dhe aksionerët e drejtëpërdrejtë të shoqërisë janë shoqëria ABCom Sarl me seli në Luksemburg dhe shoqëria DK-Invest B.V e krijuar sipas legjisllacionit Holandez.

Shoqëria Target: ABCom SHPK (ABCom), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjisllacionit shqiptar me objekt veprimtarie: të ideojë, zbatojë dhe të menaxhojë rrjete të telekomunikacionit dhe transmetimit të të dhënave dhe interkoneksionet në përgjithësi; të plotësojë nevojat industriale, tregtare, sociale dhe të rezidentëve për shërbime telekomunikacioni gjithëpërfshirëse dhe efektive. Të kënaqë të gjitha kërkesat praktike dhe të arsyeshme për këto shërbime; të sigurojë shërbime konsulence, këshillimi, trajnimi dhe kontrata shërbimi; të interkonjektohet me ofrues të tjerë shërbimesh dhe shoqëri të telekomunikacionit për të furnizuar shërbime end-to-end; të ofrojë shërbime audio dhe/ose audiovizive.

ABCom është pajisur nga AKEP me certifikatën nr. 2012-AP-U100-8-5; 2012-AP-U100-8-6 dhe 2017-AP-00232 për përdorim të rrjeteve publike të komunikimeve elektronikë nëpërmjet rrjeteve fikse, aktive në ofrimin e shërbimeve të broadband fikse, telefonisë fikse, transmetime kabllore të kanaleve televizive, mbi rrjetin e saj të fibrave hibride koaksiale ("HFC"). ABCom është subjekt i Autorizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive si ofrues shërbimi i programeve audiovizive (OSHMA) mbështetur në rrjet kabllor. Rrjeti i ABCom është i pranishëm në qytetet më të mëdha në Shqipëri.

ABCom nuk është aktiv në shërbimet e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri.

Autoriteti i Konkurrencës, kërkoi vendimmarrjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në lidhje me ndryshimin e kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, me shkresën nr. 4353/1 prot datë 26.12.2019 "Kthim përgjigje", ka bërë me dije se me Vendimin nr. 195 datë 19.12.2019, ka vendosur miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë ABCom SHPK duke e shndërruar në ortakun e vetëm të subjektit, shoqërinë Vodafone Albania SHA, me 100% të kuotave.

Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me shkresën nr. 2327/2 prot, datë 20.01.2020 "Kthim përgjigje shkresës Nr.624/3, datë 03.12.2019 "Kërkesë për informacion", shprehet se: "në bazë të nenit 74, të ligjit Nr.9918, datë 19 Maj 2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, AKEP nuk merr në shqyrtim shitjen e kuotave të kapitalit themeltar të një shoqërie, në rastin në fjalë të ABCom SHPK, për aq kohë sa ky transaksion nuk sjell si rezultat ç'regjistrimin e shoqërisë nga QKB apo nevojën e transferimit të autorizimeve individuale, me të cilat është pajisur nga AKEP, në favor të subjektit blerës, në këtë rast të Vodafone Albania SHA. Prej shqyrtimit të kontrollit të drejtëpërdrejtë të ABCom SHPK, në favor të subjektit blerës, vërehet gjithashtu se dy shoqëritë veprojnë aktualisht në tregje të ndryshme, fikse dhe celulare".

Më datë 25 tetor 2019, u nënshkrua "Marrëveshja për Shitje dhe Blerje", ndërmjet Vodafone Albania SHA dhe American Broadband B.V., në lidhje me shitjen dhe blerjen e të gjithë aksioneve në shoqërinë ABCom SHPK. Pas mbylljen së marrëveshjes, VFAL do të përfitojë kontrollin e vetme, më anë të blerjes së 1 (një) kuotë që përbën gjithë kapitalin e regjistruar të ABCom SHPK dhe transaksioni plotëson kriteret e nenit 10, pika 1 germa b të Ligjit 9121/2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar.

Vlera e transaksionit¹⁵ është XXXXX lekë, e konvertuar ne Euro.

Referuar pasqyrave financiare të shoqërive palë në transaksion, konstatohet se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 12, pika 1,b) e ligjit dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Nëpërmjet këtij transaksioni, VFAL synon për të hyrë në tregun e shërbimeve nëpërmjet rrjeteve fikse, internetit fiks, televizionit me pagesë dhe telefonisë fikse, në shërbimin *broadband*-it fiks në Shqipëri, i cili është plotësisht i shkëputur nga shërbimet e telefoninë celulare.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës përbëhet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”. Në zbatim të ligjit, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.

I). tregu përkatës i produktit, dhe

II). tregu përkatës gjeografik.

Tregu përkatës i produktit: Referuar aktivitetit të palëve në marrëveshje, VFAL dhe ABCom ofrojnë shërbimin e tyre mbështetur në rrjetet publike të komunikimeve elektronike me ndryshimin e vetëm që VFAL është i licencuar në përdorimin e rrjeteve të lëvizshme dhe ABCom në rrjetet publike fikse.

Zëvendësueshmëria e dy shërbimeve (rrjeteve) ka qenë objekt vlerësimi nga Komisioni i Konkurrencës dhe AKEP, të cilët i kanë vlerësuar dhe analizuar si tregje të ndara shërbimet nëpërmjet rrjeteve fikse dhe atyre të lëvizshme (celulare).

Në vendimin nr. 303, datë 16.01.2014 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA dhe rekomandime për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, Komisioni i Konkurrencës ka parashtruar se telefonia fikse nuk është përfshirë në tregun përkatës të shërbimit celular me pakicë për shkak të karakteristikave të ndryshme që ka kur krahasohet me telefoninë celulare; nga këndvështrimi i një konsumatori këto shërbime nuk mund të zëvendësohen me shërbime të telefonisë celulare ”.

Në mënyrë të ngjashme, në Analizën e Tregut të Shërbimeve Celulare të vitit 2019¹⁶, AKEP ka analizuar tregun e shërbimeve celulare si një treg të veçantë nga ai i telefonisë fikse.

Komisioni Evropian në rastin Orange / Jazztel¹⁷, tregoi se shërbimi celular i të dhënave nuk ofron të njëjtat karakteristika (p.sh. për nga kapaciteti apo modeli e çmimeve), dhe të dhënat e shërbimeve fikse dhe celulare synojnë nevoja të ndryshme të klientit (si p.sh. akses në internet në lëvizje, akses në aplikacione në telefoninë celulare).

Sa më sipër, mund të themi se VFAL dhe ABCom operojnë në tregje të ndryshme, përkatësisht VFAL në tregun e telefonisë së lëvizshme dhe ABCom në tregun e telefonisë fikse.

¹⁵ “Konsiderimi Baze”, referuar “Marrëveshje për Shitje dhe Blerje”.

¹⁶ Analiza e Tregut nga AKEP, miratuar me Vendimin datë. 17.04.2019, Seksioni III.2, fq. 38

¹⁷Case M.7421, COMMISSION DECISION of 19.5.2015 declaring a concentration to be compatible with the internal market and the EEA agreement (Case M.7421 – ORANGE / JAZZTEL), parag. 50-53.

https://ec.europa.eu/competition/mergers/cases/decisions/m7421_3169_4.pdf

- Për sa më sipër, si dhe referuar tregjeve të shërbimeve të dy shoqërive, treg përkatës të produktit do të konsiderohet **tregu i komunikimeve elektronike në rrjetet e lëvizshme dhe tregu i komunikimeve elektronike në rrjetet fikse.**
- **Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i komunikimeve elektronike është një treg i cili mbikëqyret dhe rregullohet nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Rreth XX% e të ardhurave nga komunikimet elektronike sigurohet nga operatorët celularë dhe ofruesi më i madh në tregu e komunikimeve mbetet Vodafone Albania me XX% të tregut, Telekom Albania përkatësisht XX%, Altelecom Mobile XX%, Altelecom Fiks XX% dhe operatorët e tjerë alternativ 8%¹⁸.

Analiza e Konkurrencës

Mbështetur në analizat e tregut të komunikimeve elektronike, AKEP vlerëson se në tregun i komunikimeve elektronike përfshihen nën tregjet e rrjedhës së sipërme (shumicë) dhe nën tregjet e pakicës si në shërbimin e telefonisë së lëvizshme ashtu edhe në shërbimin e telefonisë fikse.

Referuar udhëzuesve mbi vlerësimin e përqendrimeve horizontale, johorizontale dhe konglomerate, si dhe tregjeve të prekura nga transaksioni, u konstatua se palët **nuk krijojnë mbivendosje të pjesëve të tregut** në tregjet e shërbimeve telefonike në rrjetet e lëvizshme dhe fikse me pakicë.

- Tregu i telefonisë së lëvizshme

Shërbimet e telefonisë së lëvizshme për klientët fundorë, ose ndryshme "shërbime celulare me pakicë" përfshijnë thirrje me zë, SMS (përfshirë MMS dhe mesazhe të tjera), akses në internet përmes rrjetit celular si dhe shërbime ndërkombëtare roaming me pakicë. Këto shërbime ofrohen në rrjetet 2G / GSM, 3G / UMTS dhe 4G / LTE duke patur parasysh se rrjeti 3G është i përshtatur më mirë për sasi më të mëdha të të dhënave dhe shpejtësi më të shpejtë të downloadimit. 4G/LTE është një teknologji e lëvizshme që rrit shpejtësinë dhe kapacitetin e rrjetit dhe është përshtatur për përmirësimin e cilësisë së zërit dhe transmetimit të të dhënave me shpejtësi të lartë nga pajisjet wireless.

Shërbimi i telefonisë së lëvizshme (celulare), që pas vitit 2018, ofrohet nga tre operator ekonomik dhe sipas të dhënave në Raportin vjetor për vitin 2018 të AKEP, të ardhurat totale nga shërbimet me pakicë në rrjetet celulare në vitin 2018 arritën në XX miliard lekë që përbën një rritje me rreth 2% në krahasim me vitin 2017. Të tre operatorët Telekom Albania, Altelecom dhe Vodafone Albania, kanë shënuar rritje me 5%, 9% dhe 10% respektivisht, të ndikuar edhe efektin e daljes së Plus Communication nga tregu¹⁹.

VFAL vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile me mbi XX% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë dhe broadband, ndërsa për treguesit mbi të trafikun e minutave, SMS dhe të dhënave mbi XX% të tregut. Vodafone është operatori me pjesën më të madhe të tregut për të ardhurat me XX% të këtij tregu. Ndjekësi më i afërt është Telekom Albania pjesët e tregut të të cilit për të gjithë treguesit kryesor luhaten nga XX% (të ardhurat nga shërbimet mobile XX%). Sipërmarrësi me pjesën më të vogël të tregut është Altelecom pjesët e të cilit luhaten nga XX% (të ardhurat nga shërbimet mobile rreth XX%).

Nga analiza e tregut të shërbimit të telefonisë celulare me pakicë dhe vlerësimit të marrëveshjes mes shoqërive VFAL dhe ABCOM, konstatohet se vetëm VFAL operon në tregun përkatës të produktit dhe transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje të pjesëve të tregut mes VFAL dhe ABCOM dhe për rrjedhojë nuk

¹⁸ <https://akep.al/wp-content/uploads/2018/09/AKEP-RAPORT-VJETOR.pdf>

do të këtë krijim apo forcim të pozitës dominuese të shoqërisë VFAL në tregun e shërbimit të telefonisë celulare më pakicë.

- Tregu i shërbimit në rrjetin fiks

Shërbimet e rrjeteve fikse në Shqipëri, ofrohen nga rreth XX sipërmarrës²⁰, të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkte me përdoruesit fundorë.

Sipas të dhënave të AKEP, Altelecom zotëron numrin më të madh të pajtimtarëve të rrjetit fiks (rreth XXX mijë abonentë) me XX% të tregut, i ndjekur nga ABCom me XX% të tregut me rreth 11,6 mijë abonentë. Nëpërmjet rrjetit fiks, pajtimtarët mund të sigurojnë si shërbimin e thirrjeve ashtu edhe atë me akses broadband (internet) i cili gjatë vitit 2018 arriti në XX mijë pajtimtar ose rreth XX% më e lartë se viti 2017.

Operatori ABCom e ka të orientuar shërbimin drejt aksesit në internet, infrastrukturë teknike të cilën ky operator e përdorë edhe për shërbimin e transmetimeve audiovizive. Duke ju referuar numrit të pajtimtarëve konstatohet se ABCom ka një rritje me rreth XX % të numrit të pajtimtarëve krahasuar më vitin 2017.

Në tregun e shërbimit të rrjetit fiks, shoqëria VFAL nuk është aktive dhe nuk ofron shërbim. Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje të pjesëve të tregut mes VFAL dhe ABCom dhe për rrjedhojë nuk do të këtë krijim apo forcim të pozitës dominuese të shoqërisë VFAL në tregun e shërbimit me pakicë në rrjetin fiks.

Transaksioni i propozuar do të sjellë **efekte horizontale** në tregun e :

- Shërbimit të dhënies më qera të linjave dixhitale.

Ofrimi me shumicë i linjave me qira nuk është shërbim parësor për asnjë nga operatorët palë në marrëveshje. Sipas të dhënave të deklaruara nga palët, në tremujorin e katërt të vitit 2018, ABCom ofroi linja me qira me XX kapacitete tek operatorë të tjerë të telekomunikimit, me një pjesëmarrje të llogaritur të tregut, prej XX % për vitin 2018 ndërkohë që Vodafone ofron linja me qira për 3 operatorë me një kapacitet të ofruar total prej XX (në vitin 2018) ose XX % e tregut. Pas transaksionit, pjesa e kombinuar e tregut për këta operatorë do të jetë XX % në pjesën e tregut të shërbimeve me shumicë të linjave me qira, duke mos shkaktuar rritje të përqendrimit në tregjet e prekura dhe efekte mbi konkurrencën në këtë treg.

- Shërbimi i konjektivitetit të internetit

Sipas informacionit të depozituar nga pala blerëse, VFAL, megjithëse nuk është një operator/konkurrent i rrjeteve fikse, ai ofron në një masë shumë të kufizuar disa shërbime të konektivitetit të biznesit mbështetur në linja me qira (të tilla si aksesit në *broadband*, linja me qira, etj) për disa prej klientëve të saj të biznesit si një aktivitet suplementar i ofertës së saj celulare për të njëjtët klientë, dhe asnjëherë si një produkt i pavarur.

Pjesa e tregut e ABCom pas transaksionit nuk do të ndikohet nga ajo e VFAL, dhe Altelecom, Abissnet, Nisatel, Digicom e disa konkurrentë të tjerë lokale, do të vazhdojnë të jenë konkurrentë aktual për shoqërinë ABCom në rrjetet fikse. Palët e treta, që nuk kanë rrjetet e tyre, gjithashtu mund të konkurrojnë duke ofruar shërbime përmes aksesit të rregulluar me shumicë në rrjetin aktual të Altelecom.

Transaksioni do të krijojë **efekt vertikal** në disa tregje të influencuara nga kushtet teknike të funksionimit të shërbimit.

- Ofrimin e shërbimeve të terminimit të thirrjeve në rrjetin celular të VFAL në rrjedhën e sipërme (*upstream*) dhe ofrimin e telefonisë fikse me pakicë në rrjedhën e poshtme (*downstream*) nga ABCom;

²⁰ <https://akep.al/wp-content/uploads/2018/09/AKEP-RAPORT-VJETOR.pdf>, fq 22

- Ofrimin e shërbimeve të terminimit të thirrjeve në rrjetin fiks të ABCom në rrjedhën e sipërme (*upstream*) dhe ofrimin e shërbimeve të telefonisë celulare me pakicë në rrjedhën e poshtme (*downstream*) nga VFAL;

Shërbimet e terminimit të thirrjeve, ose tregu me shumicë ofrohen kur telefonatat origjinoohen nga një rrjet dhe terminojnë në një rrjet tjetër. Terminimi i thirrjeve lejon kështu përdoruesit e rrjeteve të ndryshme të komunikojnë me njëri-tjetrin. Terminimi i thirrjeve është një shërbim me shumicë i ofruar nga operatorë të ndryshëm të rrjetit ndaj njëri-tjetrit në bazë të marrëveshjeve të interkoneksionit.

Ky shërbim ofrohet në rrjedhën e sipërme (*upstream*) të ofrimit të shërbimeve zanore përmes telefonisë celulare ose fikse. Terminimi mund të ndërthurë shërbimin fiks me shërbimin celular në rrjedhën e sipërme e anasjelltas dhe transaksioni i propozuar krijon: (i) një marrëdhënie vertikale midis VFAL dhe ABCom, pasi tregu me shumicë për shërbimet e terminimit të thirrjeve celularë në rrjetin e VFAL është në rrjedhën e sipërme (*upstream*) të tregut, i cili realizon furnizimin me pakicë të shërbimeve, thirrjeve zanore fikse të ABCom; dhe (ii) një marrëdhënie vertikale midis ABCom dhe VFAL pasi tregu me shumicë për shërbimet e terminimit të thirrjeve zanore fikse në rrjetin e ABCom është në rrjedhën e sipërme (*upstream*) të tregut, për furnizimin me pakicë të shërbimeve celulare të VFAL.

Në përputhje me vendimet e Komisionit Evropian dhe AKEP, çdo operator celular apo fiks në tregun e terminimit zotëron 100% të rrjetit të tij individual, pasi nuk ka zëvendësues për terminimin e thirrjeve në secilin rrjet individual²¹.

Në këtë kontekst, VFAL ka 100% pjesë tregu për thirrjet që terminojnë në rrjetin e tij të telefonisë celulare dhe në mënyrë të ngjashme, ABCom ka 100% pjesë tregu për thirrjet që terminojnë në rrjetin e tij fiks.

Vodafone nuk ka rrjet të telefonisë fikse dhe për këtë arsye nuk është aktiv në tregun me shumicë të shërbimeve të terminimit të thirrjeve fikse dhe ABCom nuk ka rrjet të telefonisë celulare prandaj nuk është aktiv në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë celulare.

Transaksioni nuk prek tregje horizontale në shërbimin e terminimit por marrëdhënia është e vendosur vetëm në tregje vertikale të prekura teknikisht, marrëdhënie e cila ka ekzistuar edhe para ndodhjes së transaksionit.

Transaksioni i Propozuar, nuk sjell pasoja për konkurrencën mes operatoreve në shërbimet e terminimit të thirrjeve pasi edhe pas përqendrimit të dy operatorët do të zotërojnë 100% të rrjeteve të tyre individuale. Shërbimet e terminimit të thirrjeve janë subjekt i rregullimit *ex-ante* nga AKEP i cili duke shpallur OFNT të gjithë operatorët e shërbimit të terminimit i ka vënë përpara detyrimin në respektim të nenit 39,40,42 dhe 45 të ligjit nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”²².

- Ofrimi nga ABCom i shërbimeve me shumicë të konektivitetit në internet në rrjedhën e sipërme (*upstream*), (i) ofrimi nga Palët i shërbimeve retail të konektivitetit të biznesit mbështetur në linja me qira për klientë biznesi (*downstream*), (ii) ofrimi nga VFAL i shërbimeve retail celulare (*downstream*).

Tregu i konektivitetit në Internet është treg ndërkombëtar dhe ABCom nuk ka fuqi në tregun ndërkombëtar. VFAL nuk ofron aktualisht shërbime me shumicë të konektivitetit në internet por VFAL do të ketë mundësi të shfrytëzojë burimet ndërkombëtare të internetit të Vodafone Group, duke ofruar kapacitet më të madh sesa

²¹ M.5650 T-Mobile/ Orange, para 37; Case M.6584 Vodafone/ Cable & Wireless, para 23; Case M.6990 Vodafone/ Kabel Deutschland, para 117; Case M.7978 Vodafone/ Liberty Global/ Dutch JV, para 210.

²² AKEP ka rregulluar maksimumin e tarifave për terminimin e telefonatave që këta operatore mund të vendosin për terminimin e telefonatave zanore në rrjetet e tyre. AKEP ka zgjidhur duke mbajtur simetrike MTRs e aplikueshme për të tre MNOs, duke reduktuar tarifën e terminimit nga 1.48 ALL/min deri 1.22 ALL/min duke filluar nga 1 Dhjetor 2018 deri në 1 Dhjetor, 2019 ku tarifa finale e terminimit do të jete 1,11 ALL/min (pa TVSH) . Në lidhje me FTRs, AKEP ka reduktuar tarifën e terminimit nga 1.29 ALL/min to 1.00 ALL/min duke filluar nga 1 Dhjetori 2018 për një vit deri në 1 Dhjetor 2019 ku tarifën finale të reduktuar do të jete ALL 0,70/min (pa TVSH) .

burimet që shfrytëzon aktualisht Abcom përmes kontratave me ofruesit ndërkombëtarë të konektivitetit të internetit.

Transaksioni i synuar nuk do të sjellë forcim të pozitës së ABCCom momentalisht në treg, por pritet rritje e cilësisë së shërbimit, e ndikuar nga burimet që do të përdorë VFAL për shërbimet në këtë treg.

Efektet konglomerate

Shërbimet e VFAL në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe shërbimet e ABCCom në tregun me pakicë të shërbimeve fiks janë plotësuese të njëra tjetrës dhe transaksioni i propozuar do të shkaktojë efekte konglomerate.

Shqetësimi kryesor në sferën e efekteve konglomerate është ai i përjashtimit të konkurrenteve pasi palët në transaksion mund të kombinojnë produktet në tregjet respektive, duke shfrytëzuar pozicionin e fortë në njërin treg për të influencuar në tregun tjetër, kryesisht me anë të ofertave *tying* ose *bundling* (produkte të lidhura) ose praktika të tjera përjashtuese.

Në përgjithësi përqendrimet konglomerate nuk shkaktojnë ndonjë problem të konkurrencës sikurse parashikohet edhe në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve johorizontale dhe konglomerate” dhe shpesh ato shihet si një mënyrë e mirë për të rritur eficientësinë në treg. Komisioni European ka vlerësuar disa raste, ku një operator celular dhe një operator fiks janë përqendruar me qëllimin për të siguruar paketa (*bundles*) fikse-celulare (konvergjencia) dhe ka hedhur poshtë çdo shqetësim në lidhje me përjashtimin e konkurrentëve të pavarur fiks apo celular përmes strategjive *bundling*.²³ Komisioni ka pranuar në disa raste që, një aftësi e shtuar për të shitur paketa të kombinuara celulare–fikse, ka të ngjarë të ketë efekt pro-konkurrues, sepse kombinimi i infrastrukturës të telefonisë fikse me atë celulare mund të lejojë që një entitet i përqendruar të ofrojë cilësi më të mirë ose produkte më të lira për konsumatorët.²⁴

VFAL synon që nëpërmjet transaksionit të propozuar të ketë mundësi për të hyrë në shërbimet e rrjeteve fikse, kryesisht tregu i *broadband*-it fiks në vend.

Aktualisht, në tregun shqiptar, vetëm Albtelecom SHA ofron shërbime /kombinim të paketave fikse dhe celulare por të dhënat e AKEP treguan se depërtimi i shërbimit fiks në popullatë është ndjeshëm më i ulët se vendet e rajonit dhe më tej, dhe nëse tregu do të përparojë në drejtim të paketave të lidhura, VFAL, mbështetur dhe në fuqinë e tij ekonomike, do të konkurrojë Albtelecom SHA për ofertat e shërbimeve.

Në përfundim të analizës, u konstatua se transaksioni i njoftuar do të sjellë:

- Efekte horizontale vetëm në tregun e shërbimit të linjave me qera ku pjesa e kombinuar e tregut pas përqendrimit do të arrijë në XX % pa shkakuar problematika për konkurrencën për shkak të krijimit apo forcimit të pozitën dominuese në treg.
- Efekte vertikale në tregun e ternimit më shumicë të thirrjeve telefonike mes rrjeteve fikse dhe celulare, nga ku konstatohet se nuk do të ketë efektet mbi konkurrencën dhe për më tepër ky treg është objekt vlerësimi nga AKEP.
- Në tregjet e komunikimeve fikse dhe celulare më pakicë nuk kemi mbivendosje pjesësh tregu pasi palët operojnë në tregje të ndryshme dhe për pasojë nuk do të ketë efekte mbi konkurrencën.
- Efekte konglomerate, të cilat kanë të bëjnë më tregjet plotësuese. Pas transaksionit pala blerëse do të mundësojë aksesin e shërbimeve në tregun e rrjeteve fikse dhe do të jetë konkurrenti më i afërt i shoqërisë

²³ M.8808 T-Mobile Austria/ UPC Austria; M.7978 Vodafone/ Liberty Global/ Dutch JV; M.7421 Orange/ Jazztel; M.7231 Vodafone/ ONO; M.6990 Vodafone/ Kabel Deutschland; M.6584 Vodafone/ Cable & Wireless; Case M.8842 – Tele2/ Com Hem Holding.

²⁴ M.7637 Liberty Global/ BASE Belgium, para 364; M.7978 Vodafone/ Liberty Global/ Dutch JV, para 627.

Albtelecom SHA. Konkurrenca pas transaksionit do të nxitet drejt paketave të shërbimeve fikse-celulare, të kombinuara më shërbime të tjera duke përfshirë edhe transmetimet televizive.

Sa më sipër mund të themi se transaksioni i propozuar nuk do të sjellë krijim apo forcim të pozitës dominuese të shoqërisë VFAL në tregjet e prekura, por duke qenë se shoqëria VFAL siguron pjesën më të madhe të të ardhurave nga shërbimet e komunikimeve elektronike, zotëron pozitë dominuese në tregun e komunikimeve elektronikë në rrjetin celular, ka eksperiencë e saj dhe të grupit që përfaqëson në tregjet përkatëse të produkteve, mendohet që ky transaksion do të ketë impakt në tregun e komunikimeve elektronike dhe kryesisht në tregun e komunikimeve në rrjetet fikse.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA me kushte dhe detyrime si më poshtë vijon:
 - a. Detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA të mos abuzojë më pozitën e saj dominuese nëpërmjet :
 - i. Vendosjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve të padrejta të tregtimit dhe detyrimin e orientimit e tyre drejt kostos së shërbimeve,
 - ii. Vendosjes së palëve në kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta, e të pafavorshme për konkurrencën,
 - iii. Vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, ku këto të fundit të pranojnë detyrime shtese, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.
 - b. Detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK, për ndarjen e llogarive ekonomike për shërbimet e telefonisë fikse dhe celulare, e cila do të bëjë të mundur evidentimin e burimit të gjenerimit të të ardhurave.
2. T’i rekomandojë AKEP, që të miratojë paraprakisht çdo paketë të re që përmban shërbime të kombinuara në tregun e telefonisë celularë, fikse dhe shërbimin e internetit. Ofruesit e paketave, duhet të deklarojnë çmimin për njësi shërbimi që këto paketa përmbajnë.
3. Monitorim për një periudhë 1 vjeçare nga marrja e këtij vendimi, të veprimtarisë së shoqërive Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK.
4. Detyrimin e shoqërive Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK, të njoftojnë paraprakisht pranë Autoritetit të Konkurrencës për të gjitha ndryshimet që do të kryejnë në paketat ekzistuese dhe paketat e reja që do të hedhin në treg, gjatë periudhës së monitorimit.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 681, Datë 05.03.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë RBM Assicurazione Salute S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.03.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë RBM Assicurazione Salute S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë RBM Assicurazione Salute S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë RBM Assicurazione Salute S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

Pala blerëse: Intesa Sanpaolo Vita S.p.A është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionin Italian, me objekt veprimtarie: ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve dhe risigurimeve në fushën e jetës, aksidenteve dhe degët e sigurimeve shëndetësore. Shoqëria mund të kryejë, në përputhje me dispozitat e ligjit, operacione financiare, veprime në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë blerjen e aksioneve, duke përfshirë dhe ata kontrollues, në kompani të tjera në Itali dhe jashtë saj, në lidhje me sigurinë dhe risigurimet dhe kompanitë financiare.

Intesa Sanpaolo Vita S.p.A kontrollohet nga Grupi Intesa Sanpaolo, e cila është e pranishme në Shqipëri përmes filialit të zotëruar plotësisht prej saj Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit Shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari bankare, veprimtari financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit, pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë; veprimtari të lidhura me transaksionet e titujve, vetëm pasi të jetë licensuar nga AMF dhe veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime në përputhje me Ligjin Nr.52/2014.

Pala shitëse: RBHold S.p.A, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionin Italian.

Shoqëri Target: RBM Assicurazione Salute S.p.A, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit

italian, me objekt veprimtarie: ushtrimin në Itali të biznesit të sigurimeve në lidhje me dëmtimet dhe klasat e aksidenteve, mund të marrë interesa dhe aksione në kompani ose në entitete të tjera, mund të kryejë çdo veprim financiar të luajtshëm dhe të pasurive të patundshme, investime, etj.

RBM Assicurazione Salute S.p.A, zotërohet tërësisht nga RB Hold S.p.A. e cila nuk ka degë apo filial dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Vlerësimi i përqendrimit

Në datë 19 Dhjetor 2019, midis blerësit Intesa Sanpaolo Vita S.p.A dhe palës shitëse RB Hold S.p.A është nënshkruar “Kontratë Investimesh”, për blerjen e shoqërisë target RBM Assicurazione Salute S.p.A.

Marrëveshja parashikon blerjen dhe pronësinë e plotë dhe ekskluzive të XXX aksione të zakonshme të RBM Assicurazione Salute S.p.A, me një vlerë nominale prej XXX Euro secila, e barabartë me 50% plus 1(një) aksione të kapitalit aksionar të RBM Assicurazione Salute S.p.A (pjesëmarrja fillestare). Deri në vitin 2029, Intesa Sanpaolo Vita S.p.A do të ketë mundësinë të rrisë më tej investimet derisa të bëhet mbajtësi i 100% të kapitalit aksionar të RBM Assicurazione Salute S.p.A.

Kontrolli i qëndrueshëm mbi shoqërinë RBM Assicurazione Salute S.p.A, është përftim kontrolli nga pala blerëse, Intesa Sanpaolo Vita S.p.A dhe ky transaksion plotëson kriteret e nenit 10, pika 1 germa b të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Referuar pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni plotëson edhe kriteret e përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121/2003, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” treg përkatës mund të konsiderohet tregu i sigurimit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i synuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të shoqërisë RBM Assicurazione Salute S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 682, Datë 05.03.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Dasof doo. nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.03.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Dasof doo nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Dasof doo nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfimin e kontrollit të shoqërisë Dasof doo nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.

Pala blerëse: Porsche Informatik Gesellschaft mbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin austriak, me objekt veprimtarie: prodhimi i makinerive, pjesëve të makinerive dhe prodhimi i mallrave metalike dhe plastike dhe shitja e këtyre mallrave; riparimi i motorëve dhe mjeteve motorike; tregtimi i mallrave të të gjitha llojeve; prodhimi, riparimi dhe tregtimi i pajisjeve aeronautike; prodhimi industrial i pjesëve elektronike; ofrimi i shërbimeve në përpunimin automatik të të dhënave dhe teknologjinë e informacionit; pjesëmarrja edhe si ortak me përgjegjësi personale në sipërmarrje me objekt të njëjtë ose të ngjashëm.

Porsche Informatik Gesellschaft mbH është filial i drejtpërdrejtë i Porsche Holding Gesellschaft mbH me seli në Salzburg, shoqëri e cila ushtron veprimtarinë e saj në tregtimin e makinave në Evropë. Porsche Holding Gesellschaft mbH është filial i drejtpërdrejtë i Volkswagen AG, e cila është shoqëria mëmë e Grupit VW.

Në Shqipëri, Porsche Informatik Gesellschaft mbH (tërthorazi përmes filialeve të Grupit VW në Shqipëri) është aktive në konsulencën e produktit dhe procesit, zhvillimin e programeve informatike, shërbimet e prezantimit, trajnimit, operimin e shërbimeve të ofertesit të shërbimit të aplikacionit (OSHA).

Pala shitëse:

- Z. D K, është person fizik dhe shtetas sloven.

- Z. A P është person fizik, dhe shtetas slloven.

Shoqëria Target: Dasof doo, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Sllovenisë, me objekt veprimtarie: shitje me pakicë të pajisjeve kompjuterike në dyqane të specializuara për programet të telekomunikacionit e pajisjeve audio dhe video, programim kompjuterik, etj.

Vlerësimi i përqendrimit

Më datë 12 Dhjetor 2019, midis blerësit Porsche Informatik Gesellschaft mbH dhe palës shitëse Z. DK dhe Z. AP është nënshkruar “Kontratë për blerje dhe shitje aksionesh”, të shoqërisë target Dasof doo.

Bazuar në dispozitat dhe kushtet e kësaj kontrate, blerësi synon të blejë gjithsej 85 % (tetëdhjetë e pesë) të aksioneve në shoqëri nga shitësit dhe shitësit dëshirojnë të shesin aksionet tek blerësi. Pjesa e mbetur prej 15 (pesëmbëdhjetë) % e aksioneve të shoqërisë përfaqëson aksionet e veta të shoqërisë, të cilat gjithashtu janë të regjistruara në shoqëri dhe nuk kanë asnjë kufizim.

Kontrolli i qëndrueshëm mbi shoqërinë Dasof doo, është përftim kontrolli nga pala blerëse Porsche Informatik Gesellschaft mbH dhe ky transaksion plotëson kriteret e nenit 10, pika 1 germa b të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Referuar pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni plotëson edhe kriteret e përcaktuara në 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit dhe praktikën më të mira të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit është lënë i hapur dhe përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të Dasof doo. nga Porsche Informatik Gesellschaft mbH. Shoqëria Target Dasof doo. nuk operon në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të shoqërisë Dasof doo nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 686, Datë 06.04.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 5% të aksioneve të shoqërisë Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA nga shoqëria Banka Credins SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.04.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 5% të aksioneve të shoqërisë Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA nga shoqëria Banka Credins SHA.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 5% të aksioneve të shoqërisë Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA nga shoqëria Banka Credins SHA,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e blerjes së 5% të aksioneve të shoqërisë Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA nga shoqëria Banka Credins SHA.

Pala blerëse: Banka Credins SHA, është një shoqëri aksionare e organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, e cila vepron si bankë e nivelit të dytë në përputhje me Licencën e Aktivitetit bankar nr.16, datë 31.03.2003, lëshuar nga Banka e Shqipërisë, me objekt veprimtarie; Veprimtaritë bankare dhe financiare.

Banka zotërohet nga 51 aksionare nga të cilët me më shumë se 5% të kapitalit janë Renis Tershana 24.3 %; Aleksandër Pilo 16.68 % dhe B.F.S.E. Holding B.V., Hollandë 14.48%.

Pala shitëse: Z.Artan Gjergji, individ, i cili zotëron 5% të kapitalit të shoqërisë Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA.

Shoqëria Target: Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA, është një shoqëri e organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me objekt veprimtarie: Kryerja e veprimtarisë së regjistrarit të titujve për të gjithë titujt e lejuar sipas ligjit për titujt dhe në përputhje me licencën e dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Shoqëria do të mbaje regjistrat e titujve, do të organizojë dhe administrojë të dhënat mbi të gjitha llojet e titujve, sipas përcaktimeve dhe kufizimeve të Ligjit për titujt dhe të licencës përkatëse, si dhe do të kryejë emërtimin dhe kodifikimin e titujve sipas praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Shoqëria do të ofrojë shërbimin e regjistrimit të titujve duke bërë të mundur që të sigurohen në çdo kohë të dhëna të plota për pronësinë mbi titujt e regjistruar, si dhe kufizime të drejtave të pronësisë mbi to. Shoqëria do të kryejë të gjitha veprimtaritë e regjistrarit të titujve të parashikuara nga Ligji për Titujt dhe aktet nënligjore në zbatim.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e klerimit dhe shlyerjes së titujve si operator i sistemit të shlyerjes së titujve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Shoqëria zotërohet nga Banka Credins SHA me 47,5% të kapitalit, Banka Amerikane e Investimeve SHA me 47,5% të kapitalit dhe Z.Artan Gjergji me 5% të kapitalit.

Më datë 17 Tetor 2019, midis palës blerëse, Banka Credins SHA, dhe palës shitëse Z.Artan Gjergji është nënshkruar “Kontratë Shitje Aksionesh”, me objekt kalimin e pronësisë, nëpërmjet shitjes së paketës prej 5% të kapitalit tek blerësi. Pas transaksionit, Banka Credins SHA do të zotërojë 52,5% të kapitalit të shoqërisë Regjistri Tregtar i Titujve Alreg SHA dhe Banka Amerikane e Investimeve SHA do të zotërojë 47,5% të kapitalit

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i titujve dhe treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i titujve është një treg i rregulluar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare së bashku me Bankën e Shqipërisë janë dy institucionet rregullatore dhe mbikëqyrëse të sistemit financiar shqiptar.

Titujt janë instrumente financiare, të cilat emetohen dhe tregtohen për sigurimin e fitimit, nëpërmjet administrimit të të drejtave, që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Në termin “tituj” përfshihen pa kufizim aksionet, obligacionet e shoqërive tregtare dhe të pushtetit vendor, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga shteti shqiptar, titujt e emtuar nga Banka e Shqipërisë, dëftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumente të tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që vlerësohen dhe miratohen si të tilla nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Shoqëria blerëse, Banka Credins SHA, është e licencuar nga AMF, në tregun e titujve, si shoqëri këshillimi dhe kujdestare e letrave me vlerë të Qeverisë së RSH dhe i obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore, ndërkohë që Alreg do të operojë vetëm në veprimtarinë e regjistrarit të titujve, për të gjithë titujt e lejuar sipas ligjit për titujt.

Referuar pasqyrave financiare të administruara, konstatohet se shoqëria Alreg SHA nuk ka realizuar të ardhura nga aktiviteti ekonomik në tre vitet e fundit.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje horizontale mes palës blerëse dhe shoqërisë target. Pala blerëse, sikurse dhe subjektet e tjera të licensuar në tregun e titujve, do të përdorin bazën e te dhënave të shoqërive “regjistrarë të titujve”, për të realizuar transaksionet financiare në tregun e titujve. Për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 5% të aksioneve të shoqërisë Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA nga shoqëria Banka Credins SHA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 687, Datë 06.04.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmbH dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.04.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmbH dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmbH dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmbH dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft.

Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, është një shoqëri aksionere, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman. Porsche operon në prodhimin, zhvillimin dhe shitjen kryesisht të makinave sportive dhe automjeteve për qëllime tregtare, si dhe ofron shërbime financiare për automjetet, duke përfshirë marketimin e shërbimeve të konektivitetit, nëpërmjet markës ndihmëse MOIA.

MHP Management është një filial i zotëruar nga Porsche, një shoqëri konsultimi me seli në Ludwigsburg, Gjermani, e specializuar në shërbimet e IT dhe konsulencës në sektorët e automjeteve dhe prodhimit.

Porsche është pjesë e Grupit Volkswagen, i kontrolluar në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Grupit VW.

Gjate vitit 2019, VW Group ka patur në zotërim në Shqipëri 3 filiale: *Porsche Leasing SHPK*, me objekt aktiviteti; veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime; *Porsche Mobility SHPK*, me objekt aktiviteti, çdo

formë e aktivitetit/veprimtarisë së qirasë operationale siç parashikohet nga dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë siç mund të ndryshohet herë pas here dhe çdo veprimtari tjetër në lidhje me të dhe *Porsche Albania SHPK*, me objekt aktiviteti, shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesoreve, etj.

Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft (Munich Re) është një shoqëri risigurimi, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman. Munich Re ka për objekt shërbimet e sigurimit, duke mbuluar të gjithë zinxhirin e vlerës të risigurive, sigurimeve parësore dhe zgjidhjet e riskut të sigurimeve.

Munich Re nuk ka filiale të rregjistruara në Shqipëri dhe as nuk e ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

Joint Venture do të jetë një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit gjerman dhe mendohet që Emri i Shoqërisë të jetë “Flex Factory” me sloganin (jo pjesë përbërëse e emrit): “Digital Factory Performance”, me objekt aktiviteti zhvillimin, tregtimin dhe shpërndarjen e produkteve, konsulencës dhe shërbimeve, në veçanti teknologjia e prodhimit, softueri dhe teknologjia e informacionit, administrimi i rreziqeve, strukturimi financiar dhe orkestrimi i zgjidhjeve, të gjitha në lidhje me modele fleksibël dixhitale të prodhimit, me përjashtim të transaksioneve të shërbimeve bankare dhe financiare, në përputhje me dispozitat e Ligjit Bankar.

Vlerësimi i përqendrimit

Më datë 20 dhjetor 2019 është nënshkruar dokumenti i “Marrëveshjes së Joint Venture (Projekti MPM)”, ndërmjet shoqërive Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmBh nga njëra anë dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft nga ana tjetër, të cilat kanë rënë dakort që të krijojnë një ndërmarrje të përbashkët (joint venture) të krijuar rishtas.

Palët pranojnë të themelojnë një shoqëri me sipërmarrje të përbashkët ku shoqëritë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmBh do të kenë në pronësi 50% të aksioneve dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft do të ketë në pronësi 50% të aksioneve në joint venture.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një shoqërie të përbashkët (joint venture) me funksione të plota duke plotësuar kriteret e nenit 10 të Ligjit 9121/2003 ‘Për mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar. Referuar pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni plotëson edhe kriteret e përcaktuara në 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionin dhe praktikën më të mira të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit është lënë i hapur dhe përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Përqendrimi nuk do të prekë tregun shqiptar pasi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmbH dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 690, Datë 28.04.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë Peugeot SA. dhe shoqërisë Fiat Chrysler Automobiles N.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.04.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë Peugeot SA. dhe shoqërisë Fiat Chrysler Automobiles N.V.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë Peugeot SA. dhe shoqërisë Fiat Chrysler Automobiles N.V.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me bashkimin e shoqërisë Peugeot SA. dhe shoqërisë Fiat Chrysler Automobiles N.V.

Fiat Chrysler Automobile N.V. (FCA) është një shoqëri publike holandeze me përgjegjësi të kufizuar, shoqëria mëmë e grupit të shoqërive FCA.

Grupi FCA është një grup global i angazhuar në dizenjimin, projektimin, prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e mjeteve të transportit të markave Abarth, Alfa Romeo, Chrysler, Dodge, Fiat, Fiat Profesional, Jeep, Lancia dhe Ram, si edhe në dizenjimin e mjeteve të transportit me performancë SRT (Street & Racing Technology).

Grupi i shoqërive FCA nuk ka degë apo filial në Shqipëri. Mjetet e transportit të Grupit FCA shiten në Shqipëri nga një furnitor i pavarur, Auto Master SHA.

Peugeot SA (PSA) është një shoqëri anonime franceze. Peugeot SA është shoqëria zotëruese e shoqërive të grupit PSA, i cili është kryesisht një prodhues origjinal pajisjesh dhe tregtar i mjeteve motorike transporti, makinave të pasagjerëve si dhe të LCV-ve të markave Peugeot, Citroen, Opel, Vauxhall dhe DS. Ajo ofron gjithashtu shërbime të tjera ndihmëse, siç janë zgjidhjet financuese për blerjen e mjeteve motorike të transportit. Gjithashtu, PSA, nën markën Free2Move, është një ofrues i shërbimeve dhe zgjidhjeve lëvizëse.

Grupi PSA nuk ka degë apo filial në Shqipëri, por të ardhurat brenda vendit realizohen nëpërmjet shoqërive AVEL SHPK dhe Auto France–AL SHPK, të cilat janë distributor ekskluzive në Shqipëri për shoqëritë maqedonase Euroimpex, Avtanova dhe Opel Southeast Europe Kft.

Më datë 17 Dhjetor 2019, palët kanë nënshkruar “Marrëveshje e kombinimit nga dhe ndërmjet Fiat Chrysler Automobiles N.V. dhe Peugeot S.A.” Sipas kësaj Marrëveshje, shoqëritë Fiat Chrysler Automobile N.V.(FCA) dhe Peugeot SA. (PSA) dëshirojnë të bëjnë një kombinim strategjik të biznesit të tyre përmes një transaksioni kombinimi që përfshin një bashkim ndërkufitar të PSA në FCA, me kompaninë që rezulton me bashkimin ndërkufitar duke i’u referuar si “DutchCo”(Kombinimi).

Emrat ekzistues të FCA dhe PSA dhe pjesët përbërëse të tyre, si dhe markat përkatëse të FCA dhe PSA nuk do të jenë pjesë përbërëse e emrit të DutchCo. Struktura aksionare do të përfshijë të gjithë aksionarët e shoqërive respektive, konkretisht EXOR NV; BPI France; FFP/ EPT; Dongfeng Motor (Hong Kong) si dhe aksionare të tjerë më të vegjël.

Me kombinimin e markave FCA dhe të PSA, shoqëria e re (DutchCo) do të shërbehet nga një portofol i markave me pozicionim të diferencuar dhe plotësues duke filluar nga markat luksoze dhe premiumet deri tek automjetet e pasagjerëve të zakonshëm, duke përfutur nga një zgjerim në të gjithë botën.

Referuar deklaratës për shtyp të zyrës së Peugeot S.A, pritet që pas mbylljes së marrëveshjes, pjesa e kombinuar e tregut e shoqërive sipas treguesve të prodhimit, do të shkojë në rreth 8.7% duke u renditur në kompaninë e katër më të madhe në botë.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe duke patur në konsideratë disa vendime të Komisionit Europian për raste të ngjashme, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i importit e shitjes së automjeteve të reja dhe pjesëve të këmbimit. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Në Shqipëri kërkesa për automjete mundësohet vetëm nga importi. Importi i makinave të reja ofrohet kryesisht nga distributorët ose shitësit e autorizuar të makinave të cilët përveç shitjes së automjeteve, ofrojnë servisin dhe furnizimin me pjesë këmbimit. Automjetet e përdorura importohen nga individ ose subjekte juridike të licencuara për të kryer këtë aktivitet.

Mbështetur mbi të dhënat e importit të automjeteve dhe pjesëve të këmbimit në vend për vitin 2018 dhe 2019, u vlerësuan strukturat e tregjeve përkatëse të produktit.

Nga të dhënat u konstatua se tregu i importit të automjeteve të reja zë më pak se 4% të tregut të importit të automjeteve, treg i cili zotërohet kryesisht nga ndërmarrjet që gëzojnë ekskluzivitetin e disa prej markave, kryesisht europiane.

Markat më të importuara në **tregun e importit të autoveturave** janë Fiat, Skoda, Volkswagen, Seat, Dacia, Duster etj, të cilat në përgjithësi janë edhe markat më çmimet me konkurruese në treg. Importues të markave të grupeve në marrëveshje (PSA dhe FCA) janë AutoMAster SHA, Auto France AL SHPK; Avel SHPK dhe Noshi SHPK.

Ndërmarrjet, të cilat shesin autoveturat e Grupeve PSA dhe FCA zotërojnë së bashku XX % të tregut të importit të autoveturave të reja, por vetëm XX % të tregut të të gjithë autoveturave në vitet 2018 dhe 2019.

Në tregun e **importit të automjeteve mbi 10 persona**, rezulton të jenë importuar një numër shumë i vogël automjetesh, ku importuesi kryesor është Hyundai Auto Albania. Ndërmarrjet e evidentuara më sipër, shitës të markave të Grupeve, nuk kanë importuar asnjë automjet në këtë treg.

Porsche Albania është importuesi më i madh me markat Volkswagen, Skoda etj në tregun e **importit të automjeteve për transport mallrash**, e ndjekur nga AutoMaster me marken Fiat dhe Iveco. Referuar pjesës së tregut të ndërmarrjeve të cilat importojnë modelet e Grupit PSA dhe FCA, konstatohet se pjesa e kombinuar varion nga XX% në vitin 2018 në XX% në vitin 2019 në këtë treg.

Përsa i përket tregu të shitjes së automjeteve të reja dhe referuar të dhënave të ofruara nga pala njoftuese²⁵, konstatohet se gjatë vitit 2018 në Shqipëri janë shitur XXX automjete për pasagjere (autovetura) nga të cilat markat më të shitura janë Hyundai me XX% e tregut dhe Volkswagen me XX % e tregut.

Markat e makinave të Grupeve PSA dhe FCA zotërojnë respektivisht XX% dhe XX%. Pjesa e kombinuar e tregut për dy grupet pas bashkimit do të shkojë në XX% dhe Delta HHI 146, e cila për karakteristikat e këtij segmenti tregu nuk përbën shqetësim për konkurrencën në treg.

Në tregun e shitjes së automjeteve LCV (furgonë 3.5-6 ton), marka më e shitur është Volkswagen me XX% të tregut dhe Ford me XX% të tregut. Markat e grupit FCA zotërojnë XX% të tregut dhe ato të grupit PSA XX% e tregut. Pjesa e kombinuar e dy grupeve rezulton të jetë XX% dhe Delta HHI 265, duke konsideruar që transaksioni nuk do të ketë ndikim më konkurrencën në treg.

Tregu i importit të pjesëve të këmbimit është një treg konkurrencial në të cilin operojnë një numër i madh konkurrentësh, pa praninë e ndonjë ndërmarrje më fuqi të ndjeshme në treg. Importuesit e automjeteve të reja si dhe ato të cilat gëzojnë ekskluzivitetin e tregtimit të një marke të caktuar janë edhe ndërmarrjet më pjesën më të madhe në këtë treg.

Pjesa e kombinuar e tregut të ndërmarrjeve të cilat shesin markat e automjeteve që do të preken nga transaksioni i synuar ka qenë XX% si për vitin 2018 dhe 2019, pa arritur ndonjë tregues shqetësues për konkurrencën në treg. Përqendrimi nuk do të prekë tregun shqiptar pasi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Pas analizës së strukturave të tregut, arrihet në përfundimin se:

- a) Oferta në tregun shqiptar për automjete sigurohet më së shumti nga importi i automjeteve të përdoruar të cilat mbulojnë mbi 96% të kërkesës vendase;
- b) Shoqëritë palë në marrëveshje nuk kanë degë apo filial të tyre në Shqipëri dhe për këto arsye ndryshimi i strukturës aksionare në shoqërinë DutchCo” nuk do të ndikojë mbi shoqëritë vendase të shitjes së automjeteve; ndërmarrjet vendase të importit të automjeteve të reja janë të pavarura dhe jo detyrimisht të influencuar nga strategjitë e Grupeve pjesëmarrëse në transaksionin e synuar. Transaksioni i vitit 2017, bashkimit me përthithje i OPEL nga PEUGEOT, nuk pati asnjë efekt në tregun shqiptar të shitjes së autoveturave të markës OPEL, pasi shitja e makinës Opel vazhdon të ofrohet në tregun vendas nga ndërmarrja [...] edhe pas transaksionit.

Shitësit e autorizuar të automjeteve të markave të Grupit PSA dhe FCA zënë një pjesë shumë të vogël të tregut të importit të automjeteve, edhe markat e automjeteve të prodhuara nga Grupet në marrëveshje, dhe të shitura në Shqipëri gjatë vitit 2018 kanë zënë një pjesë të vogël në tregun e shitjes ku treguesit e përqendrimit të tregut pas transaksionit (Delta HHI) janë në nivele jo shqetësuese për konkurrencën.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

²⁵ Botimin European Car Distribution Handbook, ICDP, një organizate ndërkombëtare kërkimi dhe strategjish e specializuar.
XVI / 2020

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë Peugeot SA. dhe shoqërisë Fiat Chrysler Automobiles N.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 691, Datë 06.05.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Unione di Banche Italiane S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.05.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Unione di Banche Italiane S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Unione di Banche Italiane S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Unione di Banche Italiane S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

Pala blerëse: Intesa Sanpaolo S.p.A është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionin Italian dhe e regjistruar në regjistrin e shoqërive të Torinos. Intesa Sanpaolo S.p.A është shoqëria mëmë e Intesa Sanpaolo Group ("ISP Group"), një nga grupet më të mëdhenj bankare italiane.

Në Shqipëri, shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: veprimtari bankare, veprimtari financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit, pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë; veprimtari të lidhura me transaksionet e titujve, vetëm pasi të jetë licencuar nga AMF dhe veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe ri sigurime në përputhje me Ligjin Nr.52/2014.

Shoqëri Target: Unione di Banche Italiane S.p.A., është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit italian, me objekt veprimtarie: Depozitimin e kursimeve dhe ushtrimin e kredisë në format e ndryshme të saj, direkt dhe përmes filialeve, etj.

Unione di Banche Italiane S.p.A ka siguruar mbulimin e tregut italian nëpërmjet rrjetit të shtatë bankave: Banca Popolare di Bergamo, Banco di Brescia, Banca Regionale Europea, Banca Commercio e Industria, Banca di Valle Camonica, Banca Popolare di Ancona, Banca Carime. Riorganizimi i UBI Banca, ka kaluar në disa projekte të cilat kishin si qëllim bashkimin gradual të bankave pjesë e Unionit.

Unione di Banche Italiane S.p.A. dhe filialet e saj nuk janë aktiv dhe nuk gjenerojnë të ardhura në Shqipëri

Vlerësimi i përqendrimit

Më datë 17 Shkurt 2020, është lëshuar “Ofertë Shkëmbimi Vullnetare”, nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A, për të gjitha aksionet e zakonshme të Unione di Banche Italiane S.p.A

Për secilin nga aksionet e Unione di Banche Italiane S.p.A të tenderuara në ofertë, Intesa Sanpaolo S.p.A do të ofrojë një shpërblim, i cili nuk do të nënshtrohet ndonjë ndryshimi, të barabartë me 1.7000 aksione të lëshuara rishtazi nga Intesa Sanpaolo S.p.A. Për sa më sipër, për çdo 10 (dhjetë) aksione të Unione di Banche Italiane S.p.A, të tenderuara në ofertë, do të paguhen 17 (shtatëmbëdhjetë) aksione të lëshuara rishtazi të Intesa Sanpaolo S.p.A.

Intesa Sanpaolo S.p.A ka ofruar rreth XXX bilion Euro për mbylljen e ofertës dhe pas transaksionit ajo do të renditet si banka e shtatë më e madhe në gjithë Eurozonën në terma të kapitalit. Marrëveshja do të përfundojë pasi transaksioni të ketë marrë miratimin nga institucionet mbikëqyrëse nacionale si dhe nga Banka Europiane.

Shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A, nëpërmjet ofertës së shkëmbimit publik vullnetar, ka për qëllim që të konsolidojë më tej rolin të tij drejtues në sektorin bankar italian, në të cilin operon me sukses në të gjithë segmentet e tregut.

Ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit mbi shoqërinë Unione di Banche Italiane S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A është përfundim kontrolli dhe ky transaksion plotëson kriteret e nenit 10 dhe 12 të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhin në zbatim të nenit 53, pika 1, germa b) të ligjit palët në këtë transaksion kanë detyrimin për njoftim dhe transaksioni kërkon autorizim nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” treg përkatës i produktit është konsideruar tregu i shërbimeve bankar dhe tregu përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Në sistemi bankar aktualisht ushtrojnë veprimtarinë 12 banka të nivelit të dytë. Gjatë 2 viteve të fundit sistemi është prekur nga mbyllja/risstrukturimi i 4 bankave. Pjesa më e madhe e sektorit bankar kontrollon nga filialet e grupeve të huaja bankare me origjinë të kapitalit nga Bashkimi Evropian që ushtrojnë veprimtarinë e tyre bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2017, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 474 datë 14.09.2017 “Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjes Veneto Banca S.p.A nga Intesa Sanpaolo S.p.A”, miratoi transaksionin e blerjes nga Intesa Sanpaolo S.p.A. të disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të Banca Popolare di Vicenza S.p.A. (BPVI), në likuidim administrativ të detyrueshëm, dhe Veneto Banca S.p.A., në likuidim administrativ të detyrueshëm.

Ky transaksion ndikoi tregun shqiptar, pasi Veneto Banca S.p.A zotëronte në mënyrë të drejtpërdrejtë në Shqipëri Veneto Banka SHA. Pas transaksionit Veneto Banka SHA u përthith nga Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, transaksion i cili ndikoi në një rritje të moderuar të vlerës së portofolit të depozitave dhe kredive të Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Referuar të dhënave ekonomike të sistemit bankar, në terma të kapitalit, vlerës së portofolit të depozitave dhe kredive, struktura e tregut bankat ka karakteristikat e një tregu mesatarisht të përqendruar gjatë periudhës 2018- shtator 2019, ku Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA zotëron XX% të totalit të aktiveve, XX% të portofolit të depozitave dhe XX % të portofolit të kredisë.

Shoqëria Target, Unione di Banche Italiane S.p.A. dhe filialet e saj nuk janë aktive në Shqipëri. Vetëm grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA dhe transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në strukturën e tregut bankat në Shqipëri dhe

në pjesën e tregut që zotëron Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, pasi pjesa e kombinuar e tregut pas transaksionit nuk do të ndryshojë.

Transaksioni nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie horizontale midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Unione di Banche Italiane S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 692, Datë 06.05.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërive Air Liquide CZ, s.r.o dhe Air Liquide Slovakia, s.r.o nga shoqëritë Messer Technogas s.r.o dhe Messer Tatragas, spol.s.r.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.05.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërive Air Liquide CZ, s.r.o dhe Air Liquide Slovakia, s.r.o nga shoqëritë Messer Technogas s.r.o dhe Messer Tatragas, spol.s.r.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kapitalit të Air Liquide CZ, s.r.o dhe Air Liquide Slovakia, s.r.o nga shoqëria Messer Technogas s.r.o dhe shoqëria Messer Tatragas, spol.s.r.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfimin e kontrollit të shoqërive Air Liquide CZ, s.r.o dhe Air Liquide Slovakia, s.r.o nga shoqëritë Messer Technogas s.r.o dhe Messer Tatragas, spol.s.r.

Blerësi 1: Messer Technogas s.r.o, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjin e Republikës së Çekisë, me objekt aktiviteti; shpërndarja e karburanteve, aktivitet e projektimit në ndërtim, prodhimi i kimikateve të rrezikshëm dhe përzierjeve kimike të rrezikshme, shitja e kimikateve dhe përzierjeve kimike, të klasifikuara si shumë toksike dhe toksike, instalimi, riparimi, inspektimi dhe testimi i pajisjeve të gazit dhe mbushja e kontejnerëve me gaz, etj.

Blerësi 2: Messer Tatragas, spol.s.r.o, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjin e Republikës së Sllovakisë, me objekt aktiviteti; aktivitet reklamues, marketing, aktivitet tregtar dhe ndërmjetësimit me mallra në fushën e tregtisë së lirë, instalim, riparim dhe mirëmbajtja e pajisjeve dedikuar gazit, aktiviteti i leasing-ut, transporti i mallrave, analiza e gazeve teknike, mjekësore dhe speciale, shitje e helmeve veçanërisht të rrezikshme, mbajtja e kontabilitetit, punë administrative, etj.

Messer Group GmbH, është një shoqëri gjermane, shoqëria mëmë e Messer Technogas s.r.o dhe Messer Tatragas, spol.s.r.o.

Messer Group është e pranishme në Shqipëri përmes shoqërisë së kontrolluar Messer Albagaz SHPK, me aktivitet të saj; Prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e gazrave industrial, mjekësor dhe speciale si dhe të pajisjeve që lidhen me to. Ofrimin e shërbimeve të inxhinierisë (Engineering) si dhe tregtimin e materialeve dhe ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me pajisjet e prerjes dhe saldimit dhe me teknologjinë e veshjes apo shkrirjes, si edhe kryerjen e transportit të mallrave për nevojat e veta dhe të të tretëve në Shqipëri dhe jashtë saj.

Shitësi: Air Liquide Eastern Europe S.A është një shoqëri anonime e krijuar sipas legjislacionit francez, me objekt veprimtarie; studimi, prodhimi, shfrytëzimi, blerja e të gjitha kimikateve të gazrave industrial, gazrat medicinale, produkte të kogjenerimit, shfrytëzimi i të gjitha proceseve teknike.

Target 1: Air Liquide CZ, s.r.o, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjin e Republikës së Çekisë, me objekt veprimtarie; prodhimi i kimikateve të rrezikshëm dhe përzierjeve kimike të rrezikshme, shitja e kimikateve dhe përzierjeve kimike, të klasifikuara si shumë toksike dhe toksike, instalimi, riparimi, inspektimi dhe testimi i pajisjeve të gazit dhe mbushja e kontejnerëve me gaz, etj.

Target 2: Air Liquide Slovakia, s.r.o është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjin e Republikës së Sllovakisë. Objekti i veprimtarisë është; blerja dhe shitja e aparateve dhe pajisjeve të gazit industrial, blerja e mallrave për rishitje në fushën e tregtisë së lirë, prodhimi kimikateve bazë, prodhimi i gazrave industriale-gazrat teknikë/ përveç prodhimit të gazrave të ngrohjes, riparime, inspektime, dhe ekzaminime të pajisjeve të dedikuara gazrave teknikë dhe presionit teknik, etj.

Shoqëria Air Liquide Eastern Europe S.A, apo shoqëritë e kontrolluara prej saj nuk zotërojnë degë apo filial në Shqipëri dhe nuk realizojnë të ardhura në vend.

Më datë 06 Janar 2020, palët Messer Tatragas, spol.s.r.o dhe Messer Technogas s.r.o, kanë nënshkruar një premtim blerje për blerjen e 100% të kapitalit të regjistruar të Air Liquide CZ, s.r.o dhe Air Liquide Slovakia, s.r.o. Palët kanë rënë dakord që oferta të adresohet dhe mund të ekzekutohet nga Air Liquide Eastern Europe S.A.

Air Liquide Eastern Europe S.A, mund të ekzekutojë premtimin e blerjes menjëherë pasi të ketë përfunduar konsultimet e Këshillit për Punët e Detyrueshme. Këshilli i Punëve nuk ka të drejtë të ndalojë transaksionin dhe, pavarësisht mendimit të tij, palët janë në gjendje të kryejnë transaksionin.

Pas ekzekutimit të “Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve 2020”, Messer Tatragas, spol.s.r.o (Sllovakia) do të marrë 100% të kapitalit të regjistruar të Air Liquide Slovakia, s.r.o dhe Messer Technogas s.r.o (Republika Çeke) do të marrë 100% të kapitalit të regjistruar të Air Liquide CZ, s.r.o.

Biznesi i Air Liquide përputhet mirë në portofolin dhe veprimtarinë e Messer Group dhe nëpërmjet këtij transaksioni synohet zgjerimi i rrjetit të prodhimit, shitjes dhe shpërndarjes së gazeve të industrial në shtetet në të cilat do të ekzekutohet marrëveshja. Shoqëritë Air Liquide në Republikën Çeke dhe në Sllovakia do të zgjerojnë dhe të plotësojnë biznesin ekzistues të Messer në të dy vendet.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i gazeve industriale dhe tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar do të prekë tregun shqiptar vetëm nëpërmjet shoqërisë Messer Albgaz SHPK, shoqëri e kontrolluar indirekt nga Messer Group GmbH, e cila zotëron rreth XX% të tregut të importit të gazeve industriale.

Referuar të dhënave të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, konstatohet se tregu i importit të gazeve industriale është një treg shumë i përqendruar ku indeksi i përqendrimit HHI paraqitet në vlerën XXX, e ndikuar kjo nga pjesa e konsiderueshme e tregut e shoqërive Gazra Teknike Shqiptare me XX% e tregut dhe Messer Albgaz SHPK.

Pavarësisht strukturës së përqendruar të tregut, transaksioni i propozuar nuk do të ndikojë strukturën e tregut në Shqipëri pasi shoqëritë target nuk kanë degë apo filial në Shqipëri dhe nuk realizojnë të ardhura në vend.

Pjesa e tregut e shoqërisë Messer Albgaz SHPK do të mbetet e pandryshuar edhe pas përqendrimit, pasi ky transaksion nuk do të krijojë mbivendosje horizontale apo të rrjedhës së sipërme e të poshtme në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kapitalit të Air Liquide CZ, s.r.o dhe Air Liquide Slovakia, s.r.o nga shoqëria Messer Technogas s.r.o dhe shoqëria Messer Tatragas, spol.s.r.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 695, Datë 15.05.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota Joint-Venture nga shoqëritë Saudi Aramco Development Company dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.05.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota Joint-Venture nga shoqëritë Saudi Aramco Development Company (SADCO) dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes).

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota Joint-Venture nga shoqëritë Saudi Aramco Development Company (SADCO) dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes),

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota Joint-Venture nga shoqëritë Saudi Aramco Development Company (SADCO) dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes).

Saudi Aramco Development Company (SADCO) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në pronësi të plotë të Mbretërisë së Arabisë Saudite. SADCO është një filial i zotëruar plotësisht nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company “Saudi Aramco”, e cila merret kryesisht me prodhimin dhe tregtimin e naftës, gazit, shërbimeve dhe fushave prodhuese. Në një masë pak më të kufizuar ajo merret gjithashtu edhe me prodhimin dhe tregtimin e produkteve të rafinuara dhe petrokimike.

Baker Hughes Company është një shoqëri aksionare e themeluar në vitin 2016, e ndryshuar më datë 03.07.2017 pasi u bashkua me Ge Oil & Gas për tu bërë Baker Hughes, një shoqëri GE (General Electric Company). Ge Oil & Gas zotëron 38.4 % të aksioneve në Baker Hughes Company. Baker Hughes Company është shoqëria mëmë e grupit të shoqërive Baker Hughes, e cila është një ofruese shërbimesh dhe produktesh të integruara të fushave naftëmbajtëse. Gjithashtu ajo merret me zgjidhjet dixhitale që rrisin produktivitetin, minimizojnë riskun dhe ulin kostot. Kompania siguron industrinë e naftës dhe gazit me produkte dhe shërbime për shpimin e naftës, vlerësimin e formimit, përfundimin, prodhimin dhe konsultimin e rezervuarit.

Grupi Baker Hughes ka një degë të regjistruar në Shqipëri, përkatësisht Western Atlas International LLC. Fusha e veprimtarisë së Western Atlas International LLC në Shqipëri është eksplorim, nxjerrje, zhvillim, prodhim, transportim dhe marketim hidrokarburesh dhe nënprodukte të tyre.

Joint Venture do të jetë një shoqëri e përbashkët mbi produktet jo-metalike, e krijuar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, e cila do të operojë në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Kjo shoqëri do të ndërtojë dhe operojë objekte prodhuese të prodhimeve jo-metalike/kompozite për përdorim në aplikimet për naftë dhe gaz dhe industrinë e tjera. Produktet që do të operojë dhe shesë kjo shoqëri do të jenë tubacione termoplastike të përforcuar dhe linja rrjedhëse për përdorimet në naftë dhe gaz. Gjithashtu kjo shoqëri do të marrë në konsideratë investime të reja, fusha të blerjes, investime kapitale dhe investime për hulumtime dhe zhvillim në mundësinë e biznesit në lidhje me aplikimet jo-metalike brenda dhe jashtë sektorit të naftës dhe gazit.

Vlerësimi i përqendrimit

Më datë 20 Shkurt 2020 është nënshkruar “Marrëveshja e Aksionarëve” ndërmjet shoqërive Saudi Aramco Development Company (SADCO) nga njëra anë dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes) nga ana tjetër, të cilat kanë rënë dakord që të krijojnë një ndërmarrje të përbashkët joint-venture me funksione të plota.

Shoqëria e përbashkët J-V do të zotërohet 50% nga shoqëria Saudi Aramco Development Company dhe 50% nga shoqëria Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes).

Palët synojnë që së bashku të krijojnë dhe operojnë një shoqëri e cila do të vijojë hulumtimin dhe zhvillimin në aplikacione jo-metalike të naftës dhe gazit. Gjithashtu do të sigurohet një mbështetje dhe zhvillim dhe aftësi inxhinierie në lidhje me produktet për përdorim në aplikimet në naftë dhe gazit.

Transaksioni i propozuar konsiston në përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një shoqërie të përbashkët joint-venture me funksione të plota nga Saudi Aramco Development Company (SADCO) dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes) duke plotësuar kriteret e nenit 10 të Ligjit 9121/2003 ‘Për mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar pasqyrave financiare palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” treg përkatës do të konsiderohet tregu i eksplorimit, prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe tregtimit të produkteve të rafinuara dhe petrokimike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët Joint-Venture nga shoqëria Saudi Aramco Development Company dhe shoqëria Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes).

Shoqëria J-V do të krijohet në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe nuk do të jetë aktive në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota Joint-Venture nga shoqëritë Saudi Aramco Development Company (SADCO) dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes).
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 705, Datë 10.09.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Euroconsult Rental Division S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.09.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Euroconsult Rental Division S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Euroconsult Rental Division S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfimin e kontrollit të shoqërisë Euroconsult Rental Division S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

Pala blerëse: Intesa Sanpaolo S.p.A, (ISP) është një shoqëri aksionare e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit Italian, e cila ka objekt kryesor ofrimin e transaksioneve bankare, investimeve bankare, financë të strukturuar, tregje kapitali etj. Përsa i përket transaksioneve bankare ISP u ofron klientëve referencë për një gamë të gjerë shërbimesh transaksionale, të tilla si menaxhimi i parave të gatshme, tregtia dhe financat e eksportit, shërbimet e letrave me vlerë përmes Inbiz, platformës së Korporatave Bankare në internet.

Intesa Sanpaolo S.p.A (ISP) është shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo Group (ISP), e cila është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.A (ISP Albania).

Intesa Sanpaolo Bank Albania, SHA, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit Shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari bankare, veprimtari financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit, pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë, veprimtari të lidhura me transaksionet e titujve, vetëm pasi të jetë licencuar nga AMF dhe veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime në përputhje me Ligjin Nr.52/2014.

Pala shitëse:

Euroconsult 2001 Srl (EC 2001) është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Italian.

Locatec Sas di Francesco Miscioscia & C (Locatec) është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Italian.

Shoqëri Target: Euroconsult Rental Division S.p.A (ERD) është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit italian, me objektet veprimtarie: blerjen, shitjen, komercializimin, marrjen e mandateve dhe përfaqësive dhe dhënien me qira të mallrave dhe pajisjeve (me përjashtim të automjeteve), për individë privatë, ndërmarrje, shoqëri, institucione krediti etj. Gjithashtu ajo mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale dhe financiare, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të nevojshme për qëllimin e shoqërisë. Në veçanti, ERD jep me qira më së shumti mallra të standardizuara, për shuma të kufizuara deri në 100,000 Euro.

ERD është aktive vetëm në Itali dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Vlerësimi i përqendrimit

Më datë 05 Gusht 2020, midis blerësit Intesa Sanpaolo S.p.A dhe palës shitëse Euroconsult 2001 Srl dhe Locatec Sas di Francesco Miscioscia & C është propozuar dhe nënshkruar “Marrëveshja Kuadër”, për blerjen e shoqërisë target Euroconsult Rental Division S.p.A.

Me nënshkrimin e marrëveshjes së 05 gushtit 2020, shitësit shesin dhe i transferojn blerësit, i cili blen 283,500 aksione në zotërim të plotë të EC 2001, që përfaqësojnë 45% të kapitalit të shoqërisë dhe 94,500 aksione në zotërim të plotë të Locatec, që përfaqësojnë 15% të kapitalit të shoqërisë.

Pas përfundimit të transaksionit, Intesa Sanpaolo S.p.A do të zotërojë 60% të kapitalit të Euroconsult Rental Division S.p.A , EC 2001 do të zotërojë 30% dhe Locatec do të zotërojë 10% të kapitalit.

Kontrolli i qëndrueshëm mbi shoqërinë Euroconsult Rental Division S.p.A, është përfitim kontrolli nga pala blerëse Intesa Sanpaolo S.p.A dhe ky transaksion plotëson kriteret e nenit 10, pika 1 germa b të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Mbështetur në pasqyrat financiare të palëve në marrëveshje, konstatohet se transaksioni plotëson edhe kriteret e përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” treg përkatës u konsiderua tregu i qiradhënies së mallrave dhe pajisjeve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Përqendrimi i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të shoqërisë Euroconsult Rental Division S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 713, Datë 15.10.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.

Pala Blerëse: Euroimpex d.o.o., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut. Euroimpex d.o.o. është shpërndarës i markës Peugeot kryesisht në territorin e Maqedonisë së Veriut dhe realizon të ardhura edhe në Shqipëri e Kosovë.

Pala Shitëse: Opel Southeast Europe LLC, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë. Shitësi vepron si importues dhe shpërndarës i automjeteve Opel si dhe pjesëve të këmbimit, pajisjeve shtesë dhe aksesorëve për markat Opel dhe Chevrolet, në territorin e Evropës Juglindore. Shoqëria realizon të ardhura në Shqipëri.

Target: Opel Automotive S d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Serbisë. Targeti është një ndërmarrje me qëllime të veçanta e themeluar dhe e zotëruar nga Opel Southeast Europe LLC, në vitin 2020 për qëllime të këtij transaksioni. Aktiviteti kryesor i Opel Automotive S d.o.o. do të jetë tregtimi i automjeteve dhe mjeteve motorike të lehta, shitje me pakicë e pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve për mjete motorike etj. Targeti nuk ka filiale ose degë në Shqipëri.

Më datë 04 Shtator 2020, midis palës blerëse Euroimpex d.o.o. dhe palës shitëse Opel Southeast Europe LLC është nënshkruar “Marrëveshja e blerjes së aksioneve”.

Sipas kësaj marrëveshjeje, shitësi Opel Southeast Europe LLC zotëron të gjitha aksionet e targetit Opel Automotive S d.o.o. Shoqëria target nuk kryen asnjë aktivitet tregtar por shitësi do të transferojë tek target Biznesin e Synuar para mbylljes së transaksionit.

Biznesi i Synuar konsiston në importimin dhe shpërndarjen e makinave të markës Opel (Opel dhe Chevrolet) pjesëve të këmbimit, pajisjeve dhe aksesoreve dhe shërbime të tjera të ngjashme, të transferuara nga Shitësi tek Targeti.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksioni i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i importit dhe shpërndarjes së makinave dhe pjesëve të këmbimit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.

Opel Automotiv S d.o.o. do të operojë në tregun e importit dhe shpërndarjes së makinave dhe pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve të markës Opel (Opel dhe Chevrolet)

Euroimpex d.o.o. operon në tregun e importit dhe shpërndarjes së makinave dhe pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve të markës Peugeot.

Mjetet e transportit dhe pjesët e këmbimit Peugeot të cilat importohen në Shqipëri nga Euroimpex me bazë në Maqedoninë e Veriut dhe mjetet e transportit dhe pjesët e këmbimit Opel të cilat importohen në Shqipëri nga Opel Southeast Europe LLC, me bazë në Hungari me zyre përfaqësimi në Serbi, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë pjesë e Grupit PSA, sot Stellantis.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dh për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 721, Datë 12.11.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “ Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfimin e kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG.

Palët kanë nënshkruar Kontratën e blerjes së degës së biznesit të sistemit softuerik të kamerës më datë 28 shtator 2020.

Pala Blerëse: Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Gjerman. Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG është pjesë e Grupit Volkswagen i cili drejtohet nga ndërmarrja mëmë fundore e grupit Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG).

Volkswagen AG është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit Gjerman.

Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë.

Pala Shitëse: Hella Aglaia Mobile Vision GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit Gjerman, dhe me objekt aktiviteti: zhvillimi dhe shitja e zgjidhjeve dhe komponentëve të sistemit të orientuar drejt aplikimit për përpunimin dixhital të imazhit dhe komunikimin e imazhit.

Hella Aglaia Mobile Vision GmbH do të shesë biznesin e sistemit softuerik të kamerës përfshirë testimin dhe vlerësimin (DAS/TSO).

Garantues i Shitësit: Hella GmbH & Co. KGaA është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Gjerman.

Target: Dega e biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës përfshirë testimin dhe vlerësimin.

Më datë 28 shtator 2020, nga pala blerëse Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG, pala shitëse Hella Aglaia Mobile Vision GmbH dhe garantuesi i shitësit Hella GmbH & Co. KGaA është nënshkruar kontrata e blerjes së degës së biznesit të sistemit softuerik të kamerës (duke përfshirë testimin dhe vlerësimin).

Shitësi me anë të kësaj kontrate i shet blerësit, i cili pranon këtë shitje, degën e biznesit DAS/TSO me efekt ekonomik në datën e ekzekutimit.

Dega e shitur DAS/TSO përfshin: (i) asetet, kontratat dhe marrëdhëniet e tjera juridike të shitësit të caktuar për të në përputhje me nenet 2 dhe 3; (ii) punonjësit që janë caktuar në divizionin e DAS/TSO sipas prashikimeve të kësaj kontrate.

Referuar Kontratës së Blerjes do të shiten: asetet materiale, asetet jo materiale, të drejtat e softuerit dhe know-how, kontratat, detyrimet dhe dokumentacioni.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i sistemit softuerik të kamerës përfshirë testimin dhe vlerësimin, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundim i kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG. Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG nuk operon në Shqipëri. Target nuk operon në Shqipëri

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 722, Datë 12.11.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Solar Century Holdings Limited nga shoqëria Statkraft European Wind And Solar Holding AS.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Solar Century Holdings Limited nga shoqëria Statkraft European Wind And Solar Holding AS.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “ Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Solar Century Holdings Limited nga shoqëria Statkraft European Wind And Solar Holding AS.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Solar Century Holdings Limited nga shoqëria Statkraft European Wind And Solar Holding AS.

Sipas Marrëveshjes në lidhje me shitjen dhe blerjen e Solar Century Holdings Limited (SPA kryesore) dhe Marrëveshjeve në lidhje me shitjen dhe blerjen e Solar Century Holdings Limited (SPA-të e pakicës) firmosur më datë 1 Nëntor 2020, palët janë:

Pala Blerëse: Statkraft European Wind and Solar Holding AS, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të shtetit të Norvegjisë. Ajo vepron si shoqëri holding në Europë për biznesin e Statkraft në sektorin e prodhimit të energjisë nga era dhe dielli. Shoqëria Statkraft European Wind and Solar Holding AS zotërohet tërësisht nga shoqëria Statkraft AS. Statkraft AS është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë, aktive në gjenerimin dhe tregtimin e energjisë së rinovueshme.

Në Shqipëri Statkraft AS zotëron, në mënyrë indirekte, 100% shoqërinë koncesionare Devolli Hydropower.

Target: Solar Century Holdings Limited është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë. Shoqëria Solar Century Holdings Limited është zhvillues i projekteve të energjisë diellore në Evropë dhe Amerikën e Jugut (dhe më parë dhe në Afrikë) duke zhvilluar, ndërtuar dhe operuar sisteme fotovoltaike për bizneset dhe fermat diellore. Targeti nuk ka xhiro dhe nuk ka gjeneruar asnjë të ardhur në Shqipëri.

Pala Shitëse:

Shitësit institucional dhe disa shitës individë janë aksionar të shoqërisë target Solar Century Holdings Limited, ku secili shitës zotëron një numër të caktuar aksionesh. Këta shitës janë 17 nga të cilët 8 janë shoqëri dhe 9 janë individë. Bashkërisht ata do të shesin 81.59% të kapitalit të shoqërisë target ose 82.46% të kontrollit të shoqërisë (në varësi të votës që zotëron aksioni përkatës).

Shitësit Individë janë aksionar të shoqërisë target Solar Century Holdings Limited ku secili shitës zotëron një numër të caktuar aksionesh. Shitësit Individual janë 26 individë. Bashkërisht ata do të shesin 6.1% të kapitalit të shoqërisë target ose 4.63% të kontrollit të shoqërisë (në varësi të votës që zotëron aksioni përkatës).

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i zhvillimit, ndërtimit dhe operimit të sistemeve fotovoltaike diellore, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Solar Century Holdings Limited nga shoqëria Statkraft European Wind and Solar Holding AS.

Statkraft European Wind and Solar Holding AS zotërohet nga Statkraft AS. Statkraft AS zotëron në mënyrë indirekte, 100% të aksioneve të shoqërisë koncesionare Devolli Hydropower.

Solar Century Holdings Limited operon në tregun e zhvillimit, instalimit dhe operimit të sistemeve fotovoltaike diellore për bizneset dhe fermat diellore, nuk realizon xhiro dhe nuk ka degë apo aktivitet në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dh për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Solar Century Holdings Limited nga shoqëria Statkraft European Wind And Solar Holding AS.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 724, Datë 19.11.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Hans Müller HMP Medizintechnik GmbH dhe shoqërisë Hans Müller medizinische und technische Gase GmbH nga shoqëria Messer Medical Home Care Holding GmbH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Hans Müller HMP Medizintechnik GmbH dhe shoqërisë Hans Müller medizinische und technische Gase GmbH nga shoqëria Messer Medical Home Care Holding GmbH.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “ Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Hans Müller HMP Medizintechnik GmbH dhe shoqërisë Hans Müller medizinische und technische Gase GmbH nga shoqëria Messer Medical Home Care Holding GmbH,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Hans Müller HMP Medizintechnik GmbH dhe shoqërisë Hans Müller medizinische und technische Gase GmbH nga shoqëria Messer Medical Home Care Holding GmbH.

Sipas Marrëveshjes së Shitjes dhe Transferimit të Aksioneve, të nënshkruar më datë 29 shtator 2020, palët janë:

Blerësi : Messer Medical Home Care Holding GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Taunus, Gjermani dhe me numër regjistrimi HRB 6810. Objekti i shoqërisë është administrimi i pasurive të veta, blerja, mbajtja dhe administrimi i investimeve, në veçanti mbajtja dhe administrimi i shoqërive në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shitjes së gazrave të të gjitha llojeve, produkteve mjekësore, pajisjeve laboratorike si dhe shërbimet e lidhura me to, etj. Kjo shoqëri është pjesë e Messer Group GmbH.

Messer Group GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Frankfurt, Gjermani dhe me numër regjistrimi HRB 73307. Objekti i shoqërisë është zhvillimi, prodhimi dhe shitja e gazrave të çdo lloji, gazrave mjekësore dhe pajisjeve laboratorike etj.

Messer Group është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar prej tij Messer Albagaz SHPK.

Messer Albagaz SHPK, një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit shqiptar, me NUIS K78317002F. Objekti i aktivitetit të saj është prodhimi, shpërndarja dhe shitja e gazrave industrial, mjekësor dhe speciale si dhe të pajisjeve që lidhen me to, etj.

Garantuesi: MIG Holding GmbH me seli në Taunus, Gjermani dhe me numër regjistrimi HRB 6413, ka si objekt të veprimtarisë mbajtjen, menaxhimin dhe blerjen e aksioneve në shoqëri që janë veçanërisht aktive në fushat e zhvillimit, prodhimit dhe tregtimit të makinerive, aparateve, pajisjeve dhe materialeve shtesë për teknologji saldimit dhe prerje, pajisje mjekësore dhe pajisje laboratorike si dhe shërbimet përkatëse të ndërlidhura me to. Objekti i shoqërisë përfshin në veçanti financimin e shoqërive në të cilat ka pjesëmarrje.

Shitësi: Hans Müller, i lindur më 21 Mars 1962 dhe banues në Nurnberg, Gjermani

Target 1: Hans Müller HMP Medizintechnik GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër regjistrimi HRB 25169 dhe me seli në Nurenberg. Kjo shoqëri zotërohet nga Z. Hans Müller. Objekti i shoqërisë është shitja e pajisjeve mjekësore me fokus në pneumologji, terapi intensive dhe për kujdesin në shtëpi.

Target 2: Hans Müller medizinische und technische Gase GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër regjistrimi HRB 27165 dhe me seli në Nurenberg. Kjo shoqëri zotërohet nga Z. Hans Müller. Objekti i shoqërisë është shitja e gazeve mjekësore dhe teknike.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i produkteve dhe shërbimeve për trajtimin e pacientëve në shtëpi ku përfshihen ventilatorët dhe pajisjet e oksigjenit, inhalatorët dhe pajisjet thithëse, pajisjet e terapisë dhe diagnostikimit si edhe gazet e duhur për përdorimin e pajisjeve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë Hans Muller HMP Medizintechnik GmbH dhe shoqërisë Hans Muller medizinische und technische Gase GmbH nga shoqëria Messer Medical Home Care Holding GmbH.

Messer Medical Home Care Holding GmbH është pjesë e Messer Group GmbH. Messer Grup është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar prej tij Messer Albagaz SHPK.

Target 1 dhe Target 2, shoqëritë Hans Muller HMP Medizintechnik GmbH dhe Hans Muller medizinische und technische Gase GmbH nuk realizojnë xhiro dhe nuk kanë degë në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dh për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Hans Muller HMP Medizintechnik GmbH dhe shoqërisë Hans Muller medizinische und technische Gase GmbH nga shoqëria Messer Medical Home Care Holding GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 750, Datë 26.11.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Reyl & Cie SA nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Reyl & Cie SA nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “ Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Reyl & Cie SA nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Reyl & Cie SA nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.

Sipas Marrëveshjes Kuadër dhe Marrëveshjes së Aksionarëve, palët janë:

Pala Blerëse: Fideuram - Intesa Sanpaolo Private Banking S.P.A është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të shtetit italian. Objekti i shoqërisë është ofrimi i shërbimeve këshilluese financiare për të përmbushur nevojat financiare të klientëve të saj.

Fideuram zotërohet plotësisht nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A. Intesa Sanpaolo S.p.A është shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo, një prej grupeve bankare kryesore italiane.

Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.A.

Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.A, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i shoqërisë është ofrimi i veprimtarive bankare, veprimtarive financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit.

Fideuram zotëron 96.91% të kapitalit aksionar të Intesa Sanpaolo Private Bank (Suisse) Morval SA, aksione të cilat pas transaksionit do t'i transferohen targetit.

Target: Reyl & Cie SA është një shoqëri anonime e themeluar sipas legjislacionit të shtetit të Zvicrës. Reyl & Cie SA operon si një institucion bankar. Objekti i shoqërisë është ofrimi i shërbimeve në menaxhimin e pasurisë, menaxhimin e asetëve dhe shërbimet private të zyrës.

Pala Shitëse:

Shitësi 1: Reyl & Cie Holding SA është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Zvicrës. Objekti i shoqërisë është ofrimi i shërbimeve këshilluese financiare dhe zgjidhje efektive për klientët e saj individë dhe institucional. Shoqëria zotërohet nga Z. François Reyl me 47% të kapitalit aksionar, Z. Charles Reyl me 11.50 % të kapitalit aksionar dhe Znj. Olivia Reyl me 11.50% të kapitalit aksionar. Z. François Reyl është partner shitës në Marrëveshjen e Aksionarëve.

Shitësi 2: RB Participations SA është një shoqëri aksionar e e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Zvicrës. Objekti i shoqërisë është ofrimi i shërbimeve këshilluese financiare dhe zgjidhjet efektive për klientët e saj individë dhe institucional. Shoqëria zotërohet nga Z. Pasha Bakhtiar me 18.33% të kapitalit aksionar, Z. Nicholas Duchene me 18.33% të kapitalit aksionar, Z. Christian Fringhian me 18.33% të kapitalit aksionar dhe Z. Lorenzo Rocco di Torrepadula me 18.33% të kapitalit aksionar, të cilët janë partnerë shitës në Marrëveshjen e Aksionarëve.

Shitësi 3: Z. Thomas Fontaine është person fizik, shtetas i huaj, i regjistruar në shtetin zvicerian dhe aksionar i shoqërisë Reyl & Cie SA ku zotëron 2% të kapitalit. Z. Thomas Fontaine është partner shitës në Marrëveshjen e Aksionarëve.

Analiza e konkurrencës

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë Reyl & Cie SA nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.

Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A është pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.A.

Reyl & Cie SA është shoqëria mëmë e Grupit Reyl. Grupi Reyl nuk është prezent në tregun shqiptar dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë efekt në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Reyl & Cie SA nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 755, Datë 09.12.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK nga Kastrati Group SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.12.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK nga Kastrati Group SHA.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2013 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 16, Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve”, nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK nga Kastrati Group SHA”,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 405 prot., datë 09.11.2020 nga përfaqësuesi i shoqërisë Kastrati Group SHA, është bërë njoftimi paraprak i Draft-Marrëveshjes së blerjes së aksioneve në lidhje me shitblerjen e Tirana International Airport (TIA), nga Real Fortress Private Limited tek shoqëria Kastrati Group SHA.

Në mbështetje të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Sekretariati i AK, ka realizuar konsultimin para njoftimit. Me shkresën nr. 405/1prot., datë 25.11.2020 , drejtuar shoqërisë Kastrati Group SHA, pala njoftuese është vënë në dijeni se transaksioni përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dhe si i tillë ai do të jetë objekt vlerësimi nga ana e Autoritetit të Konkurrencës.

Pala njoftuese, shoqëria Kastrati Group SHA, me shkresën nr.405/2 prot.,datë 02.12.2020, ka paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, “Marrëveshjen e blerjes së aksioneve në lidhje me shitblerjen e Tirana International Airport (TIA)”, nga Real Fortress Private Limited tek shoqëria Kastrati Group SHA.

Transaksioni i transferimit të XX% të kuotave të shoqërisë Tirana International Airport SHPK, nga Real Fortress Private Limited tek shoqëria Kastrati Group SHA, realizohet me anë të marrëveshjes për shitblerjen e kuotave të nënshkruar ndërmjet palëve më datë 01.12.2020.

Me anë të këtij transaksioni shoqëria Kastrati Group SHA do të përftojë kontrollin XX% mbi Tirana International Airport SHPK, duke shkaktuar ndryshim afatgjatë të cilësisë së kontrollit në këtë të fundit.

Në kuptim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 10, pika 1, shkronja b, ky transaksion i cili sjell përftimin e kontrollit XX% nga shoqëria Kastrati Group SHA në shoqërinë Tirana International Airport SHPK.

2. Palët në transaksion

Kastrati Group SHA përfiton kontrollin në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës nëpërmjet shoqërisë Real Fortress Private Limited.

2.1 Palët blerëse

Kastrati Group, në cilësinë e **Blerësit**, është një kompani e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Shqipërisë, zyra e regjistruar e së cilës ndodhet në adresën Ura e Dajlanit, Autostrada Durrës-Tiranë, km 1, Shkozet, Durrës, Shqipëri, e regjistruar me numrin: K21711502V. Objekti i shoqërisë është krijimi, instalimi dhe vënia në shfrytëzim sipas kushteve teknike të impianteve, stacioneve, reparteve, linjave për tregtimin e hidrokarbureve brenda e jashtë vendit; Import-eksport dhe tregti me shumicë e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikante, transporti kombëtar e ndërkombëtar i tyre; Import-eksport dhe tregti me shumicë e pakicë të teknologjisë dhe pjesëve të këmbimit për ushtrimin e veprimtarisë hidrokarbure, të automjeteve të transportit hidrokarbur, të kokave dhe cisternave, bote për to dhe për depozita stacionare të bombolave me ose pa mbushje gazi si dhe dhënien e asistencës teknike për to; Ndërtimin dhe vënien në përdorim të depove hidrokarbure, rezervuarëve të linjave dhe pikave të shitjes së tyre sipas projektit teknologjik; Import-eksport dhe tregti me shumicë e pakicë të artikujve industrial, bujqësore, blektorale, ushqimore, ndërtimore, elektroshtëpiake, audiovizive, elektrike, të makinerive për ndërtim; Ndërtimin e çdo godine, qendra biznesi, hotele, bar-restorante, magazina, parking, komplekse turistike, depo stacionare për karburante e nënprodukteve të tyre, ngritjen dhe vënien në shfrytëzim të poligoneve të ndërtimit për prodhimin e materialeve inerte të betoneve, penobetoneve dhe të çdo materiali ndërtimor parafabrikat; Ndërtime të impianteve të pastrimit të mbeturinave civile dhe industriale, për ngritjen dhe restaurimin e rrjetit bonifikues të vaditjes dhe kullimit, punime dhe kanalizime për rrjetet e jashtme dhe të brendshme të ujësjellësve e të çdo rrjeti tjetër të sistemit hidrik; Prodhim guri, punime çimentimi, injektive detare, shtrirje kabllorsh e tubacionesh nënujore; Ndërtimin e urave, rrugëve urbane e interurbane, asfaltimin e tyre; Kryerjen e veprave të artit, agjenci turistike, doganore, spedicionere, të transportit tokësor, detar e ajror civil, të pasagjerëve e mallrave; Hapjen e zyrave të projektimit dhe zbatimit, dhënien e asistencës teknike të supervizionit, të kolaudimit dhe të ekspertizës ndërtimore për nevojat e të tretëve; Ushtrimin e aktivitetit të grumbullimit, demolimit dhe shitblerjes së skrapit, hekurishteve dhe mbeturinave të tyre; Grumbullim, magazinim, përpunim, riciklim, transport dhe asgjësim mbetjeve të llojeve të ndryshme; Furnizim me karburant dhe lubrifikant për mjetet lundruese (detare), si dhe Jet-Oil për mjetet fluturuese ajrore.

2.2 Palët shitëse

Real Fortress Private Limited, në cilësinë e palës **Shitëse**, është një kompani e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Singaporit, zyra e regjistruar e së cilës ndodhet në adresën 61 Robinson Road, #16-02, Qendra Robinson, Singapor 068893, e regjistruar me numrin: 201617063G. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është holding për investime dhe shitblerje kompanish.

2.3 Ndërmarrja objekt përqendrimi

Tirana International Airport SHPK (TIA), në cilësinë e ndërmarrjes Target, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjisllacionit shqiptar me seli në adresën: Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë

Tereza”, Tiranë. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë përfshin projektimin, financimin, ndërtimin, vënien në punë, mirëmbajtjen, administrimin dhe zhvillimin e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, i cili përfshin ndër të tjera: marrjen në pronësi nga shoqëria e terminalit të ri, zyrave të reja të administrimit, qendrës së re të ngarkesave ajrore, pajisjeve të reja të karburantit, rrugës së re të hyrjes, urës së re, si dhe ushtrimin e uzufuktit nga shoqëria në lidhje me zonën e koncesionit, etj.

3. Xhiro për vitin 2019

Xhiro totale në tregun e brendshëm:

- Tirana International Airport SHPK XXXXX Lekë.
- Kastrati Group SHA XXXXX Lekë.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

4. Treg përkatës

Treg përkatës i produktit:

Në sektorin e shërbimeve aeroportuale identifikohen tre kategori të ndryshme shërbimesh:

- (i) Shërbimet e infrastrukturës aeroportuale që i ofrohen linjave ajrore;
- (ii) Shërbimet e asistencës në tokë (ground handling services) që përbëhen nga një grup shërbimesh të nevojshme dhe ndihmëse në lidhje me nisjet, uljet, qëndrimet në tokë të avionëve dhe ngarkesës së tyre;
- (iii) Shërbimet tregtare që përfshijnë ndër të tjera, administrimin e dyqaneve të shitjes së produkteve për publikun që ushtrohen nga subjekte të treta përfituese me anë të nën-koncesionit, administrimin e parkimeve dhe shitjen e hapësirave publicitare.

Treg përkatës të produktit në Shqipëri do të konsiderojmë shërbimet e infrastrukturës aeroportuale që i ofrohen linjave ajrore dhe shërbimet e asistencës në tokë, shërbime këto të ofruara nga TIA.

Tregu përkatës gjeografik: Për vlerësimin e këtij transaksioni, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

5. Efektet në treg pas përqendrimit

Transaksioni konsiston në një ndryshim kontrolli të Target. Blerësi është i pranishëm në tregun e brendshëm.

Transaksioni nuk do të ketë as mbivendosje horizontale, as vertikale midis ndërmarrjeve përkatëse, dhe për rrjedhojë nuk do të ketë as rritje të pjesës së tregut ose ndryshim të tregut përkatës pas realizimit të transaksionit.

Transaksioni nuk do të rezultojë në ndonjë rritje të pjesës së tregut, pasi TIA do të vazhdojë të drejtohet në përputhje me kushtet e Kontratës së Koncesionit, e cila përcakton qëllimin, metodën dhe bazën e shërbimeve që do të ofrohen.

Ndërmarrja objekt përqendrimi Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës, pasi ka ekskluzivitetin “de fakto” të fluturimeve ndërkombëtare drejt/nga Shqipëria dhe ekziston rreziku i abuzimit me pozitën dominuese sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Për këtë arsye, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës duhet të zbatojë kushte të barabarta për veprime të njëjta tregtare me palët që do të operojnë në këtë aeroport (shoqëritë ajrore përfshirë dhe ato me kosto të ulët (low cost)).

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Me shkresën e përbashkët të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 8416/3 prot., datë 4.12.2020 dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.22690/1 prot., datë 4.12.2020, protokolluar me tonën me nr. 405/8, datë 4.12.2020, organi shtetëror i autorizuar shpreh pëlqimin për këtë marrëveshje shitblerje, ku pala blerëse merr përsipër dhe angazhohet në të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në ligjin nr.9312, datë 11/11.2004 “Marrëveshja e koncesionit të Aeroportit”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, dhe nenin 56, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport (TIA) SHPK, nga Kastrati Group SHA.
2. Kastrati Group SHA, në cilësinë e shoqërisë blerëse duhet të respektojë nenin 9 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
3. Autoriteti i Konkurrencës do të monitorojë për një periudhë 1 (një) vjeçare sjelljen e ndërmarrjes në treg.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 756, Datë 16.12.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët Joint-Venture me funksione të plota nga shoqëria Daimler Truck AG dhe shoqëria Aktiebolaget Volvo”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.12.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët Joint-Venture me funksione të plota nga shoqëria Daimler Truck AG dhe shoqëria Aktiebolaget Volvo.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “ Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët Joint-Venture me funksione të plota nga shoqëria Daimler Truck AG dhe shoqëria Aktiebolaget Volvo,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar “Njoftim përqendrimi”, ku jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar që ka të bëjë me krijimin e një sipërmarrje të përbashkët Joint-Venture me funksion të plotë nga shoqëria Daimler Truck AG dhe shoqëria Aktiebolaget Volvo.

Referuar dokumentit “Dokumenti i Kushteve Daimler - Volvo”, datë 21 Prill 2020, “Marrëveshje Investimi” (Shtojca 1), datë 02 Nëntor 2020, dhe “Marrëveshje e Aksionarëve” (Shtojca 2) datë 02 Nëntor 2020, palët në marrëveshje janë:

Daimler Truck AG është një shoqëri e regjistruar në regjistrin e gjykatës lokale të Shtutgartit, Gjermani. Daimler Truck AG prodhon kamionë dhe autobusë. Daimler AG (shoqëria mëmë e Daimler Truck AG), është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit Gjerman. Daimler së bashku me filialet e saj, është një prodhues lider global i automjeteve luksoze për pasagjerë dhe tregtie me një prani të fortë në industrinë e automjeteve elektrike.

Aktiebolaget Volvo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Suedi.

Daimler Truck Fuel Cell GmbH & Co. KG është një ortakëri e kufizuar e themeluar në shtetin Gjerman dhe e regjistruar në Shtutgart.

DTFC Verwaltungsgesellschaft GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Shtutgart.

Shoqëria Joint Venture (Entiteti FC/ IP Holding), do të jetë një shoqëri e vendosur fillimisht në Gjermani [.....]. [.....]. Kjo sipërmarrje e përbashkët synon zhvillimin, prodhimin, shitjen dhe mirëmbajtjen e teknologjisë së baterive me lëndë djegëse për Kamionët e Tonazhit të Rëndë.

Palët në marrëveshje realizojnë të ardhura në Shqipëri nëpërmjet shitjes së automjeteve, përmes distributorëve të pavarur -palë të tretë, të markave Mercedes Benz, Smart EQ, Volvo, Renault etj.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar, “Dokumentit të Përcaktimit të Kushteve Daimler-Volvo, datë 21 Prill 2020, palët synojnë të krijojnë një bashkëpunim strategjik në lidhje me zhvillimin, prodhimin dhe shitjet dhe pas shitjeve të teknologjisë së baterive me lëndë djegëse në formën e sipërmarrjes së përbashkët, e cila do të jetë e vetëmjaftueshme nga ana operacionale, e pavarur dhe do të funksionojë si një entitet i pavarur. Për këtë arsye Volvo, qoftë vetë, ose përmes një filiali të Volvo-s, synon të bëhet mbajtësi i 50% të aksioneve të qoftë një filiali ekzistues ose të një filiali të ri të inkuorporuar të Daimler në të cilin [.....].[.....]. Pas investimit të Volvo, aksionet në Entitetin FC do të mbahen nga Daimler 50% dhe Volvo 50%.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i zhvillimit, prodhimit dhe shitjes të sistemeve të baterive me lëndë djegëse për kamionët, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar është krijimi i një shoqëri të përbashkëta Joint-Venture me funksione të plota nga shoqëria Daimler Truck AG dhe shoqëria Aktiebolaget Volvo.

Volvo nuk ka asnjë filial, degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri. Grupi Volvo është i pranishëm në Shqipëri vetëm indirekt, përmes pjesës kryesore të biznesit të tij – shitjes së kamionëve përmes një distributori të pavarur palë e tretë Daimler nuk ka asnjë filial, degë apo zyrë përfaqësuese në Shqipëri. Daimler AG është i pranishëm në Shqipëri vetëm në mënyrë indirekte, përmes pjesës kryesore të biznesit të tij – shitjes së automjeteve makinave, kamionëve dhe autobuzëve përmes një distributori të pavarur palë e tretë.

Target, shoqëria J-V, do të operojë në tregun e zhvillimit, prodhimit dhe shitjes të sistemeve të baterive me lëndë djegëse për kamionët. Target nuk operon në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët Joint-Venture me funksione të plota nga shoqëria Daimler Truck AG dhe shoqëria Aktiebolaget Volvo.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 758, Datë 28.12.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, nenet 53-64 dhe neni 73, pika 1, germa dh. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfimin e kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK.

Sipas kontratës së shitblerjes së kuotave të datës 06 mars 2020, palët në transaksion janë:

Pala Blerëse: ABCom SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar më datë 08.01.2001. Objekti i shoqërisë është të ideojë, zbatojë dhe të menaxhojë rrjete të telekomunikacionit dhe transmetimit të të dhënave dhe interkoneksionet në përgjithësi, të sigurojë shërbime audio dhe/ose audiovizive etj

Në kohën kur është nënshkruar marrëveshja, ABCom zotërohej nga American Broadband B.V, një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në shtetin e Holandës. Sot shoqëria ABCom SHPK zotërohet nga ortaku i saj i vetëm Vodafone Albania SHA.

Target: ApNet SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar më datë 10.03.2020. Objekti i shoqërisë është ofrimi i shërbimit të komunikimeve elektronike, kryesisht transmetime televizive kabllore dhe shërbime marketingu për palë të treta.

Pala Shitëse:

Shitësi 1: Intel Media SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i shoqërisë është shërbime në lidhje me turizmin, online marketing, programim dhe implementim që lidhet me produkte digjitale, ndërmjetësim ndërmjet klientëve dhe provider të moduleve

teknologjike të prenotimeve online. Shoqëria Intel Media SHPK është zotëruese e 15% të kapitalit të shoqërisë ApNet SHPK

Shitësi 2: Teeb-Center SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i shoqërisë është ofrimi i shërbimeve telefonike të lëvizshme dhe të palëvizshme në shkallë kombëtare, shërbime radioje, shërbime globale të komunikimeve, eksport, import të mallrave të ndryshme. Shoqëria Teeb-Center SHPK është zotëruese e 85% të kapitalit të shoqërisë ApNet SHPK.

Më datë 06 Mars 2020 është nënshkruar marrëveshje “Kontratë Shitblerje Kuotash” ndërmjet shoqërisë ABCom SHPK dhe shoqërive Intel Media SHPK dhe Teeb-Center SHPK.

Sipas kësaj marrëveshjeje, Shitësit janë pronarë të 2 kuotave, që përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë target tek shoqëria ABCom. Shitësit do të shesin 2 kuotat dhe pas datës së nënshkrimit Intel Media SHPK dhe Teeb-Center SHPK do të transferojnë 100% të titullit të pronësisë mbi kuotat bashkë me të gjitha të drejtat e tjera të votës dhe të drejtat e dividendit tek shoqëria ABCom SHPK.

Shoqëria ABCom SHPK do të përftojë kontroll të plotë mbi shoqërinë ApNet SHPK dhe duke qenë se ABCom SHPK zotërohet tashmë nga Vodafone Albania SHA, atëherë Vodafone Albania SHA do të përftojë kontroll indirekt mbi ApNet SHPK.

Njoftimi i përqendrimit është depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës jashtë afatit 30 ditor nga lidhja e marrëveshjes, e parashikuar në nenin 12 pika 2 e Ligjit dhe pala blerëse ka kryer kundërvajtje administrative e parashikuar në nenin 73, pika 1, germa dh) e Ligjit.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i transmetimeve televizive dhe treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK. Pas realizimit të përqendrimit, ApNet do të shndërrohet në filial të ABCom dhe për rrjedhojë do të bëhet pjesë e Vodafone Group.

Ndërmarrja ApNet është krijuar në mars të vitit 2020 dhe për rrjedhojë nuk ka realizuar të ardhura për vitin financiar 2019. Si pasojë, pjesa e kombinuar e tregut të shoqërisë ABCom pas përqendrimit nuk do të ndryshojë.

Tregu i prekur nga transaksioni është tregu i transmetimeve televizive. Referuar të ardhurave që ka realizuar ABCom SHPK nga aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2019, transmetimet televizive përbëjnë vetëm 28% të xhiros së ndërmarrjes dhe tregu i prekur nga transaksioni nuk do të ketë ndikim të ndjeshëm në aktivitetin e shoqërisë ABCom në tërësi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 56 pika 1 dhe neni 73, pika 1, germa dh të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK.
2. Vendosjen e gjobës mbi shoqërinë ABCom SHPK në masën 0.2 % e xhiros së vitit 2019 ose 3,986,270 (tre milion e nëntëdhjete e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 759, Datë 30.12.2020

“Mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.12.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Njoftimi i bashkimit me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e bashkimit me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA,

VËREN SE:

Procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA.

Më datë 15 Tetor 2020, shoqëria Vodafone Albania SHA (ortaku i vetëm i shoqërisë ABCom SHPK) dhe shoqëria ABCom SHPK kanë nënshkruar “Projekt Marrëveshjen e Bashkimit me Përthithje”. Sipas dokumentit “Raporti i Bashkimi me Përthithje i Shoqërive”, parashikohet se bashkimi i shoqërive nënkupton transferimin e të gjitha aktiveve dhe pasiveve nga shoqëria e përthithur tek shoqëria përthithëse. Vlerat e aktiveve dhe pasiveve do të saktësohen në pasqyrat financiare të 31 dhjetor 2020.

Shoqëria Vodafone Albania SHA fitoi kontrollin e vetëm të shoqërisë ABCom SHPK nëpërmjet dokumentit “Marrëveshja për Shitje dhe Blerje”, të datës 25 tetor 2019.

Transaksioni u njoftua pranë Autoritetit dhe iu nënshtrua procedurave të kontrollit të përqendrimeve të parashikuar në nenet 10; 12 dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Gjatë vlerësimit të efekteve të transaksionit, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se shoqëria Vodafone Albania SHA siguronte pjesën më të madhe të të ardhurave nga shërbimet e komunikimeve elektronike, zotëronte pozitë dominuese në tregun e komunikimeve elektronikë në rrjetin celular, kishte eksperiencë e saj dhe të grupit që përfaqësonte dhe transaksioni do të sillte impakt në tregun e komunikimeve elektronike, dhe kryesisht në tregun e komunikimeve në rrjetet fikse.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, autorizoi ndryshimin e kontrollit me kushtet dhe detyrimet si më poshtë:

a. Detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA të mos abuzojë më pozitën e saj dominuese nëpërmjet :

- (i.) Vendosjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve të padrejta të tregtimit dhe detyrimin e orientimit e tyre drejt kostos së shërbimeve,
- (ii.) Vendosjes së palëve në kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta, e të pafavorshme për konkurrencën,
- (iii.) Vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, ku këto të fundit të pranojnë detyrime shtese, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

b. Detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK, për ndarjen e llogarive ekonomike për shërbimet e telefonisë fikse dhe celulare, e cila do të bëjë të mundur evidentimin e burimit të gjenerimit të të ardhurave.

Për vlerësimin e zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të dhëna, Autoriteti është duke monitoruar sjelljen e shoqërive Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK në tregun e komunikimeve elektronike.

Transaksioni i njoftuar, mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga Vodafone Albania SHA, nuk konsiston në një ndryshim kontrolli sipas parashikimeve të nenit 10 të ligjit nr 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dhe për këto arsye nuk kërkon autorizimin nga Komisioni i Konkurrencës.

Por, shoqëritë Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK mbartin detyrime të përcaktuara nga Vendimi nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA” dhe transaksioni i bashkimit me përthithje do të ndikojë në zbatimin e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39 e Ligjit 9121/2003 dhe nenit 20 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, në datë 23.12.2020 organizoi një seancë dëgjimore me palët në marrëveshjen e bashkimit me përthithje.

Gjatë seancës dëgjimore, shoqëria Vodafone Albania SHA mori angazhimin për zbatimin e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në Vendimi nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA” edhe pas përthithjes së shoqërisë ABCom SHPK.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mos klasifikimin si përqendrim të bashkimit me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA.
2. Detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA për zbatimin e pikës 1, germa a) të vendimit Nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”.
3. Detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA për marrjen përsipër të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që do të lindin nga procedura e bashkimit me përthithje.
4. Vazhdimin e periudhës së monitorit të veprimtarisë së shoqërisë Vodafone Albania SHA deri në 31 dhjetor 2021.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIME TË TJERA

VENDIM

Nr. 677, Datë 13.02.2020

“Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.02.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Miratimin e Raportit Vjetor të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe (e), neni 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës dhe Draft Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020,

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka depozituar Draft-Raportin Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe (e), neni 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 688, Datë 06.04.2020

“Për shtyrjen e afateve të gjitha procedurave hetimore në proces nga Autoriteti i Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.04.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për shtyrjen e afateve të gjitha procedurave hetimore në proces nga Autoriteti i Konkurrencës.

Baza ligjore: Neni 4 dhe 9, Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 41, 42, 43 dhe 44 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Urdhri nr. 132, datë 08.03.2020, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, në kuadër të masave parandaluese për përhapjen e COVID-19.

Komisioni i Konkurrencës, në vijim të rrethanave të krijuara për shkak të masave parandaluese të ndërmarra nga Qeveria për shkak të COVID-19, afati për dorëzimin e informacionit do të shtyhet deri në një vendim të dytë.

VËREN SE:

1. Për shkak të situatës epidemike të krijuar nga përhapja e epidemisë së COVID-19 dhe vështirësisë së krijuar në mbledhjen e informacionit dhe procedurave të hetimit nga zbatimi i masave të ndërmarra nga Qeveria nëpërmjet Urdhrit nr. 132, datë 08.03.2020, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, në kuadër të masave parandaluese për përhapjen e COVID-19.
2. Për të mos penguar mbledhjen e informacionit sasior dhe cilësor si nga ndërmarrjet private ashtu edhe nga institucionet shtetërore, Komisioni i Konkurrencës e ka vlerësuar si të arsyeshme që periudhat hetimore të shtyhen deri në një vendim i dytë që do të jetë në vijim të masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së COVID-19.
3. Ky vendim ka për efekt afatet kohore të procedurave hetimore dhe nuk pengon vijimin e punës nga Autoriteti i Konkurrencës dhe as inspektimet e befasishme apo analizat në vlerësimin e informacioneve të grumbulluara.
4. Procedurat e vlerësimit të përqendrimeve nuk ndryshojnë në afatet e shqyrtimit të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 41, 42, 43 dhe 44 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Urdhrit nr. 132, datë

08.03.2020, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatave të gjitha procedurave hetimore në proces nga Autoriteti i Konkurrencës.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 701, Datë 30.07.2020

“Për mos klasifikimin si përqendrim të transferimit të veprimtarisë ekonomike të degëve të shoqërive HIPPO Markets tek shoqëria SPAR Albania Shpk”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.07.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mos klasifikimi si përqendrim i transferimit të veprimtarisë ekonomike të degëve të shoqërive HIPPO Markets tek shoqëria SPAR Albania Shpk.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari të plotë të njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve dhe informacionit mbi transaksionin mes shoqërive HIPPO Markets dhe shoqërisë SPAR Albania Shpk,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me transferimin e veprimtarisë ekonomike të degëve të shoqërive HIPPO Markets (shtatë prej pikave) tek shoqëria SPAR Albania Shpk

Pala Shitëse: HIPPO MARKETS është një rrjet supermarketesh i themeluar në Shqipëri në nëntor të vitit 2015. Pjesë e rrjetit HIPPO Markets janë shtatë supermarkete, të cilat ofrojnë një gamë të gjerë artikujsh për klientët e tyre. Këtu përfshihen artikujt ushqimorë dhe jo-ushqimorë, produktet e enëve të kuzhinës dhe produktet kozmetike. Të gjitha supermarketet ndodhen në Tiranë dhe secila prej tyre operon si njësi e veçantë ekonomike-ligjore, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, si më poshtë: *Meleon Tirana Shpk, Meleon Shpk, HIPPO Shpk, XL Market Shpk, MAXI HIPPO Shpk, HIPPO STUDENTI Shpk* dhe *Hippo Tregu Elektrik Shpk*,

Pala Blerëse: SPAR ALBANIA SHPK (“SPAR AL”) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjisllacionit shqiptar, e cila zotërohet 100% të kapitalit prej shoqërisë Balfin SHPK. SPAR AL nuk zotëron kontroll në asnjë shoqëri tjetër dhe ka për objekt aktiviteti shitjen me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, produkte për kafshë etj., nëpërmjet ngritjes dhe administrimit të marketeve, supermarketve dhe hipermarketeve “SPAR” në Shqipëri dhe jashtë saj. Gjithashtu në aktivitetin e SPAR AL përfshihet import-eksport dhe prodhim i produkteve jo-ushqimore, stokimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore, transport i mallrave dhe udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit etj.

Vlerësimi i përqendrimit

Më datë 01 Tetor 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe MELEON TIRANA Shpk nga ana tjetër. Më datë 09 Shtator 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe Meleon Shpk nga ana tjetër. Më datë 12 Shtator 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe XL Market Shpk nga ana tjetër. Më datë 15 Gusht 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe HIPPO Shpk nga ana tjetër. Më datë 09 Shtator 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe MAXI HIPPO Shpk nga ana tjetër. Më datë 25 Shtator 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe HIPPO STUDENTI Shpk nga ana tjetër. Më datë 04 Shtator 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe HIPPO TREGU ELEKTRIK Shpk nga ana tjetër.

Marrëveshjet e depozituara konsistojnë në transferimin e veprimtarisë së degës së ndërmarrjes të përbërë nga zërat aktiv dhe pasiv të bilancit të shtatë shoqërive, duke përfshirë: asetet e përdorura nga transferuesi për ushtrimin e aktivitetit të tij ekonomik; mallrat e ambalazhet gjendje në magazinë në datën efektive; punonjësit operacional të punësuar efektivisht në datën efektive dhe kontratat përkatëse të punës. Shoqëritë që transferohen do të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas transferimit dhe nuk do të kenë ndryshim të strukturës së pronësisë. Veprimtaritë ekonomike që do të transferohen, do të veprojnë dhe funksionojnë si njësi autonome, pra të pavarura nga shoqëritë nga të cilat do të shpëputen. Dega e ndërmarrjes do të transferohet e lirë nga çdo barrë dhe detyrim shoqërisë SPAR AI, përveç detyrimeve të përcaktuara posaçërisht në Marrëveshjet përkatëse.

Mbështetur në nenin 10 të Ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe pikës 14, 16 dhe 20 të Udhëzimit “Mbi Kontrollin e Përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, miratuar me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.236, datë 19.07.2012, këto marrëveshje do të sjellin një situatë kontrolli në treg edhe pse nuk kanë për pasojë marrjen e kontrollit të pronësisë të shoqërive palë në marrëveshje.

Për vlerësimin e një situate të tillë, Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet Rrjetit Rajonal të Konkurrencës, bëri një Kërkesë Informale për Informacion (RFI) në të cilin u parashtrua objekti i marrëveshjeve të depozituara nga shoqëria Spar Albania SHPK dhe iu kërkuar autoriteteve të konkurrencës së rrjetit, vlerësimi i përqendrimeve sipas legjislacionit kombëtar si dhe qëndrimin e tyre ndaj këtij rasti.

Komisioni, për vlerësimin e transaksionit të transferimit të veprimtarisë ekonomike të marketeve Hippo tek SPAR AI, iu referua:

- Rastit M.7940 (NETTO / Grocery Store at Armitage Avenue Little Hulton) i KE, ndodhur midis dy shoqërive që operonin në tregun e shitjes me pakicë në UK. Transaksioni konsistonte në shitjen e objekteve të shitjes, bosh, nga shitësi tek blerësi së bashku me licencën për shitjen e pijeve alkoolike. Komisioni, mbështetur në Rregulloren 139/2004 të KE vendosi që transaksioni i njoftuar nuk përbënte përqendrim.
- Rastit No. 1163/2019 Maxima Bulgaria Ltd./11 dyqane, në Bullgari, i cili konsistonte në lidhjen e kontratave afatgjate të qerasë me 11 dyqane, ku qiramarrësi do të përdore asetet e shoqërive dhe markën. Në përfundim të vlerësimin, Komisioni Bullgar i Konkurrencës nuk e klasifikoi si përqendrim transaksionin e njoftuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mos klasifikimin si përqendrim të transferimit të veprimtarisë ekonomike të degëve të shoqërive HIPPO Markets tek shoqëria SPAR Albania Shpk.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 709, Datë 23.09.2020

“Për mos klasifikimin si përqendrim të transferimit të kuotave të shoqërisë Tranzit SHPK nga shoqëria “NCH Balkan Fund, L.P” dhe “New Century Holdings XI, L.P” tek Z.Andi Ballta”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.09.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mos klasifikimi si përqendrim i transferimit të kuotave të shoqërisë Tranzit SHPK nga shoqëria “NCH Balkan Fund, L.P” dhe “New Century Holdings XI, L.P” tek Z. Andi Ballta.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

Transaksioni

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me transferimin e kuotave të shoqërisë Tranzit SHPK nga shoqëria “NCH Balkan Fund, L.P” dhe “New Century Holdings XI, L.P” tek Z. Andi Ballta.

Pala blerëse: Z. Andi Ballta, është person fizik dhe ortak i shoqërisë Tranzit SHPK.

Pala shitëse:

- Shoqëria “NCH Balkan Fund, L.P.”, një partnership i kufizuar, i regjistruar në Ishujt Kajman.
- Shoqëria “New Century Holdings XI, L.P.”, një partnership i kufizuar, i regjistruar në Ishujt Kajman.

Shoqëri Target: Tranzit SHPK është një shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërisë është tu ofrojë kredi personave fizikë dhe juridikë, faktoringu, qiraja financiare (leasing), këshillimi dhe shërbime ndërmjetësimi. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të lidhur drejtpërdrejt ose indirekt, që vjen si pasojë ose është e lidhur me veprimtarinë e mësipërme.

Vlerësimi i transaksionit

Shoqëria Tranzit SHPK është krijuar në datë 30.03.2009 nga ortakët themelues shoqëritë NCH Balkan Fund, L.P dhe New Century Holdings XI, L.P me pjesë të barabartë të kapitalit të shoqërisë.

Më datë 03 Nëntor 2014 është nënshkruar “Marrëveshja Shitblerje Kuotash” ndërmjet:

Pala blerëse: Z. Andi Ballta

Pala shitëse:

- Shoqëria “NCH Balkan Fund, L.P
- Shoqëria “New Century Holdings XI, L.P

Sipas kësaj marrëveshjeje të dy fondet e investimeve shitën nga 10% të kapitalit të shoqërisë Tranzit SHPK tek Z.Andi Ballta dhe pas marrëveshjes, shoqëria NCH Balkan Fund, L.P. zotëronte 40% të kapitalit, shoqëria New Century Holdings XI, L.P. 40% të kapitalit dhe Z. Andi Ballta 20% të kapitalit. Sipas nenit 3.02 B, të kësaj marrëveshjeje, Asambleja e Ortakëve ka parashikuar në mënyrë të posaçme se deri në momentin kur palët të jenë ortakë të kësaj shoqërie, kontrolli në shoqëri do të ushtrohet nga të tre ortakët dhe asnjë prej vendimeve nuk do të bëhet efektiv pa votën pro të tre ortakëve, pra vendimmarrja në shoqëri do të bëhet me unanimitet.

Me datë 07 Qershor 2016 sipas “Vendimit të mbledhjes së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë Tranzit SHPK”, nga ekstrakt-i i QKB- se, ka ndryshuar organizimi i shoqërisë. Ortaku “NCH Balkan Fund, L.P.” zotëronte 1 kuotë, që përfaqëson 35% të kapitalit të shoqërisë, ortaku “New Century Holdings XI, L.P.” zotëronte 1 kuotë, që përfaqëson 35% të kapitalit të shoqërisë dhe ortaku Z. Andi Ballta zotëronte 1 kuotë, që përfaqëson 30% të kapitalit të shoqërisë.

Me datë 11 Dhjetor 2019 është nënshkruar “Marrëveshja Kuadër” ndërmjet:

Pala blerëse: Z. Andi Ballta

Pala shitëse:

- Shoqëria “NCH Balkan Fund, L.P
- Shoqëria “New Century Holdings XI, L.P

Sipas nenit 2, pika 8.1;8.2;8.3 të kësaj marrëveshjeje, ortaku “NCH Balkan Fund, L.P.” zotëron 1 kuotë, që përfaqëson 10 % të kapitalit të shoqërisë, ortaku “New Century Holdings XI, L.P.” zotëron 1 kuotë, që përfaqëson 10% të kapitalit të shoqërisë dhe ortaku Z.Andi Ballta zotëron 1 kuotë, që përfaqëson 80% të kapitalit të shoqërisë. Struktura e shoqërisë mbetet e njëjtë, secili nga ortakët zotëron 1 kuote. Kjo marrëveshje, nuk prek dispozitat e Nenit 3.02 B të “Marrëveshjes Shitblerje Kuotash” të nënshkruar më datë 03 Nëntor 2014, ku palët kanë rënë dakord që vendimet kryesore që kanë të bëjmë me drejtimin, organizimin dhe anën financiare të shoqërisë të merren me unanimitet.

Për sa më sipër, vlerësojmë se marrëveshja e njoftuar nuk plotëson kriteret e nenit 10 të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Gjithashtu në zbatim të udhëzimit ”Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, Përfitimi i Kontrollit, pika 12, jemi para rastit që nuk përfitohet kontroll për të ushtruar influencë vendimmarrje në veprimtarinë e shoqërisë Tranzit SHPK.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mos klasifikimin si përqendrim i transferimit të kuotave të shoqërisë Tranzit SHPK nga shoqëria “NCH Balkan Fund, L.P” dhe “New Century Holdings XI, L.P” tek Z. Andi Ballta.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 714, Datë 15.10.2020

“Për mos klasifikimin si përqendrim të transaksionit lidhur me ndryshimin e strukturës së tërthortë të pronësisë së shoqërisë One Telecommunications SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mos klasifikimi si përqendrim i transaksionit lidhur me ndryshimin e strukturës së tërthortë të pronësisë së shoqërisë One Telecommunications SHA.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

Transaksioni

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me ndryshimin e strukturës së tërthortë të pronësisë së shoqërisë One Telecommunications SHA.

- *ATI Albanian Telecom Invest Limited* (ATI Limited) është një shoqëri aksionare me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Qipros, me përfitues fundor Z. Spas Roussev, e cila është krijuar me qëllim për të krijuar e vetme ose në bashkëpunim me të tjerë në çdo vend të botës biznesin e një shoqërie investimesh, etj.
- *Albania Telecom Invest AD* (ATI) është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Bullgarisë, me objekt aktiviteti: investime dhe aktivitete në fushën e telekomunikacioneve si dhe çdo aktivitet tjetër që nuk ndalohet nga legjislacioni i Republikës së Bullgarisë. Shoqëria zotërohet 100% nga ATI Albanian Telecom Invest Limited.
- RSC Investments B.V është një shoqëri e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Holandës me aksionar të vetëm shoqërinë bullgare River Styxx Capital EAD (RSC EAD), ku kjo e fundit kontrollohet 100% nga Z. Elvin Guri. Emri i shoqërisë RSC Investments B.V është ndryshuar dhe në vijim është Guri Enterprises B.V.
- Z. *Atanas Dobrev*, është person fizik me shtetësi Bullgare, lindur në Varna, Bullgari, me nr.ID 385232769.

Palët në marrëveshje nuk janë aktive në tregun shqiptar por realizojnë të ardhura në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë One Telecommunications SHA.

- *One Telecommunications SHA* është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ndërtimin, zotërimin, operimin dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standartit GSM, të ofrojë shërbimin e roamingut ndërkombëtar, etj. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme datë 22 Korrik 2020 është miratuar implementimi i emrit të shoqërisë nga Telecom Albania SHA në One Telecommunications SHA.

Me Vendimin nr. 610, datë 10.04.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD”, Komisioni i Konkurrencës autorizoi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD në Bullgari.

Vlerësimi i transaksionit

Sipas informacionit të depozituar me shkresën Nr.339, datë 21.09.2020, (i) një marrëveshje e datës 31.07.2020 ndërmjet Z. Atanas Dobrev dhe Z. Spas Roussev dhe (ii) një marrëveshje të lidhur midis palëve Z. Anastas Dobrev dhe River Styxx Capital EAD, do të ndodhin ndryshime në kuotat e shoqërive si më poshtë:

Në muajin Mars 2020, lidhet marrëveshje mes River Styxx Capital EAD dhe Albanian Telecom Invest Limited, nëpërmjet të cilës River Styxx Capital EAD ka përfituar 289 Aksione të Klasës A që përfaqësojnë 16.07% të të drejtave të votës në ATI Limited ose (20.50% të aksioneve),

Po në muajin Mars 2020, me marrëveshje, Z. Atanas Dobrev ka përfituar 597 Aksione të Klasës A që përfaqësojnë 33.20% të të drejtave të votës në ATI Albanian Telecom Invest Limited. Pas shitjes së aksioneve, Z. Spas Roussev do të mbajë 114 aksione të klasës B që përfaqësojnë 50.72% të të drejtave të votës në Albanian Telecom Invest Limited duke zotëruar kontrollin e shoqërisë. Pas dy marrëveshjeve, e drejta e votës në shoqëri do të ndahet 16.07% nga River Styxx Capital EAD; 33.2% nga Z. Atanas Dobrev dhe 50.72% nga Z. Spas Roussev.

Më datë 31.07.2020, në Sofje, ndërmjet Z. Atanas Dobrev dhe Z. Spas Roussev lidhet marrëveshja e shitblerjes me objekt shkëmbim asetesh sipas kuotave, opsioneve dhe huave të përshkruara në këtë marrëveshje. Kjo marrëveshje do të rregullohet sipas ligjit Bullgar.

Gjithashtu Z. Atanas Dobrev, nuk ka aktivitet tjetër ekonomik ose të kontrollojë të paktën një ndërmarrje tjetër sipas nenit 10, pika 1/b “Përqendrimi i Ndërmarrjeve” të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Transaksionet e shitblerjes së aksioneve tek shoqëria Albanian Telecom Invest Limited nuk kanë ndikuar në kontrollin e shoqërisë Albania Telecom Invest AD e cila vazhdon të mbahet nga Z. Spas Roussev dhe Guri Enterprises BV.

Bazuar në transaksionet e mësipërme Z. Elvin Guri do të kontrollojë në mënyrë indirekte 54.2% të aksioneve në Albania Telecom Invest AD përmes Guri Enterprises BV (35%) dhe pjesëmarrjes së River Styxx Capital EAD në ATI Albanian Telecom Invest Limited (19.2%), ndërsa Z. Atanas Dobrev do të kontrollojë në mënyrë indirekte 45.8% përmes ATI Albanian Telecom Invest Limited.

Kontrolli mbi Albania Telecom Invest AD dhe aktualisht mbi shoqërinë target One Telecommunications SHA do të vazhdojë të ushtrohet bashkërisht nga ATI Albanian Telecom Invest Limited dhe Guri Enterprises BV.

Për sa më sipër, vlerësojmë se transaksioni i njoftuar nuk plotëson kriteret e nenit 10 të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Gjithashtu në zbatim të udhëzimit ”Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 4 “Koncepti i përqendrimit” dhe pika 1.6, “Ristrukturimi i brendshëm”, jemi para rastit ku ky transaksion nuk përbën një ndryshim të qëndrueshëm kontrolli.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mos klasifikimin si përqendrim të transaksionin lidhur me ndryshimin e strukturës së tërthortë të pronësisë së shoqërisë One Telecommunications SHA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 757, Datë 16.12.2020

“Mbi miratimin e Strategjisë së Advokacisë të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.12.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Miratimin e Strategjisë së Advokacisë së Konkurrencës.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d) dhe neni 26.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës dhe Draft Strategjisë së Advokacisë së Konkurrencës, për gatitur nga projekti "Ndërtimi i kapaciteteve për Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës", i financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,

VËREN SE:

1. Strategjia e Advokacisë së Konkurrencës ka për objekt pasqyrimin e të gjitha përpjekjeve dhe nismave të ndërmarra nga Autoriteti i Konkurrencës në lidhje me promovimin e një mjedisi konkurrues, duke bashkëpunuar ngushtësisht me të gjitha institucionet shtetërore si dhe nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit të publikut dhe komunitetit të biznesit lidhur me përftimet që sjell një konkurrencë e lirë dhe efektive në treg.
2. Strategjia e Advokacisë së Konkurrencës synon të përcaktojë dhe përmirësojë përpjekjet e institucionit lidhur me advokacinë e konkurrencës përkundrejt të gjithë aktorëve në treg, si konsumatorët, komuniteti i biznesit, institucionet shtetërore etj.
3. Strategjia e Advokacisë përmban rekomandime për të përmirësuar efikasitetin e punës advokuese të Autoritetit të Konkurrencës, duke përforcuar, nga njëra anë, rolin advokues të institucionit dhe nga ana tjetër, strategjinë e komunikimit, në drejtim të një grupi të larmishëm të palëve të synuar të interesit.
4. Strategjia ka identifikuar disa fusha kryesore ku duhet vepruar, ku secila ka një objektiv të gjerë dhe përfshin të paktën një veprimtari të rekomanduar.
5. Lidhur me fushën “*Forcimi i Rolit Advokues të Autoritetit të Konkurrencës*”, rëndësi duhet ti kushtohet përmirësimit të kulturës së konkurrencës në vend, rritjes së ndërgjegjësimit të palëve kryesore të interesit mbi përftimet e konkurrencës, ndërveprimit të intensifikuar me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit, marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe entet rregullatore, planifikimit të hollësishëm të aktiviteteve të advokacisë brenda institucionit, monitorimit dhe vlerësimit ex-post të veprimtarive të advokacisë etj.
6. Lidhur me fushën “*Forcimi i Strategjisë së Komunikimit të Autoritetit të Konkurrencës*” rëndësi duhet ti kushtohet mjeteve dhe përmbajtjes që duhet të këtë komunikimi, të shfrytëzohen kanalet e duhura të komunikimit, monitorimi i efikasitetit të strategjisë së komunikimit etj.

7. Strategjia e Advokacisë është hartuar nga projekti "Ndërtimi i kapaciteteve për Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës", i financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, duke synuar fuqizimin e rolit të advokacisë që ushtron AK në vend si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionalizmit të stafit të institucionit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e "Strategjisë së Advokacisë së Konkurrencës", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

AKTE TË MIRATUARA NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PKIE - 2020

VENDIM

Nr. 678, Datë 13.02.2020

“Mbi miratimin e Udhëzimit “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.02.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzimit “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Udhëzimi parashikon rregulla praktike mbi procedurat e Autoritetit të Konkurrencës, duke synuar dhe siguruar një zbatim efektiv të rregullave të konkurrencës dhe njëkohësisht respektimin e të drejtave themelore të mbrojtjes.
2. Udhëzimi përcakton parimet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës duke parasysh parimet e ligjshmërisë, transparencës, të drejtës së informimit, konfidencialitetit, proporcionalitetit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, jo-diskriminimit, të përcaktuara në ligjin nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative.
3. Udhëzimi parashikon rregulla praktike mbi procedurat e Autoritetit të Konkurrencës..

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzimit “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar””.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 683, Datë 18.03.2020

“Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.03.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Udhëzuesi është përshtatur duke u përafuar me Direktivën e Komisionit Evropian 2002/77/ EC e 16 shtatorit 2002 “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”.²⁶
2. Udhëzuesi synon të kontribuojë në zhvillimin e tregut në sektorin e komunikimeve elektronike, ndër të tjera duke zhvilluar një praktikë rregulluese të qëndrueshme dhe një zbatim të qëndrueshëm të kuadrit ligjor.
3. Udhëzuesi ka për qëllim që të sigurojë se çdo ndërmarrje ka të drejtën e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike ose të shtrirjes së rrjeteve të komunikimit elektronik pa pasur kufizime.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar,

VENDOSI:

Miratimin e Udhëzuesit “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

²⁶ Commission Directive 2002/77/EC of 16 September 2002 on competition in the markets for electronic communications networks and services. Official Journal of the European Communities, 17.9.2002, L 249/21

VENDIM
Nr. 694, Datë 15.05.2020

“Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi konfidencialitetin dhe aksesin në dosje””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.05.202, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi konfidencialitetin dhe aksesin në Dosje”

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. E drejta për të patur akses në dosjen hetimore ka shumë rëndësi për ndërmarrjet nën hetim, sepse ju jep atyre mundësinë për të përgatitur pretendimet dhe mbrojtjen e tyre. E drejta e aksesit është e lidhur ngushtë me të drejtën për t’u dëgjuar.
2. Ruajtja dhe mbrojtja e informacionit konfidencial të depozituar gjatë procedurave hetimore, mbron interesin legjitim të ndërmarrjeve nën hetim dhe në këtë mënyrë edhe konkurrencën e lirë dhe efektive, sepse ju kufizon konkurrentëve, aksesin në informacione sensitive të tilla si sekretet e buiznesit.
3. Udhëzimi trajton çështjet kryesore në lidhje me konfidencialitetin dhe aksesin në dosje, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë të BE. Qëllimi i këtij udhëzimi është sqarimi i koncepteve të lidhura me konfidencialitetin dhe të drejtën e aksesit në dosje dhe procedurat që ndiqen sipas parashikimeve ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzuesit “Mbi konfidencialitetin dhe aksesin në dosje”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

AKTE TË TJERA TË MIRATUARA NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 9121/2003 “PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS”, I NDRYSHUAR

**VENDIM
Nr. 697, Datë 30.06.2020**

“Mbi miratimin e Udhëzuesit “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.06.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzuesit “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja dh), të Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Udhëzuesi synon të adresojë aspekte shumë të rëndësishme të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, që lidhen me të drejtën për të kryer hetime, për të vendosur sanksione administrative, për të ofruar siguri ligjore dhe garanci për ndërmarrjet nën hetim dhe palët e treta, për të garantuar zbatueshmërinë e Programit të Lehtësimit nga Gjobat etj.
2. Udhëzuesi ofron sigurinë se Autoriteti i Konkurrencës ka të gjitha mjetet e duhura për zbatimin e ligjit të konkurrencës, duke ofruar garanci dhe standarde, edhe për palët e treta, pjesë e procedurave të Autoritetit të Konkurrencës.
3. Autoriteti i Konkurrencës merr vendime plotësisht të pavarura dhe ka mjetet e duhura në dispozicion të institucionit për të ndaluar dhe sanksionuar shkeljet anti-konkurrenciale në fushën e konkurrencës.
4. Kuadri ligjor i jep Autoritetit të Konkurrencës të gjitha mjetet e përshtatshme për të vendosur sanksione proporcionale dhe parandaluese për shkeljen e rregullave sipas neneve 4 dhe 9 të ligjit.
5. Në kuadër të Programit të Lehtësimit nga Gjobat, që inkurajon ndërmarrjet të paraqesin prova lidhur me zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara të paligjshme, nxiten ndërmarrjet të jenë pjesë e këtij programi duke raportuar pjesëmarrjen e tyre në një marrëveshje të ndaluar.
6. Udhëzuesi nënvizon rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave themelore të ndërmarrjeve dhe kërkon që Autoriteti i Konkurrencës të respektojë këto parime gjatë ushtrimit të kompetencave.
7. Udhëzuesi është hartuar duke përshtatur dhe përfaruar Direktivën e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit 2019/1 të datës 11 Dhjetor 2018 “Për fuqizimin e Autoriteteve të Konkurrencës të Shteteve Anëtare të jenë

zbatues më efektiv dhe të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut të brendshëm (PE/42/2018/REV/1), një direktivë e re në fushën e konkurrencës, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2019.

8. Për këtë arsye, do të lihet një periudhë e caktuar kohore 6 (gjashtë) mujore, para se udhëzuesi të hyjë në fuqi, me qëllim që të gjitha palët e interesuara të njihen me parashikimet e këtij udhëzuesi.
9. Kapitulli VII “Asistenca e Përbashkët” dhe Kapitulli VIII “Periudhat e Kufizimit”, duke qenë se kanë të bëjnë me bashkëpunimin midis autoriteteve homologe të konkurrencës të Shteteve Anëtare të BE-së, do të hyjnë në fuqi dhe do të zbatohen kur Shqipëria të jetë anëtare me të drejta të plota në Bashkimin Evropian.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh), të Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzuesit “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës””, i ndryshuar dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”.
2. Kapitulli VII “Asistenca e Përbashkët” dhe Kapitulli VIII “Periudhat e Kufizimit”, do të hyjnë në fuqi dhe do të zbatohen kur Shqipëria të jetë anëtare me të drejta të plota në Bashkimin Evropian.
3. Udhëzuesi “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, do të hyjë në fuqi në 31 Dhjetor 2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS